



# KUVENDI

Nr. 22, 2024



- "SHQIPËRIA 2030 NË BE  
- RRUGA E REFORMAVE"
- ÇELI PUNIMET SESIONI I SHTATË  
I LEGJISLATURËS X  
TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË
- PANORAMË E DISA PROBLEMEVE  
TË INTEGRIMIT NË BE DHE NË EUROZONË
- LIGJI DHE MASAT POZITIVE  
SI DOMOSDOSHMËRI  
PËR PARANDALIMIN E DISKRIMINIMIT
- SHOQËRIA SHQIPTARE DHE DEPRESIONI  
I TEKNOLOGJISË DIGJITALE



# Përmbajtja

Nr. 22, 2024

■ NË VEND TË EDITORIALIT .....	3	■ Ligji dhe masat pozitive si domosdoshmëri për parandalimin e diskriminimit .....	55
■ Kuvendi i Shqipërisë organizoi takimin e nivelit të lartë “Shqipëria 2030 në BE - Rruga e reformave” .....	6	<i>Nga Aurela ANASTASI</i>	
<b>JETË PARLAMENTARE</b>			
■ Çeli punimet sesioni i shtatë i Legjislaturës X të Kuvendit .....	10	■ Shoqëria shqiptare dhe depresioni i teknologjisë digjitale.....	64
■ Znj. Elisa Spiropali zgjidhet Kryetare e Kuvendit .....	12	<i>Nga Gëzim Tushi</i>	
■ U mbajt takimi i 18-të i Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit BE-Shqipëri .....	15	■ Jehona e proceseve demokratike në Slloveni të shqiptarët në vitet 1989-1991.....	74
■ Prezantohet Kodi i Sjelljes dhe Plani i Integritetit për administratën e Kuvendit të Shqipërisë .....	17	<i>Nga Zeqirja REXHEPI</i>	
■ Administrata parlamentare dhe besimi publik, rëndësia e reformave etike .....	18	■ Legjislacioni evropian për rregullimin e shpifjes ....	84
<b>NË FOKUS</b>			
■ Reforma zgjedhore .....	21	<i>Nga Diana KALAJA</i>	
<b>STUDIME BASHKËKOHORE</b>			
■ Panoramë e disa problemeve të integritetit në BE dhe në Eurozonë .....	44	■ Depistimi i HPV-së dhe roli i ndërgjegjësimit në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës .....	90
<i>Nga Leontiev Çuçi</i>		<i>Nga Elona GJEBREA (HOXHA)</i>	
		■ Roli i Anselmo Lorekios në mendimin politik të Rilindjes Kombëtare shqiptare .....	98
		<i>Nga Valentina Duka</i>	
		<b>AKTIVITETE .....</b>	<b>102</b>

## Bordi i revistës:

Akademike Aurela ANASTASI  
Prof. dr. Artur RIBAJ  
Dr. Ejona ISUFAJ  
Dr. Elona GJEBREA  
Sociolog Gëzim TUSHI

Prof. asoc. dr. Leontiev ÇUÇI  
Prof. asoc. dr. Përparim KABO  
Prof. asoc. dr. Teki KURTI  
Prof. dr. Valentina DUKA

Me synimin që revista të shërbejë si një platformë gjithëpërfshirëse, në të do të zënë vend shkrime në të cilat ballafaqohen ide e alternativa të ndryshme. Publikimi i tyre nuk shpreh qëndrimin, pikëpamjet dhe politikën e Kuvendit të Shqipërisë.

Revista “Kuvendi”  
përgatitet  
nga Shërbimi i Botimeve dhe Bibliotekës Parlamentare,  
pjesë e Institutit Parlamentar

## ■ Në vend të editorialit

# Çdo fëmijë lind në këtë botë me dritë, me dëshirën për jetën

(Fjala e Kryetares së Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, në mbledhjen e Grupit të Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” më 20 nëntor 2024)



Përshëndetje të gjithëve dhe mirë se keni ardhur në takimin e Grupit “Miqtë e Fëmijëve”!

Siç e shihni, ky është një takim shumë i gjerë, që dëshmon për karakterin gjithëpërfshirës të kujdesit për zhvillimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, besoj se flas edhe për ju kur them se jemi të gjithë të tronditur nga ngjarja e rëndë e para pak ditëve, ku një 14-vjeçar humbi jetën nga një krim i moshatarit të tij. Siç e nënvizova edhe në seancën plenare, është detyra jonë të reagojmë dhe të bëjmë rregullime dhe ligje më të forta kundër

dhunës, gjuhës së urrejtjes, denigrimit dhe abuzimit në rrjetet sociale, por dhe të tregojmë më shumë përkushtim e përgjegjshmëri në zbatimin e ligjeve për sigurinë, për cilësinë e arsimit dhe të edukimit, për modelet që u ofrohen fëmijëve në medie dhe në mjediset shoqërore.

Çdo fëmijë lind në këtë botë me dritë, me dëshirën për jetën, me një ndjenjë pafajësie, me mundësi e potenciale për zhvillimin e personalitetit të tij.

Mund ta imagjinojmë dhimbjen që ndien një fëmijë kur mizoritë e jetës riformësojnë pritshmëritë e tij, të prindërve e të familjes për shkak të pamundësive apo pakujdesive të institucioneve, komuniteteve, prindërve apo shoqërisë.

Është detyra e të gjithëve ne që të filtrojmë mesazhet, kuptimet, përjetimet dhe këshillat për fëmijët në të gjitha mikromjediset shoqërore për ta bërë jetën e tyre më të bukur, të marrim masat për të ngritur ato që mund t'i quajmë “diga mbrojtëse” ndaj së keqes, ndaj abuzimeve dhe dhunës, që mund të vijnë nga drejtime të ndryshme.

Ne nuk mund të kujdesemi, t'i rritim e t'i edukojmë fëmijët vetëm me fjalët a këshillat tona të mërzitshme. Para së gjithash ne duhet t'i rritim e t'i edukojmë ata me modelet që u ofrojmë. Në këtë stad të zhvillimit të shoqërisë detyra jonë prioritare është të rritim një brez të shëndetshëm fizikisht, shpirtërisht e moralisht. Presionet që vijnë nga mjediset të ndryshme shoqërore, nga patologjitë dhe defektet e shoqërisë mund të shkaktojnë thyerje të mëdha të personalitetit të fëmijëve, prandaj t'i mbrojmë ata nga format e ndryshme të dhunës dhe abuzimit, *off-line* dhe *on-line*, nga format e këqija të punës me ta, nga dhuna e dukshme dhe e prekshme fizike, por edhe nga rreziqet që vijnë nga shkëlqimi dhe joshja përmes televizioneve apo nga xhungla e pakrasitur e rrjeteve sociale.

Mendoj se detyra më e rëndësishme e Grupit të Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” është të bëjë një rivlerësim të kuadrit ligjor e nënligjor si dhe të veprimtarisë së institucioneve e të agjencive për mbrojtjen e fëmijëve

dhe t'i paraqesë sa më shpejt Kuvendit propozimet për ndryshimet e mundshme ligjore.

Kjo është mbledhja e parë që unë drejtoj si kryetare e Grupit të Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”. Mendoj se është një zgjedhje e mençur që Kryetari i Kuvendit është njëkohësisht edhe kryetar i Grupit të Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”. Ky është një mesazh që simbolizon dhe sinjalizon rëndësinë dhe përparësinë që u jep zhvillimit, kujdesit dhe të drejtave të fëmijëve Kuvendi i Shqipërisë.

Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”, i cili funksionon në Kuvend prej tre legjislaturash, ka qenë mbrojtës i të drejtave të fëmijëve përmes miratimit të legjislacionit të duhur dhe kontrollit të qeverisë për zbatimin e masave efektive.

Ngritja e Grupit bazohet në përvojat më të mira të parlamenteve në botë, siç është Komiteti i Fëmijëve i Bundestagut gjerman, organi i parë parlamentar në botë i ngritur për të përfaqësuar interesat e fëmijëve dhe një ndër më të suksesshmit në këto vite, ku deputetët i përkushtohen kauzës së mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe të adoleshentëve, duke ndërmarrë një sërë nismash që fuqizojnë zërin e fëmijëve në organin më të lartë ligjvënës: në parlament.

Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” ka shënuar arritje të rëndësishme gjatë veprimtarisë së tij, ku do të përmendja hartimin e rezolutave mbi problemet e të drejtave të fëmijëve, ndërtimin e një procesi permanent të bashkëpunimit me fëmijët dhe nxënësit e shkollave, me shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë,

hartimin e disa projektligjeve, sidomos në fushën e drejtësisë për të miturit, sensibilizimin e shoqërisë dhe të institucioneve.

Në rezolutat e miratuara në prill 2019 dhe në qershor 2020 Kuvendi ka vlerësuar angazhimin e Grupit të Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, marrjen e nismave ligjore dhe hartimin e politikave efektive për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës si dhe në forcimin e kontrollit parlamentar për realizimin e këtyre të drejtave.

Grupi “Miqtë e Fëmijëve” ka rekomanduar dhe kontribuar në shqyrtimin e nismave që mundësojnë përmirësimin e mirëqenies dhe shëndetit e çdo fëmije.

Vlerësoj në mënyrë të veçantë kontributin e Grupit “Miqtë e Fëmijëve” në miratimin e ligjit “Për Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale” dhe apeloj për fillimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin prej tij.

Siç e dimë të gjithë, ne jemi mbledhur jo rastësisht sot. 20 nëntori është Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve. Shqipëria e ratifikoi Konventën për të Drejtat e Fëmijës në vitin 1993, duke u angazhuar në këtë mënyrë të përmbushë këto të drejta dhe t'i paraqesë raporte periodike për progresin dhe sfidat Komitetit për të Drejtat e Fëmijës.

Në këtë ditë menduam të bëjmë një bilanc të punës së Grupit “Miqtë e Fëmijëve” dhe të ndërmarrim detyrat përkatëse për vijimin e kontributit tonë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.





# Rrugës drejt BE-së

Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm miratoi pozicionin negociues për çeljen e negociatave me Shqipërinë për grupkapitujt e parë. Kjo i hapi rrugën konferencës së dytë ndërqeveritare BE-Shqipëri, që u mbajt më 15 tetor 2024 në Luksemburg.

**“Ky është një sukses i merituar i Shqipërisë në rrugëtimin e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian. Sidomos po të mbajmë parasysh se Shqipëria është e para mes vendeve kandidate që çel negociatat e anëtarësimit mbështetur në metodologjinë e re të BE-së. Ky vendim është gjithashtu një vlerësim për ecurinë e reformave në vendin tonë. Kuvendi do të vijojë të udhëheqë me vendosmëri procesin e integritit europian, do të garantojë legjitimitetin demokratik dhe karakterin gjithëpërfshirës të këtij procesi.”**

**Elisa Spiropali  
Kryetare e Kuvendit**



Kuvendi i Shqipërisë organizoi takimin e nivelit të lartë  
"Shqipëria 2030 në BE - Rruga e reformave"

## Anëtarësimi i Shqipërisë në BE brenda vitit 2030 - një synim plotësisht i arritshëm

**Nën kujdesin e veçantë të Kryetares së Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, Kuvendi i Shqipërisë organizoi takimin e nivelit të lartë "Shqipëria 2030 në BE – Rruga e reformave".**

Në takim morën pjesë Kryeministri i vendit, z. Edi Rama, ambasadori i BE-së në Tiranë, z. Silvio Gonzato, ministra, përfaqësues të trupit diplomatik dhe të partnerëve ndërkombëtarë, deputetë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, të agjencive ligjzbatuese dhe të shoqërisë civile, ekspertë të nivelit të lartë të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian.

Kryetarja e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, në fjalën e saj ndër të tjera deklaroi se "ëndra dhe shpresa, zgjidhja e vetme, por dhe zgjedhja jonë pa mëdyshje për ta

bërë Shqipërinë një yll më shumë në flamurin me yje të Europës brenda vitit 2030 janë i vetmi rrugëtim dhe adresë e vetme, një rrugë njëkalimëshe e së nesërme sonë". Më tej kryeparlamentarja shtoi se se lipset avancimi i mëtejshëm i reformave zhvillimore e demokratizuese, si kushte të domosdoshme për të përcaktuar përgjegjësitë për këtë proces transformues, i cili tashmë është i pandalshëm.

Në takim e mori fjalën edhe kryetari i Komisionit të Posaçëm, z. Fatmir Xhafaj, i cili tha se "kemi zgjedhur rrugën më të gjatë e më të vështirë, por besojmë më të sigurt për të marrë rezultatin e pritshëm, duke realizuar një proces që kalon përmes nevojës për analizë, skanim e diagnostikim të situatës, përcaktim të nevojave për ndërhyrje përmes masash ligjore, strukturore e institucionale dhe më pas për konkretizimin e realizmin e tyre".

## Fjala e Krytares së Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, në takim:

I nderuar z. Kryeministër Edi Rama,  
I nderuar z. Ambasador Gonzato,  
I nderuar Kryetar i Komisionit të Posaçëm,  
z. Xhafaj, dhe anëtarë të Komisionit,  
Të nderuara ministre Dhuka dhe Pirdeni,  
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të  
trupit diplomatik,  
Të nderuar drejtues dhe përfaqësues të  
institucioneve të pavarura,  
Të nderuar ekspertë, përfaqësues të shoqërisë  
civile dhe të medias,

Zonja dhe zotërinj,

Ju faleminderit që ju përgjigjet stesës dhe jemi  
sot së bashku në këtë takim të nivelit të lartë!

Ky është një takim për të marrë përgjegjësi  
për prioritetin kryesor të Shqipërisë: anëtarësimin  
në Bashkimin Europian brenda vitit 2030.  
Është një takim për të dëshmuar çfarë kemi  
bërë mirë, çfarë duhet të bëjmë më mirë apo  
ndryshe dhe se si mund të shtojmë ritmin e punës  
për të qenë në garë jo vetëm me kohën, e cila  
kërkon shpejtësi, por për të fituar garën me  
ambicien tonë dhe vetë kohën.



Çdokush nga ne do të përshihet në diskutim,  
në debat dhe në bashkëndarjen e ideve për  
agjendën e re të energjiçimit të të gjitha proceseve  
transformuese të shoqërisë shqiptare, me synim  
shndërrimin e Shqipërisë në një vend tipik  
europian, ku qytetari dhe individit janë në qendër  
të këtij transformimi. Për arritjen e këtij synimi  
mendoj se para së gjithash lypset avancimi i  
mëtejshëm i reformave zhvillimore,  
demokratizuese dhe integruese, si kushte të  
domosdoshme për të përcaktuar përgjegjësitë tona  
për këtë proces transformues. Identifikimi hap



pas hapi i elementeve të këtij procesi, ku Kuvendi  
i Shqipërisë ka një rol kyç, shndërrimi i tyre në  
plane pune të detajuara dhe konsolidimi i klimes  
së nevojshme politike për këtë veprimtari, merr  
një rëndësi të posaçme.

Pas konferencës së dytë ndërqeveritare BE–  
Shqipëri dhe çeljes së negociatave për grupkapitujt  
e parë, “Themeloret”, vendi ynë ka hyrë në një

është një arsye më shumë, që apelon për më shumë  
përgjegjshmëri, për më shumë aksion e frymëzëm  
politik për të nesërmen.

Asgjë nuk ka qenë e lehtë deri tani. Është  
një punë jashtëzakonisht voluminoze, e bërë me  
pasion e talent, me përkushtim patriotik e  
kompetencë të lartë profesionale jo vetëm nga  
ekipi negociator, por dhe nga mijëra punonjës  
publikë, të cilët i dhanë procesit të integritetit më  
të mirën e tyre dhe u bënë një aset i rëndësishëm  
e i pazëvendësueshëm i këtij procesi, ku pa dyshim  
(e përmend të fundit, por ka një rëndësi të dorës  
së parë) rol thelbësor ka pasur vullneti politik i  
mazhborancës qeverisëse dhe ai formal dhe jo  
oponent i opozitës së sotme.

Nuk besoj se ka forcë politike dhe  
personazhe politike që të jenë kundër ambicies  
shqiptare për integrim të plotë europian. Debat  
ynë është për rrugët, mjetet dhe mënyrën se si  
realizohet ky proces. Kjo është një sipërmarrje  
ku askush nuk është i përjashtuar, askush nuk  
është i tepërt, por ne besojmë se po bëjmë më të  
mirën, ne jemi të bindur se po bëjmë gjënë e  
dubur. Dhe faktet na japin të drejtë. Përfundimi  
me sukses i procesit screening, sigurisht një ushtrim  
i vështirë, por rezultativ për të gjithë ne, na solli  
në stadin më të rëndësishëm të procesit të  
anëtarësimit: në zhvillimin e ne-  
gociatave. Mirënjohje për të gjithë ata që punuan  
dhe vazhdojnë të punojnë me përkushtim për  
Shqipërinë europiane!

Pavarësisht dilemave dembele apo dhe  
fataliste, që herë pas here ngrënë krye në politikën  
e dëtës, në debatet publike apo dhe në vetë shoqërinë  
tonë, duhet të besojmë fort një të vërtetë të  
pamohueshme: anëtarësimi në Bashkimin  
Europian do të jetë një proces i bazuar në meritë.

Askush nuk ofron dhuratë dhe askush nuk pret dhuratë nga Brukseli, ndaj ne po punojmë nisur nga këto premisë. Nuk është një ftesë dhuratë apo një dhuratë që mund të festohet papritur. Është një proces merite, pra që duhet merituar. E kundërta, madje, as që është e dobishme.

Pritshmëria e qytetarit shqiptar nga gjithë ky proces është që atij t'i shërbehet njëllor si qytetarit në hapësirën europiane nga administrata shtetërore, t'i marrë shërbimet me shpejtësi dhe pa ndikimin e korrupsionit, që t'i ofrohet drejtësi në rastet e sfidave gjyqësore qoftë në rrafshin civil, qoftë atë penal, por dhe kur ka përballë vetëm shtetin.

Prandaj më lejoni që, si organizatore e këtij takimi, të ndaj me ju disa prej sfidave të Kuvendit jo vetëm për procesin e anëtarësimit në BE, por dhe për përgjegjësitë tona për ligjërbërjen dhe kontrollin parlamentar si dhe për avancimin e reformave demokratizuese dhe integruese.

Realizimi i këtij objekti strategjik kombëtar ka shtuar para nesh detyra të reja, të cilat burojnë edhe nga ligji i ri për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit europian, për shprehje ndryshimit në këtë ligj në mars të vitit 2023, të cilat synojnë që Kuvendi t'u përgjigjet më mirë nevojave dhe sfidave të procesit të negociatave.

Këto ndryshime i përcaktojnë Kuvendit, sidomos Komisionit për Çështjet Europiane dhe Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian, një rol të rëndësishëm për të çuar përpara agjendën europiane, rritjen e rolit kontrollues dhe monitorimin e ecurisë së procesit të anëtarësimit, dhënien e rekomandimeve për pozicionet negociuese të Shqipërisë, rritjen dhe lehtësimin e konsensusit për miratimin e ligjeve me përafrim, rritjen e pjesëmarrjes së grupeve të interesit në monitorimin e procesit dhe informimin e rregullt të publikut mbi procesin e negociatave etj.

Anëtarësimi në Bashkimin Europian më tepër sesa një proces teknike i plotësimit të disa kritereve standarde është një proces transformues dhe përshtatës jo vetëm i Kuvendit, qeverisë dhe institucioneve, por i të gjithë shoqërisë shqiptare.

Mobilizimi i të gjithë faktorëve politikë e shoqërorë, arritjet e deritanishme dhe vullneti ynë për të përshpejtuar ritmet e anëtarësimit na bëjnë të besojmë se anëtarësimi i Shqipërisë brenda vitit 2030 përveçse një plan ambicioz është dhe një synim plotësisht i arritshëm.

Kuvendi do të vijojë të udhëbejë me vendosmëri procesin e anëtarësimit për të garantuar legjitimitetin demokratik dhe

karakterin gjithëpërfshirës të procesit. Përballimi me sukses i sfidave të negociatave kërkon rritjen e rolit kontrollues të Kuvendit, posaçërisht të Komisionit për Çështjet Europiane dhe të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian gjatë procesit të negociatave për të garantuar përmbushjen e kritereve të vendosura për hapjen dhe mbylljen e grupkapitujve, monitorimin e ecurisë së procesit në bashkëpunim me grupet e interesit dhe shoqërinë



civile dhe aktorë të tjerë jopolitikë si dhe informimin e publikut mbi ecurinë e negociatave.

Kuvendi po tenton sa mundet, edhe në kushtet e një klime gjithëberë të tendosur politike, që të rrisë konsensusin për miratimin e ligjeve që do të jenë kritere për hapjen dhe mbylljen e kapitujve si dhe për hartimin e pozicioneve negociuese sipas rekomandimeve që i janë përcjellë strukturës negociatore nga Komisioni për Çështjet Europiane për grupkapitujt e parë dhe të gjashtë dhe në vijim do t'i përcillen për grupkapitujt e tjerë.

Për t'u përgjigjur detyrave të shtuara me ndryshimin e ligjit dhe në këtë stad të ri të procesit të integrimit, në Kuvend kemi ngritur një strukturë të posaçme për integrimin: Shërbimin e Integrimit Europian.

Ne po vijojmë punën për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve që i drejtohen Kuvendit nga raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2024. Gjithashtu ne po punojmë për plotësimin e të gjitha detyrimeve për raportim në kuadër të takimeve të përbashkëta BE-Shqipëri për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, për plotësimin e angazhimeve të ndërmarra nga Kuvendi në të tre udhërrëfyesit: "Për shtetin e së drejtës", "Për reformën në administratën publike" dhe "Për funksionimin e institucioneve demokratike", si dhe për zbatimin e angazhimeve

të marra në pozicionin negociues të grupkapitujve të parë, "Themeloret".

Nëpërmjet Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian dhe Komisionit për Çështjet Europiane ne po punojmë gjithashtu edhe për monitorimin e zbatimit të këtyre dokumenteve për të matur progresin e realizuar.

Plani i Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor paraqet një mundësi të

jashtëzakonshme për Shqipërinë. Ky plan synon të forcojë zhvillimin ekonomik, të ndërtojë infrastrukturën lidhëse kombëtare e rajonale dhe të ndihmojë në zbatimin e reformave të nevojshme për integrimin tonë në tregun e vetëm të BE-së.

Ngritja nga Kuvendi i Shqipërisë gjatë sesionit të kaluar parlamentar i Komisionit të Posaçëm për Thelimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian ishte përgjigje ndaj nevojës së brendshme të shoqërisë shqiptare për të përshpejtuar ritmet e reformave integruese e demokratizuese. Ishte një nevojë politike, ligjore dhe institucionale për të plotësuar një vakum, për të zëvendësuar mungesën e një mekanizmi të përbërshëm parlamentar, i cili do të analizojë në mënyrë racionale gjendjen e zhvillimeve dhe të reformave në vend dhe do të rekomandojë rrugëzgjdhje e veprime për të tria degët e qeverisjes: legjislative, ekzekutive dhe atë gjyqësore.

Veprimtaria e deritanishme e Komisionit dhe 11 tryezat e organizuara tregojnë se ngritja e tyre ishte veprimi i duhur. Dje mora pjesë në tryezën e Komisionit kushtuar luftës kundër korrupsionit në sektorët me risk të lartë dhe konstatova mendimin e thelluar, analizën serioze dhe përkushtimin në trajtimin e kësaj çështjeje.

Ekspertiza, kontributi dhe konsultimi me ekspertët janë një burim i madh dijeshe dhe përvojash, që jo thjesht e pasurojnë këtë proces si një vlerë e tij e shtuar, por na ndihmojnë të fokusohemi në problemet dhe çështjet konkrete e jetësore për vendin dhe shoqërinë. Vlerësova punën e anëtarëve dhe drejtuesit të Komisionit, z. Fatmir Xhafaq. Serioziteti dhe profesionalizmi i derisotëm është garanci për atë që do të ndodhë nesër.

Jam besimplotë se procesi, i nisur me konsultime të gjera, diskutime dhe debat shterues, do të ofrojë kontribut domethënës në funksion të qeverisjes më të mirë, në përmirësimin e shërbimeve publike, rritjen e integritetit të funksionarëve dhe të punonjësve publikë, përmirësimin e veprimtarisë së institucioneve e të agjencive shtetërore dhe institucioneve të pavarura, në ndërtimin e një Shqipërie më të fortë, me një shoqëri më të drejtë, ku qytetarët të ndihen zotër e të shërbyer. Në fund të fundit, qëllimi final i qeverisjes dhe i gjithë reformave në të cilat është përfshirë shoqëria shqiptare është rritja e mirëqenies së qytetarëve.

Korrupsioni është një pengesë për arritjen e këtij synimi. Lufta e suksesshme kundër tij përbën thembrën e Akilit në përpjekjet tona për të ndërtuar një vend me ekonomi të fortë, me sektorë e tregje konkurruese dhe një shoqëri me drejtësi sociale e solidaritet njerëzor.

Arritjet e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit janë të dukshme e të matshme dhe janë vlerësuar edhe në raportet e Departamentit të Shtetit si dhe në raportin e Komisionit European për vitin 2024, por mjaft prej sektorëve të shërbimeve publike vazhdojnë të jenë ende të rrezikuar nga korrupsioni. Perceptimi mbi nivelin e korrupsionit është në një shkallë shqetësuese, ndonjëherë ndoshta edhe përtej nivelit real të tij, e megjithatë merr një rëndësi të posaçme intensifikimi i luftës kundër tij, e cila nuk është vetëm e karakterit ndëshkues, por edhe parandalues. Fryma, intensiteti, forca goditëse dhe rezultatet e luftës kundër korrupsionit nuk janë shtrirë në të gjithë diapazonin e sektorëve, institucioneve dhe agjencive të shtetit.

Është gjë tjetër veprimtaria e organeve ligjzbatuese për identifikimin e ndëshkimitin e korrupsionit dhe mbartësve të tij, çka është tagër i një pushteti tjetër të pavarur, dhe tjetër gjë ngushtimi i hapësirave ligjore, krijimi i mekanizmave frenues dhe veprimet efektive e të drejtpërdrejta që eliminojnë hap pas hapi ngasjen për të futur duart në para.

Digitalizimi i pashembullt i shumë shërbimeve – një proces krejt i pamenduar më parë, që synon thyerjen e kontaktit të

administratës me qytetarin – është një hap i jashtëzakonshëm, që ka kontribuar pikërisht në këtë drejtim. Koha kur paguhej për të marrë edhe një certifikatë në gjendjen civile ka mbaruar. Kjo është një nga rrugët efektive, që duhet të perfeksionohet më tej. Nuk është akt i vetëm, por është një proces që detyrë tjetër më parë as që mendohej se do të ndodhte. Në Shqipëri ishte krijuar një kastë politike që ishte kudo dhe kudoherë mbi ligjin. Kur njëdijja e bukës qubej “kerim”, kurse grabitja e milionave të parave publike ishte virtuozitet. Kur i dobëti shtrëngohet të hynte në kalvarin kafkian të përbaljes me ligjin, kurse i pushtetshmi dikonte ligjin duke qenë mbi të.

Sot një segment i zëshëm i drejtësisë së re, Gjykata e Posaçme dhe SPAK-u, kanë dëshmuar se koha e të paprekshmëve në këtë vend, që shibej me parametrat e Lindjes, ka përfunduar përgjithmonë. Të pandëshkueshmë e djeshëm dhe të sotëm po jetojnë nën terrorin e ligjit dhe e dinë mirë se herët a vonë do të kthejnë sheqerin e grabitur dhe do të mbeten me shap të ndarë prej tij. Pa mburoja gjithfarëshe politike, janë në shënjestër të asaj që po ndodh dhe do të vijojë të ndodhë, ashtu siç e gjykon në pavarësi të plotë një pushtet i pavarur nga politika.

Zonja dhe zotërinj të nderuar,

Besoj fort dhe e kam bindje të thellë se asnjëherë më parë si tani nuk është demonstruar një përgjegjësi kaq e përqendruar mbi procesin strategjik të integritetit sa qeverisja e sotme e vendit, në një realitet të ri të përditshëm, në një raport krejt tjetër në qasjen ndaj ligjit. Asnjëherë më parë sistemi i drejtësisë nuk ka qenë kaq funksional dhe i pavarur si sistemi që kemi sot, që po çon në ikje pa kthim kulturën e pandëshkueshmërisë. Kurrë më parë institucionet e pavarura nuk kanë qenë ashtu siç janë dhe po përpiqemi t'i bëjmë sot: rojë të interesit publik dhe qytetar. Asnjëherë më parë qytetarët, grupet e interesit dhe mediet nuk kanë pasur këtë akses në punët e shtetit që kanë sot.

Edhe për secilin nga këto arsye që përmenda e të tjera që gjithashtu mund të përmenden, ky është momentum kur Shqipëria kërkon një kontribut të tejshtuar politik, patriotik e njerëzor për t'u anëtarësuar brenda vitit 2030 në familjen europiane; që punët në këtë vend të shkojnë më mirë, anëtarësimi në familjen europiane të përshpejtohet, reformat të thellohen, mirëqenia e qytetarëve të rritet dhe shoqëria jonë të bëhet më e drejtë, më solidare, më njerëzore, ku asnjë të mos dalë mbi ligjin, por edhe askush të mos e ndiejë veten të diskriminuar; dhe që Shqipëria të bëhet atdhe i shansave të barabarta, i garës së

ndershme dhe i konkurrencës në çdo gjë.

Përfitoj nga rasti të vë në dukje preokupimin tim si Kryetar e Kuvendit pse opozita, pavarësisht stesës së përsëritur, që nuk do të mungojë sërisht, ende nuk ka arritur dot të ngrihet mbi interesin e ditës dhe të vendosë interesat e Shqipërisë mbi qasjet partiake dhe të bëhet pjesë e këtyre proceseve.

Kuvendi është një hapësirë lirie, por edhe një ushtrim i vështirë përgjegjësie dhe përgjegjshmëria, ku ka vend e nevojë për kontributin e saj.

E përsëris se përgjegjësitë e reja të Kuvendit në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European: lidhshipi i procesit, garantimi i legjitimitetit demokratik dhe i karakterit gjithëpërfshirës, na detyrojmë të vijojmë të marrim përgjegjësi, jo për të kontrolluar degët e tjera të qeverisjes dhe institucionet e pavarura, por për të rritur përgjegjshmërinë, llogaridhënieën dhe transparencën e të gjitha pushteteve ndaj qytetarëve. Është e vërtetë se institucionet janë rojat e interesit qytetar, po rajat kaush i ruan?

Kuvendi, si i vetmi pushtet i zgjedhur dhe i deleguar nga populli, garanton që të gjitha institucionet, përfshirë vetë Kuvendin, të jenë të varura e të kontrolluara nga Kushtetuta, ligji dhe qytetarët. Guxim i politik e parlamentar për të udhëbequr këto procese reformuese dhe transformuese të shoqërisë shqiptare, rezultatet e arritura, vështirësitë që kemi ndeshur dhe sfidat që po kapërcejmë, tregojnë se sinergia mes dinamizimit të shoqërisë dhe institucioneve dhe mbrojtjes së tyre prej formave të ndryshme të ndërhyrjeve të huaja është e domosdoshme dhe po funksionon. Besoj se ky është një proces që kërkon gjithashtu sakrifica njerëzore dhe politike. Pa dëshim, kërkon edhe mbështetjen e pakursyer të partnerëve tanë, siç ka ndodhur dhe do të vijojë të ndodhë ende.

Gjej rastin të falënderoj Delegacionin e Bashkimit European dhe Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, ambasadat e vendeve anëtare të Bashkimit European, Ambasadën e Zvicrës, Prezencën e OSBE-së, Zyrën e Këshillit të Europës dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe qëndrimet mbështetëse ndaj Kuvendit të Shqipërisë në këtë stad të rëndësishëm të riengjizimit tonë politik dhe patriotik, avancimit dhe thellimit të reformave për të ecur drejt objektivit Shqipëria në BE në vitin 2030.

Shumë është bërë dhe më shumë do të bëhet. Kur shihet qartë destinacioni, edhe rruga bëhet më e shpejtë dhe më e lehtë.

Ju falënderim!



# Çeli punimet sesi i shtatë i Legjislaturës X të Kuvendit



**N**ë drejtimin e Kryetares së Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, nisi punimet sesi i shtatë i Legjislaturës X të Kuvendit të Shqipërisë. Pas çeljes së seancës nën tingujt e himnit kombëtar kryeparlamentarja në fjalën e saj të parë për këtë sesion u ndal në sfidat dhe prioritetet kryesore të Kuvendit gjatë sesionit të ri parlamentar.

Për të mbajtur fjalën hapëse të këtij sesi Kryetarja e Kuvendit zgjodhi të zbriste në podium për të dëshmuar, qoftë edhe formalisht, se vendi i saj është pikërisht aty, “mes të barabartëve me njëri-tjetrin, por kaq të ndryshëm nga njëri-tjetri”. Duke iu

referuar kohës së shkurtër deri në mbylljen e këtij mandati dhe ritakimin me votuesit, ajo theksoi se në ballafaqimin e ardhshëm elektoral secili deputet do të shkojë me bilancet e veta politike, me pritshmëritë e realizuara dhe me shqetësimin se çfarë mund të ishte bërë ndryshe dhe më mirë. “Është e pamundur të ndryshojmë të shkuarën tonë të përbashkët në këtë sallë. Pënda për veprime dhe gjykime të gabuara vlen vetëm për të gjetur forcë për të korrigjuar çfarë mund të bëjmë ndryshe, por edhe më mirë të nesërmen fare të afërt. Unë besoj fort se reflektimi duhet të jetë i përbashkët

mes nesh, një reflektim që përfshin edhe qortimin e së shkuarës, edhe projeksionet për të ardhmen. Sa për një gjykim të parë, shumica e kësaj salle mund të ishte më tolerante, të gjykonte duke kujtuar kohën kur ajo vetë ishte pakicë, kurse pakica duhej të ishte më e vetëkontrolluar. Duhej të ishte, së paku në gjykimin tim, më pak luftarake dhe shumë më tepër politike”, – tha znj. Spiropali.

Kryeparlamentarja u kërkoi të gjitha palëve t’i mbrojnë deri në fund pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre, por me etikë parlamentare, duke respektuar institucionin e Kuvendit të Shqipërisë dhe qytetarët që i kanë

votuar dhe i ndjekin. “Shpesh jemi sjellë si shkak dhe pasojë të njëri-tjetrit, ku mungesa e kontrollit nga ana juaj ka sjellë bjerrjen e tolerancës sonë, por rast pas rasti të dyja bashkë kanë sjellë cenimin e cilësisë së veprimtarisë së Kuvendit, të pushtetit nga i cili buron edhe pushteti ekzekutiv dhe ndikon në gjithë jetën e vendit. Unë besoj fort se një qasje tjetër në ballafaqimin tonë [...] do të kishte sjellë, pa dyshim, një vlerë krejt tjetër në funksionimin e pushtetit legjislativ”, – tha kryeparlamentarja në fjalën e saj. Ajo shprehu dëshirën që të ketë një tjetër realitet brenda sallës së Kuvendit, ku të mbizotërojë fryma e bashkëpunimit, por shtoi se nuk beson se do të ndodhë një gjë e tillë, sepse “si në një film skematik, që ka humbur ngjyrat e kuptimin, me të njëjtët aktorë, pa ngjyra dhe sipas skemës së vjetër, ne do të bëhemi rishtas dëshmitarë dhe dëshmorë të mendësisë së vjetër, që hyxhymin dhe urren mbi kundërshtarin e sheh si armë që asgjëson armikun politik”. Dhe kjo ndodh, vijoi më tej znj. Spiropali, sepse, edhe pse kohët kanë ndryshuar, ka ndryshuar edhe Shqipëria në mënyrë të pakrahasueshme me një dekadë më parë, kanë ndryshuar pritshmëritë dhe qasja e qytetarëve ndaj politikës si dhe nevoja për atë çfarë duhet të afrojnë politika, nuk ka ndryshuar mendësia e të bërit politikë, “e cila në thelbin e saj ka mbetur ende në llogoret e viteve ’90, por fatkeqësisht e pashoqëruar me entuziazmin dhe idealizmin e asaj kohe, kur, edhe pse dinim shumë më pak, gabimet ndodhnin nga padija dhe jo nga ligësia, ndodhnin nga nguti për të kapur kohën e humbur dhe jo nga llogaria për çfarë mund të fitohej individualisht”. Megjithatë, si Kryetare e Kuvendit, ajo i ftoi deputetët t’i bëjnë pyetjen vetes se pse ndodhen në sallën e Kuvendit dhe të reflektojnë, të gjejnë rrugët e bashkëpunimit e të çojnë përpara

prioritetet që duhen realizuar deri në fund të legjislaturës. “Kjo trupë, njëlloj si individ, mund të turpërohet edhe brenda një minute, kurse për të bërë punë të mira, me durim dhe pasion, kjo është një kohë që nuk lejon të humbasë asnjë minutë më shumë”, – tha znj. Spiropali.

Duke u ndalur në disa prej prioritetëve të sesionit, Kryetarja e Kuvendit veçoi si prioritetin kryesor lidhshëm të Kuvendit në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE nëpërmjet garantimit të legjitimitetit demokratik dhe gjithëpërfshirjes. “Gjithëpërfshirja dhe garantimi i legjitimitetit demokratik në këtë proces është një prioritet absolut për të gjithë ne, ku nuk ka vend për dallim mes të majtëve e të djathtëve. Ky nuk është teprim, është një imperativ i kësaj kohe të trazuar, i një gjeopolitike që tashmë ka krijuar një klimë krejt tjetër sigurie, në të cilën Shqipëria duhet të orientohet në mënyrën e duhur dhe që e kualifikon si shkak armiqësinë tonë të përditshme”, – tha znj. Spiropali. Për përmbushjen e këtij prioriteti ajo premtoi se Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian dhe Komisioni për Çështjet Europiane do të kenë gjithë mbështetjen e saj për zbatimin e legjislativitetit dhe të detyrimeve të Kuvendit në procesin e integritetit.

Prioritete të tjera të Kuvendit në këtë sezon kryeparlamentarja tha se do të jenë: zbatimi i rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2023; forcimi i kontrollit mbi qeverinë dhe monitorimi i institucioneve të pavarura për përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në Bashkimin Europian; mbështetja e partneritetit strategjik të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me BE-në dhe NATO-n; forcimi i bashkëpunimit me parlamentet e vendeve mike e partnere dhe me organizatat ndërkombëtare për zbatimin e

projekteve në proces; konsolidimi i vlerave dhe i institucioneve demokratike; rritja e përgjegjshmërisë, produktivitetit, transparencës dhe llogaridhënies së Kuvendit përpara qytetarëve; forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe i përgjegjshmërisë së degëve të qeverisjes.

Gjithashtu gjatë këtij sesioni, tha znj. Spiropali, do të vijojnë veprimtarinë e tyre komisionet e posaçme dhe hetimore të ngritura në Kuvend si dhe do të vijojë puna për çuarjen përpara të reformave dhe përshpejtimin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Po ashtu, në zbatim të nenit 132 të Kushtetutës dhe të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, Këshilli për Legjislativitetin do të marrë në shqyrtim vendimet e Gjykatës Kushtetuese për Rregulloren e Kuvendit, ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”.

Përmirësimi i cilësisë së ligjbërjes do të jetë një tjetër prioritet i këtij sesioni parlamentar. “Këtij prioriteti, – tha znj. Spiropali, – do t’i shërbejë përfundimi dhe fillimi i zbatimit të manualit për procesin e ligjvënies në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vijimi i zbatimit të sistemit të *e-Legislation* të mbështetur nga OSBE-ja, inkorporimi në këtë proces i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të ‘Agjendës 2030’, i çështjeve gjinore dhe auditit gjinor”.

Për përmbushjen me sukses të këtyre prioritetëve përveç forcimit të frymës së bashkëpunimit Kryetarja e Kuvendit kërkoi që opozita të marrë përgjegjësitë e saj dhe “ta konsiderojë kontributin e saj pjesë të misionit parlamentar, politik dhe kombëtar” për ta shndërruar Kuvendin “në një hapësirë lirie, por edhe në arenën e një ushtrimi të vështirë përgjegjësie dhe përgjegjshmërie”.



## Znj. Elisa Spiropali zgjidhet Kryetare e Kuvendit

Pas dorëheqjes së znj. Lindita Nikolla Kuvendi u mbledh në një seancë plenare të jashtëzakonshme. Pas votimit të dekretëve të Presidentit të Republikës për disa ndryshime në kabinetin qeveritar, u votua projektvendimi "Për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë". Në përfundim të votimit znj. Elisa Spiropali u zgjodh Kryetare të Kuvendit të Shqipërisë me 75 vota pro, 4 kundër

dhe asnjë abstenim, ndërsa z. Bledar Çuçi u zgjodh nënkryetar i Kuvendit në vend të znj. Ermonela Felaj.

Në fjalën e saj të rastit znj. Spiropali vlerësoi kontributin e paraardhëses së saj, znj. Lindita Nikolla, dhe premtoi se do të bashkëpunojë me opozitën dhe do të bëjë më të mirën për jetën parlamentare, për konsolidimin e vlerave dhe të institucioneve demokratike.

## Fjala e znj. Elisa Spiropali pas zgjedhjes në krye të Kuvendit:

*I nderuar Kryeministër,  
Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,  
Të dashur qytetarë,*

*Mirënjohja është një fjalë që në gjuhën e dikujt që merret me politikë tingëllon si trokëtja false e një gote kristali, xhanëm siç tingëllojnë të gjitha fjalët kyçe të bashkëjetesës sociale, ku bashkëjetesa politike është territor i mbuluar me re të zeza gjykimesh e paragjykimesh të frikshme. Po edhe përtej këtij territori, në jetën e përditshme të turravrapit kapitalist dhe arrivist, mirënjohja ka hyrë në gardërobën e kostumeve të kohëve të vjetra, jashtë mode.*

*Sot dua të them se mirënjohjen, që gjithnjë e kam kuptuar si detyrim për të kthyer më shumë nga sa kam marrë, e ndiej si një shtysë për të bërë më shumë nga sa kam mundur deri tani.*

*Nuk kam drojë të pranoj se jam e prekur si asnjëherë në jetën time të shkurtër apo të gjatë publike (varet nga këndvështrimi) nga vlerësimi që më blatuat duke më zgjedhur në krye të Kuvendit të Shqipërisë, por besoj se e di mirë që ky është një ushtrim jashtëzakonisht i vështirë politik, social, qytetar, sa personal aq dhe kolektiv, po në fund jam shumë e qartë se në këtë ushtrim çfarë shkon mirë është juaja, çfarë shkon keq është e kujtudo që ju ngjiti këtu lart. Megjithatë, kjo nuk më tremb, por vetëm më vetëdijeson dhe më motivon.*

*Mirënjohjen së pari ua blatoj qytetarëve shqiptarë, që më sollën më 2017-n dhe më risollën më 2021-shin si deputete të Kuvendit të Shqipërisë në këtë sallë, që për mua është maja më e lartë e vendit për një qytetar. Mirënjohjen ia kam detyrim sot e gjithmonë secilit koleg në këtë sallë dhe kryetarit të kësaj shumice, Kryeministrit të vendit, njeriut më të pakënaqur nga vetja dhe nga ne, që ma besuan mua përgjegjësinë solemne të kryesbërëtorit të këtij Kuvendi, për Shqipërinë e sotme dhe Shqipërinë e 2030-s.*

*Në këto pak fjalë të këtij fjalimi të parë jopolemik në këtë sallë dhe në këtë situatë kreyt atipike për mua, duke pasur parasysh tre vjetët e këtij mandati qeverisës të kaluar në vijën e parë të zjarrit politik këtu, një shkallë më poshtë, dua të falënderoj me zemër zonjën që zëvendësova sot.*



*E dashur Lindita,*

*Gjatë këtyre tre vjetëve të parë të kësaj legjislature e drejtore Kuvendin me një përkushtim, urtësi e durim që më është dukur gjithnjë mbinjerëzor. Deri dje ndibesha e çuditur me ty, sot ndihem e sëkëlldisur nga krabasimi që më bëbet me ty. Do të përpiqem modestisht të të ngaj në përkushtim e urtësi dhe uroj që të afrohem sadopak në durim.*

*Të nderuar kolegë të opozitës,*

*Ju që jeni mësuar të debatoni me mua në këtë sallë e përtej saj, më shpesh ashpër sesa butë, djjeni se do t'ju shoh njësoj përballë, por nuk do të më keni më përballë. Do të më gjeni vullnetmirë në krabun tuaj të djathtë, po njësoj si shokët e kolegët e mi majtas do të më kenë në krabun e tyre të majtë, sa herë që e drejta që ju jep rregullorja dhe fryma e bashkëpunimit do të jenë me ju.*

*Në fakt – dhe ky është premtim – lutem që të jem thjesht e para mes të barabartëve sa kohë debati, por jo sherrnaja; argumenti i mendjeve, por jo dalja nga mendtë; zjarri i përballjes demokratike, por jo përballja piroteknike do të jenë emëruesi i përbashkët*

*nën këtë tavan, që i ka parë të gjitha dhe ku mblidhemi të gjithë për t'u ballafaquar në emër të të gjithë atyre që na kanë sjellë këtu.*

*Nga kjo foltore, prej nga po ju drejtohem për herë të parë, ju kërkoj të më ndihmoni edhe ju që ta mbaj këtë premtim, por dua po ashtu ta dini që sot se, nëse do të gjykoj se duhet të ndërhyj si palë, nuk do ta bëj nga këtu, por do të zhbres pa u stepur poshtë në foltore, si pjesë e pandashme e palës që ka përgjegjësinë në drejtimin e këtij vendi. E di që forca dhe trysnia e traditës, bindjet e mia të pandryshueshme, të njëjta me ato të shumicës së kësaj salle dhe shpesh kreyt të papajtueshme me pakicën e saj, janë një peshë nga e cila vështirë se mund të ndahem, dhe në të vërtetë as dëshiroj që të ndahem, por dua të besoj se askush në këtë sallë nuk do të ma kursejë ndihmën për të qenë thjesht e para mes të barabartëve dhe për ta kryer detyrën me paanësinë e palëkundshmërinë që kërkon kjo detyrë e lartë.*

*Ju kolegë të shumicës besoj se e dini që për ta bërë si duhet këtë detyrë unë nuk do të jem me ju si gjithnjë gjer më sot brenda këtyre*

mureve kur opozita të jetë në të drejtën e saj, që mund të mos jetë e drejtë në këndvështrimin tuaj.

Kritja e përgjegjshmërisë, e produktivitetit, transparencës dhe llogaridhënies së Kuvendit përpara qytetarëve, mbikëqyrja dhe kontrolli parlamentar në ndarjen e pushteteve do të jenë prioritet i Kuvendit. Gjithkush është i ftuar të japë kontributin e tij dhe kontributi i gjithkujt

E patolerueshme është dhuna në të gjitha llojet dhe format e saj të shëmtuara. Fjalët që fyejnë dhe frazat që vrasin do të trajtoben nga unë vetëm me gërmën e Rregullores së Kuvendit. Nëse do të gjejmë mirëkuptim në këtë pikë, nuk kam asnjë dyshim se nuk do të ketë pikë e presje tjetër që do të na ndajë nga mënyrat e ndryshme me të cilat ne, të majtë e të djathtë, gjykojmë se kryejmë detyrën tonë.

konsolidimi i vlerave të institucioneve demokratike, transparenca e qeverisjes dhe e veprimtarisë parlamentare, së bashku dhe veç e veç si mjete të pazëvendësueshme për përshpejtimin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe shndërrimin e saj në Europën e Ballkanit, do të jetë harta e yllësia jonë dhe orientimi ynë i vetëm. Le të tregojmë se jemi ligjvënës e patriotë të denjë, bashkëndërtues të institucioneve dhe bashkëmbrojtës të vlerave demokratike. Le të mos e konsiderojmë bashkëpunimin as dobësi dhe as imponim, por një instinkt të brendshëm të veprimtarisë së çdo deputeti dhe standard të procesit parlamentar.

Unë do të jem e përkushtuar që Kuvendi të ushtrijë lidhshpër dhe procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian nëpërmjet garantimit të legjitimitetit demokratik dhe gjithëpërfshirjes. Diplomacia parlamentare do të jetë në shërbim të Shqipërisë europiane. Shqipëria europiane do të jetë fari prej nga do të orientohet Kuvendi i Shqipërisë dhe secili prej nesh.

Nuk ju ftoj, por ju lutem të gjithëve: le të jemi të gjithë së bashku më shumë patriotë dhe më pak partiakël! Nesër, kur

“ Le të tregojmë se jemi ligjvënës e patriotë të denjë, bashkëndërtues të institucioneve dhe bashkëmbrojtës të vlerave demokratike. Le të mos e konsiderojmë bashkëpunimin as dobësi dhe as imponim, por një instinkt të brendshëm të veprimtarisë së çdo deputeti dhe standard të procesit parlamentar. ”

ka një ftesë të hapur për t'u ushtruar në përditshmërinë e këtij institucioni kushtetues.

Të nderuar kolegë,

Me lejoni të ndaj me ju një ndjesi të brendshme, që është sa politike aq dhe njerëzore. Ndihem e përulur, por jo e shtypur nga pesha e besimit që m'u dha, nga rëndësia e sprovës që dubet të përball dhe nga solemniteti i asaj cka dubet të ndodhë në këta muaj, që po vrapojnë drejt ndeshjes së ardhshme elektorale. Dera e zyrës sime do të jetë e hapur në dy kanata për cilindo nga kolegët, të majtë e të djathtë, që do të trokasë në të. Do të jetë e hapur për ujë e kafe, për qetësi dhe durim; do të jetë një hapësirë lirie për debatin e nevojshëm për përgatitjen e seancave dhe për garantimin e të gjitha kushteve të nevojshme për ushtrimin e detyrës së deputetit.

Sa më shumë debat në zyrë sy më sy, aq më pak sherr në sallë; sa më shumë bashkëpunim paprapak, aq më pak kacafytje të panevojshme në sy të publikut, që është neveritur së dëgjuari palokomunikimet me gishta në vesh. Kush flet qetësisht, dëgjohet më shumë, ashtu siç shkon më larg e më lart ai që ecën më ngadalë e më shtruar. Kjo nuk është këshillë, kjo është filozofia që forcën e saj e gjen tek argumenti dhe shmang forcën si argument të vetëm.



Të nderuar kolegë,

Pavarësisht ndarjeve thelbësore që kemi demonstruar me njëri-tjetrit, pavarësisht papajtueshmërive, shpesh tmerrësisht ekstreme, besoj se secili nga ne ka bindjen se vetëm nxitja e reformave për të ecur përpara, për të shmangur stancacionin e për më tepër prapaktësimet e padëshiruara, fuqizimi i institucioneve të pavarura, në radhë të parë i atyre të sistemit të drejtësisë, pavarësia e degëve të qeverisjes dhe rritja e përgjegjshmërisë së tyre përpara qytetarëve,

pasionet e luftës së paprerë politike do të jenë fashitur, besoj se secili do të gjejë një vijë ndarjeje mes atyre që do të sillen si shqiptarë patriotë dhe atyre që nuk mundën të ngriheshin në këtë lartësi të ndërgjegjes kombëtare.

Ju faleminderit të gjithëve dhe ju premtoj se nuk do të kursehem të jap më të mirën në ushtrimin e kësaj detyre të lartë që më besuat!

Mirënjohje gjithmonë!

Na priftë e mbara në sesionin tjetër!

# U mbajt takimi i 18-të i Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit Shqipëri–BE



Në datat 29 dhe 30 tetor 2024 në Tiranë u mbajt takimi i 18-të i Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit Shqipëri–BE, i cili u bashkëdrejtua nga kryetari i delegacionit të Kuvendit të Shqipërisë në Parlamentin Europian, z. Toni Gogu, dhe kryetari i delegacionit të Parlamentit Europian, z. Marko Tarquinio (*Marco Tarquinio*).

Dy delegacionet diskutuan rreth shtetit të së drejtës në Shqipëri, për luftën kundër krimit dhe korrupsionit, lirinë e medias dhe të drejtat e njeriut, për zhvillimin ekonomik, fqinjësinë e mirë dhe bashkëpunimin rajonal, për zgjedhjet dhe rekomandimet e OSBE–ODHIR-it për Kodin Zgjedhor.

Në fjalën e tyre përshëndetëse dy

bashkëkryetarët vlerësuan progresin e bërë ndër vite nga Shqipëria në rrugëtimin drejt BE-së si dhe rëndësinë e takimit për integrimin europian, për më tepër që tashmë Shqipëria është ulur zyrtarisht në tryezën e negociatave me Bashkimin Europian.

Në diskutimet për gjendjen aktuale të Shqipërisë në procesin e integritimit në BE u shkëmbyen mendime midis ministres së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adela Pirdeni, zëvendësministres për Europën dhe Punët e Jashtme, znj. Silda Anagnosti (Çepe), ambasadorit të BE-së në Shqipëri, z. Silvio Gonzato, dhe ambasadores së Hungarisë, znj. Martina Kasnyik.

Në fjalën e saj ministrja e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adela Pirdeni, shprehu angazhimin e qeverisë shqiptare për të bashkëpunuar me Komisionin Europian për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në vendit në BE deri në vitin 2030. Ministrja shprehu angazhimin se qeveria shqiptare në bashkëpunim të ngushtë me BE-në do të vazhdojë të punojë për arritjen e këtij objekti madhor për Shqipërinë dhe hapjen e negociatave në grupkapitujt e tjerë.

Ambasadorja e Hungarisë në Shqipëri, znj. Martina Kasnyik, vendi i së cilës kryeson Bashkimin Europian, u shpreh se vendi i saj është i angazhuar që ta çojnë përpara



procesin e integritetit të Shqipërisë në BE dhe se mirëpret një angazhim konstruktiv të Shqipërisë për t'u bërë një partnere e rëndësishme për BE-në.

Ambasadori i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, z. Silvio Gonzato, në fjalën e tij tha se bashkëpunimi parlamentar luan një rol të rëndësishëm në çuarjen përpara të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe Shqipëria duhet të tregojë leadership të fortë politik e të sigurojë mbështetje të gjerë ndërpartiake për reformat integruese, në mënyrë që të përparojë shpejt në negociatat e anëtarësimit.

Zëvendësministrja për Europën dhe Punët e Jashtme, znj. Silda Anagnosti (Çepe), vlerësoi mbështetjen e palëkundur që Parlamenti Europian i ka dhënë vendit tonë në procesin e integritetit dhe theksoi se Shqipëria ka qenë gjithmonë serioze në agjendën e saj europiane dhe ka treguar maturi në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Gjatë ditës së parë të takimit

europarlamentarët dhe deputetët shqiptarë diskutuan dhe shkëmbyen mendime mbi shtetin e së drejtës në Shqipëri, luftën kundër krimit dhe korrupsionit, lirinë e medias dhe zgjedhjet. Ditën e dytë diskutimet u përqendruan në çështjet e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimin rajonal.

Gjatë diskutimeve deputetët e Kuvendit të Shqipërisë shkëmbyen mendime me eurodeputetët dhe shprehën vlerësimet e tyre për progresin e arritur nga Shqipëria në luftën kundër korrupsionit dhe

forcimin e shtetit të së drejtës, për përpjekjet që janë bërë për krijimin e tregut të lirë, për lirinë e medias dhe zhvillimin ekonomik, për zgjedhjet dhe rekomandimet e OSBE-ODHIR-it për Kodin Zgjedhor, për çështje të bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit. Në diskutimet e tyre ata theksuan se procesi i integritetit europian mbetet prioritet kombëtar dhe nuk kushtëzohet nga agjendat politike të brendshme.

Eurodeputetët vlerësuan rezultatet e arritura në zbatimin e reformës në drejtësi, në fushën e zhvillimit ekonomik dhe të turizmit, si dhe shprehën mbështetjen e Parlamentit Europian për anëtarësimin e vendit tonë në BE. Ata thanë se Shqipëria po tregon vendosmëri, përkushtim dhe progres në zbatimin e reformave dhe përmbushjen e detyrimeve, duke treguar qartazi orientimin euroatlantik të saj.

Në përfundim të takimit u shqyrtua projektrezoluta e propozuar nga dy bashkëkryetarët dhe amendamentet e paraqitura nga dy delegacionet, por për shkak të mosarritjes së shumicës së kërkuar të votave nuk u bë e mundur miratimi i saj.



# Prezantohet Kodi i Sjelljes dhe Plan i Integritetit për administratën e Kuvendit të Shqipërisë

Kuvendi i Shqipërisë dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) organizuan një takim prezantues për *Kodin e Sjelljes* dhe *Planin e Integritetit* për administratën e Kuvendit të Shqipërisë. Në takim, i cili u moderua nga z. Sotiraj Hroni, drejtor ekzekutiv i IDM-së, morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, të administratës së Kuvendit dhe të ambasadës suedeze në Tiranë etj.

Takimi u përshëndet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, dhe ambasadori i Suedisë në Shqipëri, z. Niklas Ström. Në fjalën e tij z. Gjonçaj u shpreh se miratimi i *Kodit të Sjelljes* dhe *Planit të Integritetit* për administratën e Kuvendit të Shqipërisë shënon një hap të rëndësishëm për forcimin e integritetit në administratën publike dhe se për hartimin e tyre janë marrë modelet dhe praktikat më të mira të parlamenteve të vendeve të rajonit dhe BE-së. Z. Gjonçaj theksoi se këto dy dokumente strategjike administrative synojnë të sigurojnë standarde të larta të sjelljes profesionale dhe integritetit të administratës së Kuvendit, si dhe të promovojnë pavarësinë dhe besueshmërinë në shërbimin ndaj qytetarëve. “Ky angazhim është një hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së vizionit dhe misionit të Kuvendit të Shqipërisë për një administratë publike me integritet dhe eficiencë të lartë. Kjo iniciativë është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të besimit të publikut në institucionet tona dhe përmirësimin e sistemit tonë të menaxhimit të integritetit”, – u shpreh z. Gjonçaj. Më tej ai nënvizoi se tanimë sfida mbetet zbatimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i tyre. Në përfundim të fjalës së tij



z. Gjonçaj falënderoi ekspertët, grupin e punës dhe shoqërinë civile për kontributin e dhënë në hartimin e këtyre dy dokumenteve të rëndësishme.

Ambasadori i Suedisë në Shqipëri, z. Niklas Ström, vlerësoi bashkëpunimin e mirë me Kuvendin e Shqipërisë, si dhe punën e bërë për hartimin e dy dokumenteve, për të cilat u shpreh se shënojnë një hap të rëndësishëm dhe të dobishëm për të pasur një administratë profesionale dhe kultivuar kulturën e integritetit dhe antikorrupsionit. Ai tha se forcimi i integritetit të administratës publike ka një rëndësi të veçantë, pasi lidhet ngushtësisht me procesin e integritetit në BE. Dy dokumentet, shtoi më tej ambasadori Ström, do t'i shërbejnë rritjes së llogaridhënies dhe transparencës, çka ndikon në rritjen e besimit të publikut ndaj Kuvendit, por dhe

ndaj institucioneve publike në përgjithësi.

Më pas z. Erion Muharremaj dhe znj. Eralda Çani (Methasani) prezantuan për pjesëmarrësit shtyllat kryesore të *Kodit të Sjelljes* dhe *Planit të Integritetit* për administratën e Kuvendit të Shqipërisë, punën e bërë nga ekspertët dhe administrata e Kuvendit për hartimin e tyre, objektivat strategjike që përmbajnë për përmirësimin e integritetit të institucionit etj.

Takimi vijoi me diskutime mbi përmbajtjen e këtyre dokumenteve dhe pritshmërinë publike ndaj institucionit.

Takimi u zhvillua në kuadër të projektit “Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike”, zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

# Administrata parlamentare dhe besimi publik, rëndësia e reformave etike

Kuvendi i Shqipërisë u ka dhënë përparësi reformave kundër korrupsionit përmes ndryshimeve kushtetuese, ratifikimit të konventave ndërkombëtare dhe miratimit të një kuadri të gjerë ligjor, si dhe ka vënë në plan të parë reformat që lidhen me qeverisjen e mirë në kuadër të procesit të integritetit në BE. Për mbarëvajtjen e punës së administratës së tij, me synim krijimin e një mjedisi të brendshëm me integritet dhe rritjen e besimit të publikut tek institucioni, Kuvendi ka hartuar dhe miratuar *Kodin e Sjelljes* dhe *Planin e Integritetit*.



Dr. Rovena SULSTAROVA  
Instituti për Demokraci  
dhe Ndërmjetësim



Transparenca dhe llogaridhënia e Kuvendit janë thelbësore për promovimin e kulturës së integritetit në administratën e tij. Këto aspekte ndihmojnë në krijimin e një mjedisi pune ku veprimet dhe vendimet e punonjësve janë të hapura dhe të monitorueshme. Duke zbatuar rregulla dhe standarde të qarta si *Plani i Integritetit* dhe *Kodi i Sjelljes*, Kuvendi siguron që të gjithë punonjësit të kenë pritshmëri të qarta për sjelljen e tyre dhe të ndihen përgjegjës për veprimet që kryejnë. Kultura e llogaridhënies rrit besimin e publikut, çka e bën më të lehtë parandalimin e sjelljeve joetike dhe korruptive.

Në periudhën qershor 2023–korrik 2024 një grup pune me punonjës të administratës së Kuvendit dhe me asistencën teknike të ekspertëve të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim hartoi *Kodin e Sjelljes* dhe *Planin e Integritetit* për administratën e Kuvendit. Rëndësia e këtyre dy dokumenteve strategjike dhe operative, të hartuara për herë të

parë në këtë institucion me asistencën e një organizate të shoqërisë civile, për administratën e Kuvendit është e shumëfishtë, por para së gjithash ato ndihmojnë:

Së pari, në forcimin e transparencës brenda administratës së Kuvendit. Duke përcaktuar qartë rregullat dhe pritshmëritë për sjelljen e punonjësve, *Plani i Integritetit* dhe *Kodi i Sjelljes* kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të besueshëm dhe profesional. Kjo është e rëndësishme për krijimin e një imazhi pozitiv për Kuvendin te qytetarët, të cilët kanë nevojë për të pasur besim në shërbimet publike.

Së dyti, këto dy dokumente kanë si qëllim parandalimin e sjelljeve që dëmtojnë integritetin e institucionit. *Plani i Integritetit* ofron një qasje strategjike për identifikimin e riskut dhe menaxhimin e tij, ndërsa *Kodi i Sjelljes* përcakton vlerat dhe etikën që duhet të ndjekin punonjësit e administratës. Kjo ndihmon në ruajtjen e një klime ku përgjegjshmëria dhe etika janë në qendër të administratës.

Së treti, *Plani i Integritetit* dhe *Kodi i Sjelljes* promovojnë angazhimin e punonjësve në procese vendim-marrëse dhe në ndjekjen e standardeve etike. Kur punonjësit janë të përfshirë në hartimin e këtyre dokumenteve dhe kur ndihen të angazhuar në zbatimin e tyre, krijohet kultura e përgjegjshmërisë dhe bashkëpunimit. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që çdo individ të kuptojë rolin e tij në ruajtjen e integritetit të institucionit dhe të ndihmojë në ndërtimin e një administrate parlamentare më të përgjegjshme dhe më efikase.

Cilat janë risitë e *Kodit të Sjelljes* për administratën e Kuvendit?

*Kodi i Sjelljes* për administratën e Kuvendit përfaqëson një avancim të rëndësishëm në forcimin e standardeve etike dhe të përgjegjshmërisë. Qasja gjithëpërfshirëse në hartimin e tij, që përfshin pjesëmarrjen aktive të punonjësve, përbën një aspekt që vlen të veçohet. Nëpërmjet

“ Duke zbatuar rregulla dhe standarde të qarta si *Plani i Integritetit* dhe *Kodi i Sjelljes*, Kuvendi siguron që të gjithë punonjësit të kenë pritshmëri të qarta për sjelljen e tyre dhe të ndihen përgjegjës për veprimet që kryejnë. Kultura e llogaridhënies rrit besimin e publikut, çka e bën më të lehtë parandalimin e sjelljeve joetike dhe korruptive. ”

kësaj qasje ky dokument pasqyron nevojat dhe pritshmëritë e punonjësve të administratës dhe rrit angazhimin për zbatimin e tij.

*Kodi i Sjelljes* fokusohet në vlerat që shoqëria pret nga administrata e Kuvendit, të tilla si: ndershmëria, transparencja dhe shërbimi ndaj interesit publik. Kjo i jep këtij dokumenti një kuptim më të thellë dhe e bën atë më të lidhur me misionin e Kuvendit. *Kodi i Sjelljes* karakterizohet nga qartësia në përmbajtje, pasi shmang përgjithësimet dhe ofron rregulla të detajuara, të cilat lehtësojnë kuptimin dhe zbatimin nga çdo punonjës i administratës së Kuvendit.

Një aspekt tjetër është kërkesa për vullnetin politik dhe angazhimin e stafit politik të Kryesisë së Kuvendit në zbatimin e *Kodit të Sjelljes*. Promovimi nga stafi politik i sjelljes së mirë është e domosdoshme për të krijuar një kulturë të fortë etike, ku shembujt pozitivë shërbejnë si referencë për të gjithë punonjësit. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi të besueshëm dhe përgjegjës në Kuvend.

Nga ana tjetër, *Plani i Integritetit* paraqet një qasje strategjike duke u bazuar në vlerësimin e riskut të integritetit për të gjitha proceset e punës. Kjo e bën atë një instrument proaktiv, i cili identifikon dhe mundësitë për sjellje pa integritet dhe promovon forcimin e integritetit si

prioritet. Ashtu si në rastin e Kodit të Sjelljes, angazhimi aktiv i lidershit politik në procesin e hartimit dhe zbatimit të *Planit të Integritetit* garanton zbatimin rigoroz të tij nga administrata e Kuvendit.

Metodologjia për hartimin e *Planit të Integritetit* rekomandon përfshirjen e punonjësve në procesin e hartimit përmes *fokus-grupeve* dhe pyetësorëve anonime, duke siguruar që opinioni dhe sugjerimet e punonjësve të merren parasysh. Kjo krijon një ndjenjë të përbashkët të pronësisë mbi *Planin e Integritetit* dhe e bën zbatimin e tij më efektiv, pasi punonjësit janë më të prirur të respektojnë rregullat dhe të kontribuojnë në forcimin e integritetit kur ndihen të angazhuar në proces. Pra, dy dokumentet kontribuojnë në ndërtimin e një administrate më të besueshme e të përgjegjshme dhe përmirësojnë shërbimin ndaj qytetarëve.

Këto dy dokumente ndihmojnë gjithashtu në luftën kundër korrupsionit, i cili përfshin abuzimin me pushtetin për përfitime personale. Korrupsioni është një kërcënim serioz për demokracinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ai minon besimin e publikut tek institucionet shtetërore dhe pengon përparimin ekonomik e social. Përballja me këtë fenomen kompleks kërkon një qasje të koordinuar dhe strategjike, që përfshin politika të qarta, procedura

të forta dhe një kulturë organizative të shëndoshë. Në këtë kontekst, Kuvendi, si organi kryesor ligjvënës, ka një rol të rëndësishëm në ruajtjen e integritetit dhe të besueshmërisë së institucioneve publike.

Administrata e Kuvendit vepron si një strukturë mbështetëse për garantimin e transparencës dhe të

veprimet e tyre dhe janë të vetëdijshëm për pasojat e sjelljeve joetike dhe joprofesionale, ata janë më të prirur të veprojnë në përputhje me vlerat etike. Kjo ndihmon në ndërtimin e një administrate që promovon raportimin e veprimeve të dyshimta dhe mbështet një atmosferë të hapur dhe të sqartë. Për më tepër, administrata ofron

besueshmërisë, që janë të rëndësishme për ndërtimin e besimit mes qytetarëve dhe institucioneve publike. Kur administrata e Kuvendit është e hapur për veprimet e saj dhe ofron informacione të qarta mbi vendim-marrjen, qytetarët ndihen më të sigurt se përfaqësuesit e tyre po veprojnë në përputhje me interesin e përbashkët. Kjo besueshmëri është e domosdoshme për një funksionim të shëndoshë të demokracisë, sepse krijon një lidhje të fortë mes Kuvendit dhe publikut. Besimi i ndërtuar në këtë mënyrë jo vetëm forcon qëndrueshmërinë e politikëbërjes, por e bën më të lehtë zbatimin e politikave dhe të reformave të nevojshme për zhvillimin e shoqërisë.

Transparenca ndihmon në parandalimin e korrupsionit dhe të abuzimit me pushtetin. Kur proceset dhe vendimet janë të dukshme për publikun, rreziku i veprimeve korruptive zvogëlohet. Llogaridhënia krijon një sistem mbikëqyrjeje, ku qytetarët dhe mediet mund të monitorojnë veprimet e administratës së Kuvendit, duke kontribuar kështu në krijimin e kulturës së përgjegjshmërisë. Mënyra se si raporton dhe merr përgjegjësi për vendimet e saj administrata e Kuvendit është një faktor i rëndësishëm në rritjen e integritetit institucional.

Një administratë parlamentare transparente dhe llogaridhënëse inkurajon angazhimin e qytetarëve. Kur individët ndihen se kanë qasje në informacion dhe mundësi për të shprehur mendimin e tyre, ata janë më të prirur të marrin pjesë në proceset demokratike. Kjo rrit pjesëmarrjen dhe kontribuon në hartimin e politikave që përmbushin nevojat reale të shoqërisë. Angazhimi i qytetarëve krijon një mjedis ku zërat e ndryshëm, përfshirë ata të grupeve më të margjinalizuara, mund të dëgjohen dhe të kontribuojnë në debatin publik. Ky angazhim ndihmon në forcimin e demokracisë dhe garanton që administrata të jetë më e përgjegjshme dhe më e afërt me nevojat e popullit.

**“ Një administratë parlamentare transparente dhe llogaridhënëse inkurajon angazhimin e qytetarëve. Kur individët ndihen se kanë qasje në informacion dhe mundësi për të shprehur mendimin e tyre, ata janë më të prirur të marrin pjesë në proceset demokratike. Kjo rrit pjesëmarrjen dhe kontribuon në hartimin e politikave që përmbushin nevojat reale të shoqërisë. ”**

integritetit në proceset legislative. Ajo është përgjegjëse për krijimin e një mjedisi pune që promovon ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë. Në këtë kuadër, *Kodi i Sjelljes* dhe *Plani i Integritetit* i ndihmojnë punonjësit të kuptojnë dhe respektojnë standardet e larta të sjelljes në administratën publike.

Një aspekt i rëndësishëm i funksionit të administratës së Kuvendit është monitorimi i proceseve administrative dhe angazhimi proaktiv në identifikimin e risqeve të integritetit. Kjo përfshin analiza të rregullta dhe vlerësime të riskut për të parandaluar sjelljet joetike. Duke analizuar proceset dhe identifikuar pikat e dobëta, administrata mund të marrë masa parandaluese, si dhe të rrisë rezistencën institucionale ndaj risqeve të integritetit.

Nëpërmjet këtyre dy dokumenteve administrata promovon një kulturë të hapur për raportimin e shkeljeve, duke inkurajuar punonjësit të ndihen të sigurt për të raportuar çdo rast të dyshimtë pa pasur frikën e ndëshkimeve. Kur punonjësit ndihen të përgjegjshëm për

mbështetje për edukimin e punonjësve mbi vlerat etike dhe standardet e sjelljes. Programet e trajnimit dhe të edukimit rreth etikës dhe risqeve të integritetit ndihmojnë në ndërtimin e një baze të fortë për parandalimin e këtij fenomeni. Këto iniciativa përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e punonjësve dhe i bëjnë ata më të vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre dhe për pasojat që ato mund të kenë për Kuvendin dhe shoqërinë.

Përballja me korrupsionin nuk është një përgjegjësi që i takon vetëm administratës së Kuvendit. Bashkëpunimi me agjencitë e tjera qeveritare, me shoqërinë civile dhe me institucionet ndërkombëtare është i rëndësishëm për të krijuar një qasje të unifikuar në luftën kundër korrupsionit. Këto partneritete mund të ndihmojnë në ndarjen e praktikave më të mira, në forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e transparencës në proceset vendimmarrëse.

Siç thamë më lart, këto dy dokumente ndihmojnë në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe

## Reforma Zgjedhore

# Konstituimi i Komisionit të Posaçëm për Realizimin e Reformës Zgjedhore

**K**omisioni i Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore u ngrit me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 12/2022 me detyrë hartimin e ndryshimeve legjislative për reformën zgjedhore, në veçanti trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe për zgjedhjet e mëparshme të patrajuara, të rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet, të partive politike parlamentare dhe të organizatave jofitimprurëse.

Bazuar në këtë vendim, Komisioni i Posaçëm do të ngrihet mbi bazën e barazisë pozitive-opozitive dhe do të përbëhet nga 16 anëtarë, nga të cilët 8 do të ishin përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, 6 përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar "Aleanca për Ndryshim", 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar "Demokraci dhe Integrim". Komisioni i Posaçëm do ta ushtronte veprimtarinë e tij për një afat gjashtëmuor dhe do të drejtohej nga dy bashkëkryetarë: një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike, përkatësisht Damian Gjicknuri dhe Enkelejd Alibeaj. Pranë Komisionit do të ngrihet grupi i ekspertëve teknikë, përbërja dhe funksionimi i të cilit do të përcaktohej me vendim të vetë Komisionit. Për çështje të veçanta, për të cilat palët nuk do të gjenin konsensusin e nevojshëm, mund të kërkohej ekspertiza e OSBE-ODIHR-it dhe e Komisionit të Venecias. Por me vendimin nr. 48/2022 u bë një ndryshim në përbërjen e Komisionit nga 16 në 18 anëtarë, nga të cilët 9 përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, 6 përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar "Aleanca për Ndryshim", 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar "Demokraci dhe Integrim" dhe 1 deputet i pavarur.



Sipas këtij vendimi, përbërja e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore ishte si më poshtë:

- Damian Gjicknuri – bashkëkryetar (PS)
- Enkelejd Alibeaj – bashkëkryetar (PD)
- Arben Pëllumbi – anëtar (PS)
- Blendi Klosi – anëtar (PS)
- Blerina Gjylameti – anëtare (PS)
- Dashnor Sula – anëtar (PD)
- Ermonela Felaj – anëtare (PS)
- Etilda Gjonaj – anëtare (PS)
- Fatmir Mediu – anëtar ("Aleanca për Ndryshim")
- Grida Duma – anëtare (PD)
- Klevis Xhoxhi – anëtar (PS)
- Klotilda Bushka – anëtare (PS)
- Kreshnik Çollaku – anëtar (PD)
- Lindita Metaliaj – anëtare (PD)
- Oerd Bylykbashi – anëtar (PD)
- Petrit Vasili – anëtar (deputet i pavarur)
- Shpëtim Idrizi – anëtar ("Demokraci dhe Integrim")
- Toni Gogu – anëtar (PS)

Vendimi përcaktonte edhe anëtarët zëvendësues për rastet kur ndonjë prej anëtarëve të mësipërm për arsye të ndryshme nuk do të merrte pjesë në mbledhjet e Komisionit, respektivisht: Eralda Bano (PD), Ervin Salianji (PD), Jurgis Çyrbja (PS), Seladin Jakupllari (PD), Xhemal Qefalia (PS).



# Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore filloi punën

**Pas konstituimit Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore filloi punën nën drejtimin e bashkëkryetarëve Damian Gjiknuri dhe Enkelejd Alibeaj me pjesëmarrjen e**

**shumicës së anëtarëve të tij dhe në prani të ambasadorit të OSBE-së, i cili ka qenë një mbështetës i vazhdueshëm i çështjeve të reformave zgjedhore në Shqipëri.**

**N**ë zbatim të vendimeve të Kuvendit nr. 12/2022 dhe nr. 48/2022, Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore funksionoi në frymën bipartizane dhe i merrte vendimet me shumicë votash, por kuptohet që vendimet ishin konsensuale. Që një vendim të ishte i vlefshëm, duhej të pranohej nga të dy bashkëkryetarët.

Me vendimet nr. 12/2022 dhe nr. 48/2022 Kuvendi përcaktoi objektin e Komisionit të Reformës Zgjedhore, që ishte zbatimi i rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it për reformat e mëparshme zgjedhore, të cilat për arsye të mos gjetjes së konsensusit politik për disa çështje nuk u

zbatuan. “Fatkeqësisht, dua të them se ne nuk kemi mundur t’i adresojmë të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it për ato arsye që dihen, sepse nuk u gjet dakordësia politike për disa pika. Disa rekomandime për zgjedhjet e vitit 2022 do të jenë në themel të punës së Komisionit dhe më pas palët mund të diskutojnë edhe për çështje që mund të ngrihen gjatë debatit për reformën zgjedhore, ose që mund të sugjerohen nga aktorë joqeveritarë apo organizata jofitimprurëse që janë të përfshira në procesin zgjedhor. Unë jam i bindur se ne do të bëjmë maksimumin për të gjetur zgjidhjet më të mira që përmirësojnë

proceset zgjedhore. Në vendimin e Kuvendit është shkruar se ne do të kërkojmë mbështetje edhe nga organizmat e tjerë apo partnerët që na kanë mbështetur dhe na kanë inkurajuar për procesin e reformës zgjedhore, siç janë ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësia e Bashkimit European dhe Këshilli i Europës. Unë së bashku me bashkëkryetarin e propozuar nga opozita, z. Alibeaj, do t’u drejtohem me një shkresë zyrtare të gjitha organizmave për të na ofruar asistencë, dikush me ekspertizë e dikush me mbështetje të çfarëdolloj natyre, me qëllim që të na ndihmojnë në punën tonë në këtë proces”, – tha z. Gjiknuri. Më

## **Damian GJIKNURI:**

Disa rekomandime për zgjedhjet e vitit 2022 do të jenë në themel të punës së Komisionit dhe më pas palët mund të diskutojnë edhe për çështje që mund të ngrihen gjatë debatit për reformën zgjedhore, ose që mund të sugjerohen nga aktorë joqeveritarë apo organizata jofitimprurëse që janë të përfshira në procesin zgjedhor. Unë jam i bindur se ne do të bëjmë maksimumin për të gjetur zgjidhjet më të mira që përmirësojnë proceset zgjedhore.

duhet të flasim me konkluzione dhe në bazë të qëndrimeve të vazhdueshme që ka mbajtur secila palë për zgjedhjet, sepse konsideratat politike janë të tilla. Ligji zgjedhor në vetvete është një ligj që reflekton vullnete politike dhe nuk është një ligj që ka një model të caktuar, që duhet ta ndjekim. Përveç disa parimeve të pranueshme, gjithçka tjetër reflekton edhe situatën konkrete politike, edhe dëshirat politike të palëve, por gjithmonë duhet të jenë brenda disa standardeve, prandaj ne kërkojmë ekspertizën e OSBE–ODIHR-it për të afruar palët drejt gjetjes së zgjidhjeve të pranueshme”, – theksoi në fjalën e tij z. Gjikhuri.

Në fjalën e tij bashkëkryetari Enkelejd Alibeaj theksoi se veprimtaria e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore duhej të



tej ai shtoi se Komisioni kishte mandat për ta ushtruar veprimtarinë e tij në një afat gjashtëmuor, por në mungesë të konsensusit për çështje të caktuara ky afat mund të shtyhej, ashtu siç ndodhi në të vërtetë.

Z. Gjikhuri hodhi idenë për të pasur 4 deri 6 ekspertë të propozuara nga partitë politike pjesëmarrëse në Komision, dy prej të cilëve duhej të

ishin ekspertë për çështjet teknike. “Unë natyrisht që do të doja të reflektoja edhe dëshirat e bashkëdrejtuesit të Komisionit të Posaçëm, sepse është shumë normale që këtë Komision ne ta drejtojmë në mënyrë të bashkërenduar dhe të shmangim debatet e tepërta politike. Le t’ua lëmë këto debate partive politike, pra le t’i lëmë jashtë kësaj salle, pasi kjo është një sallë ku ne

orientohet në dy çështje: i) krijimi i një procesi sa më gjithëpërfshirës; dhe ii) bashkëpunimi me OSBE–ODIHR-in dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë. “E para ka të bëjë me krijimin e një procesi sa më gjithëpërfshirës. Në funksion të kësaj, edhe vetë përbërja e Komisionit të Reformës Zgjedhore, për aq sa ka mundësiar edhe tradita e kaluar, përbëhet pothuajse nga të gjitha grupet

parlamentare dhe përfaqësitë politike në parlament. Së dyti, duke iu referuar rendit të ditës, unë kam kërkuar dhe kam gjetur dakordësinë e bashkëkryetarit që përveç dërgimit të një kërkesë zyrtare ndaj OSBE-ODIHR-it, që është një traditë e kalçifikuar, bazuar edhe në vendimin e Kuvendit, ne do t'u drejtojmë të njëjtën kërkesë dhe me të njëjtët parametra dhe ekstremitete edhe organizmave ndërkombëtarë të tjerë dhe konkretisht (bashkëkryetari i tha, por po e theksoj edhe një herë për efekt të dokumentimit): Këshillit të Europës, Komisionit të Venecias, përfaqësuesit e Bashkimit Europian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, – tha z. Alibeaj.

Z. Alibeaj ka kërkuar rritjen e numrit të ekspertëve në Komision nga 4 ekspertë në 6. Ndërkohë ai ka pohuar se duhet të jetë një vlerë, e cila duhet t'i bashkojë, edhe mënyra



## Enkelejd ALIBEAJ:

E rëndësishme është që zbatimi i kësaj reforme të jetë në të njëjtën linjë me kuadrin ligjor, kuadrin normativ që do të miratohet. Ajo është një sfidë më vete, ndoshta edhe sfida më e madhe. Duhet të jetë e qartë për këdo se ky vend ka bërë dhe bën gjithmonë reforma zgjedhore, ligje gjithmonë e më perfekte, ligje gjithmonë e më të latuara, por ajo që ka rëndësi është zbatimi i ligjeve elektorale, ky është cedimi. Sigurisht që kjo pastaj është edhe një çështje e vullnetit të institucioneve, sigurisht edhe të partive politike.



se si do të interpretohet zbatimi në praktikë i rekomandimeve OSBE-ODIHR-it në zgjedhjet e vitit të kaluar. “Është e vërtetë që shtylla kryesore e Komisionit për Reformën Zgjedhore nuk është thjesht dhe vetëm puna e lënë përgjysmë dy vjet e ca më parë, por janë rekomandimet e OSBE-ODIHR-it të lëna në zgjedhjet e fundit. Në dritën e të gjitha zhvillimeve elektorale, kryesisht ato të

zgjedhjeve të vitit të kaluar, besoj se ka nevojë për t'u riparë në një optikë të re, në mënyrë që instrumentet për t'i zbatuar të gjitha rekomandimet e fundit të OSBE-ODIHR-it, por edhe ato të mëparshmet, të shihen në një panoramë më të qartë, më të plotë, bazuar edhe në eksperiencën e freskët të krijuar nga palët, nga partitë politike, por edhe nga publiku në zgjedhjet e vitit të kaluar”, – është

shprehur z. Alibeaj. Me tej ai ka shtuar se reforma zgjedhore nuk është thjesht dhe vetëm një reformë që u përket palëve politike. Sipas tij, palët politike janë aktorët kryesorë, aktorët e drejtpërdrejtë, por duhet parë si një shërbim që duhet t'i bëhet publikut shqiptar dhe vetë Shqipërisë, që më në fund të demonstron pikësëpari kuraja për një reformë zgjedhore që si bazë ligjore të ketë krijuar të paktën të gjithë pranueshmërinë. “E rëndësishme është që zbatimi i kësaj reforme të jetë në të njëjtën linjë me kuadrin ligjor, kuadrin normativ që do të miratohet. Ajo është një sfidë më vete, ndoshta edhe sfida më e madhe. Duhet të jetë e qartë për këdo se ky vend ka bërë dhe bën gjithmonë reforma zgjedhore, ligje gjithmonë e më perfekte, ligje gjithmonë e më të latuara, por ajo që ka rëndësi është zbatimi i ligjeve elektorale, ky është cedimi. Sigurisht që kjo pastaj është edhe një çështje e vullnetit të institucioneve, sigurisht edhe të partive politike”, – ka vijuar fjalën e tij bashkëkryetari i Komisionit për Reformën Zgjedhore Enkelejd Alibeaj.

# Mendime të anëtarëve të Komisionit të Posaçëm për Reformën zgjedhore

**A**nëtar i Komisionit Fatmir Mediu u shpreh që në fillim se, para të fillonin të merreshin me detajet, anëtarët e Komisionit duhej të binin dakord paraprakisht se duhej të synonin që në përfundim të punës t'i kthenin kushtetutshmërinë Kuvendit. “Ajo çka i mungon këtij parlament është kushtetutshmëria. Ky nuk është më një parlament i zgjedhur, por një parlament i emëruar. Në qoftë se nuk do ta nxjerrim këtë parlament nga procesi i emërimit dhe t’u kthejmë qytetarëve të drejtën për të deleguar autoritetin e tyre, përfaqësinë e tyre në Kuvend nëpërmjet zgjedhjes dhe garës, mendoj se ne do të kemi gjithmonë një problem të vazhdueshëm në kushtetutshmërinë e parlamentit, në funksionimin politik të këtij parlamenti dhe në pluralizmin politik në tërësi. Mendoj se kjo është çështja e parë e reflektimit tonë, pra kthimi i parlamentit te qytetarët”, – u shpreh z. Mediu, i cili do të ndalej edhe në çështjen e garantimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, duke mos e parë si një çështje të përshkrimit apo procedurave që kërkon OSBE–ODHIR-i. “Ne e dimë cilat janë problemet gjatë procesit zgjedhor me shitblerjen e votës apo intimidimin e votuesve, për të cilat ne duhet të gjejmë patjetër praktikata më të mira për të shmangur që ligjin dhe vendimmarrjen në Shqipëri ta bëjnë grupet kriminale”, – tha ai.

● Mediu do ta cilësonte sistemin zgjedhor aktual si një sistem vrasar për pluralizmin politik, i cili ka tentuar gjithmonë, me mirëkuptimin e palëve, të eliminojë pluralizmin, të heqë mundësinë e organizimit dhe funksionimit normal demokratik të

partive të mëdha.

● Anëtar i Komisionit Oerd Bylykbashi në fjalën e tij ka kujtuar se 20 vjet më parë në të njëjtën sallë është mbledhur komisioni i parë bipartizan konsensual me të drejtën e vetos së dy palëve kryesore: maxhorancës dhe opozitës. “Në vitin 2000 (është mirë të kujtohem për këto, të mos jemi në një histori, sikur përsëritim veten gjithmonë) Kodi Zgjedhor i parë i Republikës së Shqipërisë është bërë në mënyrë të njëanshme. Mazhoranca e asaj kohe nuk mori parasysh

shprehur shqetësimin e tij për mosgjatjen e gjuhës së përbashkët për miratimin e një ligji zgjedhor të gjithëpranuar. “Nëse ky është modeli që do të funksionojë sërish, në një mënyrë ose një tjetër, ky Komision sot nuk ka kuptim. Pra, ajo që arrihet me dakordësi për politikën reale, për atë se ku janë votat, qëndron, në të kundërt në tallemi me opinionin publik, me votuesit”, – theksoi ai.

Duke u ndaluar në rekomandimet e OSBE–ODHIR-it dhe marrjen e tyre në konsideratë, z. Bylykbashi



interesat themelore të opozitës reale dhe më pas, në një gjë të ngjashme në vitin 2020, tradhtoi punën që ishte bërë deri në një moment të caktuar së bashku dhe vendosi e vetme siç deshi rregullat për zgjedhje”, – u shpreh z. Bylykbashi.

Më tej ai u ndal në evolucionin e ligjit për zgjedhjet vendore dhe

theksoi se reforma zgjedhore nuk mund të jetë një pazar, as i paravendosur, as i vendosur përgjatë punës së këtij komisioni. “Nuk duhet të jetë si fundi i reformës së vitit 2020, ku, për fat të keq, një pazar nuk ndryshoi thjesht Kodin Zgjedhor, por shkatërroi një sistem zgjedhor. Ndoshta ai duhej ndërruar, por në

parim rregullat e lojës nuk ndërrohen në mënyrë të njëanshme”, – tha z. Bylykbashi. Ai kërkoi që të punohej së bashku për të përcaktuar rregulla loje për qindra mijë zgjedhës, jo për 18 anëtarët e Komisionit apo 140 deputetët e Kuvendit. “Reformat duhet të bëhen për të zgjidhur problemet. Nëse kjo reformë zgjedhore do të shërbejë për të krijuar krizë politike, është më mirë të mos nisë sesa të jetë themeli i një krize që do të na çojë edhe një herë pas 20 vjet të shkuar”, – përfundoi fjalën e tij z. Oerd Bylykbashi.



● Deputeti Petrit Vasili, anëtar i Komisionit të Posaçëm, u shpreh se kjo reformë nuk duhej të ishte tualeti politik i radhës, por të zgjidhte realisht problematikat e proceseve zgjedhore në Shqipëri. “E them këtë sepse e shkuara që lamë pas, e afërt, jo e largët, tregoi se edhe kur kemi adresuar rekomandimet e OSBE–ODIHR-it, disa prej tyre edhe në mënyrë të plotë, pritshmëria për një efekt pozitiv të tyre ka qenë zero. Për fat të keq, në disa raste ka qenë më keq sesa ishte më parë. Ky është një paradoks, të cilit i duhet dhënë fund. Besoj se nuk jemi mbledhur të bëjmë teatrin apo tualetin e radhës. Është fare e qartë se nuk kemi një institucion vote që konsolidohet nga njëri proces në tjetrin, por një institucion vote që bie dhe rrënohet poshtë e më poshtë, aq sa është fakt që disa fenomene shumë të rënda, që teorikisht duhej të shkonin drejt shuarjes së tyre, u rishfaqën si kurrë ndonjëherë. Dy ishin në mënyrë konkrete: shitblerja e votës dhe shpërdorimi flagrant i administratës”, – u shpreh z. Vasili

në fjalën e tij. Më tej ai do të theksonte se anëtarët e Komisionit duhej të kontribuonin me vetëdijen që institucioni i votës të kthehet atje ku duhet, në mënyrë që të mbizotërojë vullneti i qytetarëve. “Shqipëri do të ketë edhe pas nesh, – vazhdoi z. Vasili, – por problemi është se çfarë Shqipërie lëmë pas: të keqe, të degraduar apo të pashpresë? Shërimi i demokracisë fillon te vota dhe mirëqenia e një vendi sigurohet atëherë kur qytetarët votojnë për ata që u besojnë dhe u heqin besimin atyre që nuk u besojnë. Nëse do t’ua kthejnë përsëri, e zgjedhin ata. Kjo është e njëqinda reformë zgjedhore. Në kaq vjet pluralizëm jemi dëshmi e një turpi të votës, se normalisht kjo punë duhej të mbaronte me kohë dhe cilido sistem zgjedhor të zgjidhnim, po të ishte një votë e ndershme, korrekte, e pajedhur, e padeformuar dhe e pashkatërruar, mund të mbizotëronte. Të gjitha sistemet demokratike janë në themel të tyre, pavarësisht modelit. Të gjithë janë përdredhur për t’i ardhur vërdallë bastardimit të votës, duke bërë ndryshime sistemesh. Ky është problemi.”

● Deputetja Klotilda Bushka, përfaqësuese e Partisë Socialiste në Komision, e ka cilësuar ngritjen e Komisionit të Posaçëm si një nga vendimet më të plota, që, sigurisht, lë hapësirë për diskutim, por tregon se cilat janë standardet, cila është ekspertiza dhe OSBE–ODIHR-i, Këshilli i Europës dhe Komisioni i Venecias do të kërkohen të jenë të ftuar për të qenë pjesë e këtij procesi në ndihmë të Komisionit. Ajo u shpreh se ky duhej të ishte komision i fundit parlamentar që do të realizonte pritshmëritë e qytetarëve për reformën zgjedhore, që do t’u kthente atyre besimin te sistemi zgjedhor dhe në legjislaturën e ardhshme të mos lindë nevoja e një komisioni tjetër për procesin zgjedhor. “Reforma zgjedhore bëhet që të rritet besimi i publikut te sistemi zgjedhor, që integriteti i votës të jetë i

garantuar dhe që demokracia të jetë përfaqësuese, duke respektuar të gjitha standardet. Kuptohet që konsensusi është ai që duhet të mbizotërojë, përveç vullnetit, në punën e këtij Komisioni. Vullneti nuk është çështje dëshirash, ashtu sikurse konsensusi nuk është çështje egosh, komentesh, kritikash apo perceptimesh. Ka standarde për reformat zgjedhore, për sistemet zgjedhore, që e ndihmojnë konsensusin”, – do të shpreh znj. Bushka, e cila më tej do të theksonte se ka një sërë opinionesh shumë të mira për shumë çështje të reformës zgjedhore, që tashmë janë të administruara në Kuvend dhe duhej të merreshin në konsideratë nga Komisioni. “Ne nuk po e nisim nga zeroja, ato janë të bazuara në standarde, janë bërë me ekspertët vendas dhe të huaj, me ndihmën e partnerëve tanë në OSBE, në Këshillin e Europës. Janë materiale shumë të mira, të cilat, kur nuk ka konflikt, janë një ndihmë e madhe për të rënë dakord, sepse janë standarde të gjithëpranuara ndërkombëtarisht dhe, siç e thashë në fillim, reforma nuk është çështje dëshirash, as idesh, por çështje standardesh.”

● Anëtari Dashnor Sula, pasi bëri një përmbledhje të jetës dhe punës së tij në politikë, punës së komisioneve parlamentare për reformën zgjedhore të mëparshme, u shpreh se ka ardhur koha që t’i jepet fund lojës politike me vendimet e këtyre komisioneve sipas interesave të caktuara. “Mendoj dhe kam gjykimin se ka ardhur koha që duhet të bëjmë reformë në interes të qytetarëve shqiptarë dhe jo demagogji. Duhet të marrë fund demagogjia që në Shqipëri të votojmë vetëm ne dhe familjarët tanë që kanë mbetur këtu. Duhet të votojnë emigrantët shqiptarë kudo ku janë. Është moment historik, sepse këtu ka ngelur një pjesë e shoqërisë dhe punonjësit e administratës, të cilët votojnë sipas intimidimit që u bën pushteti, sipas forcës që tregon pushteti për të qëndruar në punë dhe për interesat e vogla që kanë. Pjesa

tjetër blihet, dhe kjo është fatkeqësi”, – u shpreh z. Sula.

Më tej ai kërkoi që çështja e votimit elektronik duhet të zgjidhet përfundimisht, pasi jemi i vetmi vend në rajon që vazhdojmë të votojmë me metodat e vjetra, në një kohë kur qeveria propagandon digjitalizimin e çdo sektori në Shqipëri. Për z. Sula votimi elektronik, numërimi elektronik dhe votimi i emigrantëve ishin tri çështje për të cilat duhej të gjendej konsensusi mes anëtarëve të Komisionit dhe t’u jepej zgjidhje përfundimisht.

● Anëtarja Blerina Gjylameti u kërkoi bashkëkryetarëve dhe anëtarëve të Komisionit të Posaçëm gjetjen e mirëkuptimit për t’u dhënë zgjidhje problematikave që janë vërejtur në proceset zgjedhore. “Besoj se ky është një komision që ka për qëllim kryesor të nxisë dhe të përmirësojë besimin e qytetarëve shqiptarë në proceset zgjedhore,



besim për të cilin pikësëpari ne politikanët duhet të kemi kujdes, sepse dëmin e kemi bërë ne shumë më tepër nga ç’mund ta bëjnë qytetarët. Kështu që duhet të mos e paragjykojmë”, – u shpreh znj. Gjylameti. Ajo theksoi rëndësinë e votimit të emigrantëve, votimit elektronik dhe identifikimit elektronik. “Këtu nuk jemi në tryezë për të ndarë pushtetin, këtu nuk jemi as për të

diskutuar se cila nga forcat politike gëzon besimin e qytetarëve më shumë se forcat e tjera, këtu jemi për të zgjidhur problematikat, për zbatuar rekomandimet e OSBE–ODIHR-it, në mënyrë që të kemi një proces zgjedhor të besueshëm, por besimi nuk fitohet duke akuzuar njëri-tjetrin apo duke paragjykuar procesin që në krye të herës”, – ka përfunduar fjalën e saj znj. Gjylameti.

## SEANCA DËGJIMORE

# Seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet zgjedhore

Në mbledhjen e datës 9.02.2024 Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore zhvilloi një seancë dëgjimore *online* me përfaqësues të disa organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet zgjedhore.

Bashkëkryetari Damian Gjijnuri bëri të ditur se kjo ishte mbledhja e radhës e Komisionit të Posaçëm dhe kushte si objekt dëgjimin e të gjitha organizatave joqeveritare që ndër vite kanë qenë pjesëmarrëse aktive në proceset zgjedhore. Ai tha se këto organizata kanë një historik marrëdhëniesh me reformën

zgjedhore dhe janë bërë pjesë aktive e proceseve zgjedhore.


Bashkëkryetari Enkelejd Alibeaj, pasi u uroi mirëseardhjen përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në këtë panel *online* diskutimi, tha se kjo mënyrë do t’u jepte atyre mundësinë optimale të shprehnin të gjitha opinionet, pikëpamjet dhe këndvështrimet e tyre për rekomandimet e OSBE–ODIHR-it, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe çështje të tjera të konstatuara prej tyre gjatë proceseve zgjedhore në Shqipëri.

Propozimet e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile u

përqendruan te problematikat që kanë lindur me zbatimin e Kodit Zgjedhor në fuqi gjatë zgjedhjeve parlamentare vitit 2021 dhe atyre vendore të vitit 2023, si: përdorimi i burimeve publike në fushatë nga partia në pushtet dhe nga drejtuesit lokalë, politizimi i administratës zgjedhore dhe transparenca e financimeve të partive politike dhe të kandidatëve etj. Disa organizata kërkuan të përcaktohet në Kodin Penal ndalimi i përfitimeve edhe para zgjedhjeve vendore. Po ashtu ato këmbëngulën në nevojën e zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për garantimin e së

drejtës së votës të shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë, një temë që shkaktoi debate në Komision.


● Diskutimet nisën me fjalën e kryetarit të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), z. Premto Gogo, i cili tha se KRIIK-u nuk është organizatë që merret vetëm me procesin zgjedhor,



por edhe me liritë dhe të drejtat politike të qytetarëve shqiptarë për pjesëmarrje efektive në proceset demokratike, një e drejtë kjo e garantuar nga Kushtetuta. “Unë nuk e di sa do ta arrijë ky Komision të sjellë diçka ndryshe, pasi ne gjykojmë se nuk ka asnjë ndryshim nga komisioni i ngritur një vit e gjysmë më parë, nuk ka asgjë ndryshe në përbërjen e tij dhe nuk janë marrë në konsideratë rekomandimet që ne kemi paraqitur në qershor të vitit 2022, përpara se ju të organizonit mbledhjen e parë”, – u shpreh zoti Gogo. Për këto arsye ai propozoi rikompozimin e Komisionit të Posaçëm, ku partitë politike parlamentare të kishin një përfaqësim më të vogël në numër, por më efikas, me qëllim që të rritej efikasiteti i punës së Komisionit dhe të bëhej e mundur “një reformë zgjedhore jo thjesht për zgjedhjet e vitit 2025, por edhe për të përmbushur angazhimet politike që kanë marrë forcat politike për të pasur një Kod të ri Zgjedhor, për të pasur një ligj të ri për partitë politike, një ligj për financimin dhe për referendumet”.

● Përfaqësuesja e Shoqatës për Kulturë Demokratike (SHKD) Gerta Meta e quajti të pakuptimtë modelin e politikës shqiptare që, sa herë ka zgjedhje, flitet për reformë zgjedhore. Më tej ajo u ndal tek e drejta e votës së emigrantëve dhe vuri në pikëpyetje vullnetin politik për ta realizuar. “Ne, aktorët e shoqërisë

civile në tërësi dhe organizata që unë përfaqësoj, e kemi mbështetur iniciativën për realizimin e votës së diasporës, meqenëse e kemi edhe si detyrim në Kodin Zgjedhor që nga zgjedhjet e vitit 2021, por ndoshta duhet një presion edhe më i fortë. Nuk e di se si do ta gjejmë mekanizmin për t’ju vënë në lëvizje si Kuvend i Shqipërisë për të përmbushur detyrimet e vendim-marrjes së Gjykatës Kushtetuese”, – u shpreh ajo. Znj. Meta u ndal edhe në financimin e partive politike, votimin dhe numërimin elektronik, depolitizimin e administratës, komisionerët partiakë dhe koalicionet parazgjedhore. “Thembra e Akilit e reformës zgjedhore, për të cilën besoj se biem



të gjithë dakord, është financimi i partive politike. Patjetër që kemi pasur diskutime për mënyrën se si qarkullojnë paratë në proceset zgjedhore në Shqipëri. Ndoshta ka ardhur koha të ndalohen rreptësisht financimet me hije të treta, të cilat nuk deklarohen dhe nuk kanë asnjë lloj transparence. Të shkohet deri në ashpërsimin e penaliteteve”, – propozoi znj. Meta. Ajo ngriti shqetësimin për patronazhistët, për burimet shtetërore, për përdorimin e burimeve njerëzore në fushatat elektorale, çështje që e kanë prekur standardin e zgjedhjeve në Shqipëri, ku nga procesi në proces vazhdimisht janë bërë tentativa për ta përmirësuar, edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.


Drejtori ekzekutiv i Akademisë së Studimeve Politike (ASP), Erion Tase, prezantoi propozimet e organizatës së tij dhe të Institutit për Studime Politike (ISP) për mekanizmat e kontrollit të përdorimit të burimeve publike në fushatë. Ndër të tjera ai propozoi që

monitorimi i rolit të administratës në zgjedhje dhe i përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë duhet të bëhet nëpërmjet një mekanizmi të pavarur jashtë KQZ-së, si Avokati i Popullit, ILDKPKI-ja, prokuroria. Po ashtu ai propozoi shtrirjen e monitorimit nga data e dekretit të Presidentit dhe zbutjen e kriterëve të hyrjes në zgjedhje për prurjet e reja politike dhe kandidatët e pavarur. Më tej z. Tase u kërkoi deputetëve që Komisioni për Reformën Zgjedhore të jetë transparent në marrëdhëniet me organizatat, të krijojë një format regjistrimi për të gjitha propozimet që sjellin organizatat dhe të japë përgjigje të argumentuara për arsyet pse rekomandimet e tyre janë të pazbatueshme.

● Financimi i partive politike në fushatat elektorale nga palët e treta, çka rrezikon financimin nga burime të dyshimta, ishin në qendër të propozimeve të Institutit Demokratik Amerikan (NDI). Propozimet e drejtorit për programet e partive politike dhe zgjedhjet në NDI, z. Vildan Plepi, fokusoheshin në kuadrin rregullator të financave të partive dhe financave zgjedhore. Ai kërkoi një reformë të plotë të legjislacionit, jo vetëm të Kodit Zgjedhor, por edhe të ligjit për partitë politike dhe të Kodit Penal, ose të shihet mundësia e një legjislacioni të posaçëm për financimin. Një nga shqetësimet e ngritura nga z. Plepi lidhej me financimet e huaja, transaksionet me kriptovaluta dhe nga donatorë fiktivë, që përdorin kanale të ndryshme për të dhuruar fonde me origjinë të dyshimtë.

● Përfaqësuesi i qendrës “Qëndresa Qytetare”, z. Rigels Xhemollari, në diskutimin e tij u ndal në përdorimin e administratës publike në fushatat zgjedhore dhe kërkoi që të hiqet në Kodin Zgjedhor togfjalëshi “përdorim i detyruar”, sepse lë hapësirë që burimet njerëzore të përfshihen në fushatë lirisht. Po ashtu, duke iu referuar denoncimeve gjatë fushatës së fundit, ai kërkoi ashpërsimin e sanksioneve ndaj zyrtarëve publikë që përdorin institucionin në funksion të fushatës.

● Të njëjtin shqetësim ngriti edhe përfaqësuesi i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, z. Erdion Maçolli. “Vlerësojmë se ndalimi i përdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale duhet të rishikohet në Kodin Zgjedhor, duke e shtrirë këtë ndalim që prej datës së dekretimit të zgjedhjeve”, – propozoi ai. Z. Maçolli foli edhe për nevojën e



depolitizimit të komisioneve zonale, rishikimin e ligjit për partitë politike, për shpërndarjen e ndihmës financiare dhe ndalimin e përdorimit të kasetave të gatshme të partive nga mediet, të cilin e quajti cenim të së drejtës së publikut për t’u informuar në mënyrë të paanshme.



● Përfaqësuesi i Lëvizjes “Shpreson”, Altin Goxhaj, e filloi fjalën e tij me kërkesën që në Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore të thirreshin përfaqësues të INSTAT-it për të paraqitur të dhënat e censit mbi numrat elektorale në Shqipëri. “Çdo diskutim për një reformë zgjedhore, ku njëra palë disponon informacion të plotë, që është mazhoranca, dhe palët e tjera nuk e disponojnë këtë informacion, është njëllë si të futesh në një lojë kur ti nuk e di me sa veta do të luajë ekipi tjetër, ti nuk e di se çfarë rregullash ka loja, sepse numrat janë ata që përcaktojnë edhe strukturën bazë të reformës zgjedhore dhe të procesit zgjedhor”, – u shpreh z. Goxhaj. Ai

bëri të ditur se propozimet e tyre do t’i paraqitnin edhe në formën e një projektligji të firmosur nga deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, duke i marrë me radhë sipas çështjeve dhe janë përfshirë në titullin “Propozime për reformën zgjedhore që garantojnë mosprekjen e Kushtetutës nga mazhoranca dhe moscenimin e votës nga patronazhimi” Z. Goxhaj iu kthye edhe një herë rëndësisë që ka vota e emigrantëve, si e vetmja mundësi që kanë shqiptarët për të besuar se edhe në Shqipëri mund të funksionojë procesi zgjedhor.


● Përfaqësuesi i organizatës “Drejtesi Sociale”, z. Gentian Sejrani, në fjalën e tij u përqendrua te shqetësimet e paraqitura në raportin e OSBE–ODIHR-it për përdorimin e administratës publike. Ai kërkoi që njoftimi i zgjedhësve të bëhet nëpërmjet postës dhe jo nëpërmjet punonjësve të administratës publike. Z. Sejrani foli edhe për pakicat rome dhe egjiptiane, për të cilat tha se janë pakicat më të marginalizuara e më të diskriminuara. Për të siguruar përfaqësimin e tyre në qeverisjen vendore, ai propozoi që të kenë përfaqësuesit e tyre në këshillin bashkiak. “Mungesa e përfshirjes politike të këtyre dy pakicave ka prodhuar një sërë pengesash dhe problemesh, që rëndojnë më shumë apo shpien në riprodhimin e vazhdueshëm të gjendjes së tyre ekonomike e sociale. Në këto rrethana, është e vështirë që partitë politike të kenë një kuptueshmëri të çështjeve dhe veçorive specifike të këtyre pakicave”, – u shpreh z. Sejrani.

● Përfaqësuesi i organizatës “Shqipëria Bëhet”, z. Ervis Çela, paraqiti propozimet për ndryshime dhe shtesa në Kodin Zgjedhor për të siguruar barazinë e votës, për listat e hapura, përcaktimin e gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë një zonë të vetme zgjedhore, vendosjen e sistemit proporcional kombëtar në zgjedhje. Ai foli edhe për votën e shqiptarëve që jetojnë jashtë

Shqipërisë. “Në kuadër të lëvizjes së lirë të personave, ne nuk mund të kërkojmë që ata të jenë fizikisht në Shqipëri për të votuar, nga ana tjetër, nuk mund t’ua kufizojmë këtë të drejtë kushtetuese. Mendojmë se instrumentet me të cilat mund të realizohet votimi janë plotësisht të mundura, pasi nuk na duhet të shpikim një instrument të tillë, por vetëm të marrim praktikat më të mira të vendeve të rajonit”, – tha z. Çela.

● Në emër të kësaj organizate foli edhe z. Adriatik Lapaj, i cili u ndal kryesisht te vota e emigrantëve, për të cilën paraqiti një projektligji. “Nuk po themi se ky projektligji është më i miri. Jemi shumë të hapur ta diskutojmë me të gjithë kolegët këtu, edhe me partitë politike. Nuk e kemi fare problem. Ne kemi bërë punën tonë dhe, për të mos folur në ajër, kemi sjellë një gjë të shkruar, kështu që për votën e diasporës jemi absolutisht pro, me duar e me këmbë”, – tha z. Lapaj. Më tej ai foli për çështjen e hapjes së listave, për të cilën tha se “mungesa e këtyre listave ka sjellë probleme me demokracinë në Shqipëri”.

● Në këtë takim ishte e pranishme edhe përfaqësuesja e rrjetit “Barazi në Vendimarrje”, z. Edlira Çepani, e cila në fjalën e saj u ndal në problematikat reale të përfshirjes së grave dhe vajzave në listat e kandidatëve të partive politike. “Problematika e parë është se në statutet e partive politike nuk parashikohet



garancia e aksesit të barabartë të grave dhe vajzave në financat e partive politike. Nga të dhënat, nga intervistat dhe nga eksperiencat e kandidatëve në të tria këto palë zgjedhje rezultojnë se gratë dhe vajzat kandidate kanë pasur zero akses në financat publike të partive politike”, – u shpreh znj. Çepani.

# Seancë dëgjimore me përfaqësues të partive politike

Në datën 14 shkurt 2024 Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të partive politike. Në fjalën e tij bashkëkryetari socialist Damian Gjicknuri u bëri të ditur të pranishmëve se qëllimi i seancës dëgjimore ishte konsultimi me të gjithë aktorët politikë për çështje të reformës zgjedhore përpara konsultimit me aktorët institucionalë, për të kaluar më pas në ekspertizën teknike. Ndërsa bashkëkryetari demokrat Enkelejd Alibeaj kërkoi marrjen e një informacioni më të plotë nga KQZ-ja, jo thjesht dhe vetëm për të përcaktuar listën e të gjitha partive politike, por për të gjetur pikat e kontaktit të tyre. “E vetmja gjë që dua t’i them secilit prej kolegëve përfaqësues të partive politike është se sigurisht që ka lirinë për të shprehur opinionet e tij mbi gjithçka që mendon për ndryshimet eventuale në reformën zgjedhore, por duhet pasur parasysh se në fokus duhet të jenë çështjet që janë objekti i veprimtarisë së këtij komisioni: *së pari*, të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it; dhe *së dyti*, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, pa u kufizuar në çështje të tjera, që mund t’i konsideroni të vlefshme dhe të dobishme”, – u shpreh z. Alibeaj.

● Në fjalën e tij z. Eduard Abazi, përfaqësues i Partisë “Aleanca Demokratike”, u fokusua në disa prej shqetësimeve që i janë adresuar Komisionit. Fillimisht ai u ndal në vlerësimin real të votave përmes një korrektimi në rang kombëtar. Më pas z. Abazi foli për administrimin e zgjedhjeve dhe kërkoi të hiqet dorë nga administrimi i tyre vetëm nga partitë

politike.

Një tjetër çështje ku u ndal z. Abazi ishte ajo e listave të hapura, për të cilën u bë debat se ç’duhet të kuptojmë me “lista të hapura” se dhe sa të hapura duhet të jenë. “Ato quhen ‘të hapura’ për një pjesë, për atë që mendohet, sepse është vendosur një artificë përmes një herësi, që unë e quaj ‘ngërç’, me anë të të cilit bëhet përzgjedhja e kandidatëve në momentin që mbyllet procesi i votimit. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në qershor të vitit 2021 e ka shfuqizuar në mënyrë të pjesshme”, – u shpreh ai.

Regjistrimi i subjekteve, i koalicioneve, mediet, listat e zgjedhësve, financimi i fushatave zgjedhore, që nga faktori ndërkombëtar është cilësuar si thembra e Akilit, ishin disa problematika të tjera të trajtuara prej z. Abazi. “Të gjitha subjektet politike në fund të proceseve zgjedhore bëjnë një raport të shpenzimeve financiare gjatë fushatës, por na rezultojnë se ato raportojnë vetëm atë fond që kanë pasur dhe pastaj thonë se kanë pasur edhe këta donatorë apo mbështetje nga persona të tjerë”, – tha ai.

Për çështjen e votës së shqiptarëve jashtë atdheut ai ka kërkuar të merret përvoja e vendeve përreth, duke filluar nga Kosova, dhe të bëhen përpjekje që votimi i tyre të bëhet i mundur në zgjedhjet e ardhshme. Rëndësi të veçantë i kushtoi z. Abazi realizimit të një filtri real moral dhe ligjor për kandidatët që marrin pjesë në zgjedhje.

● Në katër pika e përqendroi diskutimin e tij kryetari i Partisë “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, z. Dashamir Shehi. Zgjerimi i zonave zgjedhore dhe vendosja e sistemit proporcional kombëtar, sipas z. Shehi, do të bënin të mundur që zgjedhjet në Shqipëri të sillnin një ndryshim rrënjësor.

Për listat e hapura ai u shpreh se ato duhet të hapen deri në fund, në mënyrë që “ligji përveç proporcionalitetit të punojë edhe si mazhoritar, sepse një listë e hapur presupozohet se ka brenda edhe proporcionalitetin”.

Rëndësi i kushtoi z. Shehi edhe votimit elektronik. “Këtu ka njerëz që kanë dyshime për elektronikën. Është e vërtetë që mund të ndodhin probleme, siç ka ndodhur me komisionerët pothuajse në të gjitha proceset zgjedhore. Nuk është më hipotetike se çfarë do të bëhet me komisionerët, sepse ata përsëri do t’i futin duart në zgjedhje. Praktikisht zgjedhjet i kontrollojnë ata që kanë komisionerët, ata që kanë më shumë komisionerë, që i kanë më të paguar, që i kanë më të zotë. Kjo lloj historie duhet të mbarojë një herë e mirë në Shqipëri. Ta bëjmë votimin elektronik aty ku mund të bëhet këtë radhë”, – u shpreh z. Shehi dhe më poshtë vijoi: “Ne po flasim për modernizimin e administratës publike, për bankat, që po luajnë miliona nëpërmjet elektronikës, kurse, kur vjen puna te votimi, kjo është e dyshimtë. Ky më duket një justifikim i kotë. Unë jam për votim elektronik dhe sigurisht që partitë kanë gjithë të drejtën të bëjnë verifikimin e procesit më pas.”

Më poshtë z. Shehi u ndal në votën e emigrantëve dhe propozoi që votimi të bëhet me postë elektronike ose me letër. “Një numër i madh shqiptarësh jetojnë jashtë, kontribuojnë, kanë dy nënshtetësi, kurse disa nuk e kanë marrë nënshtetësinë e vendit tjetër dhe janë akoma me nënshtetësi shqiptare. T’ua japim këtë mundësi këtyre shqiptarëve, të cilët për një mijë arsye, që ne i dimë, janë në emigracion, atëherë më tepër që kjo dallgë po vazhdon. Pra, duhet të gjejmë

një shteg që të paktën ta fillojmë këtë punë. Nuk po them se do të jetë perfekte që herën e parë, por të krijohet një lloj eksperience”, – përfundoi z. Shehi.

● Kryetari i Partisë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, z. Kristaq Kiço, në fillim të fjalës së tij iu referua qershorit të vitit të kaluar, kur u publikua opinioni i Këshillit të Europës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, ku krahas problematikave të tjera ngrihej edhe çështja e përfaqësimit të minoriteteve në rrafshin kombëtar. “Është një shqetësim i veçantë, thuhet në opinion, që njerëzit që u përkasin pakicave kombëtare kanë shumë pak mundësi për të dëgjuar zërin e tyre në nivel kombëtar, ndaj masat pozitive për të siguruar ose lehtësuar përfaqësimin e tyre do të ishin të mirëpritura”, – tha z. Kiço. Ai kërkoi që të gjendet mënyra dhe formula e duhur që minoritetet të kenë përfaqësuesit e tyre në parlamentin shqiptar dhe të sigurohet vota e emigrantëve, pasi minoriteti është i prekur më shumë nga emigracioni, siç është rasti i minoritetit grek, pjesa më e madhe e të cilit ndodhet në Greqi.

Në diskutimin e tij z. Kiço ngriti edhe çështjen e administrimit të zgjedhjeve, ku kërkoi depolitizimin e komisioneve zgjedhore dhe ndjekjen e gjithë procesit në vazhdimësi.

● Edhe sekretari i Partisë “Fryma e Re Demokratike”, z. Xhafer Seitî, kërkoi depolitizimin e komisioneve zgjedhore dhe mospërfaqësimin nga partitë politike qoftë në komisionet e numërimit, qoftë në nivelet e tjera të votimit në zgjedhje. Për zgjidhjen e këtij problemi ai propozoi përfshirjen në këto komisione të juristëve të pavarur. Gjithashtu ai propozoi numërimin elektronik, listat e hapura, rishikimin e zonave zgjedhore, të mos ndodhë ndryshimi i qendrave të votimit për zgjedhësit 60 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe të kenë mundësinë për të votuar të gjithë shqiptarët që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kryetari i Aleancës “Demokracia e Re”, z. Edmond Stojku, kërkoi një ligj të ri zgjedhor dhe u shpreh dakord me listat e hapura, barazinë e votës, të drejtën e votës së shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe propozoi që Shqipëria të jetë një zonë zgjedhore. Për të shmangur shtrembërimin e delegimit të votës nga njerëzit e përzgjedhur nga radhët e militantëve të partive politike, z. Stojku kërkoi depolitizimin e komisioneve zgjedhore dhe mospërdorimin e administratës publike në proceset elektorale.

● Barazia e votës ishte një nga propozimet e bëra nga kryetari i “Nismës Thurje”, z. Endrit Shabani.

Sipas tij, sot vota e qytetarit të Kukësit nuk është e barabartë me votën e qytetarit të Tiranës apo të Dibërës, që është ngjitur me Kukësin. Një gjë të tillë ai e quajti antikushetuese, pasi Kushtetuta e përcakton qartë se vota e çdo shtetasi shqiptar ka të njëjtën peshë. Duke iu referuar Kosovës, e cila ka garantuar një sistem proporcional kombëtar me lista plotësisht të hapura dhe me votimin e kosovarëve që jetojnë në diasporë, ai kërkoi të mos ketë ndarje rajonale. “Kushtetuta ka krijuar kushte që zgjedhësi të ketë pushtetin për të zgjedhur brenda listës së partisë, pra partia propozon një listë dhe zgjedhësi ka mundësi ta përmbysë këtë listë. Unë besoj se mënyra se si e ka interpretuar Gjykata Kushtetuese ka ardhur pasi ajo ka parë që vendosja e herësit, sidomos me këtë nivel kaq të lartë votash, në fakt e ka bërë të pamundur këtë zgjedhje. Pra, teorikisht zgjedhësi ka mundësi ta ndryshojë, por teknikisht pragu është aq i lartë, sa pamundësohet e drejta që jepet nga Kushtetuta, pra një hierarki ligjore shqiptare”, – u shpreh z. Shabani.

Lidhur me idenë e primit zgjedhor, sipas të cilit do të thotë partia që merr më shumë vota duhet të marrë deputetë shtesë për të krijuar stabilitet, ai u shpreh kundër, sepse “në thelb deformon vullnetin e zgjedhësit”.

## Seancë dëgjimore me organizata të diasporës

**K**omisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore në datën 20 shkurt zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave të diasporës që merren me çështjet zgjedhore.

● Në fillim të kësaj seancë bashkëkryetari Damian Gjinkuri u bëri të ditur pjesëmarrësve se qëllimi i seancës ishte të merrej mendimi i tyre se si mund të realizohet votimi i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Tashmë, tha z. Gjinkuri, vota e

shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit është përfshirë në Kodin Zgjedhor, por Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se ka boshllëqe ligjore dhe afate të paqarta dhe kërkon që Kuvendi t'i plotësojë këto boshllëqe. Më tej ai shtoi se lista e zgjedhësve në Shqipëri përfshin të gjithë shtetasit që marrin pjesë në zgjedhje. Kjo do të thotë se çdo shtetas shqiptar që ka një adresë qoftë në Republikën e Shqipërisë, qoftë jashtë saj, por që është i regjistruar në regjistrin e

gjendjes civile, sipas Kodit aktual Zgjedhor, është zgjedhës potencial dhe ka të drejtë të votojë. “Çfarë boshllëku doni që të plotësojmë ne si Kuvend nëpërmjet Kodit Zgjedhor përveç ndonjë afati, që patjetër mund të shtohet? Pra, çfarë kërkoni nga Kuvendi i Shqipërisë? Procesi i zbatimit të votës së diasporës apo të qytetarëve shqiptarë në distancë është një proces teknik dhe Kuvendi nuk mund të përcaktojë çdo lloj detaji, por mund të vendosë


parime që do t’ia delegojë administratës zgjedhore, në këtë rast KQZ-së, për ta bërë të mundur këtë proces”, – u tha z. Gjijnuri pjesëmarrësve në këtë seancë dëgjimore.

● Bashkëkryetari Enkelejd Alibeaj u kërkoi përfaqësuesve të organizatave të diasporës që të vinin në dispozicion

gjithë shtetasit e tjerë? Çështja e fundit, sepse po përiqem t’i sistemoj, është regjistrimi. Sot janë 19 mijë. Brenda 3 vjetve ky numër do të jetë më i madh, sepse interesi i pjesës më të madhe të shqiptarëve është t’u jepet mundësia që të kontribuojnë, të shprehin vullnetin e tyre përmes votës. Edhe këta 19 mijë nuk duhet të

sime, që jetoj në Zvicër, me të një shqiptari që jeton në Shqipëri. Më e drejta është që kjo votë të shkojë në zonën ku qytetarët kanë qenë të regjistruar së fundi, siç e kanë shumica e vendeve të botës. Ju sjell këtu shembullin e Britanisë së Madhe, e cila para një muaji e kaloi këtë ligj, ku edhe fëmijët që kanë lindur jashtë kanë të drejtë të votojnë në zonën ku prindi ka qenë i regjistruar së fundi në Britani. Ky është i njëjti model që propozojmë ne përmes këtij projektligji”, – u shpreh ndër të tjera z. Bledar Milaqi.

● Eksperti kushtetues dhe hartuesi kryesor i projektligjit të paraqitur nga organizata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”, z. Klodian Rado, njëkohësisht dhe hartuesi i relacionit për votën e diasporës, duke u ndalur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, tha se për hartimin e projektligjit kishin studiuar disa modele të vendeve të tjera dhe ishin përpjekur të përzgjidhnin modelin që rregullon në mënyrë të plotë votimin e diasporës në Shqipëri. “Ne krijuam një grup pune me ekspertë nga vende të ndryshme dhe pamë modelet dhe praktikat më të mira të disa vendeve. Ne nuk menduam se do të shpiknim rrotën për Shqipërinë, por të gjenim atë lloj modeli që ishte më i përshtatshëm për Shqipërinë. E pamë me shumë kujdes edhe modelin e Kosovës, por modeli që i përshtatet më mirë realitetit shqiptar na u duk ai gjerman, i cili ka po ato komponente që ne i kemi pasqyruar edhe në projektligj”, – tha z. Rado në fjalën e tij. Më tej ai foli për regjistrin e votuesve dhe mënyrën e ushtrimit të votës. “Numërimi është një element që ne e kemi parë me shumë kujdes, sepse, përderisa është me postë, kuptohet që numërimi bëhet atje ku numërohen të gjitha vota e shqiptarëve. Pavarësisht se nga cili kontinent i botës vjen vota e shqiptarëve, ajo ndahet qartësisht sipas vendbanimit të fundit që ka pasur shqiptari, që mund të jetë në Australi apo diku tjetër, dhe, në qoftë



të Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore çdo dokument që kishin përgatitur.

● Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, znj. Anila Hyka (Smorgrav), përmendi bashkëpunimin me KQZ-në dhe me disa organizata të tjera për hartimin e akteve nënligjore për këtë çështje. Ajo propozoi plotësimin e dispozitave nga Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore dhe kërkoi zbatimin e tyre. Duke iu referuar praktikave zgjedhore të vendeve të tjera, znj. Hyka bëri të ditur se nga dita kur fillon fushata zgjedhore shtetasit kanë një afat gjashtëmuor që të deklarojnë adresën ku duhet t’u mbërrijë letra për votimin, brenda apo jashtë vendit. “Në këto dispozita duhet t’u jepet mundësia studentëve shqiptarë, që mund të vijnë paktën një herë në vit, të votojnë në vendet ku ata jetojnë. Çështja e dytë që ndoshta duhet diskutuar është: a do të futet pjesa e shtetasve shqiptarë që janë në kushte procesi, si të thuash, të paligjshëm, që ndoshta kanë kërkuar azil, por nuk e kanë të drejtën si të

përjashtohen nga procesi i votimit në vitin 2025. Për sa kohë e lejon Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, është mundësia e implementimit në vitin 2025. Sugjerimi ynë është të miratohet dhe të zbatohet sa më parë vendimi i Gjykatës Kushtetuese”, – u shpreh znj. Anila Hyka.


● Sekretari i përgjithshëm i organizatës “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”, z. Bledar Milaqi, në fjalën e tij tha se nuk ishin të interesuar vetëm për votën e diasporës, por për krejt reformën zgjedhore, sepse ka të bëjë direkt me peshën e votës së diasporës. Ai bëri të ditur përpilimin e një projektligji për plotësime në Kodin Zgjedhor, të cilin ua shpërndau përfaqësuesve të partive politike në Kuvend. “Për mendimin tonë, pesha e votës së diasporës, për të qenë kushtetuese, duhet të jetë siç është për votuesit brenda Shqipërisë. Pra, jemi totalisht kundër variantit që 1,7 milion shqiptarë, që qarkullon sot si numër, të votojnë për një numër të caktuar deputetësh, sepse kjo do të humbte peshën e diasporës dhe nuk do ta bënte të barabartë peshën e votës

se vendbanimi i tij ka qenë Kukës, ajo do të numërohet si votë e Kukësit. Kjo siguron mosprekjen e parimit kushtetues të nenit 45 të barazisë së votës së shqiptarëve, nuk ka rëndësi nëse personi ndodhet në Kukës, në Tiranë, në Australi apo në një vend tjetër të botës. Po të flasim për kuota, duhej të kishte një barazi logjike të numrit të votuesve me përfaqësuesit në parlament. Ne nuk themi që 50% e vendeve në parlament të jenë të zgjedhur nga diaspora, por themi që vota të numërohet atje ku është, si votë shqiptari, dhe të ketë peshën e një vote siç e kërkon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, – tha z. Klodian Rado.

● Drejtuesi i organizatës “Diaspora Shqiptare Voton”, z. Arban Shala, duke folur si qytetar shqiptaro-amerikan, në fjalën e tij ndër të tjera tha: “Ne kemi të drejtë jo vetëm të votojmë, por dhe të marrim pjesë në procesin elektoral. Ne kemi punuar me komisionin zgjedhor amerikan për gati 10 vjet dhe qëllimi ynë është që të sjellim eksperiencën amerikane në Shqipëri, sepse Amerika, si një shtet shumë i madh kontinental, edhe me shtete në oqeanin paqësor, si Havai, është *case study* shumë i mirë për rastin tonë, që kemi popullsinë shqiptare në Shqipëri dhe një pjesë të madhe të popullsisë në Europë, në Amerikë, në Kanada dhe në Angli.”

Më tej ai tha se vota e diasporës nuk është diçka e re, pasi ka qenë që në themelimin e shtetit shqiptar, pasi dy anëtarë të parlamentit shqiptar, Faik Konica dhe Fan Noli, ishin nga diaspora dhe kanë dhënë kontributin e tyre. Për z. Shala vota e diasporës është një e drejtë e mohuar, sepse kështu i intereson politikës shqiptare. “Është e pajustificueshme që KQZ-ja të nxjerrë justifikime, si për shembull, nuk bëhet, nuk dinë e të tjera, sepse ne kemi të pranishme këtu organizata që janë shumë të suksesshme në këtë fushë dhe mund ta përfundojnë shumë shpejt, brenda pak muajsh, këtë proces”, – u shpreh z. Shala në vijim të fjalës së tij.

# Seancë dëgjimore me përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit



Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore në datën 27.02.2024 zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

● Bashkëkryetari Damian Gjokuri në fjalën e tij u shpreh se ishte një seancë pune me tri institucione të rëndësishme, që kanë rol vendimtar në zbatimin e Kodit Zgjedhor, ndërsa bashkëkryetari Enkelejd Alibeaj kërkoi

që dëgjuesit të tilla të bëheshin dhe me institucionet e tjera që merren me miradministrimin e procesit zgjedhor.

● Më pas e mori fjalën Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, z. Ilirian Celibashi, i cili kërkoi që Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore të diskutonte rreth vendimit të Gjykatës Kushtetuese për votimin e shtetasve që jetojnë jashtë vendit dhe vendimit për shfuqizimin e dispozitës së Kodit Zgjedhor për herësin, kufirin prej 10 mijë votash për votën preferenciale.

Komisioneri solli në vëmendje të



Komisionit se një nga çështjet që kërkonte zgjidhje ishte krijimi i mundësive për të ushtruar të drejtën e votës për votuesit që për arsye objektive nuk mund të shkojnë në qendrat e votimit. “Do të vazhdojmë t’i lëmë pa votuar, apo do t’u krijojmë mundësi të votojnë? Janë rreth 30 mijë votues shqiptarë që për arsye objektive nuk e kanë të mundur të paraqiten në qendrat e votimit për të ushtruar të drejtën e votës”, – tha ai.

Z. Celibashi theksoi edhe domosdoshmërinë e përmirësimit të dispozitave që lidhen me fushatën zgjedhore për shtypin e shkruar dhe rrjetet sociale, pasi Kodi Zgjedhor parashikon dispozita vetëm për mediet tradicionale: radion dhe televizionin. Ai theksoi gjithashtu se duhet të plotësohen rregullat që lidhen me financimin e fushatës zgjedhore, si dhe të bëhen ndryshime në ligjin për regjistrimin fillestar të partive politike. “Partitë që nuk kanë marrë asnjë mandat në tri zgjedhjet e fundit duhet të paraqesin një listë me nënshkrime mbështetëse”, – tha z. Celibashi. Më tej ai kërkoi nga Komisioni i Posaçëm që në Kodin

Zgjedhor të përcaktohej vendi i numërimit të votave dhe të shihej me përparësi mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisioneve zgjedhore në nivelet e dyta e të treta, të përcaktohej qartë nëse do të përbëhen nga njerëz që vijnë nga partitë politike apo do të kemi një formulë ndryshe. Gjithashtu ai shtroi nevojën që komisionerët dhe sekretarët e komisioneve zgjedhore të jenë të trajnuar dhe të certifikuar nga KQZ-ja. “Në raport me qartësinë dhe integritetin e procesit ne kemi probleme, që vijnë nga mënyra se si janë organizuar këto komisione. Duke pasur parasysh situatën politike, mendoj se është ende herët për t’i larguar tërësisht partitë politike nga administrimi i procesit zgjedhor. Por, nga ana tjetër, komisionet e dyta dhe të treta duhet të kenë një organizim që u jep mundësi partive politike të jenë prezente dhe të kenë një dorë administrimi në procesin zgjedhor, por fjala e fundit, të paktën në aspektin teknik, t’i besohet KQZ-së. Mendoj se është pak herët që procesi zgjedhor të mund të administrohet tërësisht nga punonjës të shërbimit civil.

Kemi nevojë që partitë politike që kanë peshë elektorale të kenë përfaqësuesit e tyre”, – tha z. Celibashi, i cili më tej theksoi se duhen përcaktuar në Kod rregullat për sjelljen e zyrtarëve dhe të drejtuesve të institucioneve publike në fushatën zgjedhore. “Ka pasur edhe kritika nga vëzhgues ndërkombëtarë dhe vendas, prandaj ka nevojë që të ketë përcaktime më të qarta për veprimtaritë që u ndalohen funksionarëve publikë për një periudhë të caktuar”, – tha ai.

● Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, z. Vangjush Stavro, në fjalën e tij u shpreh se procesi i hartimit të listave zgjedhore është edhe një proces elektronik, i cili merr kohën e vet, por që ka një integritet të lartë. “Të gjitha të dhënat e shtetasve ndodhen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Zyrat e gjendjes civile i përpunojnë këto të dhëna, i administrojnë dhe i përditësojnë. Po ashtu edhe elementet zgjedhore, të cilat përcaktojnë qendrën e votimit ku do të paraqiten shtetasit, dhe elementet e tjera. Fakti që kemi disa

lista apo disa ekstrakte zgjedhore ndihmon shumë në rafinimin e ekstraktit përfundimtar, sepse deklarohen shtetasit që janë mbi 100-vjeçarë e nuk mund të votojnë. Gjatë kësaj periudhe ata duhet të shkojnë në zyrën e gjendjes civile dhe të deklarojnë se janë gjallë, pastaj mund të votojnë. Pra, i gjithë procesi garanton një integritet të lartë”, – tha z. Stavro. Më tej ai foli për çështje të tjera të procesit e votimit dhe për deklarimin e adresës nga shtetasit që jetojnë jashtë vendit. Për këtë çështje dha sqarimet e saj znj. Nevila Repishti, drejtore e *e-Albania-s* në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. “*E-Albania* është pika e vetme e kontaktit që shërben si sportel *online* i ofrimit të të gjitha shërbimeve të institucioneve publike të aparatit qendror, ku një ndër ta është edhe shërbimi i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile për deklarimin e adresës”, – tha ajo. Më tej znj. Repishti sqaroi se *e-Albania* nuk ruan asnjë të dhënë, por është një transmetues midis qytetarit dhe të gjithë regjistrave elektronikë të institucioneve të ndryshme, që përdoren si instrument për të trajtuar këto aplikime dhe për të ofruar shërbimin nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

● Drejtori i Sigurisë Kibernetike në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, z. Enis Ylli, shpjegoi procesin e mbrojtjes së të dhënave në mënyrë proaktive dhe reaktive. “Me ‘mbrojtje proaktive’ kuptojmë kontrollin që ne bëjmë për higjienën e këtyre sistemeve elektronike, ku përpunohet informacioni i tyre, sigurisht pa pasur akses në informacion. Mbi bazën e këtij kontrolli ne sigurojmë që edhe në të ardhmen nuk mund të ketë probleme me sigurinë e informacionit. Përveç mbrojtjes proaktive është edhe mbrojtja reaktive, që kontrollon nëse ka tentativa për probleme në këto sisteme, në mënyrë që të bllokohen menjëherë nga ana jonë. Të gjitha sistemet elektronike shtetërore monitorohen nga Qendra Operacionale e Sigurisë”, – tha z. Ylli.

# Seancë dëgjimore me përfaqësues të institucioneve të tjera që merren me çështjet zgjedhore

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore zhvilloi një seancë dëgjimore me Autoritetin e Medieve Audiovizive, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Prokurorinë e Përgjithshme, Policinë e Shtetit dhe Departamentin e Administratës Publike.

● Bashkëkryetari i Komisionit Damian Gjoknuri në fjalën e tij kërkoi që fokusi i raportimit të këtyre institucioneve, që kanë përgjegjësi të shumëfishta jo vetëm për çështjet zgjedhore, duhet të jetë si të përmirësojnë rolin e tyre në zbatimin e legjislacionit zgjedhor.

● Bashkëkryetari Enkelejd Alibeaj tha se kjo ishte një seancë mjaft e rëndësishme, përmes së cilës Komisioni i Posaçëm do të njihej me përvojën, veprimtarinë dhe kompetencat e këtyre institucioneve në proceset zgjedhore.


Më pas seanca dëgjimore vijoi si një bashkëbisedim me përfaqësuesit e ftuar.

● Drejtori i Drejtorisë së Monitorimit dhe Analizës në Autoritetin e Medieve Audiovizive, z. Arben Muka, në fjalën e tij tha: “Në veprimtarinë tonë deri tani, përfshirë zgjedhjet e vitit 2021 dhe të vitit 2023, por edhe zgjedhjet e pjesshme, ne kemi operuar mbi bazën e metodologjisë së monitorimit, e cila hartohet nga

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të Kodit Zgjedhor. Mes AMA-s dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuesve, asistentëve dhe këshilltarëve të Komisionerit është bashkëpunuar për një periudhë shumë intensive, në mënyrë që metodologjia të ishte me këmbë në tokë, në kuptimin që kërkesat të bëheshin në bazë të infrastrukturës që zotëron aktualisht AMA. Pra, kërkesa për AMA-n është maksimalizuar në bazë të infrastrukturës që ne kemi në dispozicion.”

● Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës Financiare, z. Ervin Koçi, mes të tjerash tha: “Pavarësisht se si institucion ne kemi për detyrë parandalimin e pastrimit të parave e të produkteve që burojnë nga veprat penale si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, kjo nuk na ndalon që, pavarësisht se nuk kemi përgjegjësi direkte për fushatën zgjedhore, të trajtojmë rastet e dyshimta që mund të shfaqen gjatë fushatës zgjedhore, të cilat mund të vijnë nga entitetet raportuese, burime të tjera apo dhe nga partnerët ndërkombëtarë. Në rast se gjatë fushatës zgjedhore vërejmë se ka transaksione financiare ose aktivitete të dyshimta, e trajtojmë këtë çështje me përparësi dhe pastaj ia kalojmë institucioneve të tjera ligjzbatuese.”

● Zëvendësdrejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve,



huaja gjyqësore, konstatohen vonesa në paraqitjen e kërkesave, të cilat dalin tej kufirit të afatit të ushtrimit të detyrës nga deputetët apo anëtarët e këshillit.”

● Drejtori i Drejtorisë së Rendit Publik në Departamentin për Sigurinë Publike në Policinë e Shtetit, z. Ferdinand Mara, në fjalën e tij do të shprehej: “Do të thosha se detyrat e Policisë së Shtetit në procesin

z. Femi Sufaj, në fjalën e tij tha: “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka obligim të rëndësishëm garantimin e së drejtës së votës të personave nën kujdes që janë zgjedhës, të cilëve gjykata nuk ua ka mohuar të drejtën e votës. Në këtë kontekst, ne kryejmë një punë koordinuese, bashkëvepruese me shumë institucione të rëndësishme, si KQZ-në, KZAZ-të, me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, me Këshillin Europian dhe organizata të tjera të pavarura. Nëpërmjet mbështetjes së Komisionit Europian janë hartuar postera informues dhe sensibilizues për të ushtuar të drejtën e votës nga ata shtetas që janë me masa sigurie, si ‘arrest me burg’ ose të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim. Mendoj se të burgosurit kanë interes ta ushtrojnë të drejtën e votës, madje më shumë se qytetarët e lirë.”

● Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, tha: “Realizimi i një procesi transparent zgjedhor nënkupton jo vetëm zbatimin e legjislacionit specifik zgjedhor, por dhe respektimin e dy fushave të përgjegjësive së zyrës së Komisionerit: të drejtën për

informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, dy të drejta dhe liri themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ashtu siç e përcakton Kodi Zgjedhor, KQZ-ja, si një autoritet publik, në raport me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale është kontrollues në kuptimin e këtij kuadri rregullator, rrjedhimisht edhe veprimtaria përpunuese duhet të kryhet në respektim të parimeve dhe kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni i mbrojtjes së të dhënave personale.”

● Znj. Anila Leka, përgjegjëse e Sektorit të Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, ndër të tjera tha: “Në lidhje me procesin e verifikimit të plotë të kandidatëve që zgjidhen qoftë deputetë, qoftë anëtarë këshilli apo kryetarë të këshillave bashkiakë, problemi që ne vërejmë nuk është ligjor, por për shkak të procesit të verifikimit me autoritetet e huaja, i cili vonohet, ku verifikimi kryhet kryesisht për të dhëna për dënimet apo për masat e dëbimit të dhëna nga autoritetet e huaja ligjzbatuese. Për shkak të procedurës ligjore që ndiqet me autoritetet e

zgjedhor janë të përcaktuara qartë në vendimin nr. 12, datë 30.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe janë zbatuar në mënyrë të saktë, korrekte dhe objektive. Nuk kemi ndonjë gjë për të diskutuar në këtë takim. Nëse do të na lindë e nevojshme për të sjellë ndonjë propozim tonin, do t’ia bëjmë të ditur me shkrim Komisionit në një kohë sa më të shpejtë.”

● Znj. Marcela Kereku, drejtore e Drejtorisë së Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore në Departamentin e Administratës Publike, ndër të tjera tha: “Ligji ‘Për nëpunësin civil’ e përcakton qartë se nëpunësi ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike, por jashtë orarit zyrtar. Gjithashtu edhe ligji ‘Për rregullat e etikës’ në pjesën e veprimtarive të jashtme e ka të përcaktuar se mjafton që nëpunësit të marrin leje paraprake tek eprorët e tyre ose te njësitë e burimeve njerëzore dhe janë të lejuar të kryejnë veprimtari të jashtme. Përveç ligjit ‘Për rregullat e etikës’ edhe vendimi i Këshillit të Ministrave ‘Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të rregullave të etikës’ e ka të përcaktuar qartazi këtë gjë.”

# Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore nisi punën për projektin final të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor



Pas seanceve dëgjimore me përfaqësues të institucioneve që merren me çështjet zgjedhore, Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore në datën 7.03.2024 u mbledh për të diskutuar rreth hapave të mëtejshëm të punës së tij për hartimin e projektligjit final të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor.

Në fjalën e tij bashkëkryetari Damian Gjilkuri bëri përmbledhjen e bisedimeve intensive me të gjithë aktorët jopolitikë të përfshirë në reformën zgjedhore, por edhe me partitë politike që nuk janë pjesë e Kuvendit. Ai përmendi bashkëbisedimin me organizatat joqeveritare, me shoqatat e diasporës, me institucionet publike që kanë rol në proceset zgjedhore për produktin që duhet të nxjerrë Komisioni në përfundim të punës së tij.

Bashkëkryetari Enkelejd Alibeaj theksoi qëndrimin e selisë blu për votën e diasporës, për propozimin që Shqipëria në zgjedhjet e ardhshme të jetë një zonë e vetme elektorale, për votimin dhe numërimin elektronik dhe për listat e hapura.

Komisioni vendosi që në datat 13 dhe 14 mars 2024 të organizohej një tryezë e përbashkët me ekspertët e OSBE-ODIHR-it për të diskutuar rreth rekomandimeve të ODIHR-it dhe gjetjen e zgjidhjeve për votimin e zgjedhësve që

jetojnë jashtë Shqipërisë, për herësin dhe propozimet e tjera të partive politike për ndryshimin e zonave zgjedhore.

Me propozim të z. Damian Gjilkuri dhe miratimin e z. Enkelejd Alibeaj u vendos që në këtë tryezë të ishin të pranishëm vetëm ekspertët ligjorë të Komisionit të Posaçëm dhe ekspertët e partive politike.

Z. Gjilkuri e vlerësoi takimin me përfaqësuesit e ODIHR-it si një *çorëkshop* pune, i cili nuk duhet të kthehet në një tryezë të partive politike. Sipas tij, partitë do të dërgojnë ekspertët e tyre, të cilët do të fillojnë me rekomandimet dhe propozimet konkrete. Ai sugjeroi që anëtarët e Komisionit të mos ishin të pranishëm në takimin e ekspertëve të dy palëve për t'i lënë që të punonin të qetë. “Me qëllim intensifikimin e punës, së bashku me bashkëkryetarin (më pas do t’ia jap fjalën edhe atij, patjetër, por thjesht po e ngre në parim) kemi rënë dakord për një metodologji pune midis ekspertëve, jashtë trysnisë së zakonshme politike të tryezës së Komisionit, që së bashku me ekspertët e ODIHR-it, siç kemi rënë dakord edhe në formulimin e ngritjes së Komisionit për Reformën Zgjedhore, të punojmë bashkë me ekspertizën e ODIHR-it për çështje për të cilat palët mund të jenë të ndara, për të dhënë sugjerime në lidhje me

rekomandimet e ODIHR-it apo për çështje të tjera për të cilat ne biem dakord. Të mos harrojmë se kemi disa çështje themelore, që kanë të bëjnë me përmirësimin e listës së zgjedhësve, me metodologjinë për votën e diasporës, për të cilën ekspertët, duke marrë parasysh edhe konstatimet e Gjykatës Kushtetuese, do të na japin opinionet e tyre se cili është modeli më i mirë që mund të aplikohet në Shqipëri; me

implementimin e mëtejshëm të sistemit elektronik me një shtrirje më të gjerë, implikimet që vijnë apo mundësitë që janë për ta bërë këtë gjë; me çështje që kanë të bëjnë me rekomandime të tjera për një transparencë më të madhe, për problemet që kemi hasur në proceset e fundit zgjedhore etj.” – u shpreh z. Gjilkuri.

Bashkëkryetari Enkelejd Alibeaj në fjalën e tij përmendi çështjet që do të diskutonin me ekspertët e ODIHR-it. “Temat për të cilat ne kemi rënë dakord dhe në bazë të të cilave do të diskutojë grupi i përbashkët i ekspertëve dhe anëtarët e Komisionit janë: regjistrimi i subjekteve zgjedhore, regjistrimi i kandidatëve, numri i tyre për çdo zonë zgjedhore, zgjedhësit, përgatitja e listës zgjedhore, shqyrtimi i propozimit lidhur me votën e diasporës, skemat e mundshme të realizimit të saj, lista e zgjedhësve të diasporës, metodologjia e votimit të zgjedhësve që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë, administrimi i procesit zgjedhor, numërimi i votave, përcaktimi i zonave zgjedhore, Shqipëria një zonë e me radhë, numri i mandatave për çdo zonë eventualisht, votimi, shpërndarja e mandateve e me radhë. Të gjitha këto çështje duhen analizuar në mënyrë integrale nga ekspertët sipas metodologjisë që do të zgjedhë secili prej tyre”, – tha z. Alibeaj.

# Zgjedhjet e 2025-s me kod të ri zgjedhor

Në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit të ardhshëm shqiptarët do të votojnë me një kod të ndryshuar zgjedhor, i cili për herë të parë në historinë e proceseve zgjedhore do t'u japë mundësinë shqiptarëve që jetojnë jashtë të bëhen pjesë e zgjedhjes së përfaqësuesve në parlament.

Pas shumë debatesh dhe kundërshtish deputetët miratuan në seancë plenare projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, «Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar». Çështja që shkaktoi më shumë debate ishte mënyra e shpërndarjes së mandateve. Me ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor lista e deputetëve nuk do të jetë tërësisht e hapur. Një e treta do të jetë e mbyllur dhe kandidatët për deputetë nuk do t'i nënshtrohen votës preferenciale, ndërsa

kandidatët në dy të tretat e listës do të luftojnë për të fituar qoftë edhe një votë më shumë se të tjerët, çka do t'u japë automatikisht të drejtën për t'u ngjitur në renditje e për të shpresuar në marrjen e mandatit.

Ndryshe nga propozimet e mëparshme, të cilat kërkonin caktimin e një herësi për të kaluar nga pjesa humbëse në atë fituese, ky parashikim ligjor e heq këtë mundësi. Kjo ishte arsyeja që deputeti Enkelejd Alibeaj do t'u drejtohet kolegëve të krahut të tij me fjalët "po ia falni zgjedhjet Edi Ramës". Këtyre fjalëve deputeti Damian Gjijnuri iu përgjigj se heqja e herësit ishte propozim i Partisë Demokratike. "Unë isha për herës 6500 vota, por nuk e deshën", – tha ai. I përballur me këto dy qëndrime, deputeti Oerd Bylykbashi u shpreh se me ndryshimet e bëra në Kuvendin e ardhshëm do të ketë më shumë deputetë nga vota preferenciale sesa më parë.

## Nga diskutimet në seancë plenare

Deputeti Damian Gjijnuri u shpreh se fjalën e tij e kishte ndërtuar në formë pyetje-përgjigjesh për të gjithë diskutimin politik në sallën e seancave plenare. Që në fillim ai iu referua Kushtetutës, e cila parashikon që lista e kandidatëve për deputetë duhet të jetë jo më pak se dy të tretat e hapur dhe një e treta e mbyllur. "Bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë, modeli që kemi sjellë është modeli që e realizon këtë. A ka vende të tjera që e kanë sistemin miks? Patjetër që ka, madje edhe Shqipëria dikur, përpara vitit 2005 ose përpara vitit 2008, ka pasur një model miks, sipas të cilit 100 mandate zgjidheshin me sistem mazhoritar dhe 40 mandate zgjidheshin me një sistem proporcional me lista të mbyllura, por edhe aty pati deformime", – tha z. Gjijnuri. Më tej ai shprehu keqardhjen që pas përpjekjesh të vazhdueshme të bëra gjatë dy vjetëve për të zbatuar



rekmandimet e ODIHR-it dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk u arrit të bëhej një reformë e plotë dhe e gjithëpranuar zgjedhore. "Së fundi një përgjigje për të gjithë ata që thonë se ky është një pazar Rama–Berisha si në vitin 2008, se edhe ky është hedhur si argument. Gaboheni

rëndë, të nderuar kolegë. U munduam dy vjet bashkë për të realizuar një reformë gjithëpërfshirëse. Ishit pjesë me të drejta të plota në tryezë, por nuk sollët asgjë konkrete se si mund ta përmirësonim procesin, por vetëm propozime që forconin pozitën tuaj



## Damian GJIKNURI:

Falë këtij vullneti politik asnjë nuk ankohet më për administrimin e zgjedhjeve në Shqipëri, pasi çdo votë numërohet siç është hedhur, çdo kuti hapet sa herë që kërkohet, çdo votë skanohet dhe ruhet, çdo qendër votimi filmohet dhe analizohet, çdo zgjedhës identifikohet me teknologji dhe mundësia është që në pesë qarqet më të mëdha të vendit të votohet elektronikisht. Ky është vullneti i mazhorancës.



“Ne kemi propozuar koalicione të përbëra, kemi propozuar që një e treta e listës së deputetëve të jetë fakultative, të jetë opsionale, e hapur, siç e ka Kushtetuta. Këtë thotë Kushtetuta, pra jo më pak se dy të tretat ose jo më shumë se një të tretat e listës. Kjo që po bëhet këtu është absolutisht e papranueshme edhe në emër të justifikimit të unifikimit, sepse duhet unifikuar. Politika është diverse, nuk është unifikim. Nuk jemi grumbull bagëtish apo parti politike që ecim nën drejtimin e lidërshipt të Partisë Socialiste. Secila parti zgjedh mënyrën e vet se si kandidon dhe si i organizon marrëdhëniet e brendshme. Këtë ka dhënë Kushtetuta si formulim të saj.”

Në fund të diskutimit të tij ai tha se e vetmja gjë pozitive e projektligjit dhe të cilën do ta votonte ishte votimi i emigrantëve. “Është e vetmja gjë që

politike”, – tha z. Gjicknuri.

Në emër të shumicës parlamentare ai shprehu gatishmërinë për kompromis politik në të mirë të Shqipërisë dhe mbështetje me çdo mjet për të bërë të mundur që zgjedhjet e radhës të jenë edhe më të mira sesa të kaluarat. “Falë këtij vullneti politik asnjë nuk ankohet më për administrimin e zgjedhjeve në Shqipëri, pasi çdo votë numërohet siç është hedhur, çdo kuti hapet sa herë që kërkohet, çdo votë skanohet dhe ruhet, çdo qendër votimi filmohet dhe analizohet, çdo zgjedhës identifikohet me teknologji dhe mundësia është që në pesë qarqet më të mëdha të vendit të votohet elektronikisht. Ky është vullneti i mazhorancës”, – shtoi më tej z. Gjicknuri.

Deputeti Fatmir Mediu në fjalën e tij u shprehu se projektligji i paraqitur nuk kishte të bënte aspak “me zgjedhjet e lira dhe të ndershme dhe me atë që presin qytetarët shqiptarë: që ata të përcaktojnë me votë se cilët janë përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Shqipërisë dhe jo thjesht e vetëm pazaret politike apo dashuritë për kryetarët e partive”. Ne, vijoi zoti Mediu, jemi vend anëtar i NATO-s



dhe duhet të plotësojmë të gjitha detyrimet dhe standardet për zgjedhje të lira e të ndershme. Ai e vlerësoi të nevojshme reformën zgjedhore, por ajo nuk duhet të përfundojë në marrëveshje të vogla, që e kthejnë Kuvendin e Shqipërisë në një institucion ku gjendet vendi i punës, ndërkohë që deputeti duhet t’u shërbejë interesave të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, të përfaqësojë interesat e qytetarëve shqiptarë.

Zoti Mediu u ndal edhe në propozimet konkrete të forcës së tij politike për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, ku ndër të tjera tha:

unë do të votoj sot, pavarësisht mangësive që ka ligji. Vota e diasporës është detyrim, sepse është më shumë se gjysma e shoqërisë. Por nuk është vetëm vota e diasporës, është dhe mundësia që diaspora të jetë pjesë e garës, po me këtë mbyllje të listave ne u kemi hequr atyre mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë të qenësishme në zgjedhje dhe ju japim juve mundësinë që ato struktura diplomatike t’i përdorni për të bërë pazare, siç bëhen me patronazhistë, që është një problem tjetër jashtëzakonisht i madh”, – u shpreh z. Mediu.



“Pazar që kërkon të marrë votat e përbashkëta të dy palëve” e ka quajtur deputeti Lulzim Basha miratimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor. Sipas tij, në zgjedhjet e 2021-shit, ndonëse opozita insistoi për lista 100% të hapura, u votua për lista gjysmë të hapura, por edhe në ato lista dikush që thyente herësin mund të zgjidhej. “Tani ustallarët e pazarit të djeshëm dhe të sotëm kanë bërë diçka tjetër, e kanë ndarë listën në dy klasa: *bussines clas* për veten e tyre dhe *karrocë* për të tjerët. Në *bussines clas* futen kandidatë që i vendos kryetari i partisë, të cilët nuk kanë nevojë për votim, nuk votohen. Domethënë, nëse një kandidat në pjesën tjetër të listës, që është e hapur, votohet dhe merr 5 mijë, 10 mijë, 15 mijë, 20 mijë, 100 mijë vota, por lista e partisë së tij nuk arrin dot përtej listës së mbyllur, ai mbetet jashtë parlamentit dhe në parlament hyjnë kamikazët e kryetarit. Prandaj kjo është një listë dopio e kyçur edhe në krahasim me atë që hodhi poshtë Gjykata Kushtetuese. Është e qartë për këdo që ka sado pak përvojë politike se me formulën e djeshme, që pritet të votohet sot nga pazarxhinjtë, pushteti i dorëzohet edhe për katër vjet Edi Ramës në këmbim të favoreve të përbashkëta, në këmbim të investimit më të madh që kanë nisur dhe duan ta bëjnë së bashku, në këmbim të goditjes me çdo kusht dhe me çdo mjet të shkaktarit të frikës, që është pandëshkueshmëria, të instrumentit të

pandëshkueshmërisë, që është Struktura e Posaçme Anti-korrupsion”, – u shpreh z. Basha. Më tej ai u shpreh se miratimi i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor ishte “akti i fundit i pazarit politik, që do të luhet në sesionin e fundit të kësaj legjislature të turpshme, prova më e pastër se ky parlament duhet shpërbëhet, dhe jo thjesht për shkak të përfundimit të mandatit të tij, por për shkak se është përfaqësuesi më famëkeq i shqiptarëve në këta 34 vjet të vështirë, bartës i fenomenit të politikanëve që për interesat e tyre u kundërvihen interesave të shqiptarëve”.

Deputeti Enkelejd Alibeaj në fjalën e tij u shpreh se të gjitha ndryshimet në Kodin Zgjedhor janë bërë me qëllimin e vetëm për t’i dhuruar mandatin e katërt Kryeministrit Rama në tavolinë. “Këtu bie edhe vetë koncepti i opozitës, – tha Alibeaj. –

Ky vend sot nuk ka opozitë. Praktikisht me këtë të sotmen është arritur bashkëqeverisja për vitin që vjen dhe për vitet që do të vijin. Duke e pranuar këtë si një të vërtetë të hidhur, duhet t’i japim përgjigje pyetjes: ku do të jenë nesër si deputetë dhe a do të kenë një vend të sigurt në lista? Apo ndryshimet në Kodin Zgjedhor po i bëjmë për t’u struktur në listat e fiksuara? Me projektin që është sjellë parlamenti i ardhshëm do të ketë 100 deputetë të fiksuar me zero vota, sepse shqiptarët nuk kanë pse t’i votojnë, pasi ata janë që sot deputetë të vendosur në lista nga kryetarët e partive, dhe një 40-she tjetër si për kusur, por vetëm ata mund të quhen deputetë të shqiptarëve, se do të marrin ndonjë votë.”

Më tej z. Alibeaj tha se me miratimin e këtij projektligji për Kodin Zgjedhor po nuk bëhej asgjë tjetër veçse po riciklohej edhe një herë tranzicioni 34-vjeçar, po sillleshin edhe një herë në pushtet “shkaktarët e varfërisë, të skamjes, të mungesës së demokracisë dhe të mungesës së drejtësisë”, po burgosej vota e 70% të shqiptarëve që nuk i duan këtë qeverisje dhe po vërtetohej se “parlamenti i shqiptarëve ka rënë dhe sot është vetëm parlamenti i deputetëve që mendojnë vetëm për karrierën e tyre”.

Deputeti Gazment Bardhi u shpreh me nota pozitive ndaj propozimit për pjesëmarrjen në



votime të qytetarëve shqiptar që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. “Kjo është një arritje, përveçse një detyrim që na e vendos vendimi i Gjykatës Kushtetuese, sepse gjysma e shqiptarëve, ata që mbajnë prindërit me bukë këtu, për shkak se ne kemi dështuar në rritjen e pensioneve të prindërve të tyre dhe në sigurimin e një jete më të mirë për ta, do të kenë të drejtën të votojnë atje ku ndodhen, çka do të thotë se do të kenë mundësi të diktojnë në qeverisjen e vendit përmes votës së tyre”, – u shpreh z. Bardhi. Pretendimeve se me miratimin e propozimit që listat e kandidatëve për deputetë të jenë gjysmë të hapura po shkelej vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ai do t’u përgjigjej: “Në fakt, kush thotë se Gjykata Kushtetuese ka urdhëruar që listat të jenë 100% të hapura, ose është injorant, ose gënjen. Gjykata Kushtetuese nuk ka thënë kështu. Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vetëm numerikisht herësin e vendosur në ndryshimet e vitit 2020, duke e konsideruar këtë si një numër votash joproporcional për qarqe të caktuara, ndërkohë që e ka quajtur kushtetuese të drejtën e ligjvënësit që brenda masës së vendosur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë të përcaktojë modelin më të mirë që i nënshtrohet parimit kushtetues që jo më pak se një e treta e listës së kandidatëve të çdo partie duhet të jetë e hapur.”. Duke iu kundërvënë kolegëve të tij që e etiketuan “pazar” miratimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, për të cilët tha se “janë mësuar ta bëjnë politikën pazar dhe për çdo ligj që miratohet thonë se është pazar”, z. Bardhi do të shprehej: “Kemi vënë dorën mbi Kushtetutë dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Kush thotë të mos e votojmë, pra të mos e zbatojmë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, na fton të shkelim Kushtetutën, por unë nuk e shkel Kushtetutën, sepse jam betuar që do ta respektoj Kushtetutën kur jam ulur në këtë karrige. Këtë po bëjmë ne



## **Gazment BARDHI:**

Kemi vënë dorën mbi Kushtetutë dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Kush thotë të mos e votojmë, pra të mos e zbatojmë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, na fton të shkelim Kushtetutën, por unë nuk e shkel Kushtetutën, sepse jam betuar që do ta respektoj Kushtetutën kur jam ulur në këtë karrige. Këtë po bëjmë ne sot.



sot”. Në fund të diskutimit të tij z. Bardhi do të thoshte se me miratimin ndryshime në Kodin Zgjedhor Kuvendi zbatoi vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por puna për reformën zgjedhore, e shpallur si prioritet nga të gjitha grupet parlamentare, duhej të vijonte edhe në dy–tre muajt në vijim për të bërë të mundur realizimin e një reforme zgjedhore kuptimplotë, një reforme siç e kërkonte OSBE–ODIHR-i dhe çdo mision europian që vëzhgon ecurinë e Shqipërisë si vend kandidat për në Bashkimin Europian.

Gjatë debatit për ndryshimet në Kodin Zgjedhor e mori fjalën edhe deputeti Dashmir Shehi, i cili në fillim të fjalës së tij u shpreh se sistemi ynë zgjedhor është i keq, sepse ai prodhon zgjedhje të këqija, prodhon politikë të keqe, prodhon korrupsion, vertikalizon dhe korrupton pushtetin, i ulë vlerën Kuvendit dhe e bënë atë shërbëtor të qeverisë. Më tej ai shtoi se me këtë sistem qytetarëve shqiptarë u është hequr e drejta për të zgjedhur deputetët e tij, i është mbyllur dera rinisë “për t’u marrë me politikë,





për të pasur idetë e veta, partitë e veta, përfaqësimin e vet, alternativën e vet”.

Dy elemente të reformës vlerësoi z. Shehi: votimin e emigrantëve dhe votimin elektronik. Për votën e emigrantëve tha se “nuk është perfekte, por të paktën do të hapet një rrugë”, rezultatet e së cilës do t’i shohim pas dy apo katër vjetësh. Ndërsa për votimin elektronik ai tha se “mirë do të ishte të bëjmë votim elektronik të paktën në qytetet e mëdha” për të larguar nga sistemi zgjedhor ushtrinë e numëruesve, mes të cilëve ka dhe shumë zullumqarë.

Deputeti Oerd Bylykbashi e nisi fjalën e tij me akuzën ndaj mazhorancës socialiste se e bllokoji reformën zgjedhore për më shumë se dy vjet dhe Kuvendi dështoi në realizimin e saj. “E bllokuat duke mbajtur peng Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore, duke përdorur persona që nuk përfaqësonin forcën politike të mandatuara nga opozita dhe pas dy vjetësh dështoi edhe çdo përpjekje e fundit për të arritur në një reformë zgjedhore në dy shtyllat kryesore: në rekomandimet e ODIHR-it dhe zbatimin e marrëveshjes politike të 5 qershorit 2020. Marrëveshja, e firmosur nga Partia

Socialiste dhe Partia Demokratike, u përshëndet nga Sekretari i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, nga Komisioni Europian dhe nga kancelari të tjera, por ajo u zhbë brenda një muaji. Çfarë thoshte marrëveshja? Nuk ndryshohet sistemi zgjedhor”, – u shpreh z. Bylykbashi, i cili më tej shtoi se shkulla nga rrënjët e këtij sistemi zgjedhor është domosdoshmëri, pasi “është sistem toksik për demokracinë shqiptare dhe për pluralizmin”.

Z. Bylykbashi u ndal edhe në pjesëmarrjen në votime të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, të cilëve u bëri thirrje që të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit të ardhshëm për të ndryshuar fatet e vendit. “Regjistrohuni dhe votoni, sepse nuk ka skemë të Partisë Socialiste apo të çdo qeverie që përmban dallgën e votës suaj. Ndikimi i votës suaj në demokratizimin e partive do të jetë i jashtëzakonshëm, se partitë, si në mazhorancë, ashtu edhe në opozitë, do të detyrohen të kenë lidhësi që i pëlqen edhe diasporës, përfaqësim që i pëlqen edhe diasporës, program që i pëlqen edhe diasporës, mesazhe që i pëlqejnë edhe diasporës. Shfrytëzoheni këtë oportunitet! Ndryshoni fatin e këtij vendi!” – u kërkoi ai emigrantëve.



# Miratohet amendamenti për kuotën gjinore, 30% e deputetëve do të jenë gra



Në seancën parlamentare në të cilën u diskutua projektligji mbi ndryshimet në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë u miratua edhe amendamenti i deputeteve që kërkonin që 1 në 3 kandidatët fitues nga pjesa e hapur e listës të jetë grua. Amendamenti kishte bashkëfirmëtare ish-kryetaren e Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, dhe deputetet Elisa Spiropali, Etilda Gjonaj, Albana Vokshi dhe Dhurata Çupi.

Deputetja socialiste Etilda Gjonaj në fjalën e saj dha shpjegime mbi amendamentin e propozuar për ruajtjen e kuotës gjinore në Kuvend. Ajo tha se kuota gjinore nuk është diskriminim pozitiv, sikundër thuhet shpesh, por një mekanizëm që përdoret nga shumë vende për të pasur një minimum të përfaqësimit të grave në strukturat politike e vendimarrëse. “Amendamenti është propozuar me një dakordësi politike kryesisht nga gratë deputete, por unë gjej rastin të falënderoj edhe kryetarin e grupit tonë parlamentar, zotin Çuçi, si dhe kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotin Bardhi, të cilët iu bashkëngjitën nismës për amendamentin që ne kemi propozuar. Duhet të kuptoni se asnjë nga zonjat deputete që ka firmosur amendamentin që kemi depozituar për ndryshimet në Kodin Zgjedhor nuk e kërkon ruajtjen e

kuotës gjinore për veten e saj. Këtu nuk bëhet fjalë as për Etildën, as për Dhurata Çupin, as për ndonjë kolege tjetër. Këtu bëhet fjalë për standardin që ne kemi arritur, dhe jo vetëm ne që jemi sot pjesë e parlamentit shqiptar, por edhe koleget tona para nesh, ashtu si dhe shumë aktorë të tjerë të shoqërisë civile dhe shumë aktiviste të të drejtave të grave, të cilave me këto ndryshime u jepet mundësia të jenë nesër këtu në parlament”, – tha znj. Gjonaj.

“Nëse sot në Kuvendin e Shqipërisë gratë zënë 36% të numrit të përgjithshëm të deputetëve, – shtoi më tej znj. Gjonaj, – kjo është falë kuotës gjinore prej 30% që garanton ligji. “Koleget tona, ish-koleget tona, por dhe gra të tjera që punojnë për mbrojtjen e të drejtave të grave, e fillojnë pikërisht me atë që është më e rëndësishmja: me rritjen e nivelit të përfaqësimit të grave në parlament, sepse, duke pasur më shumë gra në parlament, edhe politika është më e mirë. Nga ana tjetër, ne e dimë shumë mirë se kauzat për çështjet sociale, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve apo të drejtave të grave kapen dhe trajtohen më shumë nga gratë deputete. Jo se gratë deputete nuk dinë të bëjnë mirë edhe aspekte të tjera të politikës, si të merren me çështjet e sigurisë, të ligjeve apo të integritetit, sepse ne kemi kolege deputete që drejtojnë 4 komisione

të përhershme shumë të rëndësishme. Pra, gratë deputete kanë treguar se e kanë merituar rolin, pozicionin dhe të qenët në këtë parlament”, – shtoi znj. Gjonaj.

Më tej ajo sqaroi se në amendamentin e propozuar për Kodin Zgjedhor është kërkuar ruajtja e standardit që kemi arritur deri tani në kuotën gjinore, standard i vlerësuar nga Bashkimi Europian dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë. “Nëse sot në Kodin Zgjedhor në fuqi 30%-shi i kuotës gjinore respektohet, – tha z. Gjonaj, – edhe në këtë amendament, me ndryshimin që i është bërë sistemit, edhe duke pasur dy lista, garantohej kuota gjinore në hyrje për listën e hapur, por nuk garantohej në dalje. Kjo do të thotë të kemi të njëjtin numër grash deputete të zgjedhura, që minimalisht të respektohet kuota gjinore prej 30%. Amendamenti që kemi propozuar ka të bëjë pikërisht me këtë, pra të kemi mundësinë të ruajmë kuotën gjinore edhe për gratë që do të renditen në listën fituese, në atë pjesë të listës që do t’i nënshtrohet procesit të votimit me parapëlqim, e konsideruar ndryshe si listë e hapur. Kjo nënkupton që 1 në 3 kandidatët fitues të jetë grua, gjithnjë mbi bazën e numrit të votave që ka marrë në krahasim me gratë e tjera. Kjo do të na japë mundësinë që minimalisht të ruajmë kuotën gjinore prej 30%.”

Ruajtja e standardit të vendosur në kuotën gjinore, vijoi më tej znj. Gjonaj, është e rëndësishme, pasi çështjet gjinore janë pjesë e procesit të integritetit europian, por edhe sepse në rajon jemi vlerësuar për numrin më të madh të grave ministre dhe deputete dhe nuk mund ta lejojmë regresin. Ajo shprehu besimin se të gjitha koleget e saj deputete do ta votonin projektligjin, sepse “asnjë grua nuk do të ndiente legjitimitet kur të fliste për të drejtat e grave, për mbrojtjen dhe respektimin e grave nga dhuna dhe çdo element tjetër nëse nuk do të mbështeste ruajtjen e kuotës gjinore prej 30%”.

# Panoramë e disa problemeve të integrimit në BE dhe në Eurozonë



## Pak histori

Në qershor të vitit 1988 Këshilli i Europës konfirmoi objektivin – i shpallur që në Traktatin e Romës më 1957 për formimin e Komunitetit Ekonomik Europian – e realizimit progresiv të një unioni ekonomik dhe monetar dhe vendosi krijimin e një komiteti të udhëhequr nga Zhak Delor, në atë kohë president i Komisionit Europian, të cilit iu ngarkua detyra të hartonte një program konkret për realizimin e qëllimit të mësipërm.

Raporti i Zhak Delorit u bë i njohur në prill të vitit 1989 dhe rekomandoi krijimin e Unionit Ekonomik dhe Monetar (UEM) në tri faza të ndryshme progresive. *Faza e parë* duhej të përqendrohej në kompletimin e tregut të brendshëm, në reduktimin e pabarazive ndërmjet politikave ekonomike të shteteve anëtare, në heqjen e të gjitha pengesave për integrimin financiar dhe intensifikimin e kooperimit

monetar. *Faza e dytë* do të shërbente si një periudhë tranzicioni përpara etapës finale. Gjatë kësaj faze do të krijoheshin organet kryesore dhe struktura organizative e UEM-së si dhe do të fuqizohej konvergjenca ekonomike. Në *fazën e tretë* do të mbahej parasysh fiksimi i pandryshueshëm i kurseve të këmbimit dhe kalimi i plotë i kompetencave në fushën monetare institucioneve dhe organeve të Unionit.

Në mbështetje të rekomandimeve të këtij raporti, në muajin qershor të vitit 1989 Këshilli i Europës vendosi që faza e parë e formimit të UEM-së do të fillonte më 1 korrik të vitit 1990 me qarkullimin e lirë të kapitaleve. Datat e fillimit të dy fazave të tjera u përcaktuan në Traktatin mbi Unionin Europian (UE) të firmosur në Mاستriht në vitin 1992. Faza e dytë filloi më 1 janar 1994, kur u formua Instituti Monetar Europian, me qëllim forcimin e kooperimit ndërmjet bankave



Prof. as. dr. Leontiev ÇUÇI  
Dekan i Fakultetit të Ekonomisë,  
Universiteti "Luarasi", Tiranë

qendrore dhe koordinimin e politikave monetare, gjë që do t'i hapte rrugë përgatitjes së një monedhe dhe një politike monetare të përbashkët. Vlen të theksojmë këtu se Traktati i Mاستrihtit përfshiu në vendimet e tij edhe kërkesën që *çdo vend anëtar të përfshihej në hapësirën e Eurozonës*.

Më 3 mars 1998 Këshilli i Europës vendosi se 11 nga 15

shtetet anëtare të BE-së (Austria, Belgjika, Gjermania, Finlanda, Franca, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia dhe Spanja) plotësonin kriteret e konvergjencës ekonomike (nivel i lartë i stabilitetit të çmimeve, qëndrueshmëri në financat publike, kurse këmbimi të stabilizuara, norma interesi afatgjata të ulëta) dhe ligjore (pavarësia e bankave qendrore kombëtare) të fiksuara nga Traktati i Mاستrihtit, me qëllim futjen në UEM. Më 31 dhjetor të vitit 1999 Këshilli i Europës fiksoi edhe kurset e këmbimit të pandryshueshëm të valutave respektive ndaj euros.

Më 25 maj 1998 qeveritë e 11 shteteve anëtare pjesëmarrëse emëruan presidentin, zëvendës-presidentin dhe nga katër anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Europiane (BQE), me fuqi veprimi nga 1 qershori i vitit 1998, që njihet si datë e formimit të BQE-së dhe mbylljes së Institutit Monetar Europian. Të 11 shtetet anëtare pjesëmarrëse adoptuan euron si monedhë unike, duke i hapur kështu rrugë *fazës së tretë të UEM-së* më 1 janar 1999, datë që shënon edhe kalimin e politikës monetare në kompetencë të BQE-së.

Në tre vjetët e parë të Unionit Ekonomik dhe Monetar euroja luajti vetëm funksionin e parasë si mjet llogaritjeje dhe kontabiliteti, ndërsa në qarkullim ajo hyri më 1 janar të vitit 2002.

Në varësi të plotësimit të kriterëve të konvergjencës të vendosura nga Traktati i Mاستrihtit, në zonën e euros hynë: Greqia më 1 janar 2001, Sllovenia më 1 janar 2007, Qiproja dhe Malta më 1 janar 2008, Sllovakia më 1 janar 2009, Estonia më 1 janar 2011, Letonia më 1 janar 2014, Lituania më 1 janar 2015 dhe Kroacia më 1 janar 2023.

## Kushtet e zgjerimit të BE-së

Këshilli European i Kopenhagës i qershorit të vitit 1993 vendosi që “për vendet e asociuara nga Europa Qendrore dhe Lindore që dëshirojnë të bëhen anëtare me të drejta të plota të BE-së aderimi do të bëhet sapo një vend i asociuar do të jetë në

Këshilli European i Madridit të dhjetorit 1995 konfirmoi kërkesën e krijimit të kushteve të nevojshme për “integrimin progresiv dhe të harmonizuar të shteteve, mbi të gjitha zhvillimin e ekonomisë së tregut, përshtatjen e strukturës së tyre administrative dhe krijimin e një konteksti ekonomik dhe monetar të stabilizuar”.

“ Këto kushte u përcaktuan si elemente fundamentale të stabilizimit dhe asocimit dhe janë pjesë integrale e çdo marrëveshjeje me çdo shtet që kërkon të aderojë në BE. Mbi këtë bazë Komisioni European analizon kandidaturën e çdo vendi dhe përgatit raportin e tij me mendimin përfundimtar. ”

gjendje të marrë përsipër detyrime të lidhura me plotësimin e kushteve të kërkuara ekonomike dhe politike”.

Anëtarësimi në Union kërkonte (dhe kërkon):

i) vendi kandidat të kishte arritur një *stabilitet institucional* që garantonte demokracinë, parimin e ligjshmërisë, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve;

ii) ekzistencën e një ekonomie *tregu funksionale* dhe me një kapacitet që t'u përgjigjej presioneve të konkurrencës dhe forcave të tregut brenda Unionit;

iii) vendi kandidat duhej të ishte i aftë të *merrte përsipër detyrimet e aderimit*, përfshirë pjesëmarrjen në objektivat politike, ekonomike dhe monetare të Unionit.

Këshilli European i Kopenhagës i vitit 1993 deklaroi se “kapaciteti i Unionit për të absorbuar anëtarë të rinj, duke ruajtur në të njëjtën kohë të pandryshuar ritmin e integritetit european, merr një rëndësi shumë të veçantë në interesin e përgjithshëm të Unionit dhe të vendeve kandidatë”. Kjo deklaratë përcaktoi edhe kriteret politike dhe ekonomike për shqyrtimin e kërkesës për aderim të çdo vendi të veçantë.

Sa u përket kushteve për procesin e stabilizimit dhe të asocimit, të përcaktuara nga Këshilli i Europës më 29 prill 1997, figuron edhe kooperimi me Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe kooperimi rajonal. Këto kushte u përcaktuan si elemente fundamentale të stabilizimit dhe asocimit dhe janë pjesë integrale e çdo marrëveshjeje me çdo shtet që kërkon të aderojë në BE. Mbi këtë bazë Komisioni European analizon kandidaturën e çdo vendi dhe përgatit raportin e tij me mendimin përfundimtar.

## Zgjerimi i BE-së në shekullin e ri

Më 1 janar 1999, pasi kishte filluar faza e tretë e krijimit të Unionit Ekonomik dhe Monetar, tri shtete anëtare të BE-së, konkretisht Danimarka, Mbretëria e Bashkuar dhe Suedia, nuk aderuan në monedhën unike.

Më 1 maj 2004 në BE hynë edhe dhjetë shtete të tjera, që ishin Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Qiproja, Republika Çeke, Sllovakia dhe Sllovenia, ndërsa më 1 janar 2007 hynë edhe Bullgaria dhe Rumania.

Më 1 janar 2013 u shtua edhe Kroacia. Nga të gjitha këto vende të BE-së deri më sot kanë hyrë në zonën e euros Estonia, Letonia, Lituania, Kroacia, Malta, Qiproja, Sllovakia dhe Sllovenia. Ndërkohë Danimarka dhe Mbretëria e Bashkuar gëzojnë një status special (të përligjur me protokolle bashkëlidhur me Traktatin e Mastrohit), që u rezervon atyre të drejtën e aderimit në proces në Eurozonë. Të gjitha shtetet e tjera kanë statusin e shtetit anëtar me përjashtimet që parashikohen në nenin 122 të Traktatit të Mastrohit.

Pjesëmarrja në BE i detyron shtetet anëtare që bankat qendrore kombëtare t'i integrojnë në sistemin e Bankës Qendrore Europiane (SBQE), guvernatorët e tyre të jenë anëtarë me të drejta të plota në Këshillin e Përgjithshëm të BQE-së dhe ekspertët e tyre të marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve të SBQE-së sa herë që trajtohen çështje që hyjnë në kompetencën e Këshillit të Përgjithshëm.

Gjatë kohës që një shtet i BE-së përgatitet për të hyrë në zonën e euros, ai duhet të demonstrojë plotësimin e kriterëve të konvergencës të përcaktuara nga Traktati i Mastrohit.

*Kriteret e konvergencës* për vlerësimin e pranueshmërisë së një vendi për të adoptuar monedhën unike janë përcaktuar në nenin 121, paragrafi 1 të Traktatit të Mastrohit dhe së fundi janë specifikuar në Protokollin nr. 21 të bashkëlidhur këtij Traktati. Modalitetet e aplikimit të kriterëve janë përcaktuar në proces nga BQE-ja. Ato janë:

i) *stabiliteti i çmimeve*: norma mesatare e inflacionit në dymbëdhjetë muajt e fundit përpara vlerësimit nuk duhet të tejkalojë pragun e 1,5% të normës mesatare të tri vendeve anëtare me normën më të ulët të inflacionit;

ii) *stabiliteti i situatës së financave publike*: borxhi neto dhe debiti i administratës publike (borxhi publik) nuk duhet të jenë më të lartë se 3% dhe 60% të GDP-së, me përjashtim të rasteve kur vërehet një ulje substanciale e tyre në periudhë afatgjatë;

iii) *stabiliteti i kursit të këmbimit*: kuotimi i valutave kombëtare duhet të lidhet për të paktën dy vjet brenda marzheve

normale të fluktacioneve të fiksuar në marrëveshjet e këmbimit, pa zhvlerësimin e saj përkundrajt monedhave të çdo vendi tjetër anëtar;

iv) *konvergenca e normave të interesit në periudhë afatgjatë*: norma nominale e interesit afatgjatë (mbi bonot e thesarit ose tituj analogë), e vëzhguar afërsisht në harkun kohor të një viti përpara shqyrtimit, nuk duhet të tejkalojë më tepër se dy pikë përqindje atë të mesatares së tri vendeve anëtare me inflacion më të ulët.



### Kriteret e konvergencës për zonën e euros të detajuara nga BQE-ja

#### Dispozita të Traktatit të Mastrohit për trendin e çmimeve

Neni 140, paragrafi 1 i Traktatit parashikon "arritjen e një niveli të lartë të stabilitetit të çmimeve; kjo do të rezultojë nga një normë inflacioni që do të llogaritet për vitin në vazhdim, duke pasur parasysh normën e inflacionit të tri shteteve anëtare që kanë arritur rezultate maksimale në termat e stabilitetit të çmimeve".

Neni 1 i Protokollit nr. 13 mbi kriteret e konvergencës të mbështetura në nenin 140, paragrafi 1 të Traktatit përcakton se "kriteri relativ për stabilitetin e çmimeve të shpjeguara më sipër nga Traktati [...] nënkupton në thelb se shtetet anëtare kanë një trend çmimesh të qëndrueshëm dhe një normë mesatare inflacioni, e vëzhguar afërsisht në harkun kohor të një viti përpara shqyrtimit, që nuk duhet të kalojë 1,5 pikë përqindje të

normës së inflacionit të tri shteteve anëtare që kanë arritur në vazhdimësi rezultate maksimale në termat e stabilitetit të çmimeve. Inflacioni do të matet nëpërmjet çmimeve të konsumit (IPC), i llogaritur në bazë krahasuese dhe duke mbajtur parasysh dallimet në përcaktimet kombëtare."

#### Modalitete të zbatimit të dispozitave të Traktatit

Sa i përket normës mesatare të inflacionit, e vëzhguar afërsisht në harkun

kohor të një viti përpara shqyrtimit, duhet mbajtur parasysh mesatarja e 12 muajve të fundit të treguesit të harmonizimit të çmimeve të konsumit (IAPC), krahasuar kjo me mesataren e 12 muajve të mëparshëm.

Parimi "i maksimumit të tri shteteve që kanë arritur rezultatet më të mira në stabilitetin e çmimeve", i përshtatur për përcaktimin e vlerës së referimit, llogaritet si mesatare e thjeshtë aritmetike e normës së inflacionit për tri vendet që kanë normat më të ulëta të tij, duke përjashtuar vlerat anormale. Trendi i çmimeve të një vendi do të vlerësohet anormal kur norma e inflacionit është në mënyrë domethënëse më e ulët se ajo e tri shteteve anëtare për shkak të veprimit të një sërë faktorësh specifikë kombëtarë!

#### Dispozita të Traktatit të Mastrohit për trendin e financave publike

Neni 140, paragrafi 1 i Traktatit të Mastrohit përcakton se "qëndrueshmëria e situatës së financave publike ka të bëjë me vazhdimësinë e një situatë të bilancit

publik që nuk karakterizohet nga një deficit i tepruar”, siç përcaktohet në paragrafin 6 të nenit 126 të tij.

Lidhur me konvergencën që kërkohet nën 140, paragrafi 1 i Traktatit saktëson se “në momentin e shqyrtimi shteti anëtar nuk është objekt i një vendimi të Këshillit sipas neni 126, paragrafi 6 mbi ekzistencën e një deficiti të tepruar”, siç thuhet në Traktatin në fjalë.

### **Procedura e deficitit të tepruar**

Neni 126 i Traktatit përcakton procedurën e duhur për pranimin e ekzistencës së një deficiti buxhetor. Në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni Komisioni Europian ngarkohet të përgatisë një raport në rastin kur një shtet anëtar i BE-së nuk plotëson kriteret e disiplinës së bilancit, në mënyrë të veçantë kur:

1. Raporti midis deficitit publik të parashikuar ose efektiv dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) tejkalon vlerën e referimit (të fiksuar tashmë në protokollin mbi procedurat për deficitin e tejkaluar), përveç rasteve kur:

- raporti nuk është zvogëluar në mënyrë të ndjeshme, por vazhdon të qëndrojë në një nivel që i afrohet asaj të referimit ose në alternativë;

- tejkalmi i vlerës së referimit është i veçantë e i përkohshëm dhe raporti mbetet afër vlerës së referimit.

2. Raporti midis deficitit publik dhe PBB-së tejkalon vlerën e referimit (të fiksuar 60% të PBB-së në protokollin mbi procedurat e deficitit të tepruar), përveç rasteve kur raporti i mësipërm nuk zvogëlohet në masë të mjaftueshme dhe nuk i afrohet vlerës së referimit me ritmet e duhura.

### **Dispozita plotësuese**

Raporti i përgatitur nga Komisioni Europian mban parasysh edhe diferencën eventuale midis deficitit publik dhe shpenzimeve publike për investime dhe të gjithë faktorëve të tjerë domethënës, përfshirë edhe situatën ekonomike të bilancit afatmesëm të shteteve anëtare.

Komisioni mund të përgatisë një raport edhe nëse mendon se në një shtet

anëtar, pavarësisht se ka respektuar kriteret, ekziston risku i një deficiti të tepruar. Komiteti ekonomik-financiar formulon një mendim të vetin për raportin e Komisionit lidhur me problemin në fjalë.

Sipas neni 126, paragrafi 6 të Traktatit, Këshilli i BE-së, duke biseduar mbi rekomandimet e Komisionit dhe duke mbajtur parasysh vëzhgimet ndaj shtetit anëtar të interesuar, vendos me shumicë të cilësuar të përjashtojë shtetin anëtar edhe pas një vlerësimi kompleks, nëse në atë shtet ekziston një deficit i tepruar.

### **Aspekte procedurale dhe zbatime të dispozitave të Traktatit të Mastrihit**

Për të vlerësuar konvergencën BQE-ja shpreh një mendim mbi ecurinë e financave publike, ndërsa për të vlerësuar qëndrueshmërinë shqyrton treguesit kryesorë relativë të llogarive publike në periudhën e referimit si dhe perspektivën dhe sfidat që paraqiten në këtë aspekt, duke e përqendruar analizën e saj në marrëdhëniet ndërmjet evolucionit të deficitit dhe borxhit publik.

### **Dispozita të Traktatit të Mastrihit për trendin e kursit të këmbimit**

Neni 140, paragrafi 1 i Traktatit përcakton detyrimin e “respektimit të fluktuacioneve brenda marzheve normale të parashikuara nga mekanizmi i këmbimit të Sistemit Monetar Europian (SME) për të paktën dy vjet, pa zhvlerësim ndaj euros”.

Neni 3 i Protokollit nr. 13 mbi kriteret e konvergencës të përcaktuara në nenin 140, paragrafi 1 të Traktatit parashikon se “kriteri relativ i pjesëmarrjes në mekanizmin e këmbimit të SME-së nënkupton se shteti anëtar ka respektuar fluktuacionet brenda marzheve normale të mekanizmit të këmbimit të SME-së pa tensione të rënda për të paktën dy vjet përpara shqyrtimit, në mënyrë të veçantë, të paktën për të njëjtën periudhë, nuk duhet të zhvlerësojë me iniciativë të vetën kursin e këmbimit ndërmjet monedhës së vet me atë të euros”.

### **Modalitete të zbatimit të dispozitave të Traktatit**

Traktati i Mastrihit i referohet kriterit të pjesëmarrjes në Akordet e reja Europiane të Këmbimit (AEK II), të cilat iu bashkëngjiten mekanizmit të këmbimit të SME-së në janar të vitit 1999.

Në radhë të parë BQE-ja shqyrton nëse vendi ka marrë pjesë në AEK II “për të paktën dy vjet përpara shqyrtimit, siç është përcaktuar në Protokollin nr. 13”.

Së dyti, në vlerësimin e stabilitetit të kursit të këmbimit të monedhës vendase ndaj euros i kushtohet rëndësi e veçantë faktit nëse ky ka qëndruar afër paritetit bazë të AEK II-shit, megjithatë në linjën e qasjes së përshtatur në të kaluarën mbahen parasysh edhe faktorët që mund të kenë përcaktuar një vlerësim. Në këtë vështrim, gjerësia e intervalit të luhatshmërisë brenda AEK II-shit nuk paragjykon “provimin” e stabilitetit të kursit të këmbimit.

Së fundi, parimi i mungesës së “tensioneve të rënda” trajtohet vetëm në rastet kur vërehen deviacione të paritetit të kursit bazik të këmbimit të vendosur nga AEK II-shi midis monedhës vendase dhe euros. Ky kurs vendoset në bazë të luhatshmërisë së monedhës vendase ndaj euros, ndryshimit të normës së interesit afatshkurtër të monedhës vendase ndaj zonës së euros dhe evolucionit të saj si dhe nga roli që kanë luajtur ndërhyrjet në tregun valutor dhe nga programet e asistencës financiare ndërkombëtare për stabilizimin e monedhës vendase.

### **Dispozita të Traktatit të Mastrihit për trendin e normave të interesit afatgjatë**

Neni 140, paragrafi 1, sythi i katërt i Traktatit kërkon “nivelimin e normave të interesit afatgjatë, që reflektojnë stabilitetin e konvergencës së arritur nga shteti anëtar, me përjashtim ose/dhe me pjesëmarrjen e tij në mekanizmin e

<sup>1</sup>Për më shumë informacion shih raportin e konvergencës të BQE-së për vitin 2010.

këmbimit”.

Neni 4 i Protokollit nr. 13 mbi kriteret e konvergencës sipas paragrafit 1 të nenit 140 të Traktatit përcakton se “kriteri relativ i konvergencës do të thotë se norma nominale e interesit afatgjatë të një shteti anëtar, e vëzhguar afërsisht në harkun kohor të një viti përpara shqyrtimit, nuk ka tejkaluar më shumë se 2 pikë përqindje atë të maksimumit të tri shteteve anëtare që kanë arritur rezultatet më të larta në termat e stabilitetit të çmimeve. Normat e interesit maten mbi bazën e obligacioneve afatgjata të emetuara nga shteti anëtar ose/dhe të mbështetura në tituj analogë, duke llogaritur diferencat në përkufizimet kombëtare”.

### **Modalitete të zbatimit të dispozitave të Traktatit**

Norma nominale e interesit afatgjatë, e vëzhguar afërsisht në harkun kohor të një viti përpara shqyrtimit, llogaritet si mesatare aritmetike e 12 muajve të fundit, për të cilët janë të disponueshme të dhënat dhe indicet e harmonizuara të çmimeve të konsumit.

Parimi i “maksimumit të tri shteteve që kanë rezultatet më të mira në termat e stabilitetit të çmimeve”, i përshtatur për të përcaktuar vlerën e referimit, aplikohet duke llogaritur mesataren e thjeshtë matematikore të normave të interesit afatgjatë të këtyre tri shteteve anëtare, të cilat merren në konsideratë për llogaritjen e vlerës së referimit për stabilitetin e çmimeve. Llogaritja bëhet në bazë të harmonizimit të normave të interesit afatgjatë të përpunuara për vlerësimin e konvergencës.

Ky kompleksitet kërkesash për kriteret dhe standardet e integritimit në BE, por edhe në zonën e euros, tregon se sa i komplikuar është procesi i integritimit, sa kohë duhet për realizimin e tij, sa impenjim të madh kërkon, çfarë gjithëpërfshirje institucionale është e nevojshme dhe çfarë organizimi e monitorimi duhet për suksesin e tij. Çështja nuk është thjesht një situatë e brendshme që lidhet vetëm me ne shqiptarët, por lidhet në radhë të parë me Brukselin dhe me një numër të madh institucionesh brenda dhe jashtë

strukturave të BE-së; lidhet me institucionet ndërkombëtare, jo thjesht ekonomike, por edhe politike e diplomatike, lidhet me bashkëpunimin me shtete të veçanta për ndihmë e përvojë etj. Kjo lidhet edhe me njohjen e përvojave të ecurisë së vendeve të ndryshme në procesin e integritimit në BE dhe në zonën e euros; me historikun e

social, vullneti i shtresave intelektuale dhe profesionale, i shoqërisë civile etj. e përshpejtuan procesin dhe bënë të mundur që brenda një periudhe 20-vjeçare Kroacia të bëhej anëtare e BE-së dhe të aderonte në Eurozonë (në janar të vitit 2013 Kroacia u pranua anëtare me të drejta të plota në BE, ndërsa më 1 janar 2023 aderoi në Eurozonë). Ky

“ Nëse ka diçka të re, ajo është se anëtarësimi i vendeve kandidate, duke marrë shkas edhe nga përvoja kroate, po bëhet duke pasur parasysh plotësimin e standardeve sa në procesin aderimit në BE, aq dhe në procesin e aderimit në zonën e euros. Thënë më thjesht, po luhet më shumë se më parë në të dy frontet: plotësimi i standardeve për në BE, por dhe për në Eurozonë. ”

procesit të tyre, por dhe me historikun e marrëdhënieve me fqinjët rajonalë e më gjerë. Nuk përjashtohet këtu edhe njohja e koniunkturave gjeopolitike dhe gjeostrategjike e sidomos zhvillimet e fundit në këtë rrafsh, ku pas luftës pushtuese ruse në Ukrainë dolën më në evidencë problemet e sigurisë dhe të militarizimit të ekonomive. Është koha të shihen interesat e koniunkturës, por sidomos ato të perspektivës; të shihen lëvizjet dhe qëllimet e miqve, por edhe të armiqtve dhe kundërshtarëve për të kthjelluar mendjen dhe lëvizjet e mençura që duhen bërë.

Përveç sa më sipër duhet përmendur edhe një përvojë e veçantë dhe spektakolare e integritimit të Kroacisë në BE, por dhe në hapësirën monetare të Eurozonës. Ky vend dërgoi një ushtri të tërë specialistësh dhe ekspertësh në institucionet e Brukselit, të cilët u atashuan pranë zyrave të tij sipas kapitujve të agjendës së integritimit (Kroacia kishte 28 kapituj) me shpenzime shtetërore. Impenjimi shumë i lartë politik dhe institucional, konsensusi i gjerë politik e

vend është – besoj se nuk e teproj – kampioni i parë i rekordit cilësor e kohor të integritimit në BE dhe Eurozonë nga vendet e Europës Lindore, ndërkohë që ka vende si Hungaria, Polonia dhe Republika Çeke (këto vende hynë në BE në vitin 2004) që ende nuk kanë aderuar në Eurozonë, apo si Bullgaria dhe Rumania (këto dy vende hynë në BE në vitin 2007) që jo vetëm nuk kanë hyrë në zonën e euros, por parashikohet që të hyjnë nga viti 2030 e më tej.

Pas krizës së parë botërore të financave në vitet 2007–2008 dhe problemeve të zhvillimit të vendeve të BE-së, por edhe të integritimit të vendeve të tjera, “kali i betejës” për integritimin // *bë fusha e politikës monetare*, si pika thelbësore dhe fokale e ecurisë së tërë procesit të integritimit në të ardhmen. Natyrisht, në këtë vështrim zë një vend prioritar përfshirja e atyre vendeve të BE-së që nuk janë ende në Eurozonë, pa përjashtuar këtu vendet kandidate, ku bën pjesë edhe Shqipëria, për të cilat kriteret dhe standardet janë njëjloj të përcaktuara e kontrolluara rigorozisht,

pavarësisht se ka një impenjim më të madh, vendosje kufijsh më të përafërt dhe një ndihmë sinjifikative financiare. Nëse ka diçka të re, ajo është se anëtarësimi i vendeve kandidate, duke marrë shkas edhe nga përvoja kroate, po bëhet duke pasur parasysh plotësimin e standardeve sa në procesin aderimit në BE, aq dhe në procesin e aderimit në zonën e euros. Thënë më thjesht, po luhet më shumë se më parë në të dy frontet: plotësimi i standardeve për në BE, por dhe për në Eurozonë. Edhe nëse ka ndonjë ndryshim, ai është thjesht në aspektin procedural të kalimit të procesit në “sita” më të holla e më të kujdesshme, të cilat janë të fushës së procedurave miratuese.

Le të ndalemi tani në rastet e mëposhtme, në të cilat jam përqendruar tek aderimi në zonën e euros, pasi këtu procesi bëhet më i kualifikuar, është më kompleks, sepse lidhet me lënie të sovranitetit ndaj ushtrimit të politikës monetare dhe është më sensitiv edhe nga pikëpamja politike dhe sociale.

### Rasti i Kroacisë

Sa i përket këtij rasti, Komisioni Europian veprimi, si dhe më parë, mbi një strukturë të miratuar të *shprehjes së mendimit* për integrim në BE, por duke theksuar edhe përshpejtimin e aderimit në Eurozonë, çka nënkuptonte:

i) përshkrimin e marrëdhënieve të Kroacisë me Unionin, në mënyrë të veçantë edhe në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruara;

ii) analizën e situatës lidhur me kushtet politike të treguara nga Këshilli i Europës (demokracia, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut, tutela ndaj minorancave), përfshirë edhe kërkesat e qenësishme të procesit të stabilizim-asocimit;

iii) vlerësimin e situatës dhe të perspektivës së Kroacisë lidhur me kushtet ekonomike të treguara nga Këshilli i Europës (ekonomia e tregut, kapaciteti konkurrues);

iv) vlerësimin e kapacitetit të Kroacisë për të respektuar detyrimet dhe sjelljen ndaj aderimit.

v) shprehjen e një vlerësimi të përgjithshëm të situatës dhe të perspektivave të Kroacisë për aderimin

e saj dhe formulimin e një rekomandimi për negociatat e aderimit.

Për të përgatitur mendimin e tij për Kroacinë Komisioni i BE-së shfrytëzoi dhe përdori informacionet shteruese të servitura nga autoritetet e saj, por edhe shumë burime të tjera të shteteve anëtare, të organizatave ndërkombëtare (Këshillit të Europës, OSBE-së, UNHCR-së,

vi) bilanci tregtar ishte negativ, por me një përmirësim në vitet e fundit para 2013-s (ndonëse Kroacia ishte një vend që mbështetej fort në eksportet falë kunës së dobët);

vii) norma e obligacioneve (shtetërore) gjatë 10 vjetve të fundit ishte 4,9% (më e lartë se në Itali dhe Spanjë).

Duke iu referuar historisë së vendeve



Paktit të Stabilitetit, FMN-së, Bankës Botërore, BERZH-it, Bankës Europiane të Investimeve etj.) dhe të OJQ-ve.

Kroacia në korrik të vitit 2013 hyri zyrtarisht në BE. Guvernatori i bankës qendrore kroate i asaj periudhe deklaroi se “Kroacia do të kishte vetëm avantazhe nga hyrja në Eurozonë”, në të cilën ai parashikonte të hynte pas 5–6 vjetësh. Të dhënat kryesore makroekonomike të asaj periudhe ishin:

i) monedha kroate, *kuna* (emri i monedhës së zëvendësuar nga euroja), ishte mjaft e dobët ndaj euros, gjë që favorizonte vazhdimisht eksportet, ndërsa më parë pati favorizuar edhe sektorin e turizmit;

ii) norma e papunësisë ishte 20,9%, shifër që nuk ka nevojë për komente;

iii) raporti i deficitit publik ndaj GDP-së ishte 53,6% (brenda parametrave të Traktatit të Mastrohitit, që e parashikonte maksimumin në 60%);

iv) deficitin e borxhit publik ndaj GDP-së ishte 4,6% (sipas Traktatit të Mastrohitit nuk duhej të kalonte 3%-shin);

v) norma e inflacionit ishte 3,3% (mjaft e lartë në krahasim me objektivat afatmesëm e afatgjatë të BQE-së për një normë afatmesme prej 2% në Eurozonë);

të BE-së pas vitit 2002 (kohë kur euroja hyri në qarkullim), vërejmë se të gjitha vendet e vogla me një para të vjetër kombëtare më të dobët sesa mesatarja europiane (është rasti tipik i Kroacisë, por edhe i Greçisë etj.) janë ende në vështirësi të mëdha për shkak bumit të madh e të menjëhershëm të importeve me hyrjen e euros. E thënë thjesht, ajo që ndodhi është se disa qytetarë europianë u ndodhën papritur (duke marrë këtu si shembull grekët) përballë faktit se morën mallra nga importi me çmime shumë më të larta se në të kaluarën. Në të njëjtën mënyrë, duke parë anën tjetër të medaljes, adoptimi i euros eliminoi tërë avantazhet që mund të rridhnin në të kaluarën nga dobësimi i monedhës së vjetër kombëtare, *kunë*; si rezultat i rritjes së eksporteve. Ishte një bilanc tregtar negativ apo hipernegativ, që çoi në pikiatë GDP-në.

Fuqja e Kroacisë në zonën e euros u prit me kënaqësi nga institucionet e larta të BE-së, por shoqatat e konsumatorëve dhe të shoqërisë civile kroate që nga 1 janari i vitit 2023, që shënon dhe datën zyrtare të futjes në qarkullimin ekonomik të Kroacisë të euros, u përballën me rritje të mëdha të çmimeve. Pas 48 orësh të futjes së euros në qarkullim ministri i

Ekonomisë, Davor Filipović, u detyrua të takonte drejtuesit e rrjeteve kryesore të supermarketeve. Rritja e çmimeve çoi menjëherë në rritjen e kostos së jetesës, çka e detyroi qeverinë kroate të reagonte me ultimatum nga vetë Kryeministri Andrej Plenković, i cili do të deklaronte se “disa po sillen si mashtrues” dhe paralajmëroi zinxhirin e shpërndarësve të mëdhenj me shumicë se kishin kohë “deri të premtën për të ristabilizuar çmimet respektive deri në nivelin real të kursit të këmbimit të 1 euroje me 7,53 kuna”. Ndonëse ende nuk dihej se si do të vepronte qeveria kroate ndaj situatës së krijuar, ultimatumit vlente për të mos ndenjtur pa reaguuar ndaj spekulimeve me rritjen e çmimeve.

Rritja e pajustificuar e çmimeve përveç dëmit ekonomik ndaj qytetarëve kroatë hodhi hije dyshimi mbi suksesin historik të futjes së euros si valutë kombëtare. Nëse për Kryeministrin Plenković “gjithçka shkoi në mënyrën më të mirë të mundshme dhe pa probleme, që nga furnizimi i bankomateve me kartëmonedha euro e deri tek operacionet e pagesave dhe funksionimi i sporteveve automatike”, ai nuk mund të lejonte as mikrodështime nga spekulantët dhe mashtruesit, të cilët i jepnin zemër e armë propagandës kundër BE-së të forcave më armiqësore në Bruksel. “Ky kaos i çmimeve në Kroaci duhet të shërbejë si paralajmërim për ne”, – tha ish-kryeministri polak Mateus Morawiecki (*Mateus Morawiecki*). Ndonëse në vjeshtën e vitit 2023 Polonia do të hynte në votime të përgjithshme parlamentare, ai ripërzjashtoi politikën e aderimit të vendit të tij në zonën e euros. Ai do të deklaronte se “vendit nuk i shtrohet kërkesa për të aderuar në monedhën e përbashkët” dhe se “duhet mbështetur fort monedha kombëtare, *złoty*, për të evituar rritje të mëtejshme të kostos së jetesës”.

### **Pse Polonia nuk do të hyjë në zonën e euros?**

Polonia aderoi në BE më 1 janar 2004, por ende nuk ka hyrë në Unionin Ekonomik dhe Monetar. Një arsye e dhënë nga ministri aktual i ekonomisë, Mateus Morawiecki, është fakti se “shumë

vende europiane nuk i kanë trajtuar avantazhet e aderimit në euro, me përjashtim të Rumanisë, e cila është impenjuar seriozisht në këtë linjë dhe e shikon me shumë përfitim futjen në zonën e euros në kushtet e realitetit të saj”.

Po ta lëmë mënjanë këtë deklaram dhe t'i referohemi aspektit ekonomik,

prodhim i madh i ekonomisë gjermane. Normalisht, përpara se të hynte euroja në qarkullimin ekonomik, kur ekonomia gjermane rritej dhe të tjerat binin (p.sh. ajo spanjolle), kursi i këmbimit të tyre (të *markës* gjermane me *pesetën* spanjolle) ndryshonte në favor të monedhës më të fortë, kështu që qytetarët spanjollë nuk mund të blinin më shumë mallra

**Polonia është mjaft e madhe e mund ta mbajë valutën e saj, është potencial i ndjeshëm ekonomik, ka kapitale dhe bilanc të gjerë tregtar, ka investime të huaja, industri komplekse e konkurruese, ka pretendime ambicioze rajonale e më gjerë. Të paktën ky është mendimi i ekspertëve polakë, që ka ndikuar edhe në një opinion politik të caktuar.**

problemi është më kompleks. Ekonomia polake është më e fortë se ajo e vendeve të saj fqinje. Në Europën Qendrore vetëm Lituania, Letonia, Estonia, Sllovakia dhe Sllovenia, që përbëjnë ekonomitë më të dobëta, e kanë adoptuar euron. Këto vende, por edhe të tjera si këto, nuk kishin mundësi të mbanin valutat e tyre me vlera shumë të vogla, ndërsa Polonia është mjaft e madhe e mund ta mbajë valutën e saj, është potencial i ndjeshëm ekonomik, ka kapitale dhe bilanc të gjerë tregtar, ka investime të huaja, industri komplekse e konkurruese, ka pretendime ambicioze rajonale e më gjerë. Të paktën ky është mendimi i ekspertëve polakë, që ka ndikuar edhe në një opinion politik të caktuar.

Ndërkohë Eurozona kontrollohet kryesisht nga Gjermania, madje edhe fuqia blerëse e euros kur ajo hyri në qarkullim (më 1 janar 2002) u mbështet në kursin e këmbimit të *markës* gjermane, e cila vlerësohej si monedha më e fortë e asaj periudhe. Prandaj edhe Eurozona përdoret si destinacion i mallrave nga një

gjermane me *pesetën* më të zhvlerësuar. Automatikisht produktet spanjolle ishin më të lira, sepse ishte zhvlerësuar monedha e tyre. Në Eurozonë kjo situatë është e pamundur. Tashmë Italia, Spanja, Greqia dhe Portugalia nuk humbasin më nga vlera e valutës së tyre ndaj *markës* gjermane, pasi kanë të njëjtën monedhë, kështu që konsumatorët e tyre i përfitojnë mallrat gjermane në një treg europian mjaft më të gjerë se tregu lokal dhe me çmime logjiksht më të ulëta. Por efekti i kësaj situatë ishte një *papunësi e madhe* në këto vende. Natyrisht që të papunët nuk mund të blinin mallra gjermane dhe efekti mbeti i njëjtë. Ndryshimi ishte se para euros këto ekonomi patën vlerë të ulët të monedhës së tyre kombëtare, por ruajtën vendet e punës, ndërsa niveli i jetesës ecte në rënie të përballueshme, në masën që i jepte mundësi ekonomisë të rimëkëmbje. Përkundrazi, me euron fituan papunësinë dhe *humbën një gjeneratë të tërë të forcës punëtore, sidomos të të rinjve* dhe po vuajnë ende këto pasoja.

Por le të kthehemi te Polonia. Ajo ndodhet në një situatë të ndryshme nga

Italia, Spanja, Greqia dhe Portugalia. Për Poloninë, ashtu si dhe për Mbretërinë e Bashkuar, Danimarkën, Suedinë dhe Zvicrën, nuk është vetëm një çështje ekonomike. Ajo ka një kufi prej 500 km me Gjermaninë, i cili është dhunuar disa herë nga kjo e fundit. Polonia nuk mundet dhe me shumë mundësi nuk do ta lejojë kurrë kontrollin e monedhës së saj nga gjermanët apo nga institucione të kontrolluara prej tyre. Ky është një problem historik. Nëse tani Gjermania ndihet e dobësuar (si Rusia 20 vjet më parë), kjo, sipas tyre, është koniunkturale, sepse nesër mund të ndodhë e kundërta. Sot Polonia ka një ushtri të krahasueshme me atë gjermane, por kjo e fundit ka potencialin të ndërtojë një ushtri të madhe brenda një kohe të shkurtër. Imagjeroni se çfarë mund të ndodhte në rast të një konflikti gjermano-polak dhe çfarë mund të pësonte monedha polake. Të paktën ky është mentaliteti që ka zënë vend në opinionin polak. Po të pyesësh për këtë në disa vende europiane, si për shembull në Mbretërinë e Bashkuar, në Danimarkë, në Suedi dhe në Zvicër, vende që nuk kanë pranuar të aderojnë në zonën e euros, përgjigja do të ishte e njëjtë: frika nga kontrolli gjerman. Vendet e Beneluksit e kanë pranuar euron, edhe pse kanë kufij me Britaninë e Madhe dhe Francën, që i mbrojnë nga Gjermania, pra nuk kanë më frikë si Danimarka ose Suedia, të cilat nuk kanë asnjë që t'i mbrojnë.

Mund të duket disi e çuditshme, por ka ende vende që nuk kanë asnjë që t'i mbrojnë.

Ekziston mendimi se gjermanët janë miq kur nuk janë shumë të fortë. Ata vazhdojnë të kenë një besim të tepruar në qeveritë e tyre dhe ndjekin gjithmonë moton se “çfarëdo që thotë qeveria duhet të bëhet që të ketë rregull”. Dhe kjo nuk kuptohet si një çështje në vetvete, por si një problem në kohë, deri kur një qeveri tjetër gjermane do të gjejë një tjetër “ide të madhe”, siç e gjeti me nazizmin. Pse polakët, që njihen si jodashmirës të qeverive të tyre, duhet të jenë të pranueshëm ndaj një qeverie gjermane?!

Pa dashur të zgjatëm me çështjen polake, ka dhe një element tjetër historik pse polakët nuk e duan euron. Nga viti

1949 deri në vitin 1989 ata ishin pjesë e KNER-it, organizatës së bashkëpunimit dhe kooperimit midis vendeve të bllokut ish-socialist, që drejtohej nga Rusia. Kontrolli i valutës (*zlotit*) i kishte kaluar institucioneve të drejtuara prej saj dhe Polonia përfundoi në një nga vendet më të varfra të Europës. Megjithatë, të mos harrojmë se pas 8 vjetësh, më 1997, ajo arriti të kalonte nivelin mesatar botëror të zhvillimit ekonomik.

Aktualisht ekonomia polake është në rritje të vazhdueshme me valutën e saj dhe analistët polakë nuk e shohin konkurrues *zlotin* e tyre me euron. Ata mendojnë se “fuqia blerëse e euros është më e madhe se e *zlotit* dhe zëvendësimi i tij me një monedhë më të fuqishme përveç rritjes së kostos në rrugë joekonomike do të na dëmtojë edhe në avantazhin konkurrues lidhur me pagat dhe prodhimin e të mirave materiale”. E thënë thjesht, analistët e ekonomisë polake mendojnë se diferenca në fuqinë blerëse të valutave i japin mundësi, i lejojnë vendit të mbetet konkurrues në tregun e tërheqjes së kapitaleve dhe investimeve të huaja.

### **Pse Republika Çeke nuk do të hyjë në zonën e euros?**

Republika Çeke aderoi në BE më 1 maj 2004 dhe vazhdon të ketë në përdorim monedhën e saj kombëtare, *koronën*. Me rastin e përshëndetjes për

vitin e ri 2024 Presidenti i Republikës Çeke, Petr Pavel, mbështeti qëndrimin se “aktualiteti i situatës gjatë viteve në BE kërkon tashmë hedhjen e hapave konkretë që do ta çojnë Republikën Çeke në mbajtjen e premtimit për të adoptuar euron, sepse [...] një monedhë e përbashkët europiane është një e ardhme logjike për vendin tonë të orientuar nga eksportet”.

Sipas Presidentit Pavel, ekonomia çeke “është e mbështetur kryesisht në eksportet në vendet e zonës së euros dhe do të ketë vetëm përfitime nga adoptimi i monedhës unike europiane”, por ky qëndrim i tij, me sa duket, nuk është në të njëjtën linjë me atë të qeverinë çeke. Një raport i publikuar më parë nga banka qendrore çeke dhe nga Ministria e Financave rekomandonte (duke iu referuar euros – shënimi im) “një kujdes ekstrem valor”. Këto dy institucione hartojnë çdo vit një raport të veçantë vetëm për këtë problem, që përbën dhe një nga kushtet e Traktatit të Mastroit për futjen e Republikës Çeke në hapësirën e euros. Vitin e kaluar ky raport nuk u vlerësua nga qeveria, pra le të themi se e kaloi në heshtje, ndërsa banka qendrore çeke vuri në dispozicion një material analitik, me synim që të paraqiste një vizion afatgjatë të zhvillimeve ekonomike dhe të detyrimit për t'u futur në zonën e euros. Konkluzioni kryesor ishte se “aderimi në të ardhmen në hapësirën e euros do të rriste më tej përfitimet e vendit, të



çilat do të rridhnin nga përfshirja më e gjerë e tij në marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare”. Në të njëjtin raport theksohej gjithashtu se “adoptimi i euros do të sillte rritjen e mundësive të risqeve të lidhura me humbjen e pavarësisë ndaj politikës monetare të vendit dhe rolit stabilizues ndaj një kursi këmbimi fleksibel”. Sipas karakteristikave të ekonomisë çeke, për

afatgjatë, ndërsa sektori bankar i brendshëm, me rritje të kapitalit fillestar në vitet e fundit, paraqitet mjaft i fortë në aspektin e likuiditetit.

### 2. Treguesit me një nivel të ndërmjetëm rrishte.

Kjo kategori treguesish fokusohet në aspektet neutrale të riskut që mund të vijë nga konvergjenca e ekonomisë në hapësirën e euros. Republika Çeke dallon

“ Nëse indicet ekonomike tregojnë se ekonomia çeke është gati të adaptojë euron, duke plotësuar edhe standardet për këtë qëllim, ekziston frika e një situatë politike analoge sa më sipër, që do ta minonte koniunkturën e veprimit konkret të lëvizjes drejt saj. Heterogjeniteti politik që ekziston për këtë qëllim, me sa duket, do ta vonojë ende aderimin e Çekisë në zonën e euros. Kjo situatë u shfaq edhe në sondazhin e zhvilluar në fillim vitin 2024, ku 68% e të anketuarve u shprehën kundër aderimit të vendit në zonën e euros. ”

analistët risqet e adoptimit të euros kanë të bëjnë me tri grupe treguesish, si më poshtë:

### 1. Treguesit që sugjerojnë një nivel të ulët rrishte.

Ky grup përfshin lidhjet e ngushta tregtare të Republikës Çeke me hapësirën e euros dhe kushtet e favorshme që do të gjenerojnë përfitime eventuale nga aderimi në monedhën unike. Rreshtimi i ciklit ekonomik të Çekisë në atë të zonës së euros do të mbështet, ndonëse lehtësisht, nga tendenca e rritjes së zënies me punë në sipërmarrjet çeke. Nivelet e ulëta të riskut, që shoqërojnë adoptimin në hapësirën e euros, janë të lidhura me vlerësimin e tregut të punës dhe të sektorit të brendshëm bankar. Tregu i punësimit vlerësohet pozitivisht falë nivelit të lartë të aktivitetit ekonomik të popullatës çeke dhe nivelit të ulët të papunësisë në

nga Unioni Monetar në disa tregues financiarë, të cilët nuk përbëjnë ndonjë disavantazh ose pengesë përjashtuese për aderim. Kështu, devijimi i normave të interesit në rrjedhën e viteve është konsideruar një faktor neutral, derisa niveli i tyre, i krahasuar me vite të mëparshme, është ulur për shkak të fillimit të ciklit shtrëngues të politikës së brendshme monetare.

### 3. Treguesit e risqeve ekonomike të lidhura me aderimin në zonën e euros.

Grupi i tretë i treguesve përfshin faktorë që e bëjnë procesin e konvergencës ekonomike të Republikës Çeke në euro të pakompletuar dhe të zgjatur në realizim. Këtu hyjnë faktorët relativë të lidhur me dinamikën e çmimeve dhe nivelin e pagave. Një tjetër risk është ngjashmëria e vogël strukturore e ekonomisë çeke me atë europiane. Divergjenca do të lindin edhe në tregun kombëtar të punësimit,

ku vazhdon *problemi i konfigurimit të sistemit fiskal dhe të sigurimeve shoqërore*, që mund të ketë si efekt *disimpenjimin për kërkimin aktiv të punësimit*. Po t'i shtosh punësimit edhe elementet e politikës fiskale, të zbatuar, p.sh., gjatë pandemisë, kuptohet se në çfarë përqëndrimi mund të futen financat publike.

Analistët vërejnë se në qeveri jo vetëm nuk ka entuziazëm për adoptimin e euros si monedhë e BE-së, por ka edhe qëndrime kontradiktore dhe nuk kuptohet se si do të vijohet në këtë drejtim. Në një raport të vitit të kaluar të bankës qendrore çeke dhe Ministrisë së Financave afirmohej se “vendi duhet të jetë gati për të hyrë në zonën e euros në vitin 2024”, por në të njëjtën kohë thuhej që “të mos ndërmerren hapa konkretë”. Kjo linjë e qëndrimit qeveritar është pasojë e koalicionit aktual politik, ku përveç Partisë Qytetare Demokratike të Kryeministrit është në koalicion edhe një parti konservatore euroskeptike, por shumë më e vogël se partia konservatore në pushtet e Hungarisë.

Nëse indicet ekonomike tregojnë se ekonomia çeke është gati të adaptojë euron, duke plotësuar edhe standardet për këtë qëllim, ekziston frika e një situatë politike analoge sa më sipër, që do ta minonte koniunkturën e veprimit konkret të lëvizjes drejt saj. Heterogjeniteti politik që ekziston për këtë qëllim, me sa duket, do ta vonojë ende aderimin e Çekisë në zonën e euros. Kjo situatë u shfaq edhe në sondazhin e zhvilluar në fillim vitin 2024, ku 68% e të anketuarve u shprehën kundër aderimit të vendit në zonën e euros.

### Pse Hungaria nuk do të hyjë në zonën e euros?

Edhe Hungaria aderoi në BE më 1 maj 2004 dhe vazhdon të ketë në përdorim monedhën e saj kombëtare, *forintën*. Ndonëse shumë besojnë se kalimi në monedhën euro do të zgjidhë një numër të pafund problemesh ekonomike të vendit, kjo nuk është kaq e thjeshtë. Natyrisht që një monedhë e përbashkët europiane ka shumë avantazhe. Ajo ndihmon në “shtrimin” e ekonomisë, nivelimin e fushës së lojës në tregjet lokale dhe rritjen e ndikimit në tregjet e huaja

etj., megjithatë nuk përjashtohet që adoptimi i euros të shkaktojë më shumë dëme sesa përfitime, prandaj Hungaria, sipas analistëve, duhet të jetë shumë e vëmendshme taktikisht dhe mjaft e kujdesshme në rrugën e aderimit në zonën e euros. “Një mori avantazhesh ose kundërgoditjesh të fuqishme, të dyja janë të mundura”, – thonë ekspertët. Sipas

paqartësi. Dhe paqartësia më e madhe rrethon “stuhinë” e futjes së euros. Çuditërisht, vetëm Polonia ndodhet në situatë të njëjtë me paqartësinë hungareze. Rumania dhe Republika Çeke janë mbrojtëse të mundimshme të valutave të tyre kombëtare, por pavarësisht kësaj kanë arritur të përcaktojnë afate për aderimin në Eurozonë, gjë që i mungon

ritmet e rritjes së asaj kohe një gjë e tillë do të arrihej në vitin 2059. Kujtojmë se Orbani u rikonfirmua Kryeministër edhe në zgjedhjet e vitit 2018 dhe 2022.

Ndonëse vitet e fundit ka një zbutje të toneve kundër euros, nga Matolcsy është hedhur hipoteza se “ka shumë rëndësi që të mësojmë nga gabimet e vendeve të tjera”, duke iu referuar këtu Sllovakisë dhe vendeve të Mesdheut, por edhe kujdesit që treguan vendet Baltike në përgatitjen për Eurozonën. Qëndrimi më i fundit i Matolcsy-it është deklarata e tij se “kam besim se me strategjinë adekuate ekonomike mund të arrihet në afatmesëm nivel i zhvillimit të nevojshëm për një futje të sigurt dhe të suksesshme të euros”. Në zhargonin financiar termi “në afatmesëm” shkon nga 1 deri në 5 vjet, ndërsa ne parashikojmë që Hungaria mund ta konkretizojë adoptimin e euros nga viti 2030.



shypit vendas, “shumë shohin tek euroja një shpëtimtar, avantazhe që sjellin ndihmë për zhvillimin e vendit dhe promovimin e konkurrencës së ndershme në tregje, lëvizje më të lira e sidomos më efektive të investimeve të huaja, standarde më të larta të mekanizmave të funksionimit të ekonomisë etj.”, por nuk janë të paktë edhe ata që shohin negativitetet, në mënyrë të veçantë zvogëlimin e autonomisë së ekonomisë kombëtare dhe impaktin e saj në humbjen e sovranitetit në politikën monetare. Parashikimin se si do të lëvizë raporti avantazhe–disavantazhe dhe nga do të anojë balanca midis tyre, duke parë dhe përvojën e Sllovakisë dhe Kroacisë, hungarezët preferojnë t’ia lënë vendimmarrësve të ekonomisë dhe financave.

A do të hyjë Hungaria në zonën e euros? Duke vlerësuar problemin e autonomisë, lind një pyetje stresuese: kur do të jetë Hungaria dëshmitare e hyrjes në Eurozonë dhe të ofrojë perspektivën e mbështetjes në sforcot e bëra për rimëkëmbjen ekonomike sipas parashikimeve optimiste? Perspektiva duket pozitive, por fillimi i kësaj epoke transformimi mbetet ende i mbuluar me

Hungarisë.

Banka qendrore e Hungarisë pretendon të aderojë ekonominë e vendit në Eurozonë, “por kur të ketë një ekonomi kompetitive, që do të garantojë një progres të pandërprerë të shëndoshjes ekonomike nëpërmjet euros”. Sipas presidentit të kësaj banke, Gyorgy Matolcsy, “Hungaria aktualisht nuk i plotëson kriteret e nevojshme për të futur euron në vend të monedhës kombëtare”. Sfidat kanë të bëjnë me vështirësitë për të plotësuar kriteret nominale të Mastroitit, sidomos ndaj normës së lartë të inflacionit në vitet e fundit. Po sipas Matolcsy-it, inflacioni në Hungari “është më i lartë se standardi i kërkuar dhe performanca jonë afatgjatë parashikojmë të jetë mbi limitet aktuale”.

Në ndryshim nga presidenti i bankës qendrore të Hungarisë, politika hungareze ka qenë e tërhequr, për të mos thënë edhe më e ashpër ndaj detyrimit për t’u futur në zonën e euros. Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orbán, në vitin 2013 do të deklaronte se vendi i tij nuk do të adoptonte euron për sa kohë që të ardhurat për frymë nuk arrijnë në 90% të mesatares së Eurozonës. Me

### Rasti i Shqipërisë

Kemi një dallim thelbësor nga sa trajtuam më sipër. Shqipëria nuk është bërë ende anëtare e BE-së me të drejta të plota, por jemi në prag të hapjes së negociatave për këtë qëllim. Zhvillimi i konferencës së parë ndërqeveritare më 19 korrik 2022 shënoi fillimin zyrtar të negociatave të anëtarësimit në BE. Hapja e negociatave mbi bazë merite ishte një arritje historike për Shqipërinë, por në të njëjtën kohë ajo shënoi edhe fillimin e një procesi transformues dhe të gjithanshëm për vendin tonë. Menjëherë pas konferencës së parë ndërqeveritare, më 15 shtator 2022, filloi procesi i shqyrtimit analitik të *acquis* (*screening*), si hapi i parë i negociatave të anëtarësimit, i cili zgjati deri më 24 nëntor 2023, datë që shënoi edhe finalizimin me sukses të mbylljes së këtij procesi. Shpresojmë dhe besojmë se brenda këtij viti, me më shumë mundësi në 6-mujorin e dytë të tij për shkak të zgjedhjeve europarlamentare gjatë këtij qershori, të mbahet konferenca e dytë ndërqeveritare midis Komisionit të BE-së dhe qeverisë sonë për hapjen *de facto* të negociatave, për të cilat është përgatitur “Udhërrëfyesi i shtetit të së drejtës” dhe ai për reformën në administratën publike, që përbëjnë piketat e hapjes së negociatave për grupin

e parë të kapitujve “Themeloret”. Krahas këtij realiteti, që lidhet me aspektin e jashtëm, duhet të kemi parasysh dhe të përqendrohemi, madje më shumë, te realiteti i brendshëm, pasi tashmë loja do të zhvillohet këtu.

Vendi ynë hyri në rrugën e sistemit demokratik pas një periudhe të gjatë autoritarizmi dominues dhe të

madhorë të vendit. Lufta për pushtet zbehu luftën për shtetformim dhe i hapi rrugën një korrupsioni që nuk besoj se ka nevojë për koment ekzistence dhe veprimi edhe në të sotmen. Në këtë qasje marrëdhëniesh pozitive–opozitive më shumë ka dominuar lufta me sharje fyese e denigruese deri në pikën që ia “kemi futur vetes” dhe e kemi katandisur qenien tonë

“ Hapja e negociatave mbi bazë merite ishte një arritje historike për Shqipërinë, por në të njëjtën kohë ajo shënoi edhe fillimin e një procesi transformues dhe të gjithanshëm për vendin tonë. ”

ekstremizuar në sistemin socialist. Në gati gjysmë shekullin e kaluar kultura dhe institucionet demokratike nuk ekzistonin në thelbin e tyre. Dominonte sistemi njëpartiak, një ekonomi tërësisht e planifikuar në gjithçka dhe pa asnjë element tregu, një ideologji e vetme dhe pa hapje me botën. Ky realitet izolacionist i së shkuarës la pasojë edhe traumatizuese për procesin e tranzicionit, i cili është reflektuar edhe në zgjatjen e procesit të hapjes së negociatave për anëtarësimin në BE. Këtë e tregon edhe fakti që ne kemi hyrë në vitin e 34-t të ndryshimit të sistemit të kaluar dhe ende presim hapjen e negociatave, ndërkohë që të gjitha vendet europiane ish-komuniste janë sot anëtare të BE-së dhe shumica e tyre kanë aderuar edhe në Eurozonë.

Vlera e së kaluarës duhet parë me syrin e analizës për të kuptuar reflektimin mbi të sotmen dhe rregullimet apo plotësimet e mangësive për të ardhmen. Sistemi politik i diktaturës u përmbys e u zëvendësua nga pluralizmi partiak, por ai ishte më shumë anarkik dhe u bë shumë shpejt i “modës së fundit”. Fillimet e tij ishin revanshiste dhe arrogante, deri në masën që nga fundi i viteve ’90 na çuan në prag të një lufte civile. Pavarësisht përmbysjes së klasës së vjetër politike, klasa e re që erdhi në pushtet ishte pa kulturë demokratike dhe pasojat e marrëdhënies ndërpartiake u karakterizuan më shumë nga konfliktualiteti dhe dëmtimi i interesave

në një nivel politik foshnjor, ku problemet e mëdha të zhvillimit të vendit, por edhe ato të nivelit të mesëm e në ndonjë rast edhe ato të rëndomtë, më shumë na i kanë zgjidhur miqtë ndërkombëtarë sesa i kemi zgjidhur vetë.

Në planin ekonomik pësuam fatkeqësinë e “terapisë së shokut” të servirur dhe imponuar deri në detaje nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Me sloganin e shkatërrimit të marrëdhëniesh socialiste në prodhim, që nënkuptonte zëvendësimin e shpejtë dhe me dhunë, pa asnjë parapërgatitje dhe pa asnjë lloj niveli strategjie, të pronës shtetërore e kooperativiste me pronën private, ne shkatërruam bazën materialo-prodhuese të sistemit të vjetër dhe “nxorëm sytë tanë” me të ashtuquajturin “proces i privatizimit”. Me ligjin nr. 7501 për privatizimin e tokave bujqësore të kooperativave u dhamë tokë pa kritere të sakta dhe të drejta të gjithë atyre që jetonin në fshat, pa mbajtur parasysh shpërndarjen sipas trashëgimisë dhe kohës së vendndodhjes me banim në juridiksionin kooperativist. Anarkia që shoqëroi këtë proces vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe vetëm një Zot e di se kur do të zgjidhen problemet e pronësisë në zonat rurale. Më vonë me ligjet për privatizimin e të gjitha llojeve të ndërmarrjeve shtetërore me letra me vlerë ne nuk bëmë gjë tjetër veçse i dhamë privatizimit karakter administrativo-

burokratik dhe e çuam këtë pronë te militantët e partive dhe shërbëtorët qeveritarë, në vend që t’ia nënshtonim atë, me transparencë dhe kritere efektiviteti e performance, shitjes së më të aftëve.

Kjo ecuri pati si pasojë krijimin e një strukture të cunguar tregu dhe konkurrence, ku edhe sot ne kemi të formësuar tregun e mallrave dhe të shërbimeve, por *na mungon tregu i kapitaleve dhe i ai punës*. Në këto kushte, standardet e një tregu funksional e të institucionalizuar nga aspekti i funksionimit të mekanizmave të tij, që të përballojë me një masë niveli potencialiteti presionet e konkurrenciale të tregut të BE-së. Standardet e konvergjençës, që përfshijnë stabilitetin e çmimeve, kontrollin e inflacionit, të normave të interesit, stabilitetin e situatës financiare, të kursit të këmbimit etj., janë që të gjitha probleme që nuk mund të zgjidhen vetëm me vullnet politik, por duan edhe kohën e tyre. Të paktën këtë na ka treguar përvoja.

Përmenda më shumë aspektet negative, jo për efekt pesimizmi, as për të mohuar arritjet dhe sukseset, të cilat janë mjaft të mëdha, por thjesht për të treguar pasojat e realitetit të së kaluarës, vështirësitë e rrugës që kemi bërë dhe pse jemi vonuar relativisht gjatë. Ajo që meriton të vlerësohet është sidomos mirëpritja që iu bë prezantimit nga ana e delegacionit tonë në BE të raportit për hapjen e negociatave, që u kurorëzua më 19 korrik të vitit 2022, dhe impakti që lamë pas në ecurinë e mëtejshme të këtij procesi.

Kroacia në vitin 1995 doli nga lufta ushtarake dy–trevjeçare me Serbinë, në vitin 2003 iu pranua kërkesa për anëtarësim në BE, më 1 janar 2013 u pranua anëtare me të drejta të plotë në BE dhe më 1 janar 2013 aderoi në Eurozonë. Ky proces *simbol*, i arritur brenda 25-vjetve dhe pas një lufte, nuk mund të përsëritet në kushtet tona. Realitetet e koniunkturave të sotme gjeopolitike dhe gjeostrategjike ndihmojnë arritjen e objektivit të anëtarësimin në BE në vitin 2030, por të mos harrojmë se hyrja në Eurozonë, e detyrueshme nga Traktati i Mastihut, do të jetë një histori e veçantë, e cila mund të shkojë edhe pas viteve 2040.

# Ligji dhe masat pozitive si domosdoshmëri për parandalimin e diskriminimit

(Rasti i barazisë gjinore në të drejtat e pronësisë)



## Vështrim i përgjithshëm

Ky punim analizon çështje të legjislacionit për barazinë gjinore në të drejtat e pronësisë dhe fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave në familje. Për sa është e mundur, analiza ka për qëllim të evidentojë ndikimin që ka mënyra e formulimit të ligjit në respektimin e parimit të barazisë gjinore në kushtet e mentalitetit dhe të tabuve të krijuara në shoqëri. Një vend të veçantë zë analiza e pasojave që vijnë nga një legjislacion i pavetëmjaftueshëm ose i paplotë për të përballuar pengesat që vijnë nga realiteti social.

Gjetjet e këtij punimi ndihmojnë në nxjerrjen e përfundimeve të dobishme për disenjinin e legjislacionit dhe zbatimin e tij në përputhje me kërkesat kushtetuese të parimit të barazisë gjinore. Metodologjia për realizimin e studimit ndihmon në vlerësimin e situatës së barazisë gjinore në marrëdhëniet e pronësisë si dhe në përmirësimin e legjislacionit, me qëllim arritjen e barazisë gjinore në kuptimin e saj thelbësor. Spikatin metodat shkencore të studimit të institucioneve që ballafaqohen me faktet sociale.



Akademiqe Aurela ANASTASI

Parimi i barazisë dhe ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë janë sanksionuar shprehimisht në Kushtetutën e Shqipërisë. Neni 18/2 i saj e përcakton gjininë si shkakun e parë që mbrohet nga diskriminimi. “*Asksush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia...*”, – thuhet në këtë nen. Aktet e tjera për zbatimin e Kushtetutës e detajojnë këtë parim. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” (2008) përkufizoi llojet e ndryshme të diskriminimit si dhe format me të cilat mund të ushtrohet ai, ndërsa ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (2010) ndërtoi Komisionerin si një organ administrativ për shqyrtimin e konflikteve për shkak të diskriminimit. Megjithatë,

këto ligje nuk kanë dispozita të posaçme për diskriminimin në lidhje me të drejtat e pronësisë. Për këtë çështje Kodi i Familjes parashikon dispozita mbi regjimin e pasurisë bashkëshortore, ndërsa Kodi Civil rregullon marrëdhëniet pronësore e trashëgimore, përfshirë regjimin e familjes bujqësore.

Për të garantuar zbatimin e parimit

Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW). Vërejtjet përmbyllëse të Komitetit të CEDAW-t kanë shërbyer si nxitje për marrjen e masave nga institucionet shtetërore, me qëllim që barazia gjinore të mos mbetet thjesht formale.

Një tjetër garanci është edhe procesi

“ Diskriminimi gjinor nuk është vetëm formal, por edhe thelbësor, çka do të thotë se ai nuk vjen vetëm për shkak të pabarazive të parashikuara në ligj ose të mangësive të tij, por edhe për shkak të zhvillimeve ekonomike, politike, shoqërore, kulturore etj. Ndeshen sidomos pabarazi gjinore që burojnë nga pafuqia e zbatimit të ligjit për shkak të stereotipave dhe paragjykimeve gjinore në shoqëri. ”

të barazisë gjinore një vend të rëndësishëm zë zbatimi i akteve ndërkombëtare të ratifikuara, sidomos zbatimi i standardeve që burojnë nga jurisprudenca e gjykatave ndërkombëtare. Kushtetuta e Shqipërisë ka parashikuar zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe në rast konflikti u ka dhënë atyre fuqi mbiligjore në krahasim me ligjin e brendshëm. Mekanizmat ndërkombëtarë janë një mjet i rëndësishëm për përbushjen e standardeve. Procesi i raportimit periodik nga shteti shqiptar përpara tyre si dhe paraqitja e raporteve alternative nga institucionet e pavarura dhe organizatat e shoqërisë civile kanë pasur rol të rëndësishëm në identifikimin e problemeve të respektimit të barazisë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e të drejtave të pronësisë. Një ndihmesë të veçantë ka dhënë raportimi periodik përpara Komitetit të CEDAW-t në kuadër të zbatimit të i Konventës së Kombeve të

që ndiqet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian në sja të proceseve për integrimin. P.sh., ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” është përafruar pjesërisht me të drejtën e BE-së, kurse ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, është përafruar plotësisht me direktivën e Bashkimit Europian sa i përket zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime.

Gjykatat kombëtare janë një mekanizëm efektiv mbrojtjeje në rastet e konflikteve që lindin për të drejtat e pronësisë. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare e lehtëson këtë rol të gjyqësorit. Praktikisht gjyqësori shqiptar është ndeshur me sfida të reja për respektimin e mekanizmave të barazisë gjinore në të drejtat e pronësisë. Gjatë miratimit të ligjeve të reja për barazinë gjinore dhe dhunën në familje është shfaqur hapur një lloj skepticizmi për dobinë e masave të reja ligjore. Këto ligje konsideroheshin më tepër si ligje që i

imponoheshin shoqërisë shqiptare në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare, sesa si ligje për të cilat shoqëria kishte realisht nevojë. Kjo është arsyeja pse ka pasur debate të gjera jo vetëm nga grupet e interesit dhe përfaqësuesit në politikë, por edhe nga profesionistët e sistemit të drejtësisë. Kishte mjaft që mendonin se ishin ligje të adoptuara nga shoqëri të tjera dhe vështirë të zbatoheshin në terrenin shqiptar, megjithatë në dy dekadat e fundit gjykatat kanë zhvilluar një jurisprudencë gjyqësore të re mjaft të dobishme.

Jurisprudenca gjyqësore ka çuar në forcimin e opinionit se diskriminimi gjinor mund të vijë jo vetëm për shkak të problemeve në legjislacion, por edhe për shkak të asaj që ndodh në realitetin social. Edhe pse ka një gjuhë neutrale gjinore, ligji nuk mund të garantojë barazinë nëse nuk ndërhyr për të rregulluar stereotipat gjinorë të krijuar në shoqëri, që pengojnë ushtrimin e saj. Diskriminimi gjinor nuk është vetëm formal, por edhe thelbësor, çka do të thotë se ai nuk vjen vetëm për shkak të pabarazive të parashikuara në ligj ose të mangësive të tij, por edhe për shkak të zhvillimeve ekonomike, politike, shoqërore, kulturore etj. Ndeshen sidomos pabarazi gjinore që burojnë nga pafuqia e zbatimit të ligjit për shkak të stereotipave dhe paragjykimeve gjinore në shoqëri. Në mjaft raste legjislacioni nuk është i vetëmjaftueshëm për t’i mënjanuar ato, prandaj identifikimi dhe analizimi i diskriminimit gjinor në marrëdhëniet e pronësisë mbetet vendimtar për parandalimin dhe luftimin e tij, por dhe për forcimin ekonomik të grave e vajzave.

Pas rënies së regjimit monist më 1991 dhe krijimit të institucioneve të reja ndodhën ndryshime të mëdha si rezultat i dy faktorëve: i) *zhvillimeve të ekonomisë së tregut*; ii) *procesit të privatizimit të pronave shtetërore*. Këto patën ndikim të madh edhe nga pikëpamja gjinore në ndarjen e pasurisë dhe të pronës. Një nga ligjet e para ishte ligji “Për privatizimin e banesave shtetërore”, i cili u duk si një fillim i mbarë për regjistrimin e bashkëpronësisë në emër të dy

bashkëshortëve, pasi parashikonte privatizimin e banesave shtetërore për të gjithë anëtarët madhorë të familjes. Regjistrimi i banesës shtetërore të përfituar me privatizim bëhej në emër të të gjithë anëtarëve madhorë të familjes në bazë të certifikatës së gjendjes familjare. Në qarqet e juristëve pati kritika ndaj ligjit, një prej të cilave ishte se nuk mbante në vëmendje kontribuesit e mirëfilltë, ata që kishin paguar qiranë gjatë gjithë periudhës së posedimit të pronësisë. Një debat i tillë u shua shpejt dhe nuk njohu ndonjë shqyrtim institucional. Për fat të keq, përvoja e këtij ligji nuk shërbeu për të mënjeluar rolin e institutit zakonor e ligjor të kryefamiljarit, i cili peshon edhe sot në marrëdhëniet e pronësisë midis bashkëshortëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Kështu, në mjaft reforma të tjera që lidheshin me privatizimin, legalizimin, rindërtimin dhe transaksionet me pronat në qarkullimin civil mbizotëroi regjistrimi i tyre në emër të kryefamiljarit.

### **Pabarazitë që identifikohen nga analiza e ligjit dhe fakteve sociale**

Një metodë studimore institucionale e gërshetuar me faktet sociale mundëson identifikimin e shkeljeve të parimit të barazisë gjinore dhe të diskriminimeve. Mbi këtë bazë konstatohet se pabarazi të mëdha kanë sjellë stereotipat që ekzistojnë në realitetin shoqëror, sipas të cilëve pasuria e familjes trashëgohet nga trashëgimtarët meshkuj. Këta stereotipa janë bërë faktorë për pabarazi gjinore, edhe pse ligji nuk ka shprehur ndonjë pabarazi të tillë. Për shembull, zakoni sipas të cilit kryefamiljari ka pushtetin në familje, ka krijuar traditën që e konsideron atë zotërues të pronave të familjes. Kjo është arsyeja kryesore që gratë zhvishen nga pronat që trashëgojnë në favor të anëtarëve meshkuj të familjes së origjinës. Kjo realizohet përmes mosregjistrimit të bashkëshortëve si bashkëpronare dhe përmes heqjes dorë vullnetare nga e drejta e pronësisë. Është ngritur vazhdimisht shqetësimi se gratë dhe vajzat heqin dorë nga pasuria e trashëguar ose e dhurojnë atë në favor të anëtarëve meshkuj të familjes.

Edhe pse legjislacioni nuk ka dispozita që krijojnë pabarazi, sa më sipër na çon në përfundimin se dispozitat ligjore neutrale nuk janë të mjaftueshme për parandalimin e këtyre fenomeneve. Mosparashikimi në ligj i dispozitave parandaluese ose i masave pozitive e bëjnë ligjin të pavetëmjaftueshëm për të përballuar stereotipat dhe tabutë, që kanë një ndikim shumë të madh në shoqëri e në mënyrë të veçantë në marrëdhëniet familjare. Pa këto masa gjuha neutrale e ligjit mbetet një gjuhë e barazisë formale, krejt e pafuqishme që të rezultojë në një barazi reale ose thelbësore. Ndoshta një gjykim kushtetues mund të kishte konstatuar ometim ligjor deri në shkallën që sjell pasoja të pakushtetutshmërisë, porse në Shqipëri Gjykata Kushtetuese nuk ka gjykuar raste me këtë objekt dhe doktrina e saj për barazinë gjinore në përgjithësi mungon.

### **Pabarazitë në të drejtat e trashëgimisë**

Fenomeni i pabarazisë në çështjet e pronësisë u evidentua në trashëgimin e pronave të fituara gjatë martesës. Ligji nuk parashikonte dallime ose privilegje për burrat, por, meqenëse prona

Ajo barazohej me fëmijët si trashëgimtare e radhës së parë dhe pasuria ndahej në pjesë të barabarta midis tyre. “Në praktikë transkriptimi i dëshmisë së trashëgimisë në ZRPP bëhet [...] duke transferuar pronën në emër të të gjithë trashëgimtarëve në pjesë të barabarta, pa marrë në konsideratë faktin se prona ishte në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve.” (Mandro 2016.)

Për shkak të stereotipave të krijuar kjo praktikë dukej e natyrshme dhe ishte një problem i fjetur derisa konfliktet gjyqësore nisën të shtoheshin. Këto paraqiteshin më tepër në periudha krizash familjare. Pati edhe raste kur fëmijët kërkonin të tjetërsonin pronën e trashëguar, duke rrezikuar në këtë mënyrë deri strehimin e nënës së tyre. Në këto kushte, thirrjet e para të juristëve drejtuar organizatave të shoqërisë civile synonin rritjen e ndërgjegjes juridike të qytetarëve, me qëllim që gratë të njihnin të drejtat e tyre pronësore dhe të kërkonin në çdo rast regjistrimin e titullit të bashkëpronësisë, sepse “është e rëndësishme që në çështjet e trashëgimisë të mbahet parasysh prezumimi ligjor i bashkëpronësisë së dy bashkëshortëve për pasurinë e vendosur gjatë martesës. Për këtë është e nevojshme që gratë të këmbëngulin për regjistrimin e pasurive të fituara gjatë martesës në emër të të dy bashkëshortëve,

“Megjithëse ishte formuluar me një gjuhë neutrale dhe nuk pengonte aspak regjistrimin e pronësisë së paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, për shkak të praktikave privilegjuese për kryefamiljarin ndërhyrja në ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme do të ishte masa më e shpejtë dhe më efektive. Detyrimi për të regjistruar të dy bashkëshortët si titullarë të pronës së fituar gjatë martesës do të sillte përmirësimin e situatës.”

regjistrohej në emër të bashkëshortit, bashkëshortja humbte pjesën që i takonte nga prezumimi ligjor si bashkëpronare.

pasi në praktikë ndodh shpesh që ato të regjistrohen vetëm në emër të burrit”. (Anastasi, 2010.)

Ndërgjegjia juridike e shtetasve është mjaft e rëndësishme, por një masë e tillë do të ishte me rezultate mjaft të ngadalta. Ndërkohë zhvillimet ekonomike dëshmonin se gjendja e pronës për gratë po përkeqësohej, prandaj nevojiteshin masa më efektive e me rezultate më të shpejta. Vëmendja u drejtua te përmirësimi i praktikave të zyrave të regjistrimit për transkriptimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore dhe transferimin e pronës së fituar me trashëgim. Ky sugjerim hasi në mjaft kundërshtime, pasi institucionet e regjistrimit kërkonin që gjithçka të bëhej përmes noterit, por në mjaft raste noterët pretendonin se nuk kishte parashikime ligjore ku të bazoheshin veprimet e tyre. Nga ky debat u arrit në përfundimin se duhej të korrigjohesh ligji. Megjithëse ishte formuluar me një gjuhë neutrale dhe nuk pengonte aspak regjistrimin e pronësisë së paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, për shkak të praktikave privileguese për kryefamiljarin ndërhyrja në ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme do të ishte masa më e shpejtë dhe më efektive. Detyrimi për të regjistruar të dy bashkëshortët si titullarë të pronës së fituar gjatë martesës do të sillte përmirësimin e situatës.

### ***Pamjaftueshmëritë nga prezumimi ligjor i bashkëpronësisë midis bashkëshortëve***

Parashikimi i Kodit të Familjes se “*pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak*” (neni 76) është kuptuar vazhdimisht si një garanci që shërben vetëm për të zgjidhur konfliktet gjyqësore midis bashkëshortëve, sidomos për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore në rastin e divorcit. Mungesa e një dispozite ligjore për regjistrimin e pasurive të krijuara nga martesa në emër të të dy bashkëshortëve, për shkak të regjimit të bashkësisë ligjore, rezultonte në përqendrimin e pasurive në duart e kryefamiljarit. Në pjesën dërrmuese kryefamiljar ishte një nga burrat e familjes (bashkëshorti, babai i tij, vëllai), i cili kishte mundësi për të

vepruar si pronar i vetëm në kryerjen e transaksioneve me pronën bashkëshortore. Për rrjedhojë, gratë bashkëshorte nuk kishin një titull pronësie. Ky fakt i ka privuar vazhdimisht ato nga të drejtat që lidhen me disponimin e pronës dhe me statusin e bashkëpronares. Madje, mohimet arritën deri tek të drejtat elementare, si e



drejta për t’u pajisur me vërtetimin e pronësisë për qëllime gjyqësore, me justifikimin se certifikata e pronësisë disponohej vetëm në emër të bashkëshortit.

Për të korrigjuar këtë situatë, masa e parë ligjore u parashikua nga ligji “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i cili shfuqizoi ligjin e mëparshëm, që kishte qenë në fuqi nga viti 1994. Ky ligj në nenin 41/2 sanksionoi shprehimisht: “*Nëse pasuria objekt i kontratës së kalimit të pronësisë realizuar në favor të personave fizikë të cilët në regjistrin e gjendjes civile kanë statusin e të martuarit, është pasuri e fituar gjatë martesës, në përputhje me nenin 76 të Kodit të Familjes, regjistrimi në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë bëhet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve.*”

Ligji e përcaktoi qartë detyrimin e punonjësve të organeve regjistruese të pronave që të regjistrojnë automatikisht në kartelën e pasurisë jo vetëm titullin individual të bashkëshortit pronar, por edhe emrin e bashkëshortes, që mbi bazën e certifikatës së gjendjes familjare prezumohet si bashkëpronare. Për noterin buronte detyrimi të bashkëngjiste certifikatën e martesës në dokumentet e transaksionit me pronën. U shpresua se

me këtë parashikim situata do të ndryshonte rrënjësisht, por nuk ndodhi. Mungonin praktika të unifikuar dhe pati mjaft debate midis regjistruësve dhe noterëve për detyrimet përkatëse ligjore. Në zbatim të këtij ligji, bashkëshortet filluan të thirreshin për të firmosur krahas bashkëshortit përpara noterit. Të gjitha veprimet i kryente titullari i pronës i

regjistruar në hipotekë, kurse bashkëshortja deklaronte përpara noterit dhënien e pëlqimit për veprimin e kryer nga bashkëshorti. Kjo praktikë të kujtonte paksa *alieni juris* në Romën e lashtë.

Për të kryer veprime në fushën e huave dhe të kredive bankare fillimisht paraqiteshin vetëm titullarët e pronës, por pas vitit 2012, në saje të ligjit të ri të sipërpërmendur, bashkëshortet shprehnin pëlqimin për kontratat e dorëzanisë. Ka pasur mungesa në informimin e tyre për pasojat në rastet kur kredimarrësi nuk paguante rregullisht detyrimin e kredisë, gjë që ka çuar në konflikte midis bashkëshortëve, të cilat kanë përfunduar në gjykatë për zgjidhje, veçanërisht gjatë dhe pas divorcit.

### ***Marrëdhëniet pronësore gjatë bashkëjetesës***

Më e vështirë paraqitet situata e pronësisë midis partnerëve në bashkëjetesë. Në Shqipëri bashkëjetesa është njohur ligjërisht nga Kodi i Familjes në vitin 2003, i cili e përkufizon si “*një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët,*

që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmëri” (neni 163). Më parë bashkëjetesa përbënte kundërvajtje administrative të dënueshme. Megjithatë, ende sot ajo nuk ka një rregullim ligjor dhe marrëdhëniet e pronësisë mbrohen sikurse për të gjithë bashkëpronarët. Pra, nuk ka një mbrojtje nga prezumimi ligjor i bashkëpronësisë së bashkëshortëve. Sidoqoftë, për partnerët që bashkëjetojnë me vullnetin e tyre të lirë Kodi parashikon mundësinë që të lidhin marrëveshje përpara noterit për pasurinë (neni 164).

### *Pabarazitë e krijuara në familjen bujqësore*

Ligji aktual që rregullon marrëdhëniet e pronësisë midis anëtarëve të familjes bujqësore, Kodi Civil, nuk ka pësuar ndryshime që nga viti 1994. Familja bujqësore përbëhet nga personat që lidhen ndërmjet tyre për shkak të gjinisë, martesës, birësimi ose pranimit si anëtar i saj (neni 223). Pronësia u përket anëtarëve të saj në tërësi, por në marrëdhëniet pasurore me të tretët ajo përfaqësohet nga kryetari, i cili, edhe pse duhet të zgjidhet nga anëtarët e familjes, zakonisht është babai, gjyshi, bashkëshorti ose vëllai. Kjo për shkak të traditës, e cila në asnjë rast nuk është zëvendësuar nga zgjedhja demokratikisht brenda anëtarëve të familjes. Së paku nuk është evidentuar ndonjë rast i tillë.

Për zbatimin e Kodit Civil dhe të akteve të tjera që lidhen me mbarëvajtjen e familjes bujqësore janë konstatuar praktika të ndryshme për identifikimin e bashkëpronarëve të kësaj familjeje si dhe të transaksioneve me pronësinë e saj. Zbatimi i praktikave të ndryshme të paunifikuara i ka thelluar pabarazitë gjinore në familjen bujqësore. Për më tepër, për shkak të pamjaftueshmërisë së dispozitave të ligjit vajzat e familjes martohen dhe largohen nga shtëpia e vajzërisë pa asnjë pjesë të pronës, ndërkohë që në familjen e re ku shkojnë nuk përfitojnë nga prona e përbashkët e familjes bujqësore. Ky fakt e ka thelluar hendekun gjinor në të drejtën e pronësisë mbi tokën brenda familjes bujqësore.

### *Pjesëtimi i pasurisë bashkëshortore dhe pabarazitë gjinore*

Mungesa e titullit të pronësisë i përball gratë me vështirësi kur ato kërkojnë pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore, madje ka pasur raste gjyqësore kur gratë bashkëshorte kanë kërkuar që gjykata t'i

gjykimin për shkak të mosparaqitjes së paditësit apo paditëses. Kjo mund të ketë arsye të ndryshme, por njëra prej tyre lidhet me procedurat e gjata dhe të kushtueshme të këtyre gjykimeve. Sidoqoftë, për këto çështje ka pak të dhëna, madje mund të themi se të dhënat e vetme janë ato të organizatave të shoqërisë civile, pasi të dhënat zyrtare

**Mungesa e titullit të pronësisë i përball gratë me vështirësi kur ato kërkojnë pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore, madje ka pasur raste gjyqësore kur gratë bashkëshorte kanë kërkuar që gjykata t'i njohë ato si bashkëpronare për pasurinë e vënë gjatë martesës.**

njohë ato si bashkëpronare për pasurinë e vënë gjatë martesës. Nga praktika gjyqësore vërehet qartë se ka më shumë gra sesa burra që kërkojnë pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore pas divorcit. Nga një monitorim i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës për periudhën 2011–2012 me objekt “Pjesëtim i pasurisë bashkëshortore”, konstatohet se pjesa më e madhe e kërkesave paraqiten nga ish-bashkëshortet. Në 54 vendime të monitoruara rezulton se 37 prej kërkesëpadive që kanë vënë në lëvizje gjykatën ose 69% e tyre janë paraqitur nga ish-bashkëshortet, kurse pjesa tjetër janë paraqitur nga ish-bashkëshortët. Kjo mund të dëshmojë edhe faktin se gratë duhet të përballen të parat me procedura të gjata të pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore për shkak të mungesës së titullit të pronësisë. Për fat të keq, këto gjykime zgjasin shumë në kohë, pasi zhvillohen me dy faza dhe me praninë e ekspertit të fushës dhe sjellin shpenzime të konsiderueshme.

Përveç sa më sipër nga ky monitorim rezulton se mbi 60% e kërkesave të paraqitura për pjesëtimin e pasurisë përfundojnë me pushimin e

mungojnë. Në vjetarin statistikor të Ministrisë së Drejtësisë ky objekt nuk evidentohet. Ai nuk është i përfshirë në të dhënat mbi çështjet familjare. Kjo ndoshta ndodh ngaqë objekti përfshihet në çështjet civile me objekt “pjesëtim sendi” ose në “çështje të tjera”. Kjo praktikë është tejet e gabuar, pasi studimi statistikor mbi këto çështje do të ishte mjaft i dobishëm për të arritur në përfundime të vlefshme për zgjidhjen e problemeve që lindin për shkak të mungesës së titullit të pronësisë për gratë.

### *Pabarazitë në të drejtat për sigurimet shoqërore*

Stereotipat gjinorë dhe paaftësia e institucioneve për vëmendje ndaj barazisë gjinore në zbatimin e ligjit kanë shkakuar probleme edhe në fitimin e pensionit të pleqërisë nga gratë. Kjo çështje lidhet me një nga mohimet e mëdha të barazisë gjinore midis anëtarëve të familjes bujqësore. Gjykata Administrative dhe ajo civile në Tiranë kanë shqyrtuar çështje në lidhje me pavlefshmërinë e akteve administrative për ndërprerjen e pensionit të pleqërisë të grave anëtare të familjes bujqësore për

shkak të mungesës së titullit të pronësisë. Për shembull, në një prej rasteve gjykata shprehet se “nga certifikata e pronësisë emri i I. A. nuk figuron si bashkëpronarë në tokë bujqësore dhe nuk rezultojnë nëse përfutjesja ka qenë pjesëtare në trungun familjar me tokë në pronësi sipas ligjit nr. 7983, datë 27.07.1995 Për shpërbërjen e tokës bujqësore, livadhe dhe kullota” (vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 2010). Bazuar në nenin 224 të Kodit Civil, familja bujqësore në marrëdhëniet pasurore me të tretët përfaqësohet nga kryetari i saj. Në praktikë dokumenti i pronësisë mbi tokën regjistrohet në emër të bashkëshortit për shkak të stereotipave dhe praktikave të gabuara, që nuk janë në përputhje me parimin e barazisë gjinore. Për më tepër, asnjë institucion tjetër publik nuk merr përsipër të korrigjojë këtë deficit që krijohet, prandaj të gjitha çështjet përfundojnë në gjykatë. Në këtë rast organet kompetente të sigurimeve shoqërore nuk kanë marrë në konsideratë punën e bërë nga gruaja në bujqësi si fermere private, duke e privuar në këtë mënyrë atë nga e drejta për pensionin e pleqërisë. Stereotipat gjinorë të vijës mashkullore në gëzimin e pronësisë kanë sjellë si pasojë mohime të mëdha të pronësisë për gratë anëtare të familjes bujqësore. Nga ana tjetër, një ligj që nuk merr parasysh faktet sociale dhe nuk ka asnjë dispozitë për të rregulluar deficitet që krijohen nga realiteti social është i paaftë t'i parandalojë këto privime.

### ***Pabarazitë në ofrimin e shërbimeve***

Stereotipat gjinorë dhe praktikave të institucioneve kanë rezultuar në diskriminime për gratë edhe gjatë ofrimit të shërbimeve. Bashkëshorti, si kryefamiljar, ka disponuar kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe me ujë. Për më tepër, ka pasur edhe raste që bashkëshortes i është mohuar e drejta për të lidhur një kontratë të tillë në emër të saj me argumentin se nuk ishte titullare e pronësisë ose e posedimit të shtëpisë. Këto probleme janë shtuar sidomos gjatë periudhave të krizave familjare. Më të rënda paraqiten rastet kur institucionet u

kanë mohuar energjinë dhe ujë bashkëshortes dhe familjarëve të tjerë për shkak të zgjidhjes së kontratës me këto institucione nga kryefamiljari. Gjatë shqyrtimit të një rasti të tillë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konstatuar mohimin e së drejtës së gruas për shërbime nga institucionet. Institucioni përgjegjës për furnizimin me energji elektrike nuk pranonte kërkesën e bashkëshortes për të vijuar furnizimin, edhe pse ajo kishte aftësi paguese. Refuzimi bazohej në argumentin se “pronar i vetëm i shtëpisë figuron bashkëshorti”. Këtë sjellje të entit publik Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e konsideroi “diskriminim në ofrimin e shërbimeve për shkak të gjinisë” dhe kërkoi korrigjimin e kontratës tip të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) të lidhur me vullnetin e kryefamiljarit, e cila parashikonte të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfutjesit të shërbimit.

### **Barazia gjinore dhe të drejtat e pronësisë gjatë krizave dhe emergjencave**

Në periudhat e krizave dhe të emergjencave, për shkak të rritjes së riskut, pabarazia gjinore në të drejtat e pronësisë mund të thellohet. Në Shqipëri kjo u konstatua gjatë krizës urbane që u krijua për shkak të shtimit masiv e të pakontrolluar të ndërtimeve pa leje si dhe gjatë pasojave të tërmetit të 26 nëntorit 2019, pak muaj para shpërthimit të pandemisë së COVID-19.

Dy periudhat kanë ndryshime nga njëra-tjetra. Ndërsa shtimi i vazhdueshëm i ndërtimeve pa leje solli anarki në ndërtime e për pasojë një krizë urbane, tërmeti solli shkatërrime të pronës. Në bazë të Kushtetutës (neni 174), në rastin e dytë në Shqipëri u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore. Megjithatë, dy situatat kanë një bazë të përbashkët, për shkak se procesi për fitimin e pronësisë bazohet në vetëdeklarimin e personave, i cili në të dy rastet bëhet nga kryefamiljari në emër të tij, ndërsa procesi i kalimit të pronësisë është mjaft intensiv dhe i shpejtë. Të dy këta faktorë e rritin ndikimin e stereotipave gjinorë dhe të mentalitetit mashkullor, çka do të thotë

se rritet rreziku që stereotipat gjinorë dhe tabutë të shkaktojnë largimin e vëmendjes nga respektimi i barazisë gjinore.

Për të menaxhuar krizën urbane të krijuar si rezultat i anarkisë së ndërtimeve, ndërhyrjet e posaçme me ligj synuan të rregullonin gjendjen përmes legalizimit, urbanizimit dhe integritetit të ndërtimeve pa leje. U krijuan mekanizma të posaçëm qendrorë e vendorë për menaxhimin e situatës, që vazhdojnë të kryejnë një volum të madh pune për legalizimin e banesave, por gjatë këtij procesi u shfaqën probleme të konsiderueshme në regjistrimin e pronave të legalizura në emër të bashkëpronarëve. Po ashtu gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të pasojave të tërmetit pabarazia gjinore në pronë u thellua më shumë gjatë dhurimit të granteve për ndërtimin e shtëpive të rrënuara, pasi dhurimi bëhej vetëm në emër të kryefamiljarit.

### ***Pabarazia gjinore në realitetin e legalizimit të banesave të ndërtuara pa leje***

Gjatë legalizimit të ndërtimeve pa leje, për shkak të pabarazisë gjinore, u krijuan konflikte në familje, veçanërisht midis bashkëshortëve ose në marrëdhëniet nuse-vëhërr. Përgjithësisht ato u shfaqën gjatë krizave në marrëdhëniet familjare si dhe gjatë periudhës së divorcit ose postdivorcit. Disa prej tyre u shqyrtuan nga gjykatat, por pati edhe konflikte që u shqyrtuan nga Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për këtë nuk ka të dhëna zyrtare, megjithatë mund të nxirren disa përfundime nga përvoja e organizatave joqeveritare që ofrojnë ndihmë ligjore falas për shtresat në nevojë.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, një organizatë jofitimprurëse shqiptare, ka parashtruar kërkesën që agjencia kompetente (ALUIZNI), duke respektuar parimin e prezumimit të bashkëpronësisë së detyrueshme, të kalonte pronën në favor të dy bashkëshortëve, pavarësisht se vetëdeklarimi për legalizimin e ndërtimeve pa leje ishte paraqitur vetëm nga

kryefamiljari. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për raste të tilla ka kërkuar korrigjimin e praktikave të ALUIZNI-t, që lëshonte lejen për legalizim vetëm në emër të kryefamiljarit. Komisioneri ka vlerësuar se praktika e institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e lejes së legalizimit dhe nxjerrjen e certifikatës së pronësisë vetëm në emër të njërit bashkëshort (burrit) është “*dukshëm e njëanshme, në shkelje të ligjit e mbi të gjitha në shkelje të parimit kushtetues të barazisë*”. Ai ka arsyetuar se këto veprime kanë sjellë si pasojë një diskriminim të tërthortë të bashkëshorteve në raport me kryefamiljarin.

Opinionin e Komisionerit nuk përcakton qartë organet nga veprimi apo mosveprimi i të cilave ka ardhur si pasojë diskriminimi. Sidoqoftë, Komisioneri ka theksuar se ky diskriminim nuk vjen nga parashikimet e ligjit (neni 7 i ligjit për legalizimet), por nga mungesa e efektivitetit gjatë zbatimit në praktikë të tij. Ajo çfarë na mungon në opinionin e Komisionerit është një analizë e testit të diskriminimit të tërthortë gjinor. Ky i fundit është shtruar dhe pretenduar në debatin publik, veçanërisht nga organizatat jofitimprurëse, të cilat e kanë parashtruar edhe në raportimet e tyre. Por nuk rezultojnë një vendim i plotë gjyqësor ose *quasi* gjyqësor për vërtetimin e tij. Gjithashtu u diskutua se një diskriminim i tërthortë gjinor mund të burojë edhe nga vendimet gjyqësore, të cilat normalisht duhet të jenë garante për mbrojtjen e tij.

### ***Pabarazia gjinore në fitimin e pronësisë nga rindërtimi i banesave të rrëzuara nga tërmeti***

Ende pa përfunduar rregullimet e situatës së krijuar nga ndërtimet pa leje, Shqipëria u ndodh në situatën e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. U miratuan akte ligjore për rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti, të cilat rregullonin edhe programet për grante që u dhuroheshin qytetarëve për rindërtimin e banesave të dëmtuara. Procedurat i përcakttoi vendimi i Këshillit

të Ministrave (VKM) nr. 904, datë 24.12.2019, “*Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit*”. Vendimi ka parashikuar që granti të jepej në emër të aplikuesit përmes vetëdeklarimit. Në këtë rast titullar i grantit është kryefamiljari, i cili bën vetëdeklarimin në emër të familjes. Megjithatë, VKM-ja kërkon detyrimisht paraqitjen e certifikatës së përbërjes familjare në datën e dëmtimit nga tërmeti (26 nëntor) si dhe zbatimin e Kodit të Familjes për bashkëpronësinë e dy bashkëshortëve mbi pasurinë e vënë gjatë martesës. Kodi i Familjes sanksionon se pasuria e përfitur me dhurim në favor të bashkësisë konsiderohet pasuri në bashkësi ligjore dhe u përket të dy bashkëshorteve. Në çdo rast merret si referim përbërja familjare e aplikuesit në datën 26 nëntor 2019. Për fat të keq, këto dispozita nuk u mbajtën parasysh nga zbatuesit e ligjit dhe prona e fituar nga rindërtimi me dhurim u kalua në emër të aplikuesit (kryefamiljarit). Nëse aplikuesi në datën 26.11.2019 ka qenë me status civil i martuar, bashkëshortja përfiton *ipso jure* për shkak të regjimit pasuror martesor në bashkësi ligjore. Bashkëshortja përfiton edhe në rast se pas kësaj date është bërë zgjidhja e martesës, edhe nëse bashkëshorti aktualisht ka lidhur një martesë tjetër, por certifikata e përbërjes familjare nuk merret fare në konsideratë nga organet kompetente pranë bashkive.

Këto praktika të zbatimit të ligjit vetëm në favor të kryefamiljarit u konstatuan nga organizatat e shoqërisë civile në Tiranë dhe në rrethe të tjera të vendit, si Lezhë, Kavajë, Krujë. Ato informuan Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të cilit i kërkuan që të shprehej për këtë diskriminim të grave në raport me të drejtat e pronësisë bashkëshortore. Mbi bazën e këtij informacioni Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bërë disa sugjerime për hartimin e kontratave të dhurimit të banesave të përfituara nga grantet e rindërtimit (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2022). Në këndvështrimin e Komisionerit, kur

prona e shkatërruar nga tërmeti ka qenë pjesë e bashkësisë ligjore, përfitimi vetëm nga njëri bashkëshort nëpërmjet kontratës së dhurimit do të ishte cenim i së drejtës së pronësisë dhe do të krijonte premisa për diskriminim gjinor. Për këtë arsye Komisioneri rekomandon marrjen e masave nga Këshilli i Ministrave për respektimin e së drejtës së pronësisë midis dy bashkëshortëve apo ish-bashkëshortëve në kontratat e dhurimit të banesave të përfituara nga grantet e rindërtimit. Ai thekson se kjo praktikë duhet të ndiqet edhe në rastet kur paraqitet njëri prej bashkëshortëve dhe u sugjeron njësitë të qeverisjes vendore dhe noterëve që të përfshijnë të dy bashkëshortët apo ish-bashkëshortët në kontratat e dhurimit të banesave të përfituara nga grantet e rindërtimit edhe në rastet kur vetëdeklarimi bëhet vetëm nga njëri prej bashkëshortëve. Të njëjtën qasje ka pasur edhe ministri i Drejtësisë në shkresën drejtuar Dhomës Kombëtare të Noterëve të Shqipërisë, ku u kërkon të gjithë noterëve të Republikës të zbatojnë sa më sipër.

### **Masat për korrigjimin e diskriminimit**

Sikurse u theksua më lart, reflektimet e paraligjore datojnë në vitin 2012 me ligjin e ri “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, që synonte pikërisht fuqizimin e mekanizmave për respektimin e barazisë gjinore në çështjet e pronësisë. Ligji parashikoi për herë të parë dispozita për regjistrimin e pronës bashkëshortore në emër të dy bashkëshortëve. Në vitin 2018 u miratua dhe hyri në fuqi ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, i cili solli reformimin e institucioneve të regjistrimit të pronave të paluajtshme. Krahas dispozitave për regjistrimin e pronës bashkëshortore në emër të dy bashkëshortëve ky ligj parashikon edhe dispozita që mundësojnë korrigjimin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve (neni 45). Këto dispozita kanë fuqi prapavepruese, e cila zbatohet për kontratat e kalimit të pronësisë si dhe për regjistrimin e pasurive që fitohen nga legalizimi gjatë martesës. Prapaveprimi

parashikohet shprehimisht edhe për regjistrimin e kontratës së sipërmarrjes, të porosisë e të premtimit për shitje kur këto të fundit synojnë kalimin e pronësisë së objektit në ndërtim në të ardhmen. Fuqia prapavepruese e ligjit, si një rast përjashtimor nga parimi i përgjithshëm se “ligji nuk ka fuqi prapavepruese”, përveç të tjerave u pa

ndonjëherë të dhëna gjinore mbi pronësitë e paluajtshme. Edhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk publikon të dhëna gjinore për regjistrimin e pronave. Sidoqoftë, disa të dhëna për regjistrimin e akteve të pronësisë lidhen me shënimet përkatëse në kartelën e pasurisë mbi bazën e kërkesës. Nga të dhënat që ofron sistemi i Kadastrës, rezulton se në zbatim

rëndësinë që ka gjuha e ligjit dhe zbatimi i tij për ta bërë të mundur barazinë gjinore. Punimi arrin në përfundimin se deklarimi i barazisë gjinore dhe gjuha neutrale e ligjit nuk janë të mjaftueshme për të garantuar këtë barazi në pikëpamjen e saj përmbajtjesore. Përveç faktit që ligji duhet të jetë korrekt dhe të parashikojë qartë të drejtat dhe detyrimet nga pikëpamja gjinore, ka nevojë që të parashikojë edhe klauzola të afta që të parandalojnë pabarazitë që krijohen për shkak të mentalitetit dhe stereotipeve gjinore. Punimi arrin në përfundimin se reformat ligjore për barazinë gjinore dhe të drejtat e pronësisë midis bashkëshortëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes janë të domosdoshme. Gjithashtu ligji duhet të jetë i aftë të korrigjojë pabarazitë e krijuara në realitetin social. Një vëmendje të veçantë marrin reformat ligjore në këtë fushë gjatë periudhave të jashtëzakonshme dhe periudhave të emergjencave. Mësim të rëndësishme u drejtohen organeve gjyqësore e *quazji* gjyqësore për interpretimin dhe zbatimin e ligjit duke pasur në vëmendje standardet e parimit të barazisë gjinore. Nga ana tjetër, një mësim që buron nga punimi është nevoja për krijimin e një miqësie mes gjykatave dhe drejtësisë sociale, me qëllim rritjen e rolit të tyre në parandalimin dhe eliminimin e diskriminimeve që krijohen në realitet. I gjithë punimi është bazuar në përvojën e Shqipërisë, por përfundimet që dalin prej tij mund të jenë të dobishme dhe në vende të tjera.



si një mjet korrigjues për reduktimin e pabarazive dhe të diskriminimit gjinor të krijuar ndër vite.

Një tjetër masë e përshtatshme është ndërmarrë nga ligji për lehtësimin e procesit të regjistrimit të pronës për gratë. Në bazë të këtij ligji, regjistrimi i pronës nga bashkëshorti është një proces automatik. Pra, mjafton vetëm kërkesa e vërtetuar me dokumentet përkatëse dhe nuk kërkohet pëlqimi i bashkëshortit tjetër. Ligji sanksionon detyrimin e drejtorisë vendore të Kadastrës të korrigjojë ose të përditësojë të dhënat kadastrale për pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve në çfarëdo kohe që të jenë fituar. Kjo procedurë korrigjimi ose përditësimi me fuqi prapavepruese nuk i nënshtrohet tatimit. Edhe kjo është një masë e rëndësishme për korrigjimin e situatës diskriminuese në titujt e pronësisë.

Është e rëndësishme të shohim efikasitetin e masave të mësipërme pas hyrjes në fuqi e ligjit. Për këtë iu drejtuam të dhënave zyrtare të INSTAT-it, por ky institucion nuk ka publikuar

të ligjit “Për Kadastrën” gjatë vitit 2020 janë regjistruar 235 akte për bashkëpronësinë e detyrueshme, të cilat kanë korrigjuar aktet e mëparshme në bazë të kërkesës së bashkëshortit të paregjistruar. Si rezultat i pakësimit të kërkesave, në vitin 2021 janë regjistruar vetëm 6 akte të bashkëpronësisë së detyrueshme, ndërsa në vitin 2022 janë regjistruar 19 akte. Ka një rritje të lehtë në vitin 2023, kur janë regjistruar 63 akte. Kjo situatë tregon se: *së pari*, identifikimi i gjendjes gjinore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ka nevojë për të dhëna të besueshme, por këto të dhëna nuk ofrohen ende në Shqipëri; *së dyti*, ka nevojë për studime mbi bazën e të dhënave për të arritur në përfundime mbi efikasitetin e masave që janë marrë ndër vite nga ligji në Shqipëri.

### Përfundime

Përmes analizës së legjislacionit dhe të fakteve sociale për çështjet e barazisë gjinore në të drejtat e pronësisë në përvojën shqiptare punimi evidenton

### Bibliografia

1. Anastasi, Aurela; Mandro, Arta; Saliq, Elona, *Issues of discrimination and gender-based violence in property rights relations*. Tiranë: Center for Legal Civic Initiatives. Property\_Rights\_Info\_Brochure.pdf (qag-al.org).
2. Anastasi, Aurela; Saliq, Elona, 2022, “*Të drejtat pronësore për gratë në grantet e rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019*”, Tiranë: Center for Legal Civic Initiatives. DOI: 10.13140/RG.2.2.19716.91525
3. Anastasi, Aurela (1998), 2004, “*Historia e institucioneve*”, Tiranë: Publishing House of the University Book.
4. Anastasi, Aurela, 2010, “*Të drejtat e*

gruas në legjislacionin shqiptar”, Tirana: OSCE presence in Albania. Të drejtat e gruas në legjislacionin Shqiptar | OSCE.

5. Anastasi, Aurela, 2016, Shadow report. Submitted to the 64th session of CEDAW. Center for Legal Civic Initiatives. shadow\_report.pdf (qag-al.org).

6. Anastasi, Aurela, 2021, “Barazia dhe drejtësia gjinore”, Tirana: Academy of Sciences of Albania.

7. Anastasi, Aurela, Rule of Ligj in Times of Emergency, 2023. In: Cremades, J., Hermida, C. (eds) *Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism*. Springer, Cham. [https://doi.org/10.1007/978-3-319-31739-7\\_223-1](https://doi.org/10.1007/978-3-319-31739-7_223-1).

8. “Çështjet e barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare e ndërkombëtare”, 2010 (Guidelines), Tirana: Magistrate School.

9. Concluding observations of the Committee on the Elimination of Discrimination against Women Albania: Committee on the Elimination of Discrimination against Women Forty-sixth session 12–30 July 2010. Etpu (icj.org).

10. Concluding observations on the 4th periodic report of Albania: Committee on the Elimination of Discrimination against Women. 2016. Concluding observations on the 4th periodic report of Albania: (un.org).

11. *Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women*. Adopted and opened for signature, ratification, and accession by General Assembly resolution 34/180 of 18 December 1979 entry into force 3 September 1981, in accordance with article 27(1). Microsoft Word - Document1 (ohchr.org).

12. *D.H and others v. the Czech Republic*; [https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:\[%22002-2439%22%7D](https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:[%22002-2439%22%7D)].

13. Danaj, Ermira, 2022, Albanian Context. In: Women, Migration and Gendered Experiences. IMISCOE Research Series. Springer, Cham. [https://doi.org/10.1007/978-3-030-92092-0\\_3](https://doi.org/10.1007/978-3-030-92092-0_3)

14. Vendim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 93, datë

30.09.2013. 1503001608-vendim-93-30.09.2013.pdf (kmd.al).

15. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”. <https://qbz.gov.al/share/Bhc1x5ubQampeEKdndc9Ig> Riparë më 13 maj 2024.

16. Decision of the United Chambers of the Supreme Court, No. 22/2002. <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/vendime-unifikuese-ne-vite>.

17. Document 32004L0113. Council Directive 2004/113/EC of 13 December 2004 implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services. Directive - 2004/113 - EN - EUR-Lex (europa.eu).

18. Kocaqi, Monika; Nini-Pavli, Agustela, Plaku; Ani dhe Wittberger, Dolly, 2020. *UN Women Albania Country Gender Equality Brief 2020*. CGEB A l b a n i a \_ R E P O R T \_ 2 . p d f (unwomen.org).

19. Ligj nr. 10221, datë 4.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. 2.pdf (kmd.al).

20. Ligj nr. 111/2018 “Për Kadastrën”: Ligj nr. 111/2018 për kadastrën – ASHK.

21. Ligj nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. [https://qbz.gov.al/share/fQMwmQxES6m2\\_a5SISJkw](https://qbz.gov.al/share/fQMwmQxES6m2_a5SISJkw).

22. Ligj nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”. albanian-legislation (euralius.eu).

23. Ligj nr. 9062, datë 8.05.2003, “Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë”. [https://qbz.gov.al/share/6-zzMDAXRsSAqrhRy\\_pwZA](https://qbz.gov.al/share/6-zzMDAXRsSAqrhRy_pwZA).

24. Ligj nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”. 36682.pdf (osce.org).

25. Ligj nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, <https://qbz.gov.al/share/Soq78UjLTrmtcpYwgG9-Ig>

26. Ligj nr. 9482, datë 3.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejë”, as amended. <https://qbz.gov.al/share/gOjGoM0PT>

5aYaQZwZoFHFw.

27. Mandro, Arta, 2016. “Women’s property rights in Albania”: 2016\_ALB\_Women Property Rights Albania.pdf (unwomen.org).

28. Mandro-Balili, Arta; Anastasi, Aurela; Bozo, Aurela, 2013. *Report on knowledge and implementation of gender equality standards in court decisions*. DOI: 10.13140/RG.2.2.34384.28167.

29. Millard, E. (2023). Hauriou, Maurice. In: Sellers, M., Kirste, S. (eds) *Encyclopedia of the Philosophy of Law and Social Philosophy*. Springer, Dordrecht. [https://doi.org/10.1007/978-94-007-6519-1\\_958](https://doi.org/10.1007/978-94-007-6519-1_958).

30. Nini-Pavli, Agustela, *Accelerating progress on gender equality in Albania. A UN perspective on the revision of the Ligj on Gender Equality in Society*. UN Women Albania. FINAL UN Position Paper on GE Ligj\_FINAL.pdf (unwomen.org).

31. One room, her only home. *An Albanian woman’s struggle to claim her property rights*. Date: Thursday, 1 March 2018: An Albanian woman’s struggle to claim her property rights | UN Women – Europe and Central Asia. Accessed 13 May 2024.

32. Urdhër nr. 1150, datë 3.06.2019, “Për procedurën e korrigjimit të kartelave të pasurive të paluajtshme që janë prona bashkëshpërndarë”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

33. Rekomandim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 1627/1, datë 17.12.2018, KM\_454e-20181218093239 (kmd.al).

34. Rekomandim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 939/1, datë 29.07.2022.

35. Statistical Yearbook of the Ministry of Justice: Vjetari-Statistikor-2022.pdf (drejtësia.gov.al).

36. Studim, “Përmirësimi i legjislacionit shqiptar në fushën e barazisë gjinore”, 2023, Tirana: Center for Legal Civic Initiatives. [https://www.qag-al.org/publikime/legal\\_review\\_report.pdf](https://www.qag-al.org/publikime/legal_review_report.pdf).

37. Toward Gender Equality in Albania: Shifting Mindsets through Institutional Reform. 2020. The world Bank: Toward Gender Equality in Albania: Shifting Mindsets through Institutional Reform (worldbank.org).



# Shoqëria shqiptare dhe depresioni i teknologjisë digjitale

## Efektet sociale të teknologjisë digjitale

Që në fillim duhet të pranojmë se përfshirja e shoqërisë shqiptare në përdorimin e internetit, të *Facebook*-ut dhe rrjeteve të shumta sociale në këto përmasa europiane është shenjë e qartë e adoptimit të suksesshëm të ritmit social bashkëkohor tekniko-informativ. Kjo është njëra anë e problemit, që ka të bëjë me pjesën objektive të raporteve të njerëzve tanë dhe të shoqërisë shqiptare në tërësi me sfidat e epokës digjitale, por shfaqja e shumë problemeve me natyrë sociale e psikologjike dhe format e ndryshuara të sjelljes e të komunikimit social kanë diktuar një realitet kontroversal. Kjo është arsyeja pse tani shoqëria shqiptare është përfshirë në mënyrë të natyrshme nga dilema dhe debate, të cilat deri tani kanë qenë më shumë me natyrë empirike dhe më pak të përqendruara në ndikimet ontologjike të internetit dhe rrjeteve sociale, roli i të cilave po ndihet përditë e më shumë në transformimet e thella që po sjellin në mënyrën e sjelljes individuale dhe adoptimin e formave të reja të ndikimeve, interferimeve dhe relacioneve sociale.

**P**a dyshim, shqetësimi i qytetarëve dhe i shoqërisë në gjithë gamën e ndikimeve të teknologjisë në sistemin e komunikimit social dhe ndërpersonal, në shtimin e njohurive dhe të problemeve të edukimit, në shtimin e anomalive sociale të panjohura më parë, në shumë aspekte herë evidente e të dukshme e herë të pritshme e të padukshme, me impakte humane e morale të drejtpërdrejta apo të tërthorta,

nuk është eterik dhe imagjinar, por real dhe konkret. Sido që ta shikojmë realitetin e raporteve të shoqërisë dhe të individit me teknologjinë digjitale, janë fare të dallueshme reperkusionet, ndikimet evidente në jetën e individit, të familjes, shkollës, medias, botës së punës, komunitetit dhe shoqërisë në tërësi. Jo vetëm në aspektet formale të sasisë dhe intensitetit të lartë të lidhjeve ndërpersonale, informacionit publik dhe komunikimit



Gëzim TUSHI,  
sociolog  
Mjeshtër i Madh  
Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut

social, por dhe shfaqjes së konceptimeve e të realiteteve të reja të lidhjeve dhe marrëdhënieve sociale. Diagnostikimi sociologjik i efekteve dhe kundërefekteve të lidhjeve të reja të njerëzve tanë me teknologjinë digjitale, sidomos me rrjetet sociale, ka sjellë analiza, konkluzione sociale e gjykime sociologjike herë të qarta e herë të nxituara. Në bisedat e qytetarëve konstatohet një qëndrim i hapur dikotomik dhe gjykime të personalizuar,

që fillojnë nga njerëzit që ndihen të bezdisur nga teknologjia, të cilët shfaqin hapur prirje teknofobiste (kundërshtues të internetit dhe rrjeteve sociale, që i konsiderojë fajtorë dhe burim të mëkateve sociale) e deri tek teknoprofetistët (simpatizantët dhe mbivlerësuesit pa kushte të rolit utilitar të internetit dhe rrjeteve sociale). Kjo dikotomi konceptuale dhe optika kontradiktore e shikimit të anëve të mira dhe negacioneve sociale, ndikuese në jetën e përditshme të shoqërisë shqiptare, aktualisht mund dhe duhet të bëhen objekt gjykimi profesional, duke i parë gjërat në optikë logjike, epistemologjike, pse jo dhe ideologjike, sociale e psikologjike për të ndihmuar në krijimin e balancave dhe të perceptimit të ekuilibruar të dikotomive të këtij realiteti të përzierë: real dhe virtual.

Analiza sociologjike që kam mundur t'i bëj realitetit dhe diagnostikimi i patologjive shoqëruese më çojnë në përfundimin se aktualisht te shumica e qytetarëve tanë është krijuar ideja se tani, në kohën e internetit e të informacionit të digjitalizuar, duket sikur jetojmë në kohën e lirive të mëdha në krahasim me të kaluarën. Kjo është njëra anë e së vërtetës, por nuk mund të themi në mënyrë të thjeshtëzuar se kjo është plotësisht e vërteta, sepse duhet marrë parasysh edhe fakti që tashmë, si kurrë më parë, po jetojmë në një realitet social që teknologjikisht nuk ka qenë kaq shumë i kontrolluar sa tani.

Besoj se nuk ka njeri - qytetar, punonjës i çdo profesioni, nxënës shkolle apo student - që nuk e kupton dhe e ndien se çdo veprim social, madje edhe në jetën private, është i monitoruar me mjete dhe metoda digjitale. Madje, sikurse po duket, janë shtuar konfliktet sociale në shoqëri, deri edhe krimet digjitale për shkak të intervenimeve të shpeshta, të shumta e shpeshherë të panevojshme në jetën tonë private. Shoqëria shqiptare ka filluar të ndihet e bezdisur nga këto kufizime të jetës që sjellin intervenimet digjitale, që kanë filluar të na imponohen në gjithë veprimtarinë tonë fizike, mendore, profesionale, private dhe intime. Nëse i referohemi filozofit Jürgen Habermas, jemi në situatën kur "shfrytëzimi i internetit i ka zgjeruar e njëkohësisht i ka fragmentuar ndërvarësitë e komunikimit". Kjo është një e vërtetë që tashmë shfaqet e konturuar

qartë edhe në strukturat e jetës dhe në realitetet sociale të shfaqura në të gjitha institucionet ku jetojmë dhe ndërveprojnë njerëzit tanë. Nëse do t'u bëjmë një diagnozë të përgjithësuar raporteve të shoqërisë shqiptare, në mënyrë evidente do të konstatojmë se ajo është kthyer gati në një turmë sociale të masivizuar pas rrjeteve sociale, e izoluar nga interneti, rrjetet sociale

e lidhjeve virale dhe kombinimin, që po bëhet aq shumë dominues në lidhjet midis njeriut dhe teknologjisë. Pothuaj të gjithë njerëzit sot harxhojnë orë të tëra duke parë tekste apo informacione të ndryshme në celularët e tyre. Kjo tashmë është kthyer në një sjellje sociale normale. Mund të konsiderohet si sjellje sociale e pashëndetshme, por paradoksalisht

**Të gjitha këto realitete të reja të marrëdhënieve të shoqërisë shqiptare me teknologjinë digjitale janë tregues i qartë se tashmë shoqëria shqiptare është në koherencë të plotë me dilemat dhe zhvillimet globale që ka sjellë paradoksi i zhvillimit të teknologjisë, me efektet dhe ndikimet e zgjeruara të tij në formatimin dhe riformatimin e moduleve psikologjike dhe modeleve etiko-sociale të jetës së sotme.**

dhe celularët. Kjo pandemi sociale ka si pasojë të parë një sjellje monotone, e cila po than ndjeshmërinë e njerëzve, po mpin mendjen dhe po dëmton shpirtin e tyre, sidomos te fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë. Ky sistem i mbyllur komunikimi dhe informacioni digjital, me të cilin po mësohemi, po izolon individin brenda vetes e njëkohësisht po cenon lidhjet reale, bashkëjetesën njerëzore.

Intelektuali dhe gazetari i njohur Uill Storr (*Will Storr*) ka bërë një analizë të zgjeruar të raporteve të reja të njeriut me rrjetet sociale. Ai mendon se "rrjetet sociale janë më tepër se thjesht dukje", se "ato janë njëkohësisht një produkt thellësisht neoliberal, që e ka veshur unin me tipare loje, duke e kthyer kështu identitetin tonë në një gur shahu që konkurren në platforma digjitale për të fituar pëlqime, reagime dhe miq..."<sup>1</sup>.

Është fakt se brenda një kohe të shkurtër interneti dhe rrjetet sociale janë bërë një realitet psikosocial dhe komunikativ në zgjerim, ndikimi dhe pasojat e të cilit janë tejet evidente. Këtu është fjala për zgjerimin

skllavërimi digjital po bëhet sjellje e përshtatshme për kohën që jetojmë, pavarësisht pasojave të shumta mendore e sociale që e shoqërojnë këtë lloj sjelljeje.

Është e vërtetë që tani jetojmë në realitete të reja sociale dhe komunikative, sepse interneti, rrjetet dhe mediet sociale kanë sjellë shkurtimin e distancës midis ngjarjeve dhe perceptimit të tyre. Ndikimi i tyre është shumë i fuqishëm edhe në jetën politike (si kurrë më parë jemi nën pushtetin e formave moderne të komunikimit publik përmes videopolitikës dhe telepolitikës), në sistemin e zgjedhjeve elektorale, në lëvizjet me natyrë sociale. Nëse e shikojmë me optikë strategjike dhe vlerësim gjithëpërfshirës, duket sikur sociologjikisht jemi përballë një realiteti të ri, i cili për shkak të përdorimit të zgjeruar të celularëve dhe rrjeteve sociale e ka bërë shoqërinë gati si një turmë të masivizuar.

Të gjitha këto realitete të reja të marrëdhënieve të shoqërisë shqiptare me teknologjinë digjitale janë tregues i qartë

<sup>1</sup> Uill Storr, "Selfie", f. 361.

se tashmë shoqëria shqiptare është në koherencë të plotë me dilemat dhe zhvillimet globale që ka sjellë paradoksi i zhvillimit të teknologjisë, me efektet dhe ndikimet e zgjeruara të tij në formatimin dhe riformatimin e moduleve psikologjike dhe modeleve etiko-sociale të jetës së sotme. Duket qartë shqetësimi social për këto realitete të reja, i cili kërkon një përgjigje nëse shoqëria shqiptare ka kapacitetet sociale dhe kulturën e nevojshme për të ecur në mënyrë organike me kërkesat e jetës postmoderne.

Sa janë mundësitë që në këto kushte të sigurohet dhe “hibridizohet” bashkëjetesa në nivele kaq intensive midis teknologjisë digjitale dhe formave virtuale në zgjerim, që ka intervenuar pothuaj në të gjitha fushat, me format e vjetra të strukturave të jetës shoqërore tradicionale? A duhet marrë parasysh fakti që format elektronike të lidhjeve sociale virtuale po bëhen faktorë që determinojnë me forcë ndryshimin e formave klasike të saj?

S’ka dyshim se prania masive e internetit, e celularëve dhe plotfuqishmëria komunikuese e rrjeteve sociale është një realitet evident, i prekshëm dhe në përmasa të zgjeruara tashmë edhe në shoqërinë shqiptare, por nuk është ana teknike e problemit që duhet parë. Ndoshta ka ardhur koha që gjërat t’i shikojmë më thellë nga pikëpamja sociologjike, të vlerësojmë efektet dhe kundërefektet e këtij realiteti teknologjik. Ndryshimet nuk janë të thjeshta. Si të tilla, ato nuk mund të vlerësohen me përfytyrime mekaniciste, sepse, sikurse shkruan Sheryl Sendberg, ish-drejtoreshë ekzekutive e Facebook-it, “teknologjia ka ndryshuar mënyrën tonë të komunikimit, jetën e njerëzve”. Ne jo vetëm po mësohemi, por dhe po përshtatemi me këtë realitet ekzistencial, që ka shanse e mundësi të shtojë informacionin e të intensifikojë lidhjet dhe komunikimin virtual midis njerëzve për qëllime profesionale, sociale apo thjesht argëtuese.

Kjo është ana “e ndritur” e realitetit të ri të përdorimit të teknologjisë. Ana negative është se në të njëjtën kohë po përballemi me disa dukuri komplementare të përdorimit të saj pa kulturën e duhur dhe në forma abuzive, që, me sa duket, po thajjnë ndjeshmërinë, po mpijnë

mendjen dhe po cenojnë modulet e lidhjeve, të marrëdhënive dhe formave humane të bashkëjetesës njerëzore. Kjo është arsyeja që sociologët postmodernë thonë se jemi bërë të gjithë pjesë e një shoqërie tërësisht teknologjike, një shoqëri e përbërë nga konsumatorë të hutuar pas celularit dhe rrjeteve sociale. Ato kanë marrë trajtën e një psikovampiri, që po atrofizon energjitë reale të njeriut dhe po dëmton në të njëjtën kohë edhe kohezionin social të jetës e të institucioneve fundamentale të shoqërisë. Beteja e zhvilluar deri tani nga institucionet, familja, shkolla dhe shoqëria shqiptare për të krijuar kulturën e duhur dhe për t’i përdorur me maturi internetin, celularin dhe rrjetet sociale duket se nuk ka krijuar bindje sociale apo të ketë sjellë maturinë që kërkohet.

### **Pse kaq indiferentë ndaj patologjive dhe varësisë nga teknologjia?**

Ndoshta faktorët materialë e shpirtërorë më të pranishëm e që shfaqen si dukuri të përditshme me tendencë agravuese në jetën e sotme sociale në Shqipëri janë bërë interneti, celularët, rrjetet sociale dhe Facebook-u. Pa më të voglin dyshim do të thoshim se në botën tonë reale dhe virtuale apo në aliazhin e ndërlikuar të komunikimit ato janë bërë instrumente të plotfuqishme dhe jo vetëm po fitojnë gjithnjë e më shumë hapësirë sociale, por edhe po dëshmojnë autoritet kominkativ dominues dhe peshë sociale me rëndësi *sui generis*. Mjetet moderne elektronike sot po shfaqen jo vetëm si realitete sociale në zgjerim, por edhe si ingredientë të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm të habitatit të jetës urbane. Por nuk është vetëm ana teknike e formale e problemit. Situata është komplekse dhe marrëdhëniet e njerëzve me teknologjinë kanë ndikime të shumfishta (materiale, psikologjike e sociale) dhe sot janë ndoshta me fuqinë më të madhe “imperialiste”, duke u kthyer kështu në faktorë tejet ndikues, ndryshues e përcaktues mbi mënyrën e jetës dhe tipologjinë e sjelljes së njerëzve, të pasqyruara me intensitet të lartë si në jetën private, ashtu dhe në atë publike. Efektet dhe kundërefektet e tyre janë

evidente në kohën e sotme. Jemi përballë një realiteti që duhet vlerësuar seriozisht, sepse analizat sociologjike, gjykimet socialpsikologjike në shumë raste janë ende të përcipta, të thjeshtëzuara, empirike, janë qëndrime e vlerësime të njëanshme herë teknofobiste e herë mbivlerësuese, pa na dhënë mundësinë të bëjmë “llogari” sociale, të bëjmë bilancin e duhur dhe konkret të efekteve dhe kundërefekteve materiale, psikologjike, sociale, humane e shpirtërore.

Teknofobistët, si ludistë të kohës moderne, kanë ngritur alarme të ekzagjeruara për dëmet që po sjell në shoqëri dhe te njerëzit tanë zgjerimi i hapësirave të lidhjeve dhe komunikimeve digjitale. Nuk është metaforikë, as eufemizëm mjekësor fakti që ka sociologë, studiues të realiteteve digjitale dhe të ndikimit në përzjerjen e realiteteve tekno-humane që mendojnë se efektet e lidhjeve virale dhe të marrëdhënive digjitale midis njerëzve mund të bëhen shkak që kjo botë tërësisht e lidhur “të çmendet e gjitha në të njëjtën kohë”.

Mund të mos ketë qenë e parashikuar që në këtë epokë të globalizimit, teknologjisë dhe komunikimit digjital efektet dhe kundërefektet, epërsitë dhe defektet e këtij komunikimi social do të shndërroheshin në një problem kulturor, human e urban me kaq shumë forma, efekte e ndikime dikotomike në jetën e përditshme të njerëzve tanë. Sigurisht, për ne shqiptarët, si për të gjithë popujt dhe vendet e cymtuara, zgjerimi i përmasave të përdorimit të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit është një sukses i madh, tregues sintetik për progresin e integruar, individual e social, madje kjo fushë është kthyer në arritje pararojë në zhvillimet që ka shënuar shoqëria shqiptare, sidomos në këto dekadat e para të shekullit tonë. Si sociolog arsyetoj se është ide e çmendur, mendim konservator të reagosh negativisht ndaj teknologjisë, akoma më keq, nisur nga disa negacione thelbësore apo periferike të këtij progresi, të thuash me mendjelehtësi se zhvillimi teknologjik në tërësinë e tij është i keq.

Besoj se në këtë lidhje dikotomike të njeriut me teknologjinë dhe procesin e akseluar të digjitalizimit, me efekte

evidente e konkrete në të gjitha fushat e jetës: ekonomike, sociale, kulturore, arsimore, mjekësore etj., duhen parë me kujdes, duhen gjykuar me objektivitet dhe vlerësuar me realizëm e objektivitet si kostot, ashtu dhe përfitimet. Aktualisht, për shkak të zgjerimit dhe intensitetit të marrëdhënieve njeri–teknologji, praktikisht si shoqëri jemi në fazën zhvilluese, kur te

Madje, nëse e analizojmë problemin me kujdes dhe në thellësi, në mënyrë evidente do të shohim se disa prej tyre janë bërë thelbësore, me ndikim të gjerë kulturor, social dhe ontologjik. Efektet e teknologjisë janë aq gjithëpërfshirëse, sa që të duket sikur kemi filluar të jetojmë në një shoqëri tjetër, në të cilën, ngaqë teknologjia është bërë determinuese, ka

jetojmë, sepse nuk kemi si të mendojmë ndryshe, pasi lidhjet *on-line* dhe informacionet e shumta që vijnë nga rrjetet sociale e kanë rrethuar njeriun në këtë rrjetë informative. Ato janë ngacmime të jashtme, që shpeshherë kanë sjellë një gjendje kaotike në jetën individuale, në relacionet dhe marrëdhëniet e tij shoqërore.

Tani jemi në situatën kur teknologjia e komunikimit digjital, që është bërë ontologjikisht sunduese në shoqëri, po shoqërohet me shfaqjen e shumë anomalive sociale, të devijimeve psikologjike të natyrave të ndryshme, të njohura, por dhe të panjohura më parë; të lidhura me veçoritë e personalitetit individual, por edhe me turbulencat sociale që shfaqen në zgjerim; të ndikuara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga efekti toksikues, anestezues dhe paralizues i një lloj varësie të re, të asaj që po shfaqet në shoqëri si “drogë elektronike” dhe që ka përfshirë masa të gjera njerëzish, grupe të veçanta shoqërore, madje edhe shoqërinë shqiptare në tërësi. Kaq i fortë, ndikues dhe tronditës po bëhet fenomeni i varësisë nga rrjetet sociale dhe instrumentet elektronike, sa që pothuaj po bëhet gjithnjë e më e vështirë për njerëzit të dallojnë saktë, të perceptojnë në mënyrë objektive se ajo që duket apo afshohet virtualisht në rrjetet sociale nuk është gjithnjë e saktë dhe e vërtetë. Shpeshherë realitetet e vërteta transformohen apo deformohen përmes rrjeteve sociale. Ky është një realitet që po bëhet shqetësues për njeriun dhe shoqërinë tonë. Mjafton të përmendim faktin që një pjesë e madhe njerëzish, pa qenë fare të sigurt për të vërtetën objektive, në shumë raste i konsiderojnë të vërteta lajmet, pamjet e publikimet me përmbajtje të diversifikuara që shfaqen në rrjetet sociale. Unë jam munduar ta analizoj këtë varësi dhe kam konstatuar se në shumë raste disa njerëz i ndjekin informacionet në rrjetet sociale për hatër të simpativë që kanë për personazhe të politikës, medias, artit, sportit e të fushave të tjera të jetës. Ka të tjerë që këtë punë e bëjnë për inat social apo për armiqësi me individë që shfaqen dëndur apo janë tejet aktivë në internet.

Për të gjitha këto lidhje të gabuara e

<sup>2</sup> Matt Haig, “Shënime mbi një planet nervoz”, f. 129.



njerëzit tanë, veçanërisht tek të rinjtë, duhet të kultivojmë kulturën, sjelljen sociale, e cila duhet bazuar në bindjen se “çdo vegël që përdoret në mënyrën e gabuar mund të bëhet e rrezikshme, po nëse përdoret në mënyrën e duhur, mund të bëjë çudira”<sup>2</sup>.

Në mënyrë të ndërgjegjshme apo spontane, nën ndikimin e nevojave integrale apo imitimit të modave sociale të kohës, ne kemi hyrë, jemi pjesë gjithëpërfshirëse dhe ekuivalente me të gjitha komponentet e epokës së zhvillimit të teknologjisë digjitale. Ajo që kërkohet sot besoj se është nevoja e një kulture solide për lidhjet utilitare, marrëdhëniet e zgjeruara, në mënyrë që të kemi të pranishëm jo njeriun e varur prej teknologjisë, me sjellje spontane e veprime kaotike e të paorganizuar, por njeriun me mendje të organizuar për të siguruar përfitime pragmatiste, pa rënë në grackën teknologjike pasive, që është një nga rreziqet që po na kërcënon seriozisht si shoqëri, e cila, si kurrë më parë, është bërë me lidhje sociale të shumëfishta e informacion të mbingarkuar.

Duhet të jesh miop social që të mos kuptosh natyrën e lidhjeve komplekse të njeriut me teknologjinë digjitale, paralelisht edhe disa veçori bashkëshoqëruese, që tani janë bërë të nevojshme për organizimin e jetës moderne në shoqërinë shqiptare.

sjellë zhvillime të paparashikuara më parë, të shoqëruara me një proces të ndërvarjes mbarëshoqërore socio-teknologjike.

Unë besoj se sociologët e postmodernitetit kanë të drejtë kur e tipizojnë shoqërinë e sotme si “shoqëri informacioni”, “shoqëri e rrjetëzimit”, të cilat janë bërë struktura me efekte sociale kompakte, të lidhura e të ndërvarura midis tyre. Duhet të jesh i verbër që të mos pranosh se në shoqërinë shqiptare interneti dhe komunikimi përmes kanaleve virtuale janë bërë “rrënja” sociale më e thellë e realitetit që jetojmë, që në mënyrë të pashmangshme shoqërohet me shumë ndryshime pozitive sociale. Në shumë drejtime ato janë evidente, sidomos në ndryshimin e botëkuptimit të njerëzve, në rendimentin dhe transformimet që shfaqen në sjelljen sociale. Ritmi i ndryshimeve nga ky efekt në të ardhmen do të jetë edhe më i madh, ndoshta edhe më i paparashikueshëm. Nga ana tjetër, ka shumë shqetësime e patologji sociale që vijnë nga lidhjet frenetike me rrjetet sociale, nga mania sociale e kontrollit të vazhdueshëm të internetit, imilit apo Facebook-ut. Për pasojë, në mënyrë të dukshme është krijuar një lloj varësie nervore në jetën e njeriut të sotëm, pikërisht e determinuar nga kultura e përdorimit me defekte të teknologjisë. Por duhet të jemi objektivë, analogë me të vërtetat e jetës që

anomali të përdorimit të teknologjisë digjitale sot ka filluar të shfaqet një patologji e re, që vlerësohet si “depression i Facebook-ut” e që vjen nga prinja e dukshme e ndjekjes së jetës së njerëzve të tjerë, nga mania për të mësuar si jetojnë, sa të pasur e të suksesshëm janë, duke kultivuar në këtë mënyrë ndjenjën shqetësuese të krahasimit social. Këto janë qëndrime sociale e përjetime personale që në shumë raste shoqërohen me shfaqjen e përjetimit të ndjenjës së dëshpërimit, të papërshtatshmërisë apo pakënaqësisë personale. Interneti ka shtuar dhe zgjeruar epideminë destruktive të ambicies, egoizmit dhe krahasimit social të jetës, të arritjeve dhe problemeve personale, duke i vënë ato në çdo rast, shpesh në mënyrë të pajustificueshme, në balancë me të tjerët, me jetën e tyre. Kjo tendencë sociale bashkëshoqërohet edhe me dukuri të tjera komplementare me natyrë sociale e teknologjike, që tashmë janë evidente në jetën e shoqërisë sonë. Krahas lidhjeve të dobishme me synime sociale, personale apo profesionale ka një zgjerim të jashtëzakonshëm, ndikim të drejtpërdrejtë të internetit në shtimin dhe aktivizimin e zgjeruar të personave toksikë, që celularët dhe rrjetet sociale i përdorin për të ekspozuar materiale me përmbajtje të dëmshme, që shpesh sjellin konflikte, bullizëm, ashpërsi në komunikim, agresivitet emocional, presione e sjellje banale etj.

### **Interneti, të rinjtë dhe “diktatura digjitale”**

Zhvillimi i teknologjisë digjitale, zgjerimi i rrjeteve sociale dhe përfshirja masive e njerëzve në to, sidomos e të rinjve, është një fakt i pamohueshëm, qoftë në vështrimin sasior, qoftë në atë cilësor. Ato janë faktorë me efekte të brendshme e të jashtme në jetën e shoqërisë, me ndikime krejtësisht të dukshme në ndryshimin e formave të sjelljes së të rinjve tanë. Nëse e vlerësojmë objektivisht atë që ka ndodhur në përmbajtjen e shkollës shqiptare dhe në lidhjet e marrëdhëniet e të rinjve me të, në mënyrë evidente dallojmë se krahas veprimtarisë më të rëndësishme, që është mësimi, tani është shtuar edhe fenomeni i lidhjes, ndërveprimit individual dhe me

grupe shokësh përmes celularëve dhe komunikimit të pandërprerë përmes internetit. Sigurisht, marrëdhëniet e nxënësve, të adoleshentëve dhe të rinjve me internetin janë të kushtëzuara nga shumë faktorë me natyrë sociale dhe individuale, që në thelb kanë sjellë konceptime të diferencuara të qëllimeve, formave dhe mënyrave të lidhjes dhe përdorimit të teknologjisë. Ideja fillestare se interneti do të hapte për të gjithë të rinjtë vetëm botën e përbashkët të dijes duket se nuk po vërtetohet. Ideja se interneti do të shërbente si mjet për të ngushtuar dallimet midis të rinjve në fushën e dijes dhe të mundësive të arsimimit personal jo vetëm nuk po vërtetohet, por po bëhet gjithnjë e më shumë një pritmëri e dyshimtë. Ka fëmijë, adoleshentë dhe të rinj që e përdorin internetin dhe kapacitetin informues të tij për qëllime të mira, për shtimin dhe thellimin e njohurive, por, për fat të keq, një masë e madhe e tyre po e përdorin thjesht për argëtim, thashetheme, bullizëm, madje dhe për synime akoma më banale e të rrezikshme me natyrë seksuale dhe kriminale. Varësia nga celularët është më e theksuar tek adoleshentët, e cila shpesh shoqërohet me depresion dhe rezultate të dobëta në shkollë. Ajo ka krijuar një njeri që po mësohet me tekat e modës dhe skandalet që ndjek përmes rrjeteve sociale, të cilat i bëjnë më pak përshtypje se në të kaluarën e botës së mbyllur e pa teknologji të komunikimit *on-line*. Është fakt se teknologjia, celulari, rrjetet sociale i kanë bashkuar të rinjtë tanë me botën në mënyrë të pakthyeshme. Ky realitet ka sjell një gjë që tri dekada më parë ka qenë blasfemi, realisht e paimagjinueshme, sepse “individët e të njëjtit brez shpesh do të kenë më shumë të përbashkëta me individët e të njëjtit brez në kulturat e tjera sesa me brezat më të vjetër në kulturën e shtetit të tyre”<sup>23</sup>.

Nuk ka dyshim se shoqëria shqiptare është përballë një realiteti të ri, në të cilin interneti është bërë një faktor ndikues në jetën e të rinjve. Përparimet teknologjike të kohëve të fundit dhe komunikimi i digjitalizuar kanë ndryshuar mënyrën si ndërveprojnë, lidhen dhe komunikojnë sot të rinjtë tanë. Në shkollë dhe në mjedis të jetës rinore janë shtuar së tepërmi rastet e konflikteve, të dhunës, bullizmit,

ngacmimeve seksuale e plot forma të tjera moshore të fenomenologjisë së konfliktualitetit. Me të drejtë intelektual Uill Storr mendon se koha ka sjellë në jetën e të rinjve “trysni sociale të pashembullta, nën ndikimin e të cilave jetojnë aktualisht të rinjtë”<sup>24</sup>. Problemi është se shumica e konflikteve nuk janë me natyrë fizike, por në formën e agresionit relacional moshor, që synon dëmtimin e reputacionit, cenimin e personalitetit. Shumë shqetësues dhe me pasoja jo të lehta shfaqet agresioni relacional që ushtrohet nga të rinjtë përmes internetit, një ngacmim që është i vështirë të zbulohet nga prindërit dhe mësuesit, sepse ai realizohet në fshehtësi, me një të lëvizur të mausit. Studimet për sigurinë e fëmijëve dhe teknologjitë *on-line* kanë treguar se burimi më i madh i rrezikut me të cilin përballen fëmijët në internet nuk është aq shumë pornografia, por mesazhet reciproke me përmbajtje dhe ngacmim seksual. Në këtë aspekt ndikimi më i madh është ai i agresionit relacional moshor, që përgjithësisht realizohet përmes lidhjeve që kanë dhe krijojnë fëmijët dhe adoleshentët përmes rrjeteve sociale.

Ndikimi i internetit dhe i rrjeteve sociale në personalitetin e të rinjve dhe adoleshentëve është me efekte emocionale jo të zakonshme. Për këtë mjafton të shikojmë fëmijët kur komunikojnë në internet dhe në rrjetet sociale. Disa ndihen të gëzuar e fitimtarë nga rezultatet e lidhjeve *on-line*, disa të tjerë janë të acaruar e tejet të dëshpëruar nga ngacmimet apo dështimet komunikative, ndërsa disa kanë perceptimin se përmes rrjeteve sociale, sasisë dhe intensitetit të komunikimit kanë pasur mundësinë për t'u bërë persona publikë, të famshëm, me influencë në shoqërinë e moshës së tyre. Ndërkaq për të njëjtën arsye disa të tjerë ndihen të dëshpëruar, janë në gjendje ankthi e të shqetësuar nga disfatat konkurrionale apo mospëlqimet moshore.

Këto ekstreme po bëhen shkak që të shfaqen disa dukuri shqetësuese në këtë grupim të gjerë social. Fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë janë përfshirë nga anomali psikologjike e sociale, si: ankthi, dëshpërimi, pasiguria te vetja, agresiviteti, ndjenja e hakmarrjes etj. Disa studime socialpsikologjike kanë treguar se përdorimi i tepruar i internetit dhe i rrjeteve sociale, madje edhe i celularëve për

komunikim të pandërprerë telefonik, është një nga shkaqet që nxit tek adoleshentët dhe të rinjtë situata të personalizuara të zhvillimit të ndjenjës së brendshme të palumturisë. Psikoterapistja Amanda Foks është e mendimit se “rjetet sociale shoqërohen me uljen e mirëqenies vetjake dhe me një kënaqësi jetese më të paktë, sepse njerëzit i kanë sytë tek të tjerët, tek ata që kanë një jetë më të mirë se e tyra”<sup>5</sup>.

Unë kam analizuar në shumë raste sasinë, intensitetin dhe tematikat e komunikimeve të të rinjve dhe adoleshentëve në rjetet sociale dhe kam konstatuar se fëmijët dhe të rinjtë provokohen në internet me biseda seksuale të papranueshme për moshën e tyre, shpesh të shoqëruara me përshkrime të akteve seksuale dhe provokime të hapura për seksualitetin, që janë banalizuar në këtë lloj komunikimi të rrezikshëm anonim, virtual dhe pa fytyrë të personalizuar apo të identifikuar. Ky është një fenomen në zgjerim, por të mos harrojmë se fëmijët dhe adoleshentët tanë po jetojnë dhe po rriten në këtë shoqëri liberale dhe individualiste, ku kemi një përzierje të formave të ngacmimit dhe krimit tradicional me atë elektronik dhe kibernetik, që është shumë i rrezikshëm dhe i vështirë për t’u kontrolluar. Kjo ndodh sepse, sikurse thonë psikologët dhe sociologët, të rinjtë dhe adoleshentët, por jo vetëm ata, marrin për të vërtetë gjithçka që mund të jetë edhe e rreme. Madje të rinjtë shpesh nuk e vënë fare në dyshim atë që u serviret si e vërtetë nga rjetet sociale. Për fat të keq, jo gjithnjë të rinjtë dhe adoleshentët i përdorin celularin dhe rjetet sociale për informacion dhe kauza moshore të mira. Ata po i nënshtrohen asaj situatë të përgjithshme që sociologu Ylvi Harari e quan “marrëdhënie në kushtet e diktaturës digjitale”. Natyrisht, problemet nuk janë vetëm për ne, as shqetësime sociale të mbyllura e me natyrë nacionale. Sot është bërë fare e qartë se problemet dhe shqetësimet që vijnë nga celularët dhe rjetet sociale, janë probleme globale dhe zgjidhjet, qoftë teknike, qoftë ato sociale apo edukative e kulturore, mund dhe do të jepen vetëm globalisht. Kjo nuk do të thotë se nuk duhet t’u mësojmë fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve që të bëjnë

kujdes me publikimin e të dhënave personale, siç janë adresat, llogaritë, lëvizjet etj., sepse rreziqet që vijnë nga rjetet sociale janë të shumta e komplekse, janë materiale, psikologjike e seksuale. I gjithë rreziku qëndron në faktin se lidhjet *on-line* kanë aftësi të fshehin thelbin e gjërave dhe të duken jo ashtu sikurse janë në të vërtetë. Kjo situatë lehtëson penetrimin në komunikimin

teknologjike në zgjerim kanë efekt social në dinamikën e rritjes, në formimin dhe sjelljen e të rinjve tanë. Kjo ka sjellë shtimin e ritmit të jetës dhe të përjetimeve të tyre. Duke dashur të jenë sa më të pranueshëm për shokët dhe miqtë e tyre, ata përpiqen për të ecur më shpejt dhe në përputhje me dinamikën aktive të kohës së tyre. Kjo është një nga arsytet pse duket sikur të rinjtë tanë

“ Interneti dhe rjetet sociale ndihmojnë për t’i kuptuar më mirë këtë situatë dhe këto veçori dialektike të veprimit kontroversal, që sjellin në të njëjtën kohë nevojën për ritme më të shpejta të jetës së rinisë, por ky progres teknologjik sjell njëkohësisht edhe kriza, që jo rrallë sjellin vanitet e shpërqendrim të forcave, ulje të aftësisë orientuese tek të rinjtë tanë, dukuri këto që janë ekzistenciale, por njëherësh edhe të kapërcyeshme. ”

elektronik të kriminelëve, pedofilëve, maniakëve të seksit, mashtruesve etj. Në këto kushte është e nevojshme të forcojmë, sidomos te fëmijët dhe të rinjtë, kulturën e denoncimit të presioneve materiale dhe të formave të ngacmimit seksual. Pa dyshim, raporti midis fëmijëve dhe llojeve më të sofistikuar të celularëve që ata përdorin është kthyer në një problem serioz social, pedagogjik dhe psikologjik. Sipas sociologëve, celularët kanë marrë formën e “drogës elektronike” dhe kanë krijuar një varësi të thellë, gati patologjike te fëmijët dhe të rinjtë, sidomos te nxënësit e shkollave tona.

Por nuk duhet parë vetëm ana e jashtme e lidhjes së të rinjve dhe nxënësve të shkollave me celularin dhe rjetet sociale, sepse problemi nuk është thjesht teknologjik. Ai është më i gjerë. Pasojat që po ndodhin, ndoshta edhe ato që do të ndodhin në të ardhmen, janë më të thella e ndonjëherë edhe të vështira për t’i parashikuar sociologjikisht në mënyrë ekzakte. Ndryshimet e thella, risitë

përjetojnë kriza të caktuara ekzistenciale, me veten dhe shoqërinë. Sa më shumë përshpejtohen ritmet e jetës dhe shtohen nevojat dinamike për vetëpërbushjen e konceptit që të rinjtë kanë për jetën në kohën e sotme postmoderne, aq më tepër ata ndihen të pasigurt në realizimin e tyre.

Interneti dhe rjetet sociale ndihmojnë për t’i kuptuar më mirë këtë situatë dhe këto veçori dialektike të veprimit kontroversal, që sjellin në të njëjtën kohë nevojën për ritme më të shpejta të jetës së rinisë, por ky progres teknologjik sjell njëkohësisht edhe kriza, që jo rrallë sjellin vanitet e shpërqendrim të forcave, ulje të aftësisë orientuese tek të rinjtë tanë, dukuri këto që janë ekzistenciale, por njëherësh edhe të kapërcyeshme. Shumë probleme në jetën e të rinjve dhe adoleshentëve kanë filluar të agravohen pikërisht nga ndikimet

<sup>3</sup> Robert Grin (Robert Greene), “Ligjet e natyrës njerëzore”, f. 544.

<sup>4</sup> Uill Storr, “Selfie - Uni i unit?”, f. 23.

<sup>5</sup> Po aty, f. 362.

e kësaj “diktature digjitale”, që i ka mbërthyer në jetën e tyre të përditshme dhe që në jo pak raste shoqërohet me pasoja individuale psikologjike e sociale, si: çrregullime të gjumit dhe të ngrënies, dobësim i funksioneve konjitive, shfaqje të depresionit e në jo pak raste edhe të prirjeve për vetëvrasje.

### Shoqëria në dilemë: teknofobi apo teknoprofeci?

Interneti masiv dhe zgjerimi i rrjeteve sociale kanë sjellë shumë pasoja pozitive dhe negative në shoqërinë tonë. Nëse nga ana formale e dukjes statistikore për komunikimin virtual rezultatet janë pozitive, në anën thelbësore ndodh shpesh që përballemi me një dukuri të re sociale: njerëz me pikëpamje të ngjashme, për shkak të bombardimit të vazhdueshëm me informacione nga interneti dhe rrjetet sociale, duket sikur përfundojnë në një “situatë bosh”, sepse interneti ka aftësinë t’i vërë njerëzit në komunikim nëpërmjet një “dhome jehone” të vogël, duke krijuar konturet e dëmshme të një shoqërie të vogël sociale, por me dimensione të zgjeruara digjitale.

Tashmë është fare evident ndikimi i internetit në procesin e “egalitarizmit”, pra njëtrajtësimin, rrafshimit të ideve, qëndrimeve dhe mënyrave të sjelljes në shoqërinë tonë. Ndikimi pozitiv dhe negativ në të njëjtën kohë nga sociologët konsiderohet një problem social urgjent, sepse, siç thotë Tritan Harris, një punonjës me influencë i *Google-s*, ka efekte të gjëra dhe “po ndryshon demokracinë tonë, po ndryshon aftësinë tonë për të bërë një bisedë të vërtetë apo për të pasur një marrëdhënie të sinqertë me njëri-tjetrin”.

Ne duhet të përpiqemi për të kuptuar më mirë realitetet e mbi të gjitha ndikimin pa rregulla të informacionit të shpejtë e të njëtrajtshëm në publikun shqiptar, që në shumë raste është faktori që sjell shkulme të njëjta, të njëtrajtshme në kohë, të barabarta në sasi, të njëjta në cilësi. Kjo situatë ndikon në rrafshimin e nivelit të informacionit dhe shfaqjen te njerëzit të një fenomeni të ri, të cilin sociologët e konsiderojnë si shfaqje masive të “publikut egalitar”, një produkt evident i revolucionit digjital dhe zgjerimit të rrjeteve

sociale, që është i pranishëm edhe në shoqërinë tonë. Është një proces që i bën njerëzit të jenë në të njëjtën kohë shkruar dhe lexues të lajmeve dhe informacioneve që prodhojnë “fabrikat” e politikës, të jetës sociale, shpifjeve dhe thashethemeve banale.

Një nga gjërat pozitive është karakteri demokratik e masiv i kanaleve të

metropolitan dhe banori rural, intelektual dhe i papuni, pensionistët dhe të rinjtë, burrat dhe gratë janë me të drejta të barabarta në këtë konsum të informacionit elektronik të demokratizuar dhe të unifikuar, qoftë politik, qoftë kulturor, global, rajonal apo nacional, i vërtetë apo i gënjeshtërt. Ky është një rrjet që tashmë në shoqërinë shqiptare është



komunikimit social dhe lidhjeve ndërpersonale, që në shoqërinë tonë ka sjellë një realitet të ri, përmasa të gjëra të demokratizimit të skajshëm të komunikimit. Janë të shumta komponentet e interferuara e të integruara që kanë sjellë interneti dhe rrjetet sociale, por gjykoj se tashmë është krijuar një dukuri e re me përmasa të plota sociale, që ka sjellë krijimin e një lloj barazie informative dhe strukturën sociale të “publikut egalitar”. Kjo dukuri është më e fortë në dukje sesa në thelbin e vet, çka krijon dikotominë midis së vërtetës dhe iluzionit të krijimit të një shoqërie që përjeton informacion “të demokratizuar”, në të cilën njerëzit kanë mundësi të barabarta në lidhjen, komunikimin, përdorimin e personalizuar të informacionit. Është e vërtetë që sot në Shqipëri kemi një realitet të ri komunikativ, në të cilin ekziston një hapësirë virtuale e barabartë, ku nxënësi e studenti, qytetari

një realitet socio-komunikativ dhe ka prekur të gjitha sferat e jetës: politikën, ekonominë, arsimin, shkencën, kulturën, shëndetësinë, ushtrinë etj. Nga pikëpamja sociale teknologjia ka sjellë ndryshime në strukturën e lidhjeve mes njerëzve, në tipologjinë e marrëdhënieve të shoqërizimit human. Njerëzit sot presin më shumë impakt nga teknologjia, nga potencia e saj komunikative virtuale sesa nga lidhjet reale e të personalizuara me njëri-tjetrin, sepse, sikurse ka thënë Mark Zuckerberg, “qëllimi *Facebook*-ut është të ndihmojë njerëzit për ta bërë botën më të hapur, si dhe të ndihmojë në promovimin e të kuptuarit të njerëzve”. Sociologët mendojnë se diskutimet për raportet e njeriut dhe të shoqërisë me internetin dhe komunikimin digjital duhen vlerësuar në mënyrë sintetike, sepse ndikimi i tij është gjithëpërfshirës, por mbi të gjitha ai ndikon në ndryshimin e strukturës së jetës dhe në cilësinë e

demokracisë. Ky realitet digjital dhe elektronik po ndryshon gjithashtu aftësitë individuale të njerëzve, kapacitetet e tyre për të bërë një bisedë të vërtetë, për të pasur marrëdhënie të sinqerta me njëritjetrin. Pa dyshim, unifikimi informativ është një dukuri e postmodernitetit, tërësisht e lidhur me teknologjinë digjitale dhe fuqinë rrafshuese të rrjeteve sociale. Kjo ka bërë që në jetën e sotme është e vështirë të dallosh se cilat janë problemet e tua, pasi edhe të tjerët shfaqin në rrjetet sociale të njëjtat probleme. Nga ana tjetër, edhe pse është krijuar përshtypja se nëpërmjet lidhjeve virtuale marrëdhëniet midis njerëzve po forcohen, është e padiskutueshme që lidhjet e vërteta empirike e sociale midis njerëzve po shkojnë drejt dobësimit, madje deri në nivele të skajshme të shfaqjes në mënyrë masive të njeriut mbiindividualist, asocial, të vetmuar, të njeriut të bindur për të qenë i vetëmjaftueshëm në marrëdhëniet e personalizuar. Realisht dhe virtualisht.

Ne nuk kemi statistika se sa është përqindja e popullsisë shqiptare që ka lidhje me internetin apo se sa herë në ditë, javë e muaj njerëzit tanë përdorin *Facebook*-un, por me siguri është në rritje numri i njerëzve që kanë mundur të kenë akses të zgjeruar në internet përmes telefonave celularë (smartfonëve). Kjo ka krijuar një gjendje për të cilën kohë më parë Erik Schmid, ish-shefi i *Google*-s, do të shprehej se “interneti është gjëja e parë që njerëzimi ka ndërtuar dhe që nuk arrin ta kuptojë si funksionon, eksperimenti më i madh anarkik që kemi bërë ndonjëherë”.

Zhvillimi i teknologjisë, përdorimi i rrjeteve sociale, i celularëve inteligjentë në mënyrë kaq të zgjeruar e me intensitet në rritje është një nga treguesit sintetikë të faktit se shoqëria jonë është përfshirë integralisht nga sfidat, shqetësimet, dukuritë më komplekse të jetës postmoderne të lidhur dhe interferuar me teknologjinë digjitale. Sikurse ka thënë ish-presidenti SHBA-ve Barak Obama, “sa më lirisht të rrjedhë informacioni, aq më e fortë bëhet shoqëria”<sup>6</sup>. Ndërkaq, për shkak të niveleve të ndryshme të arsimimit dhe kualifikimit, struktura sociale e publikut informativisht të barabartë nuk është e tillë, sepse raporti i qytetarëve, për shkak të shumë faktorëve materialë e kulturorë, konceptualisht dhe

materialisht nuk është i njëjtë me këto zhvillime të informacionit, rrjetëzimit dhe mediatizimit. Kjo situatë sociologjike kaotike e bën imperative nevojën e shpjegimit dhe konceptimit të drejtë të lidhjeve të njeriut me teknologjinë, internetin dhe rrjetet sociale, duke evidentuar anën pozitive si faktor me rëndësi në përshpejtimin e lidhjeve dhe të komunikimit social, por dhe si shkaktar për shfaqjen e shumë negacioneve, patologjive me dimension të gjerë social.

Marrëdhëniet e shoqërisë dhe të individit me internetin dhe rrjetet sociale mbeten në qendër të vëmendjes së jetës së shoqërisë. Të gjithë sociologët dhe psikologët kanë arritur në përfundimin se kjo situatë duhet vlerësuar seriozisht, sepse “rrjetet sociale janë ndër problematikat tona më të mëdha”, pasi kanë sjellë shumë probleme dhe shqetësime sociale, madje deri në nivelin e rrezikut social që në lidhjet dhe marrëdhëniet tona jo vetëm të mos i zëmë besë njëritjetrit, por edhe të kemi vështirësi për të punuar me njëritjetrin. Interneti ka sjellë ndryshime konceptuale në shoqërinë shqiptare dhe në jetën e përditshme komunikative të njeriut, i cili ka filluar ta kuptojë, ta ndiejë dhe ta realizojë ndryshe rolin e tij jo vetëm në vendin tonë, por edhe si lojtar universal dhe aktor pjesëmarrës në këtë dramë të madhe të historisë globale. Shumica absolute e shqiptarëve e kanë kuptuar dhe janë ndërgjegjësuar për faktin se numri i ngjarjeve dhe densiteti i pandërprerë i informacioneve kanë krijuar një raport të ri me kohën, me shoqërinë dhe perceptimet vetjake.

Jetojmë në kohë të reja, kur “nga të gjitha ndryshimet e shpejta në jetën moderne asgjë nuk krahasohet me evolucionin e shpejtë në teknologji, me mënyrën se si e përdorim atë për të argëtuar veten, për të komunikuar dhe për të ndikuar tek të tjerët, por dhe me mënyrën se si na ndikojnë të tjerët përmes asaj që na vjen nëpërmjet televizioneve tona, kompjuterave, ekraneve të smartfonëve dhe medieve të tjera”<sup>7</sup>.

S’ka dyshim se teknologjia e informacionit u ka dhënë një formë të caktuar postmoderne zhvillimeve në qytetërimin tonë. Ajo është bërë tashmë

frymë e kohës, filozofi kolektive e jetës, në kuptimin se ka përfshirë të gjitha strukturat e jetës intime, private, kulturore, kolektive e globale. Sikurse shkruan Margartet Arker (*Margaret Archer*), jetojmë në një shoqëri informative, e cila po sjell rikonceptimin e çështjes se çfarë do të thotë të jesh njeri në këtë kohë, në kushtet kur e gjithë kultura i nënshtrohet teknologjisë informative, kurse racionaliteti instrumental bëhet bazik dhe, për pasojë, mbizotëron “imperializmi i arsyes instrumentale”, që është tipik për sjelljen e njeriut postmodern, i cili jeton intensivisht në mënyrë të pashmangshme, madje të detyruar, në konturet determinuese të “shoqërisë së informacionit, rrjetëzimit [...] dhe komunikimit të përshpejtuar”. Në këtë kontekst duhen parë të dyja anët e ndikimit kontradiktor të internetit dhe komunikimit virtual, i cili paradoksalisht sjell pasoja që në dukje kanë ndikime të kundërta te publiku i gjerë. Kjo gjendje sociale, këto marrëdhënie të reja të njeriut me teknologjinë e informacionit kanë sjellë disa të mira, që jo vetëm duken, por kemi filluar t’i “shijojmë”, sikurse janë humbja e kontrollit dhe censurës së informacionit, mundësia e leximit dhe komunikimit të lirë midis njerëzve. Komunikimi përmes kanaleve mediatike apo rrjetit digjital ka mundësi që nëpërmjet transmetimit të një informacioni të gjerë të sjellë në të njëjtën kohë një proces social që shfaqet në formën e unifikimit të opinionit publik për çështje të caktuara që shqetësojnë qytetarin, politikën dhe shoqërinë shqiptare në tërësi.

Nga ana tjetër, është plotësisht e besueshme shfaqja e zgjeruar e një lloji ndikimi social fragmentues në strukturën e opinionit për shkak të larmisë virtuale të këndshikimit të fakteve, ngjarjeve dhe interpretimit të diversifikuar të tyre si rezultat i larmisë dhe peshës sociale të hermeneutikës mediatike apo optikës individuale me të cilën vështrohet informacioni që përcillet.

Të gjitha këto realitete të interferuara

<sup>6</sup> Yuval Noah Harari, “Nexus”, f. 15.

<sup>7</sup> Po aty, f. 14.

<sup>8</sup> Eliot Aronson, Joshua Aronson, “Kafsha sociale”, f. 139.

midis shoqërisë, individit dhe teknologjisë duhen parë me një optikë të re, sepse, sikurse mendojnë sociologët, jetojmë në kohën kur “shoqërinë informative e lëvizin informacionet, jo vlerat materiale”, kur “zhvillimi kuptohet përtej rritjes materiale, sepse kërkon ndryshim qëndrimesh, përshtatje kulturore, një arsimim të ri të fuqisë punëtore dhe një strukturë të ndryshuar politike, me fjalë të tjera, kujdesi për cilësinë e jetës zëvendëson prirjen e njëanshme për qëllime ekonomike”<sup>9</sup>.

### Shoqëria e informacionit dhe njeriu i hutuar pas celularit

Është më se e vërtetë se në kohën e sotme përdorimi celularit, i cili nuk është vetëm mjet folës, por ka funksione të shumta e polivalente, ka marrë përmasa të gjëra në Shqipëri. Të gjithë e përdorin celularin si agjendë takimesh, makinë shkrimi, kompjuter i vogël, mjet leximi etj., por ndërkohë ai po bëhet një mjet toksik, pasi po favorizon së tepërmi bullizmin dhe konfliktet virtuale.

Kur flasim për celularin dhe integrimin e tij intensiv në jetën personale dhe sociale të njeriut, duhet të jemi të kujdesshëm, të ekuilibruar dhe të ruhemi nga rreziku i vlerësimeve të njëanshme, sepse jetojmë në kohën digjitale, kur celulari është bërë gjëja më personale që zotëron njeriu. Përhapja e gjerë e përdorimit të celularëve ka krijuar një realitet të ri, të panjohur më parë, sepse celulari është bërë plotësues natyror i fizikut të njeriut, zgjatimi i veshit, syrit dhe bashkë me internetin po ndryshojnë aftësinë tonë për të bërë një bisedë të vërtetë apo për të pasur një marrëdhënie të sigurt me njëri-tjetrin. Është krijuar një iluzion social në përmasa alarmante sikur celulari është mjeti adekuat që e ndihmon njeriun të shmangët nga vetmia. Pa dyshim që kjo ka një pjesë të së vërtetës, por nuk është krejt e vërteta, sepse, edhe pse celulari është mjet i komunikimit të personalizuar, nuk është i aftë të zëvendësojë nevojat e njeriut për komunikim social. Sigurisht që nuk mund ta mohojmë se celularët kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën tonë të jetesës, ka thënë sociologu Mauricio Ferraris në librin e tij “Ontologjia e celularit”, madje janë bërë objekte filozofikisht interesante, po a është

normale patologjia dhe qëndrimi i paralizuar pranë celularit? Sociologët mendojnë dhe në mënyrë metaforike thonë se tani jetojmë në një botë të rrjetëzuar aq shumë, saqë ka mundësi që shoqëria në të cilën jetojmë “të çmendet në të njëjtën kohë”. Nga ana tjetër, celulari është bërë mjeti me anë të të cilit të gjithë kanë mundësi të gënjejnë miqtë e tyre, një



mjet individual shumë i fuqishëm, instrument komunikimi social, përdorimi pa kriter i të cilit po sjell situata të patologjive dhe intoksikimit social.

Me të drejtë sociologu britanik Pol Kollier (*Paul Collier*) thotë se “telefonat celularë smart përbëjnë cepin e skajshëm të individualizmit”, sepse po ndodh një fenomen që po sjell zhdukjen e “komunitetit special”, gjë që njerëzit e kuptojnë kur qëndrojnë në hapësira publike, si në kafe, në autobus, në lulishte, ku jemi të rrethuar nga njerëz që i kemi afër si hapësirë, por që në marrëdhëniet me njëri-tjetrin janë “të padukshëm”. Tashmë njerëzit kemi filluar të mos i shikojmë dhe takojmë në hapësirat e jetës sociale, por në ekranet e kompjuterave dhe të celularëve. Një situatë patologjike kjo, që po ushqen një lloj egoizmi dhe narcizmi të ankthshëm. Po jetojmë në një situatë të përgjithshme sociale në të cilën pikërisht ky mjet i vogël ka rimodeluar me rrënjë sjelljet dhe gjestet e individëve, madje i ka bërë edhe më abstrakte marrëdhëniet midis njerëzve. Kjo shoqërohet me iluzionin se celulari është mjet që na ka bërë më të lirë dhe ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe të

komunikimit social. Në njëfarë mase kjo është e vërtetë, por problemi i varësisë nga celulari dhe ndikimi i tij mbi lirinë individuale dhe lumturinë sociale janë të diskutueshëm. Filozofi i shquar italian Giorgio Agamben ka një vështrim sintetik për këtë problem. Ai mendon me të drejtë se “ai që e lë veten të kapet nga dispozitivi ‘telefon celular’, cilido qoftë intensiteti i dëshirës

që e ka shtyrë, nuk përfton kurrfarë subjektiviteti të ri, por vetëm një numër serie për të qenë eventualisht nën kontroll”<sup>10</sup>. Ndërkaq është vërtetuar, çka e tregojnë dhe studimet e fundit të bëra nga ekspertët e lumturisë, se celularët dhe laptopët e dëmtojnë lumturinë po aq sa dhe largësia e punës nga shtëpia. Të gjitha këto sjellin stres te njeriu.

Çfarë duhet të bëjmë, atëherë? Ajo çfarë duhet të bëjmë dhe që e kemi në dorën tonë është të ndikojmë që të përmirësohen, madje të ndryshojnë lidhjet dhe marrëdhëniet e njerëzve tanë, sidomos të fëmijëve dhe të rinjve, me teknologjinë, me celularin, internetin, rrjetet sociale. Të gjithë studiuesit - psikologët, sociologët, mjekët - kanë një përgjigje, që ka si rrugë përpjekjen për limitimin e përdorimit të rrjeteve sociale dhe forcimin e lidhjeve reale apo edhe shëtitjet në natyrë. Ekoterapia apo lidhja më e fortë me natyrën është terapia më e mirë për të shpëtuar nga varësitë patologjike që sjellin rrjetet sociale. Nuk është fjala që t'i sulmojmë mjetet teknologjike të komunikimit modern, sepse jetojmë në kohën e “shpejtësive të mëdha” dhe “informacioni është oksigjeni i kohës moderne”<sup>11</sup>, por të

mësojmë që ato t'i përdorim në mënyrë inteligjente, të moderuar. Sociologët e komunikimit, të cilët janë të kujdesshëm në përfundimet dhe rekomandimet e tyre, mendojnë se komunikimi digjital përbën një faktor social imponues, një lloj kulture që kërkon korrektesë, sepse ndryshe njeriu mund të përballlet me një lloj turpërimi publik, që realizohet menjëherë nëpërmjet informimit dashakeq e bullizues në rrjetet sociale. "Megjithatë më se një herë kam menduar se si mund të shkatërrohen apo çaktivizohen celularët dhe si mund të zhduken ose të paktën të ndëshkohen e të burgosen përdoruesit e tyre, nuk mendoj se është kjo zgjidhja e duhur e problemit"<sup>12</sup>, – thotë filozofi Giorgio Agamben.

Tanimë, konstatojnë sociologët e postmodernitetit, komunikimi midis njerëzve ka marrë formën e një lloj dialogu mes të verbërish. Me gjithë këto konstatime dhe kontroversalitete të përdorimit individual dhe shpërdorimit social, ne ndodhemi përballë një realiteti kokëfortë e të padyshtimtë, çka e tregon edhe fakti që edhe në shoqërinë shqiptare, me një shpejtësi përhapjeje dhe intensitet marramendës përdorimi, telefonat celularë janë bërë pjesë integrale e jetës së fëmijëve dhe adoleshentëve tanë. Ata janë pjesa sociale e lidhur më shumë me celularët, por në të njëjtën kohë janë shtresa që po pëson nga kjo epidemi masive e lidhjeve ndërpersonale e sociale elektronike.

Efektet e celularit dhe përdorimi patologjik është bërë dominues në përcaktimin e modaliteteve të sjelljes dhe komunikimit të fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë. Krahas gjërave pozitive përdorimi i celularit nga ky grup social ka sjellë një përçarje të madhe sociale. Për të gjithë është i pranishëm efekti i përdorimit intensiv të celularit, i cili po sjell izolimin e fëmijëve dhe të adoleshentëve, reduktimin e lidhjeve sociale ndërpersonale fizike dhe dobësimin e vitalitetit të marrëdhënieve shoqërore të vendosura me modulën "ballë për ballë". Jo vetëm kaq, por shumë shqetësues kanë filluar të bëhen edhe komponentet materiale të llojeve të celularëve që përdorin të rinjtë. Celularët, marka dhe performanca e tyre sipas estetikës, sipas modës shpesh janë objekt

konflikti midis prindërve dhe fëmijëve, sidomos me adoleshentët, të cilët përveç nevojave moshore specifike për komunikim kanë preferenca për cilësinë dhe markën e celularit. Për fat të keq, edhe instrumente të tilla si celulari kanë filluar të shërbejnë si matës të nivelit të jetës së familjes, si objekt që dëshmon stratifikimin social të familjes. Celulari si instrument teknik është bërë tregues i koduar për statusin social të familjes së fëmijës, adoleshentit, të riut. Në këtë kontekst, është e dukshme që fëmijët janë bërë viktimat të shoqërisë së konsumit dhe celulari, paradoksalisht, është kthyer në "ciklin e modës" tek të rinjtë, njëherësh edhe mjet presioni, që diktohet nga nevoja për të qenë dhe ecur paralelisht me modën e kohës. Është rritur pesha obseduese e tendencës sociale të fëmijët dhe adoleshentët, të cilët celularët po i përdorin si mjet komunikimi, por dhe si instrument të argëtimit virtual. Aq shumë janë të lidhur fëmijët dhe adoleshentët virtualisht me njëri-tjetrin, sa që më duket e saktë teza e Umberto Ekos se në kohën e sotme nuk është e qartë cila është paradigma rinore: jetojnë për celularin apo me celular? Pa dyshim, mënyra e gabuar e përdorimit të celularit është shoqëruar me shtimin e rreziqeve, sikurse janë ngacmimet seksuale, bullizmi elektronik, thashethemet, përgojimet, kërcënimet erotike etj.

Vlerat dhe antivlerat, utilitetet dhe patologjitë e ndikimit të celularëve mbi fëmijët dhe adoleshentët janë me ndikime antinomike, pozitive në shumë aspekte, por dhe negative në shumë të tjera. Nuk mund të mohohet vlera e celularit si mjet komunikimi midis fëmijës dhe prindit, as përdorimi i tij në disa raste për informacion të shpejtë dhe si kompjuter xhepi, por ka raste të shumta që fëmijët e përdorin celularin si mjet mashtrimi, fjala vjen, për të kopjuar në provime, apo si mjet për të plotësuar kënaqësinë e deformuar të fotomanisë kompulsive, që ka marrë formën ekstreme të drogimit elektronik. Prandaj duhet kujdes me fëmijët dhe adoleshentët. Kujdes që nuk është kurrë i tepërt.

Idolatrizimi i celularit në jetën e fëmijëve, mbivlerësimi i epërsive dhe anës pozitive të tij po shoqërohet me një ideologji rruge, e cila në emër të informacionit të

digjitalizuar, të shpejtë e situativ po krijon idenë e gabuar të spostimit të librit dhe kohës së tij. Unë besoj se është koha kur duhet bërë diçka për të ndaluar epideminë në zgjerim të nënvleftësimit të librit nga adoleshentët dhe të rinjtë. Pa mohuar vlerën e informacionit digjital, të cilin të rinjtë e marrin me shpejtësinë e dritës përmes internetit, celularëve dhe kompjuterave, libri ka epërsinë e tij. Edhe pse nuk ka çelësa, bateri, rrymë elektrike, është një objekt kompakt, që mund të përdoret kudo, kurdoherë dhe sa herë të duhet. Psikologët mendojnë se faqet e librit kanë epërsi mbi informacionin e lexuar përmes internetit.

Kundërshtarët e librit dhe simpatizantët patologjikë të epërsisë së vetme dhe të pakonkurrueshme të informacionit kibernetik janë ata që nxitin debate konfuze dhe me përfundime të shterpëzuara se është fare e kollajtë të zëvendësohen librat me materiale të marra nga interneti. Dinakëria e kësaj teze lidhet me disa gjykime utilitare, merkantiliste se kjo mënyrë, ky zëvendësim i librave me kompjuterat dhe celularët do të sjellë lehtësimin e çantave të shkollës dhe do të ulë koston e blerjes së librave. Është e vërtetë se interneti ka potencial dhe mund të japë informacione pa fund për shumë gjëra e fusha të dijes, por mungesa e filtrave, që mund t'i ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë në përzgjedhjen e informacionit, në shumë raste sjell pështjellime tek ata. Ky është një nga gabimet ontologjike që bëhet sot, i cili po dëmton dijen, formimin e të rinjve dhe shkollën si institucion i posaçëm i kulturës dhe formimit qytetar. Interneti nuk duhet të sjellë zëvendësimin e librave. Ai ka vlerë dhe është i domosdoshëm si mjet plotësues, madje duhet të shërbejë si nxitës për të rinjtë, si motiv shtesë për të lexuar më shumë libra. Unë jam i sigurt se ideja e përhapur se kjo epokë do të shënojë fundin e librit është një legendë urbane që do kalojë.

<sup>9</sup> Z. Goluboviç, "Unë dhe tjetri", f. 93.

<sup>10</sup> Giorgio Agamben, "Çfarë quajmë dispozitiv?", f. 43.

<sup>11</sup> N. Hararri, "Nexus", f. 14.

<sup>12</sup> Po aty, f. 33–34.



# Jehona e proceseve demokratike në Slloveni te shqiptarët në vitet 1989-1991

Zhvillimi i proceseve demokratike në Slloveni është ndjekur me shumë interes nga shqiptarët që jetonin në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Kjo është bërë e njohur kryesisht përmes revistave “Mlladina” dhe “Alternativa”, në të cilat janë prezantuar shkrime në gjuhën shqipe. Konstatim i përgjithshëm mbetet fakti se zhvillimet demokratike në Slloveni, që filluan në vitin 1989, patën jehonë të madhe në hapësirën ku jetonin shqiptarët (në Kosovë dhe Maqedoni).

Shtrohet pyetja: pse shqiptarët ishin shumë të interesuar për ngjarjet që ndodhnin në Slloveni? Sepse proceset demokratike, të cilat në Republikën e Sllovenisë filluan në vitin 1989, shqiptarët i përjetuan si të vetmen shpresë për rregullimin e çështjes së tyre shoqërore dhe politike. Pra, në qoftë se reformat politike sllovene për rirregullimin e Federatës Jugosllave do të ishin të suksesshme, shqiptarët, të cilët për vite me radhë jetonin në kushte të jashtëzakonshme, në rrethanat e reja demokratike do të mundnin t’i realizonin synimet e tyre, që ishin:

- i) çështja e të drejtave kombëtare në Jugosllavi, që do t’i mundësonte demokracia parlamentare;
- ii) çështja e statusit juridiko-kushtetues të Kosovës, si njësi e veçantë në Federatën ose në Konfederatën Jugosllave.



Prof. ordinar Zeqirja REXHEPI  
Universiteti i Tetovës

**D**o të përpiqem të heq një paralele midis principit slloven për vetëqeverisjen e popujve më 1989–1991, në krye të të cilit ndodhej Milan Kuçani, një nga personalitetet e palëkundura të politikës sllovene, dhe principit amerikan të vetëvendosjes, të cilin

SHBA-të përmes presidentit Udrou Uillson u përpoqën ta impononin në Konferencën e Parisit më 1919. Princi amerikan për vetëvendosjen e popujve fitoi shpirtat e popujve të robëruar europianë, ndërsa më 1989 sllovenët fituan simpatinë e popullit shqiptar në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Megjithatë, duhet theksuar se filltet e jehonës së proceseve demokratike sllovene vlejné për fazën e parë të zhvillimeve politike, atëherë kur sllovenët mbështetën postulatet themelore të Federatës Jugosllave dhe u përpoqën të impononin konceptin e vetëvendosjes si princip për rirregullimin e shtetit jugosllav, ndërsa në fazën e dytë, me fillimin e bisedimeve për *Jugosllavinë e Tretë*, shqiptarët dhe Kosova ishin plotësisht të mënjeluar nga këto bisedime dhe për këtë arsye jehona sllovene filloi të dobësohej. Përpos të tjerash shqiptarëve nuk u interesonte ndarja e Sllovenisë nga Jugosllavia, sepse kjo e dobësonte frontin demokratik përballë qarqeve të politikës unitare, me ç'rast pozita e shqiptarëve në Jugosllavinë e mbetur do të përkeqësohej edhe më tepër.

Duhet theksuar se lëvizjet e para demokratike të shqiptarëve në Jugosllavi e kanë zanafillën që më 1981, të cilat vazhduan deri në shkatërrimin e Jugosllavisë. Kjo ndodhi për dy arsye themelore:

i) në shumë vende të Europës jetonin një numër i madh shqiptarësh me punë të përkohshme, shumica e të cilëve merreshin edhe me veprimtari shoqërore dhe politike;

ii) pjesa më e madhe e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, përpos nomenklaturës komuniste, nuk e mbështetnin sistemin komunist, të cilin e konsideronin një sistem të pabarazisë së popullit shqiptar në Jugosllavi.

Pra, akumulimi i energjive negative të shqiptarët e mërgatës dhe urrejtja kundër regjimit komunist jugosllav iniciuan ngjarjet e “*Pravërës 1981*”, kur doli në skenën politike parulla “Kosova republikë”<sup>1</sup>.

Udhëheqja më e lartë jugosllave ngjarjet e vitit 1981 i vlerësoi si “*kundërrevolucion dhe rrënim i rregullimit shoqëroro-politik të Jugosllavisë*”. Me këtë rast anëtarit i KQ të LKJ-së Stane Dolanci më

6 prill 1981 do të thoshte se “*mund të them se parulla ‘Kosova republikë’ është jo vetëm parullë nacionaliste, por drejtpërdrejt kundër-revolucionare*”<sup>2</sup>. Një konstatim i tillë, pra “*kundërrevolucion dhe rrënim i rregullimit shoqëroro-politik të Jugosllavisë*”, më jep të drejtë në konstatimin se lëvizja demokratike në Jugosllavi filloi të shqiptarët, sepse ngjarjet e kësaj natyre

do të vendosej baraspesha e popujve dhe njësisive federale, gjë që do të shfaqej edhe në institucionet federative, me fjalë të tjera, do të vazhdonte të ruhej Jugosllavia Federative.

Dallimi midis lëvizjes demokratike të vitit 1981 dhe lëvizjes demokratike sllovene të vitit 1989 qëndron në faktin se lëvizja të shqiptarët u shfaq në një periudhë historike,

“ Nëse ngjarjet e vitit 1981 të shqiptarët do të ishin vlerësuar drejt, me ç'rast Kosova do të fitonte statusin e Republikës në kuadër të Federatës Jugosllave, atëherë koncepti i Jugosllavisë unitariste do t'i takonte historisë, por me këtë në Jugosllavi do të vendosej baraspesha e popujve dhe njësisive federale, gjë që do të shfaqej edhe në institucionet federative, me fjalë të tjera, do të vazhdonte të ruhej Jugosllavia Federative. ”



(kundërrevolucionit dhe rrënimin i rregullimit shoqëroro-politik) tetë vjet më vonë u zhvilluan në tërë Europën Lindore dhe Juglindore.

Nëse ngjarjet e vitit 1981 të shqiptarët do të ishin vlerësuar drejt, me ç'rast Kosova do të fitonte statusin e Republikës në kuadër të Federatës Jugosllave, atëherë koncepti i Jugosllavisë unitariste do t'i takonte historisë, por me këtë në Jugosllavi

kur rrethanat ndërkombëtare ishin të disfavorshme (edhe më tej vazhdonte Lufta e Ftohtë, ndërsa J. Brozi, autoriteti udhëheqës i Federatës Jugosllave, sapo

<sup>1</sup> Akademia e RPS të Shqipërisë, “*E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*”, Tiranë, 1990, f. 474.

<sup>2</sup> Ukshin Hoti, “*Filozofia politike e çështjes shqiptare*”, Tiranë, 1995, f. 76.

kishte vdekur). Pra, lëvizja demokratike slovene filloi pikërisht në periudhën kur rrethanat ndërkombëtare ishin në favor të proceseve slovene: ishte koha e reformave të mëdha të Mihail Gorbaçovit, e rënies së Murit të Berlinit dhe sistemit komunist në Europë.

Shtrohet pyetja: pse ngjarjet e vitit 1981 patën ndikim të jashtëzakonshëm në jetën shoqërore dhe politike të ish-Jugosllavisë? Përgjigja është më se e qartë: sepse ngjarjet e vitit 1981 e ndryshuan historinë, por haraçi që paguan shqiptarët ishte tepër i lartë. Në vijim të platformës së kundërrevolucionit udhëheqja jugosllave jo vetëm që i ngufati forcat demokratike në Jugosllavi, por u hapi rrugën qarqeve unitare, të cilat e drejtuan Jugosllavinë në kah të kundërt me proceset demokratike që zhvilloheshin në Europën Lindore e Juglindore në vitet 1989–1990. Ndërsa Kosova ishte e ngufatur, roli historik i lokomotivës për zhvillimin e proceseve demokratike i takoi Sllovenisë, gjegjësisht udhëheqjes brilante slovene. Republika e Sllovenisë historikisht do të mbetet udhëheqëse e proceseve demokratike në periudhën e shpërbërjes së shtetit jugosllav. Pikërisht për këtë arsye Sllovenia sot është jo vetëm shtet i pavarur, por është anëtare e familjes së madhe europiane, ndërsa njësitë e dikurshme federale të ish-Jugosllavisë janë ende larg këtij zhvillimi.

Lëvizja demokratike slovene, sipas bindjes sime, u nxit nga lëvizja antidemokratike në Serbi. Nënkuptoheq që e tërë kjo fillimisht u zhvillua në kuadër të strukturave të LKJ-së, të cilat qeverisnin vendin.

Nyja kryesore politike në Jugosllavi në vitet '80 ishte Kosova, rreth së cilës sillej tërë kriza jugosllave, e cila nga fundi i viteve '80 arriti kulmin. Filluan edhe ndryshimet e kushtetutës federative, të cilat do të kishin si epilog ruajtjen apo shkatërrimin e këtij shteti. Ngjarjet historike treguan se Federata Jugosllave, si një krijesë artificiale e Traktatit të Versajës, nuk do të mund të mbijetonte pas rrënimit të sistemit komunist.

Në Kosovë në vitet '80 u bënë përpjekje për zgjidhje përmes të ashtuquajturit "*Programi jugosllav për parandalimin e shpërnguljes të serbëve dhe malazezëve nga Kosova*". Realizimi i këtij

“ Republika e Sllovenisë historikisht do të mbetet udhëheqëse e proceseve demokratike në periudhën e shpërbërjes së shtetit jugosllav. Pikërisht për këtë arsye Sllovenia sot është jo vetëm shtet i pavarur, por është anëtare e familjes së madhe europiane, ndërsa njësitë e dikurshme federale të ish-Jugosllavisë janë ende larg këtij zhvillimi. ”

programi merrte një punë kolosale dhe masa të shumta. Në të vërtetë, ishte e qartë se ushtrohej presion i madh mbi shqiptarët, sidomos mbi institucionet e pushtetit të Kosovës, që për epilog kishin ndryshimet në kushtetutën e Serbisë, me qëllim që të realizohej i ashtuquajturit "*unifikimi i Serbisë*". Në këtë frymë në Brezovicë të Kosovës më 21 mars 1988 u mbajt mbledhja e sekretarëve të Punëve të Brendshme të krahinave dhe republikave, në të cilën përveç të tjerash u shqyrtua "*Programi i masave dhe aktiviteteve të përbashkëta të Sigurimit Shtetëror të Serbisë, Vojvodinës dhe Kosovës*" si dhe "*Raporti për realizimin e programit të përbashkët të masave dhe aktiviteteve*"<sup>5</sup>.

Në këtë dokument policor vërehet qartë se Jugosllavia as që mendonte për proceset e reja që zhvilloheshin në Europën Lindore. Përkundrazi, duke përforcuar kufijtë, sidomos kufirin me Shqipërinë, Jugosllavia do të mbyllej edhe më tepër. Në kahe të mbylles hermetike, si një detyrë e veçantë programore, ishte planifikuar ngritja e një sistemi operativ për sigurimin e kufirit shtetëror me Shqipërisë, me qëllim zbulimin e kanaleve për hyrjen e bashkëpunëtorëve të sigurimit dhe bartjen e armëve<sup>4</sup>.

Krahas mbylles hermetike të kufirit me Shqipërinë policia e Kosovës do të angazhohej në mënyrë të vazhdueshme në mbledhjen e fakteve dhe informatave për të gjitha rastet e mosrespektimit të ligjit për ndalimin e shitblerjes së pasurisë së patundshme, përmes të cilave, siç thuhej, nxitje shpërngulja e serbëve dhe

malazezëve, dhe marrjen e masave në zbatim të ligjit për pengimin e këtyre shfaqjeve<sup>5</sup>. Kjo detyrë, pra parandalimi i shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve, kishte për qëllim të krijonte klimën psikologjike se jeta në Kosovë ishte e padurueshme. Për realizimin e kësaj detyre ishte angazhuar policia e Kosovës, e Serbisë, e Maqedonisë dhe e Malit të Zi (të gjitha institucionet nga njësitë federale antishqiptare), që është një fakt i pamohueshëm se nga organet drejtuese të sigurimit shtetëror nuk ishin të mirëpritura institucionet federale në realizimin e detyrave delikate. Njëkohësisht, si rezultat i masave të marra dhe të koordinuara në periudhën prill 1987–mars 1988 u zbulua dhe u pengua veprimtaria ilegale e organizatës armiqësore marksiste-leniniste të formuar në vitin 1982, e cila përbëhej nga 14 anëtarë, si dhe një grupim në rajonin e Kërçovës, që përbëhej nga 12 anëtarë<sup>6</sup>. Nga ana tjetër, duhet theksuar se në këtë periudhë, kur Kosova ishte ende element konstitutiv i Federatës Jugosllave, udhëheqja e Serbisë ua imponoi politikën e saj njësitë të tjera federale në sferën e forcave të sigurimit. Për realizimin e detyrave në zbatim të vendimit të Kryesisë së Jugosllavisë u formua *Njësia e Përbashkët Policore*, e cila në Kosovë qëndroi deri më 25 tetor 1987. Nga këto informacione mësojmë se në përbërje të Njesisë kishte 1011 policë dhe oficerë nga të gjitha njësitë federale dhe krahina e Vojvodinës. Ekzistojnë të dhëna të sakta për pjesëmarrjen e policëve nga republikat

dhe krahina e Vojvodinës. Në ndërrimin e parë kishte 300 policë dhe oficerë nga policia federative; në ndërrimin e dytë kishte 250, prej të cilëve 116 nga Vojvodina, 86 nga Bosnjë-Hercegovina dhe 48 nga policia federative; në ndërrimin e tretë kishte 249 policë gjithsej, nga të cilët 118 nga Kroacia, 87 nga Serbia dhe 46 nga policia federative; në ndërrimin e katërt kishte 212 policë gjithsej (në Kosovë nga 23 prilli 1988), 112 nga Mali i Zi, 84 nga Sllovenia dhe 16 nga policia federative<sup>7</sup>.

Nga ky dokument kuptohet qartë jo vetëm mosbesimi ndaj institucioneve legale të Kosovës, por edhe marrja graduale e kompetencave të njësisë federale Kosovës. Ja si thuhet në këtë dokument: “Grupi punues pothuajse në të gjitha organet e Punëve të Brendshme të KSA-së së Kosovës filloi rishikimin e të gjitha lëndëve me karakter penal, në të cilat kishin marrë pjesë persona të nacionaliteteteve të ndryshme”, ndërkohë ekipi i përbashkët profesional i policisë së Serbisë dhe Kosovës bëri rishikimin e punës së organeve të Punëve të Brendshme në Krahinën Socialiste Autonome e Kosovës<sup>8</sup>.

Se si ishte gjendja në partinë e përbashkët (LKJ), por edhe gjendja në shtetin e përbashkët (Jugosllavi) në gjysmën e dytë të vitit 1988, pra në prag të rënies së sistemit komunist në Europën Lindore, kuptohet qartë nga informacionet e sigurisë nga shtatori i vitit 1988. Në dokumentin e Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme konstatohet *ashpërsimi i gjatë i marrëdhënieve, kundërtbëniet dhe mungesa e unitetit në Lidhjen Komuniste dhe udhëheqjen e saj*.

Proceset e reja, të cilat filluan intensivisht në Jugosllavi, u cilësuan si *veprimtari armiqësore brenda Jugosllavisë*, si p.sh. “komploti për copëtimin e Jugosllavisë dhe krijimin e Serbisë së Madhe, “shteti i pavarur i Kroacisë”, “Sllovenia separatiste”, “ndarja e Bosnjë-Hercegovinës” etj.<sup>9</sup> Ky informacion është me shumë rëndësi, sepse të gjitha ngjarjet që u zhvilluan në Jugosllavi flasin qartë se Kosova dhe shqiptarët ishin vetëm shkas për rirregullimin e Jugosllavisë sipas parimeve të reja, në përputhje me kërkesat e udhëheqjes serbe me në krye “vozhdin” serb Slllobodan Millosheviçi, i cili përfaqësonte qarqet unitare, një koncepti

kundërt me parimet themelore mbi të cilat ishte krijuar Jugosllavia Federative.

Në vitet 1989–1990 në Jugosllavi u themeluan shoqata të ndryshme, si p.sh. *Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut* në Ljublanë, *Këshilli për Mbrojtjen e Lirisë dhe Shprehjes së Mendimit* në Beograd etj. Të gjitha këto shoqata përfaqësonin fazën fillestare të krijimit të opozitës në Jugosllavi. Duhet theksuar se ngjarjet e reja ishin në përputhje me proceset europiane dhe frymën e përgjithshme që mbizotëronte në Europën Lindore, mirëpo në Jugosllavi organet e pushtetit shfaqnin nervozitet dhe padurim të madh ndaj proceseve të reja, për këtë arsye të gjitha ngjarjet që zhvilloheshin jashtë kontrollit të LKJ-së konsideroheshin veprimtari armiqësore. Kjo vërteton faktin se pjesa politike konservatore dhe dogmatike në LKJ, e cila qeveriste me institucionet e sistemit, absolutisht nuk ishte e gatshme të pranonte opozitë politike. Organizatat dhe shoqatat që formoheshin në Jugosllavi ndiqeshin nga organet e Sigurimit Shtetëror. Nga një dokument i Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme mësojmë për një takim të M. Miliçit dhe V. Sheksit në Beograd, të cilët i propozuan M. Gjillasit që shumë shpejt të takohet një grup, i cili do të dilte me një program jugosllav. Gjegjesisht morën qëndrime rreth zhvillimit të mëtejshëm të LKJ-së<sup>10</sup>.

Në vjeshtë të vitit 1988 u vunë në gatishmëri të gjithë mekanizmat e institucioneve supreme të sigurisë së Jugosllavisë, të cilat ishin nën kontrollin e udhëheqjes serbe dhe ndiqnin çdo gjë që nuk ishte sipas programit të saj. U sulmua faktori ndërkombëtar dhe të gjitha organizatat ndërkombëtare që ishin formuar në Jugosllavi për të ndihmuar në gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e krizës në të cilën ndodhej shoqëria jugosllave. Veprimtaria e organizatave ndërkombëtare llogaritej si veprimtari e së djathtës nacionaliste në kuadër të organizatave kuazi-humanitare.

Situata e rëndë shoqërore dhe politike në Jugosllavi i përshkruhej shërbimit informativ amerikan, që gjoja në bashkëpunim me emigracionin dhe armikun e brendshëm po komplotonin për shkatërrimin e Jugosllavisë.

Organet e sigurisë kishin informacione për Franjo Tugjmanin, i cili në atë periudhë kishte shkuar në Kanada, ku përpos të tjerash kishte mbajtur ligjërata rreth çështjes kombëtare në Jugosllavi, për Stjepan Radiçin etj. Ndërkaq në RF të Gjermanisë do të shtypej libri i Vladimir Sheksit sipas diktatit të emigracionit<sup>11</sup>.

Në këtë dokument të Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme nuk anashkalohej edhe Kosova, së cilës i kushtohej hapësirë e madhe. Thuhej se në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës gjendja e sigurisë ishte shumë e rëndë, ndërsa kohët e fundit po përkeqësohej nga dita në ditë. “*Nacionalistët dhe separatistët shqiptarë filluan ofensivën e re, që është rezultat i aktivitetit rreth ndryshimeve kushtetuese në Jugosllavi, e sidomos kërkesa për rregullimin e kushtetutshmërisë së marrëdhënieve në Serbi*”<sup>12</sup>, – thuhej rreth gjendjes në Kosovë. Theksohej gjithashtu se ishin zbuluar pamflete të reja, mesazhi i të cilave në esencë ishte i njëjtë: nuk kërkonin Republikën e Kosovës, por bashkimin me Shqipërinë<sup>13</sup>.

Vërehet qartë se regjimi komunist në Jugosllavi, veçanërisht pjesa konservatore, nuk e kuptonte se po afrohej çasti historik i shkatërrimit të sistemit komunist jo vetëm në Jugosllavi, por në tërë Europën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik. Faji për gjendjen e rëndë në Jugosllavi i vihej faktorit të jashtëm, në veçanti lëvizjes shqiptare, e cila në atë periudhë luftonte për të drejtat kombëtare. Kjo është periudha historike kur bëhet presion i

<sup>3</sup> ДАРМ, К 4/13-88, *Савезни Секретаријат за Унутрашње Послове*, 10.06.1988 (Строго поверљиво), Републички секретар за унутрашње послове, друг Томаж Ертл, Лубљана.

<sup>4</sup> По ату.

<sup>5</sup> По ату.

<sup>6</sup> По ату.

<sup>7</sup> По ату.

<sup>8</sup> По ату.

<sup>9</sup> ДАРМ, Савезни секретаријат за унутрашње послове (Строго поверљиво), Информација..., Београд, Септембар, 1988 год.

<sup>10</sup> По ату.

<sup>11</sup> По ату.

<sup>12</sup> По ату.

<sup>13</sup> По ату.

jashtëzakonshëm përmes të ashtuquajturve “mitingje të së vërtetës”, që në të vërtetë ishin lëvizje të organizuara të udhëheqjes serbe për rrënimin e pushtetit në njësitë federale që nuk ishin sipas “shijes” së saj. Kështu, më 8 tetor 1988 njihemi me rënien e udhëheqjes malazeze përmes informacionit special të Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme, ku propagandohej gjithçka ishte thënë në tubimin e madh në Titograd (Podgoricë)<sup>14</sup>.

Më 12 tetor 1988 u mbajt mbledhja e 22-të e KQ të Lidhjes Komuniste të Sllovenisë, në të cilën u dhanë vlerësime rreth çështjeve më të rëndësishme, midis të tjerash u fol se si i shihte Sllovenia zhvillimet në Jugosllavi. Dokumenti përfundimtar përmban informacione për qëndrimin e KQ të Lidhjes Komuniste të Sllovenisë, me përmbajtjen e të cilit u njoh Kryesia e KQ të LKJ-së, kryesitë e republikave dhe krahinave autonome si dhe organizata e LKJ-së në APJ<sup>15</sup>.

Ngjarjet që ishin zhvilluar deri atëherë në Jugosllavi komunistët sllovenë i cilësuan si kritike dhe shumë të ndërlikuara. Emërtimi i përbashkët i zhvillimeve të përgjithshme u vlerësua si rrezikshmëri dhe frikë si dhe mungesë iniciative të forcave socialiste, përfshirë edhe Lidhjen Komuniste. Përpjekja federative për të ruajtur frymën reformuese ishte shprehje e guximit për t'i rezistuar kërcënimit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Kjo tendencë nënkuptohet si përpjekje për t'u imponuar zgjidhje, të cilat duhej të arriheshin përmes rrugës legale, demokratike dhe kushtetuese. Krahas kësaj është brengosës fakti që mendohej për vendosjen e masave të jashtëzakonshme, të cilat në thelb i rrezikonin të drejtat e njeriut dhe i hapnin dyert anarkisë burokratike, që vinte nga institucionet e sistemit që ishin përgjegjëse për veprim ligjor<sup>16</sup>.

Nga sa u tha më sipër, mund të kuptohet qartë situata politike në Jugosllavinë e atëherëshme. Për organizatën komuniste të Sllovenisë ishin të pranueshme vetëm vendimet e marra sipas kushtetutës, asesi vendimet që mund të merreshin për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme.

Shkak për reagimin e komunistëve

sllovenë përpos të tjerash ishin edhe ngjarjet në Mal të Zi, ku më 7 tetor 1988, në tubimin e njerëzve të rajoneve të ndryshme, filloi procesi i rrëzimit të personaliteteve udhëheqëse të asaj njësie federale<sup>17</sup>. Duhet theksuar se në kohën e zhvillimit të ngjarjeve në Mal të Zi Kryesia e Lidhjes Komuniste të Sllovenisë i mbështeti përpjekjet e KQ të Lidhjes

përmes konceptit unitar ose shtetit të centralizuar. Më tej KQ i Lidhjes Komuniste të Sllovenisë theksonte se dalja nga kriza nuk mund të realizohej me përqendrimin e pushtetit në nivel federativ, por me zbatimin e ligjeve kur ishte fjala për ekonominë, demokratizimin dhe racionalizimin e sistemit<sup>19</sup>.

Shihet qartë se Republika e Sllovenisë

**“Greva e minatorëve të Trepçës është një ngjarje shumë e rëndësishme historike. Pas saj pritej që të zgjohej vetëdija e klasës punëtore dhe e minatorëve të tjerë në tërë Jugosllavinë, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Grevën e minatorëve e mbështeti vetëm Republika e Sllovenisë, gjegjësisht Lidhja e Sindikatave të Sllovenisë dhe udhëheqja sllovene.”**

Komuniste të Malit të Zi dhe Kryesinë e Malit të Zi për zgjidhjen e çështjeve përmes rrugës legale (institucioneve), mirëpo ndërkohë erdhi reagimi i ashpër i Kryesisë së Serbisë dhe KQ të Lidhjes Komuniste të Serbisë, që në esencë vërteton faktin se brenda LKJ-së ekzistonin pikëpamje të ndryshme për ekzistencën dhe zhvillimin, siç thuhej, të “bashkësisë sonë shumëkombëshe socialiste vetëqeverisëse dhe rolën e LKJ-së në shoqëri dhe në marrëdhëniet shoqërore”<sup>18</sup>.

Në letrën e tyre komunistët sllovenë bënin me dije se KQ i Lidhjes Komuniste të Sllovenisë theksonte nevojën e mëtutjeshme kur bëhej fjalë për realizimin e synimit që në Jugosllavi të mbisundonte logjika e bashkëjetesës së kombeve dhe kombësive; se në republika dhe në krahina mund të bëheshin ndryshime vetëm mbi bazë të marrëveshjeve dhe harmonizimit të interesave lidhur me jetesën e përbashkët në shtetin federativ, në përputhje me rregullimin kushtetues, kurrësi me shpalljen apo imponimin e qëndrimeve të njëanshme. Ishte ky qëndrimi parimor i komunistëve sllovenë, të cilët donin ta ruanin shtetin e përbashkët, por kurrësi

ishte kundër tendencave për ta ndryshuar mënyrën e vendosjes në nivel të institucioneve federative. Gjithashtu komunistët sllovenë bënë të ditur se ishin të papranueshme propozimet për mënyrën e sjelljes së vendimeve rreth marrëdhënieve të ndërsjella midis organeve federative dhe veprimeve për ndryshimin e kushtetutës së Jugosllavisë, sikurse dhe qëndrimi se Kuvendi i Jugosllavisë duhej të verifikonte zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Jugosllavisë.

Komunistët sllovenë kishin qëndrim të qartë e të saktë se republikat, gjegjësisht krahinat autonome, duhej të vendosnin në mënyrë të pavarur se kush do t'i përfaqësonte në Kryesinë e Jugosllavisë. Po ashtu ata kishin qëndrim të qartë edhe për krizën në Kosovë, e cila mund të tejkalohet vetëm përmes procesit demokratik. KQ i Lidhjes Komuniste të Sllovenisë mendonte se konflikti kombëtar në Kosovë mund të zgjidhej vetëm me mjete demokratike, me metoda për vendosjen dhe forcimin e shtetit të së drejtës dhe krijimin e kushteve për marrëveshje demokratike. Qëndrimi slloven shkonte në favor edhe të

republikave dhe krahinave që dëshironin të ruanin pavarësinë në marrjen e vendimeve si dhe më shumë të drejta në institucionet federative. Një qëndrim i tillë kishte rëndësi të veçantë për Kosovën dhe shqiptarët, prandaj nuk është për t'u habitur që proceset demokratike slovene patën jehonë të madhe.

Përfaqësuesit slovenë, në kontakt me përfaqësues ndërkombëtarë, i rezistuan ashpër politikës unitare serbe, e cila kishte filluar të imponohej në tërë Jugosllavinë<sup>20</sup>. Nga janari i vitit 1989 udhëheqja e Lidhjes Komuniste të Slovenisë u përpoq të hapte çështje të ndryshme për demokratizimin shoqëroro-politik për rregullimin e Jugosllavisë, por përpjekjet e tyre nuk gjetën përkrahje nga njësitë e tjera federale. Në vend të kësaj, pra konceptit federalist, LKJ-ja përballët me antikonceptin “unjësimi i LKJ-së”. Kuptohet që pas së dytës qëndronin qarqet konservatore brenda LKJ-së, që përpiqeshin të ruanin statukuonë, pra ngufatjen e lirisë së fjalës dhe të gjitha alternativave të tjera, gjë që ishte në favor të qarqeve unitare dhe udhëheqjes serbe. Për këto çështje është folur në Plenumin e KQ të LKJ-së, ku udhëheqësi i komunistëve slovenë, Milan Kuçani, mes të tjerash do të shprehë se “*Jugosllavia mund të jetë vetëm demokratike, socialiste dhe federative, ose nuk do të jetë fare*”<sup>21</sup>. Deri atëherë askush nuk e kishte deklaruar diçka të tillë publikisht, sidomos në ndonjë forum të lartë të LKJ-së. Deklarimi i Milan Kuçanit zgjoi interesim të jashtëzakonshëm në hapësirat ku jetonin shqiptarët, të cilët për një kohë të gjatë ishin përballur me Jugosllavinë jodemokratike, josocialiste dhe jofederative. Deklarimi i tij zgjoi tek ata shpresën se diçka do të ndryshonte.

Në hapësirat shqiptare, në veçanti në Kosovë, shtypja po çonte drejt humbjes së durimit, kështu që shqiptarët i prisnin ndryshimet më shumë se kombet dhe kombësitë e tjera në Jugosllavi. Nga ana tjetër, në Kosovë aplikohet programi i punës i Sigurimit Shtetëror, i cili kishte për detyrë të mbante nën kontroll tërë popullin shqiptar në Jugosllavi në prag të ndërrimit të kushtetutës së Serbisë. Duhet theksuar se në atë periudhë Sigurimi Shtetëror Jugosllav në Kosovë e koordinonte veprimtarinë vetëm me Sigurimin

Shtetëror të Malit të Zi, Maqedonisë, Serbisë dhe Kosovës, pra me të gjitha shërbimet që ishin të afërta me udhëheqjen serbe<sup>22</sup>, të cilat nuk gëzonin kurrfarë besimi të shqiptarët.

Në shkurt të vitit 1989 në Sloveni, krahasuar me njësitë e tjera federale, patën avancuar reformat e sistemit politik. Po atë muaj shfaqet partia e parë politike, si alternativë e LK-së: Partia Socialdemokrate e Slovenisë. Programi i kësaj partie ofronte një *Jugosllavi të re - Jugosllavinë e Tretë*, e cila do të zhvillohej sipas vendeve të zhvilluara të Europës<sup>23</sup>.

Ndërsa në Sloveni shfaqen idetë pluraliste, hapësirat ku jetonin shqiptarët (Kosovë dhe Maqedoni) u përballën me një situatë të kundërt. Në Kosovë ishte aktuale greva e minatorëve në Stan-Tërg<sup>24</sup>, ku minatorët në galeritë e nëntokës, në thellësinë 600–800 metra, përpiqeshin të mbronin parimet themelore të Jugosllavisë Federative<sup>25</sup>. Greva e minatorëve të Trepçës është një ngjarje shumë e rëndësishme historike. Pas saj pritej që të zgjohej vetëdija e klasës punëtore dhe e minatorëve të tjerë në tërë Jugosllavinë, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Grevën e minatorëve e mbështeti vetëm Republika e Slovenisë, gjegjësisht Lidhja e Sindikatave të Slovenisë dhe udhëheqja slovene. Në deklaratën e Lidhjes së

Sindikatave të Slovenisë midis të tjerash thuhej: “*Deklarojmë solidaritet njerëzor me minatorët dhe protestojmë kundër sjelljes, pa pranuar përgjegjësi, së organeve politike dhe shtetërore, të cilat në këtë mënyrë ikin nga problemi.*”<sup>26</sup>

Rezultati i ngjarjeve të bujshme në Kosovë dhe në Jugosllavi imponon pyetjen: a do të mundeshin proceset të rridhnin në kahun që kërkonin slovenët? Sipas bindjes sime, përgjigja është “jo”, sepse situata në Jugosllavi do të zhvillohej në drejtim të kundërt. Më 28 shkurt 1989 në Beograd u organizua një miting i madh, në të cilin demonstruesit kërkuan dorëheqjen e udhëheqësve të LKJ-së, konkretisht të Stipe Shuvarit, kryetar i KQ të LKJ-së, dhe Shtefan Koroshedit, sekretar, për të cilët mendohej se ishin pengesë për realizimin e shtetit unitar jugosllav. E gjithë kjo do të zhvillohej nën mburojë të kryetarit të Kryesisë së Jugosllavisë, Raif Dizdareviçit, i cili i njoftoi demonstruesit se kishte urdhëruar marrjen e masave të veçanta për mbrojtjen e rregullit kushtetues, të rendit publik dhe sigurisë personale<sup>27</sup>.

Ndërsa Kryesia e Jugosllavisë mori vendimin për vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë (më 1 mars 1989), disa ditë më parë, më 26 shkurt 1989, në Ljubljanë, në pallatin “Cankar”,

<sup>14</sup> ДАРМ, 1.427.528.30/30/326/328, Савезни секретаријат за унутрашње послове, (Само за лично информација), 8 октобар 1988 год.

<sup>15</sup> ДАРМ, 1.427.529.52/472, ЦК на СК Словеније, Претседателство, бр. 02-80/7, 13.10.1988 год., до Председателство на ЦК на СКЈ, до Председателствата и Комитетите на Републичките и Покрајинските организации на СК и на организациите на СКЈ во ЈНА.

<sup>16</sup> По ату.

<sup>17</sup> ДАРМ, 1.427.528.30, Савезни секретаријат за унутрашње послове, Специјална информација, 8 октобар, 1988 год.

<sup>18</sup> ДАРМ, 1.427.529.52/472, ЦК на СК Словеније, Председателство, бр. 02-80/7, 13.10.1988 год., до Председателството на ЦК на СКЈ, до Председателствата на Републичките и Покрајинските организации на ЦК и на организациите на СКЈ во ЈНА.

<sup>19</sup> По ату.

<sup>20</sup> “Flaka e vëllazërimit”, “Pohime dhe vlerësimet të papranueshme”, Shkup, 25 janar 1989.

<sup>21</sup> “Flaka e vëllazërimit”, “Gjithnjë e më larg Europës dhe Marksit”, Shkup, 1 shkurt 1989.

<sup>22</sup> ДАРМ, Савезни секретаријат за унутрашње послове, Служба државне безбедности (Државна тајна), Програм рада..., Београд, 1989.

<sup>23</sup> “Flaka e vëllazërimit”, “Opozita e parë zyrtare ndaj LK-së, 19 shkurt 1989.

<sup>24</sup> Shkëlzen Maliqi, “Nyja e Kosovës: as Vlasi, as Millosheviçi”, Ljubljanë, 1990, 253.

<sup>25</sup> “Flaka e vëllazërimit”, “Situatë shumë e rëndë në mbarë Kosovën”, 26 shkurt 1989.

<sup>26</sup> “Flaka e vëllazërimit”, “Solidarizim me minatorët”, 26 shkurt 1989.

<sup>27</sup> “Flaka e vëllazërimit”, “Miting protestues në Beograd”, 1 mars 1989.

u mbajt mitingu kundër vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme. Në mitingun *për paqe dhe bashkëjetesë në Kosovë* morën pjesë rreth 2000 qytetarë. Në këtë tubim mbajtën fjalime Milan Kuçani dhe Jozhe Smole. Ky i fundit mes të tjerash tha: *“Shqiptarët në Jugosllavi janë në pozitë të ngjashme me hebrejtë, për këtë arsye Lidhja e Rinisë së Sllovenisë mban simbolin me Yllin e Davidit dhe mbishkrimin ‘Kosovo – moja dezhele’.*” Në frymën e kundërshtimit të gjendjes së jashtëzakonshme, brenda një dite (më 27 shkurt 1989) rreth 500 mijë qytetarë sllovenë nënshkruan peticionin<sup>28</sup>. Megjithatë, kumbaria midis udhëheqjes së Serbisë dhe udhëheqjes së Jugosllavisë (përveç Sllovenisë) kishte për qëllim të ushtronte presion mbi opinionin jugosllav në prag të miratimit të amendamenteve në kushtetutën e Serbisë (më 28 mars 1989) për të eliminuar autonominë e Kosovës e të Vojvodinës, gjë që ishte në kundërshtim me çdo logjikë kushtetuese<sup>29</sup>. Kumbaria u vërejt edhe gjatë mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Jugosllavisë, në të cilën anëtar i Kryesisë së Jugosllavisë Lazar Mojsov doli hapur me të ashtuquajturin “dokumenti i Shtabit” (*Shtabski dokument*), që në të vërtetë ishte një letër e falsifikuar për situatën në Jugosllavi, sipas të cilës ishin shqiptarët ata që donin ta shkatërronin Jugosllavinë Federative. Pra, në njëfarë mënyre duhej të justifikoheshin gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë<sup>30</sup>.

Prof. dr. Agim Vinca, profesor në Universitetin e Prishtinës, shkrimtar dhe intelektual i njohur shqiptar, më 28 mars 1989, ditën kur mbahej mbledhja e Kuvendit të Serbisë për ndryshime kushtetuese, është mbajtur rreth 20 orë në bisedë informative në Sekretariatit e Punëve të Brendshme në Prishtinë. Profesor Vinca mes tjerash thotë: *“Në xhëpin e këmbës mbaja një kartëvizitë të një gazetari slloven, me të cilin isha takuar në Prishtinë. Pas tubimit në pallatin ‘Cankar’, ku intelektualët sllovenë mbështetën minoritet e Trepçës, një gjë e tillë përbente vepër të dënueshme. Në qoftë se policia serbe do të ma kishte vërejtur, seriozisht mund të dënoshesha. Për këtë arsye duhej ta fsihja kartëvizitën, gjegjësisht duhej ta zhdrukja kur të më jepej mundësia. Kjo ishte pak a shumë demokracia në atë kohë në hapësirën shqiptare në ish-Jugosllavi.”*<sup>31</sup>

Në dallim nga Republika e Sllovenisë, e cila ishte deklaruar kundër gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë, në Maqedoni, përkundrazi, propagandohej masivisht gjendja e jashtëzakonshme. Me këtë rast u organizua mbështetja e fuqishme e studentëve dhe të punësuarve në Universitetin e Shkupit, sikurse dhe organizatave të tjera dhe personaliteteve me ndikim. Ndryshimet në Kushtetutën e Serbisë, edhe përkundër faktit se përmes tyre kufizoheshin të drejtat e autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës, edhe përkundër thyerjes së parimeve bazë të kushtetutës së Jugosllavisë, në Republikën e Maqedonisë të gjitha këto shiheshin pozitivisht, pra gjykohej revolta e shqiptarëve.

Menjëherë pas revoltës së shqiptarëve kundër ndryshimeve të Kushtetutës, më 29 mars 1989, u mbajt mbledhja speciale e Kryesisë së Lidhjes Komuniste të Maqedonisë, në të cilën u mbështet politika serbe e Sllobodan Millosheviçit për konceptin unitar të Jugosllavisë. Nga procesverbali i mbledhjes mund të vërehet politika e gabuar e organeve drejtuese të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë. *“Kryesia vlerëson se demonstratat në KSA të Kosovës janë pjesë e veprimtarisë armiqësore nga pozitat e nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar, që është zhvilluar në kontinuitet me ngjarjet e janar-shkurtit dhe paraqesin formën shumë më të rëndë të veprimtarisë armiqësore në krahasim me demonstratat e vitit 1981. Është fjala për veprimtari të paramenduar masive dhe agresive nga pozitat e nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar me elemente të kryengritjes së armatosur, drejtpërdrejt kundër rregullimit kushtetues dhe integritetit të vendit, me qëllim destabilizimin e Jugosllavisë, rrënimin e integritetit territorial, shpërbërjen e pjesëve në të cilat jetojnë shqiptarët dhe bashkëngjitjen e tyre Shqipërisë, në kufijtë e të ashtuquajturës ‘Shqipëria e Madhe.’”*<sup>32</sup>—thuhet mes të tjerash në procesverbal.

Është shumë e qartë se në këtë fazë të historisë Maqedoninë udhëhiqnin kadro komuniste, të cilët i frikësoheshin udhëheqjes serbe me në krye Millosheviçin. Ata ishin plotësisht me orientim antishqiptar dhe nuk kishin kurrfarë vizioni për zhvillimin e mëtejshëm të proceseve politike që do të zhvilloheshin në Jugosllavi. Pra, vazhdonte logjika e vjetër, edhe përkundër faktit se

ajo ishte në kundërshtim me interesat e vetë Republikës së Maqedonisë. Komunistët maqedonas vlerësonin se kundërshtimi i shqiptarëve për ndryshimet në kushtetutën e Kosovës ishte akt kundërrevolucionar, që rrezikonte destabilizimin e marrëdhënieve dhe integritetin territorial.

Në Republikën e Maqedonisë udhëheqja komuniste konservatore assesi nuk mund të kuptonte se sistemi komunist ishte në prag të falimentimit dhe se po fillonte një erë e re, një periudhë me vlera të reja: ajo e sistemit të demokracisë parlamentare. Idetë e reja, që shfaqeshin përmes shtypit publik që nuk ishte nën kontrollin e sistemit, gjithashtu nuk ishin të pranueshme për udhëheqjen komuniste të Maqedonisë. Për shembull, gazetaret “Danas”, “Rilindja”, “Delo” manipulonin me informacione për udhëheqjen maqedonase duke i shtrembëruar faktet, duke nxitur forcat, të cilat paraqiteshin nga pozitat e nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar (*“Mladina’ mbështet drejtpërdrejt nacionalizmin shqiptar”*).

Se sa të rrezikshme konsideroheshin idetë demokratike në Maqedoni më 1989, mund të shihet nga disa argumente, të cilat në atë kohë i vëren një gazetar: *“Më 17 mars 1989 gazetarët sllovenë të ‘Mladinës’ Marjan Horvat e Adrijano Kirshin dhe gazetarja e Radio-Ljubljanës Tanja Barashin ishin në qytetin tim, në Tetovë, me qëllim të njëbeshin burimisht me reaksionin e ashpër të organizatës së Rinisë së LK-së, në krye të së cilës ishte Zoran Tomiq, në lidhje me artikullin ‘Dy shqiptarë – tre parti’ të prezantuar në revistën ‘Mladina’. Për realitetin në Tetovë gazetarët sllovenë janë informuar nga disa personalitete të njohura, të cilët në atë kohë ishin përjashtuar nga LKJ-ja (Miftar Ziberi, Mitat Emimi, Habil Bexheti). Gjatë vizitës mysafirët nga Ljubljana ndanë bexha: shqiptarët dykrerëshe dhe sloganet e shkruara në gjuhën serbe dhe shqipe: ‘Kosova – atdheu im’ dhe ‘Jetën e japim, Kosovën nuk e japim’.*

*Të njëjtët gazetarë mbajnë një mbledhje në Kërçovë me kryetarin e Lidhjes së Rinisë Komuniste, Mladen Vançoskin, nga i cili kërkuan rritjen e numrit të ‘Mladinës’ në Kërçovë. Vançoski me këtë rast përgjigjet: ‘Ajo që kërkoni është e pamundur, para së gjithash për shkak të shkrimeve provokative dhe të rreme të ‘Mladinës’.*<sup>33</sup>

*Që të mos mbetet me kaq, me shkrimet e*

*'Mladinës' do të merret edhe konferenca republikane e Lidhjes Socialiste të Maqedonisë, e cila i dërgon letër Lidhjes Socialiste të Sllovenisë.*

*Në Tetovë shkobet edhe më tej, pasi jo vetëm që dënobet sjellja e gazetarëve sllovenë, por prokurori publik i gjiqit komunal në Tetovë kërkon ngritjen e procedurës kundër gazetarëve të 'Mladinës' dhe Radio-Ljubljanes.'*<sup>34</sup>

Duhet theksuar se Lidhja Komuniste e Maqedonisë gjatë kohës së ndryshimeve shoqërore në Jugosllavi ka luajtur rol të dyfishtë në rirregullimin e Jugosllavisë. Në kohën e ndryshimit të kushtetutës së Serbisë komunistët maqedonas i mbështetën hapur qarqet unitare serbe, pra në kundërshtim me qëndrimet e komunistëve sllovenë. Kjo mund të shihet në dokumentin e njohur si *"Vlerësime dhe qëndrime të KQ të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë"*, mbledhja e të cilit u mbajt në Shkup më 9 maj 1989. Në pikën 5 të këtij dokumenti thuhet se *"Lidhja Komuniste e Maqedonisë thekson se Jugosllavia federative është shprehje e vetëdijes historike dhe përcaktim i kombeve dhe kombësive jugosllave, të cilat lirinë dhe zhvillimin e vet mund ta sigurojnë vetëm të bashkuar mbi principin e barazisë kombëtare, vëllazërim-bashkimit dhe bashkësisë socialiste vetëqeverisëse"*. Lidhja Komuniste e Maqedonisë deklaronte se Federata Jugosllave duhej të bazohej në vetëqeverisjen e klasës punëtore, në proceset demokratike dhe në realizimin e barazisë së kombeve dhe kombësive jugosllave. Mbi këtë bazë duhej të zhvillohej dhe të forcohej jugosllavizmi dhe patriotizmi socialist jugosllav, si përcaktim dhe vetëdije për bashkësinë e barabartë socialiste, vetëqeverisëse dhe demokratike të kombeve dhe kombësive<sup>35</sup>.

Kur i krahasojmë reformat e sistemit politik në Slloveni me ato në Maqedoni, arrijmë në përfundimin se në Slloveni ishte pranuar pluralizmi politik dhe kishte një vizion të qartë për rirregullimin e Jugosllavisë, ndërsa Maqedonia assesi nuk mund të çlirohej nga qëndrimet konservatore, ndaj përpiqej që të krijonte shtetin kombëtar maqedonas përmes sistemit komunist (pika 9). Vazhdonte përsëritja e refrenit *"nacionalizmi dhe separatizmi shqiptar"*, kundër të cilit luftonte Lidhja Komuniste e Maqedonisë, sepse përbënte kërcënim të drejtpërdrejtë dhe

rrezik të madh për stabilitetin dhe integritetin e Jugosllavisë dhe Maqedonisë (pika 10)<sup>36</sup>.

Pas ndryshimeve kushtetuese dhe "vendosjes së rendit dhe qetësisë në Kosovë", nga institucionet e sistemit mundën të funksiononin vetëm organet e sigurisë shtetërore, gjë që nënkupton se në Kosovë ishte vendosur diktatura policoro-ushtarake. Në Prishtinë më 30 maj 1989 u mbajt mbledhja e nënsekretarëve të Punëve të Brendshme, të cilën e drejtoi Zdravko Mustaq. Kosovën e përfaqësonte R. Shaloviçi<sup>37</sup>. Nga procesverbali i mbledhjes vërtetohet ajo që është thënë më parë: në Kosovë situata përkeqësohej, vazhdonte shpërngulja e serbëve dhe malazezëve, ndërsa jeta publike mund të funksiononte vetëm përmes organeve të sigurisë.

Procesi demokratik në Slloveni më 1989 u zhvillua përmes shumë pengesave, megjithatë Sllovenia mbetet oazë, ndërsa njësitë e tjera federale dhe udhëheqja më e lartë federative (Kryesia dhe qeveria e Jugosllavisë) treguan shkurtpamësi dhe nuk e ndoqën shembullin slloven. Aq më tepër që koncepti unitar nuk tregoi mirëkuptim ndaj proceseve të reja demokratike, çka i detyroi qarqet demokratike sllovene të ktheheshin te koncepti separatist ose koncepti për federatë asimetrike. Republika e Sllovenisë ishte e detyruar për këtë hap, por, nga ana tjetër, tendenca e re sllovene do ta dobësonte frontin demokratik në Jugosllavi. Hapi i ri slloven do të mbetej i pakuptueshëm edhe për anëtarin e Kryesisë së Jugosllavisë Vasil Tupurkovski, i cili në fjalën e tij gjatë kampanjës te "11 Tetori" në Shkup tha se *"Republika e Sllovenisë dhe populli slloven nuk kanë perspektivë jashtë Jugosllavisë"*, mirëpo koha e demantoi Vasil Tupurkovskin.

Nga fundi i vitit 1989, kur në Europë kishin ndodhur ngjarje të mëdha historike (rënia e Murit të Berlinit dhe e të gjitha regjimeve komuniste në Europën Lindore), në Jugosllavi vazhdonin kundërrthëniet. Ndalimi i *"mitingut të së vërtetës"* në Ljubljane do t'i ashpëronte edhe më tepër marrëdhëniet midis udhëheqjes së Sllovenisë dhe asaj të Serbisë. Përfundimisht gjithçka u qartësua në Kongresin e 11-të të Lidhjes Komuniste

të Sllovenisë më 22–23 dhjetor 1989, që u mbajt nën moton *"Evropa zëdaj"*. Në këtë Kongres udhëheqësi i komunistëve sllovenë do të deklaronte se *"për komunistët sllovenë Jugosllavia si zgjerim i Serbisë nuk është e pranueshme, por vetëm si shtet i përbashkët i kombeve dhe kombësive të barabarta, sipas masës së të gjithëve dhe interesave për të gjithë"*<sup>38</sup>. Kjo ishte e mjaftueshme për shqiptarët në ish-Jugosllavi, të cilët sytë dhe veshët i kishin kthyer nga Republika e Sllovenisë.

Se si e përshkruan Sekretariati Federativ i Punëve të Brendshme gjendjen në hapësirat ku jetonin shqiptarët në

<sup>22</sup> ДАРМ, Савезни секретаријат за унутрашње послове, Служба државне безбедности (Државна тајна), Програм рада..., Београд, 1989.

<sup>23</sup> "Flaka e vëllazërimit", "Opozita e parë zyrtare ndaj LK-së, 19 shkurt 1989.

<sup>24</sup> Shkëlzen Maliqi, "Nyja e Kosovës: as Vllasi, as Millosheviçi", Ljubljane, 1990, 253.

<sup>25</sup> "Flaka e vëllazërimit", "Situatë shumë e rëndë në mbarë Kosovën", 26 shkurt 1989.

<sup>26</sup> "Flaka e vëllazërimit", "Solidarizim me minatorët", 26 shkurt 1989.

<sup>27</sup> "Flaka e vëllazërimit", "Miting protestues në Beograd", 1 mars 1989.

<sup>28</sup> "Liria" nr. 7, mars 1990, Ljubljane.

<sup>29</sup> "Flaka e vëllazërimit", "U shpall Kushtetuta e RS të Serbisë, 29 mars 1989.

<sup>30</sup> "Flaka e vëllazërimit", "Nga greva pasive deri në kryengritje të armatosur", 3 mars 1989.

<sup>31</sup> Deklaratë e prof. dr. Agim Vincës, profesor i rregullt në Fakultetin filologjik të Universitetit të Prishtinës.

<sup>32</sup> ДАРМ, 1.427.536.61/422, Записник од стодвадесет и третата (проширена) седница на Председателството на ЦК СКМ, одржана на 22 март 1989 год.

<sup>33</sup> "Flaka e vëllazërimit", "Një mision provokues", 22 mars 1989.

<sup>34</sup> "Flaka e vëllazërimit", "Mladina provokon dhe fyen", 22 mars 1989.

<sup>35</sup> ДАРМ, ЦК на СКМ, Оцени и ставови, 9 мај 1989 год.

<sup>36</sup> По ату.

<sup>37</sup> ДАРМ, Савезни секретаријат за унутрашње послове, Служба државне безбедности (строго поверљиво), Закључки са састанка..., Београд, јуни 1989.

<sup>38</sup> "Flaka e vëllazërimit", "Europa tani", 22 dhjetor, 1989.

pranverën e vitit 1990, gjegjësisht pas ndryshimeve të mëdha në Europën Lindore dhe bashkimit të Gjermanisë ose gjatë periudhës së hapave të parë drejt pluralizmit, mund të vërehet nga një dokument tjetër që përfshin periudhën nga 27 shkurti deri më 23 marsi 1990. Në këtë dokument jepen vlerësime dhe përfundime rreth gjendjes së sigurisë në

*Komuniste të Kosovës, duke relativizuar legjitimitetin e institucioneve të sistemit. Në vend dhe në diasporë propagandojnë se janë forca reale politike, me të cilën duhet zhvilluar dialog për stabilizimin e gjendjes në Kosovë. Me këtë dokument pranohet se gjendja në KSA të Kosovës nuk qetësohet edhe pas ndryshimeve në kushtetutën e Serbisë. Edhe pse është vendosur rendi dhe qetësia, me angazhimin e forcave të sigurisë dhe të ushtrisë*

slovenë me në krye Mile Shetincin u takua me përfaqësues politikë dhe me shoqërinë elitare të shqiptarëve. Pas kritikave të shumta të përfaqësuesve shqiptarë Mile Shetinci do të shprehej: “*Duhat të pranohet hapur se deri këtu na sollë ndjenja e ndërgjegjes së vrarë. Në Slloveni ka filluar të besohet se me Kosovën, ka vazhdon represioni, nuk mund të shkohet në Europë, pra duhet ta largojmë pak*

*Kosovën, sepse, në qoftë se insistojmë, atëherë nuk do të ketë marrëveshje për Jugosllavi, për shkak se nuk do të marrë pjesë Serbia.*”<sup>42</sup>

Nga gjysma e dytë e vitit 1990 Sllovenia filloi të tërhiqej pak nga pak nga opsioni për rirregullimin e Jugosllavisë, edhe si konfederatë. Shkaku i tërheqjes ishte shpallja e deklaratës për pavarësinë e Republikës së Sllovenisë më 25 qershor 1991<sup>43</sup>. Nga ky moment interesimi për Kosovën dhe shqiptarët ishte në rënie, bashkë me të



*Jugosllavi. Vlerësimi ishte se “situata e përgjithshme politike dhe e sigurisë në vend është jashtëzakonisht e rëndë, me shkallë të lartë të destabilizimit, ndërsa në disa pjesë të vendit, sidomos në Kosovë, është dramatike”*<sup>39</sup>. Duke pasur parasysh këto përfundime, është më se e qartë se tërë Jugosllavia ishte “kosovizuar”, që do të thotë se shkaku i krizës jugosllave nuk ishte Kosova dhe shqiptarët, të cilët kërkonin barazi në Federatën Jugosllave. Kriza e rëndë vinte nga qarqet nacionaliste, që angazhoheshin për Jugosllavinë unitare dhe jofederative, çka nënkupton kthimin në Jugosllavinë e viteve para Luftës së Dytë Botërore. Në këtë dokument të Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme lidhur me gjendjen në Kosovë ndër të tjera thuhet: “*Edhe më tutje përkeqësohet situata politike dhe e sigurisë në KSA të Kosovës. Krabas grupëve dhe organizatave ilegale nga janari i këtij viti është në rritje alternativa kosovare, në veçanti Lidhja Demokratike e Kosovës. Në udhëheqësinë e tyre gjenden kryesisht separatistë shqiptarë nga rrethet intelektuale dhe ish-të burgosur politikë. Synimi themelor i veprimtarisë së tyre është masivizimi, ku kanë arritur rezultate të dukshme. Njëkohësisht zhvillojnë agjitacion për shkëputjen e Lidhjes*

*së APJ-së, gjendja në Krabinë edhe më tej vazhdon të mbetet e tensionuar dhe e përkeqësuar.*”<sup>40</sup>

Mirëpo duhet përmendur se entuziazmi i shqiptarëve në ish-Jugosllavi, i nxitur nga proceset demokratike në Slloveni, në gjysmën e dytë të vitit 1990 dhe gjatë vitit 1991 pak nga pak filloi të zbehej, sepse ngjarjet në Jugosllavi u zhvilluan në atë drejtim që shqiptarët ishin të detyruar për zgjidhje alternative, pra të kërkonin aleatë të faktori ndërkombëtar. Përkrahja e fundit e institucioneve shtetërore të Sllovenisë ishte çasti kur në Kuvendin e Republikës së Sllovenisë (më 19 korrik 1990) u miratua *Deklarata për Kosovën*, me të cilën Sllovenia në mënyrë eksplicite shprehu papajtueshmërinë e saj me udhëheqjen e Jugosllavisë<sup>41</sup>. Pra, deri në atë kohë Sllovenia ishte shumë tërheqëse për shqiptarët, sepse parimisht angazhohej për barazinë e popujve, të cilën e synonin edhe shqiptarët. Në periudhën e mëtejme Republika e Sllovenisë heshti për mospjesëmarrjen e shqiptarëve në bisedimet për rirregullimin e Jugosllavisë. Një përfundim i tillë shpaloset qartë në një mbledhje të mbajtur në Prishtinë më 2 prill 1991, kur një grup i parlamentarëve

edhe jehona e proceseve demokratike në Slloveni filloi të zbehej. Nuk mund të thuhet se Sllovenisë i interesonte ky opsion, me siguri i është imponuar, por është fakt se shkëputja e Republikës së Sllovenisë nuk i ndihmonte Kosovën dhe shqiptarët. Kjo vërteton deklaratën e deputetit të parlamentit slloven Mile Shetinc se “*shkëputja e Sllovenisë nuk e ndihmon Kosovën*”<sup>44</sup>.

Që Republika e Sllovenisë nga gjysma e dytë e vitit 1990 ishte e detyruar t'i tejkalohte Kosovën dhe shqiptarët, sikurse dhe parimet themelore për rirregullimin e Jugosllavisë, vërtetohet nga fakti se të gjitha aktet e sjella nga organet legale të pushtetit në Kosovë nuk do të mbështeteshin nga institucionet e Republikës së Sllovenisë. Kështu ndodhi me mospranimin e kushtetutës së Republikës së Kosovës më 7 shtator 1990 në Kaçanik<sup>45</sup>, mosreagimin e përfaqësuesit të Sllovenisë me rastin e shkarkimit të anëtarit të Kryesisë së Jugosllavisë nga Kosova, Riza Sapunxhiut, e njëkohësisht emërimin e përfaqësuesit nga Kuvendi i Serbisë, Sejdo Bajramoviçit<sup>46</sup>, vazhdimin e bisedimeve për *Jugosllavinë e Tretë* pa pjesëmarrjen e shqiptarëve.

## Përfundime

Është i njohur fakti se shqiptarëve në ish-Jugosllavi mbështetja e vetme u vinte nga Republika e Sllovenisë. Pra, nuk mund të jetë i rastësishëm përfundimi se proceset demokratike që u zhvilluan në Slloveni patën jehonë të gjerë të shqiptarët në ish-Jugosllavi, gjë që mund

demokratike sllovene dhanë shqiptarët me punë të përkohshme në Republikën e Sllovenisë, mediumet sllovene, sidomos revista “Mladina”, paraqitja publike e politikanëve sllovenë në nivel federativ, por kontribut shumë të rëndësishëm për lexuesin shqiptarë dhe revista “Alternativa” e Sali Kabashit, e cila botohej në Slloveni në gjuhën shqipe. Kjo revistë shkoi dorë

“ Proceset demokratike sllovene u zhvilluan në bazë të parimeve të demokracisë parlamentare, në përputhje me demokracinë e vendeve perëndimore, para së gjithash duke mbrojtur parimet themelore të Jugosllavisë Federative, të cilat për shqiptarët dhe Kosovën, si njësi federale e Jugosllavisë, ishin shumë të kapshme. ”

ta krahasoj me idetë e Revolucionit Francez (shek. XVIII), të cilat patën jehonë të madhe në tërë Europën. Nga Republika e Sllovenisë jo vetëm që buronin idetë reformuese, por vinte edhe mbështetja konkrete për Kosovën dhe shqiptarët. Duhet të theksohet se në gjysmën e parë të vitit 1989, pavarësisht faktit se idetë reformiste sllovene konsideroheshin shumë të rrezikshme për elitën politike konservatore të Jugosllavisë, ato ushtruan ndikim të madh në hapësirën ku jetonin shqiptarët. Republika e Sllovenisë për shqiptarët ishte një dritë në fund të tunelit, e vetmja shpresë që çonte tek e drejta.

Duke analizuar zhvillimin e proceseve demokratike në Slloveni dhe jehonën e tyre të shqiptarët e ish-Jugosllavisë në vitet 1989–1990, mund të konstatojmë se në fazën e parë të zhvillimit të atyre proceseve, kur përfaqësuesit e reformatorëve sllovenë mbronin parimet themelore të Jugosllavisë Federative, të cilat në Kosovë kishin pushuar së ekzistuari, patëm përhapjen e madhe të zgjerimit të ideve të reja. Një kontribut të rëndësishëm në përhapjen e ideve

më dorë të lexuesit shqiptarë.

Pse proceset demokratike sllovene patën jehonë shumë të fortë të shqiptarët?

Proceset demokratike sllovene u zhvilluan në bazë të parimeve të demokracisë parlamentare, në përputhje me demokracinë e vendeve perëndimore, para së gjithash duke mbrojtur parimet themelore të Jugosllavisë Federative, të cilat për shqiptarët dhe Kosovën, si njësi federale e Jugosllavisë, ishin shumë të kapshme. Duke mbrojtur parimet e Jugosllavisë Federative, praktikisht Republika e Sllovenisë luante rolin e avokatit të Kosovës në nivel federativ. Për këtë arsye jehona e madhe e proceseve demokratike sllovene nuk ishte e rastësishme. Mirëpo më vonë, kur Republika e Sllovenisë u kthye kah pavarësia e saj, filloi periudha e rënies graduale të jehonës së proceseve demokratike të shqiptarët. Megjithatë, Republika e Sllovenisë mbetet vendi i parë dhe i vetëm i fillimit të proceseve demokratike në ish-Jugosllavi në vitet 1989–1991.

## Burimet arkivore:

• ДАРМ – Државен архив на Република Македонија

## Gazetat dhe revistat:

- “Flaka e vëllazërimit”, 1989–1991.
- “Koha”, Prishtinë, 1991.
- “Lirija”, Ljubljana, 1990.
- “Ora”, Prishtinë, 1991.
- “Zëri i rinisë”, Prishtinë, 1990–1991.

## Literatura:

- Akademia e RPS të Shqipërisë, “E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, Tiranë, 1990.
- Глигоров, Киро, *Македонија е се што имаме*, Скопје, 2002.
- Horvat, Branko, “Kosovsko pitanje”, Zagreb, GLOBUS, 1989.
- Hoti, Ukshin, “Filozofia politike e çështjes shqiptare”, Tiranë, 1995.
- Stavileci, Esat, “Kosova dhe shqiptarët: ndërmjet kërcënimeve të brendshme dhe premtimeve të jashtme”, Prishtinë, Shoqata e Pavarur e Juristëve të Kosovës, 1991.
- Malcolm, Noel, “Kosova: histori e shkurtër”, Prishtinë, 2000.
- Maliqi, Shkëlzen, “Njyja e Kosovës: as Vllasi, as Millosheviçi”, Ljubljana, 1990.
- Serbia i Albanci, Knj. 2: Pregled politike Srbije prema Albancima od 1913 do 1945 godine, *Ljubljana: Univerzitetna konferenca Zvezde Socijalistične mladine*, 1989.
- Reuter, Jens, “Shqiptarët në Jugosllavi”, Tiranë, 2003.

<sup>39</sup> ДАРМ, Савезни секретаријат за унутрашње послове (строго поверљиво), Оцене и закључци, Београд, 2 април 1990 год.

<sup>40</sup> По ату.

<sup>41</sup> “Flaka e vëllazërimit”, “U miratua Deklarata për Kosovën”, 17 korrik 1990.

<sup>42</sup> “Zëri i rinisë”, 20 prill 1991.

<sup>43</sup> “Ora”, “Ditët që e tronditën Slloveninë”, 18 korrik 1991.

<sup>44</sup> “Koha”, “Shkëputja e jonë nuk i ndihmon Kosovës”, 10 prill 1991.

<sup>45</sup> Esat Stavileci, “Kosova dhe shqiptarët ndërmjet kërcënimeve të brendshme dhe premtimeve të jashtme”, Prishtinë, 1991, f. 24.

<sup>46</sup> По, ату, f. 80.

# PSSST...!



## Legjislacioni european për rregullimin e shpifjes

**Modeli i zhvillimit të biznesit mediatik, profesionalizmi i gazetarisë, kuadri ligjor rregullator dhe ndërhyrja e shtetit në sistemin mediatik janë ndër faktorët kryesorë që formësojnë median e një vendi. Zhvillimet teknologjike të lidhura me industrinë mediatike janë një tregues tjetër me mjaft ndikim. Peizazhi mediatik reflekton shtimin e numrit të medieve *on-line*, e lidhur kjo me përparimin i teknologjisë dhe të rrjeteve sociale. Ndikimi i rrjeteve sociale në përhapjen e produktit të tyre informues është mjaft i madh.**



Dr. Diana KALAJA

### **Balancimi i lirisë së medias dhe mbrojtjes së reputacionit. Standardet europiane për shpifjen, fyerjen dhe dezinformimin**

Rregullimi i lirisë së shprehjes si e drejtë themelore e njeriut është pjesë e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të 10 dhjetorit 1948. Në vijimësi Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar në dhjetor 1966, në nenin 19 të saj garanton lirinë e shprehjes. Edhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 1950,

garanton lirinë e shprehjes. Në nenin 19 të Konventës thuhet: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur opinione pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacione dhe ide nëpërmjet çdo mjeti dhe pavarësisht kufijve.”*

Në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut garantohej të drejtat e njeriut për privatësinë dhe moscenimin e saj. *“Askush nuk duhet t’u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare në privatësinë, familjen, shtëpinë dhe korrespondencën e tij, as sulmeve ndaj nderit dhe reputacionit të tij. Gjithkush ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve dhe sulmeve të tilla”*, – thuhet në nenin 12 të Deklaratës.

Ndërkohë që media vepron si vrojtues (*public watchdog*) i veprimtarisë për institucionet qeverisëse, nevojitet një raport i balancuar midis interesit publik për informacion dhe transparencë, nga njëra anë, dhe interesit për të mbrojtur të drejtën e privatësisë, reputacionit, nga ana tjetër. Balancimi në praktikë i këtyre dy të drejtave, të shprehura edhe në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, merr formë konkrete në rastet e padisë gjyqësore, ku duhet të balancohet e drejta e privatësisë me interesin e gjerë të publikut për të marrë informacion dhe për të folur lirisht. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe

“Zhvillimi i medievetë reja, i rrjeteve sociale, masivizimi i tyre dhe digjitalizimi, duke e bërë publikun njëkohësisht edhe krijues të përmbajtjes dhe përzgjedhës së saj, e ka fragmentarizuar më tepër medien. Ajo po përballlet gjithnjë e më shumë me sfidën e besimit të publikut.”

**Baza rregullatore europiane:**

- European Media Freedom Act. [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:L\\_202401083](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:L_202401083). REGULATION (EU) 2024/1083 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 11 April 2024 establishing a common framework for media services in the internal market and amending Directive 2010/13/EU.
- Regulations Regulation (EU) 2022/2065 of the European Parliament and of the Council of 19 October 2022 on a Single Market For Digital Services and amending Directive 2000/31/EC (Digital Services Act). <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32022R2065>.
- COUNCIL OF EUROPE, COMMITTEE OF MINISTERS, Recommendation Rec (2000)23, of the Committee of Ministers to member states, on the independence and functions of regulatory authorities for the broadcasting sector (Adopted by the Committee of Ministers on 20 December 2000 at the 735<sup>th</sup> meeting of the Ministers' Deputies). <https://search.coe.int/cm?i=09000016804e0322>.
- Recommendation CM/Rec(2012)1 of the Committee of Ministers to member States on public service media governance (Adopted by the Committee of Ministers on 15 February 2012 at the 1134<sup>th</sup> meeting of the Ministers' Deputies). <https://search.coe.int/cm?i=09000016805cb4b4>.
- Recommendation CM/Rec(2018)1[1] of the Committee of Ministers to member States on media pluralism and transparency of media ownership (Adopted by the Committee of Ministers on 7 March 2018 at the 1309<sup>th</sup> meeting of the Ministers' Deputies). <https://search.coe.int/cm?i=0900001680790e13>.
- Declaration of the Committee of Ministers, on measures to promote the respect of Article 10 of the European Convention on Human Rights (Adopted by the Committee of Ministers on 13 January 2010 at the 1074<sup>th</sup> meeting of the Ministers' Deputies). [https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset\\_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2016-1](https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2016-1)
- Recommendation CM/Rec(2011)7 of the Committee of Ministers to member states on a new notion of media (Adopted by the Committee of Ministers on 21 September 2011 at the 1121<sup>st</sup> meeting of the Ministers' Deputies). [https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset\\_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2011-7-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-a-new-notion-of-media](https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2011-7-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-a-new-notion-of-media).
- Parliamentary Assamble, Council of Europe “Resolution 2254 (2019)1 Media freedom as a condition for democratic elections”. <https://pace.coe.int/en/files/25409>.
- Venice Commission, “Opinion on draft amendments to Law no 97/2013 on Audiovisual Media Service” 19 June 2020. <https://rm.coe.int/vc-opinion-albania-0620/16809ec9c9>.
- “General comment No. 34”, U.N. Human Rights Committee, 102<sup>nd</sup> session, published 12 September 2011, UN. <https://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/GC34.pdf>.

Politike, miratuar në vitin 1966, në nenin 19 përcaktonte edhe arsyet e kufizimit të lirisë së shprehjes. Në të thuhet: *“Ushtrimi i të drejtave të parashikuaru në pikën 2 të këtij neni mbart me vete detyra dhe përgjegjësi të veçanta, prandaj mund t’u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, por këto do të jenë vetëm ato që parashikohen me ligj dhe janë të nevojshme për respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve dhe për mbrojtjen e sigurisë kombëtare ose të rendit publik, të shëndetit dhe të moralit publik.”*<sup>2</sup>

Media dhe gazetaria ndërtojnë me publikun dhe audiencën e tyre një marrëdhënie besimi, si kërkues të së vërtetës, balancues të informacioneve dhe referues të burimeve të informacionit për lajmet që përcjellin. Pa këtë besim të publikut do të kufizoheshin të gjitha funksionet e tjera të gazetarisë, si: dhënia e informacionit, zbulimi i çështjeve komplekse, ndjekja hap pas hapi i veprimtarisë së institucioneve qeverisëse, ekspozimi i korrupsionit dhe një forum për një debat të kuptimtë për çështje të rëndësishme publike. Zhvillimi i medievetë reja, i rrjeteve sociale, masivizimi i tyre dhe digjitalizimi, duke e bërë publikun njëkohësisht edhe krijues të përmbajtjes dhe përzgjedhës së saj, e ka fragmentarizuar më tepër medien. Ajo po përballlet gjithnjë e më shumë me sfidën e besimit të publikut. Rritja e besimit të publikut te media dhe përgjigjet e mundshme rregullatore ndaj problemeve ekzistuese të çrregullimit informativ fokusohen në shqetësimet për pavarësinë e medias dhe llogaridhëniet me publikun, në gjendjen e pluralizmit mediatiq, në pasojat e konsumimit të lajmeve në mediet sociale dhe në sfidat e çrregullimit informativ.

**Përgjigjet e industrive mediatike, vetërregullimi dhe verifikimi i fakteve**

Për të shpjeguar rënien e besimit te media dhe për t’iu përgjigjur përhapjes së lajmeve të rreme dhe dezinformimeve në rrjet, vetë industria mediatike ka ndërtuar disa bashkëpunime midis medievetë, si dhe ka hartuar kode praktike

<sup>1</sup> (<https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>)  
<sup>2</sup> <https://www.ohchr.org/en/instrumentmechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>.

dhe udhëzime.

Organizmat europianë kanë theksuar se praktikat më të mira të industrisë mediatike synojë tri kategori kryesore (Komiteti i Ministrave për shtetet anëtare për pluralizmin e medias dhe transparencën e pronësisë së medias, 2018): i) transparencën; ii) rritjen e besimit; iii) edukimin mediatik dhe informacionin. Në këtë kontekst, platformat e mëdha *on-line* dhe rrjetet e reklamimit kanë nënshkruar Kodin e Praktikës së BE-së për Dezinformimin (CoP) dhe janë zotuar të investojnë në produkte, teknologji dhe programe për të zhvilluar dhe zbatuar në mënyrë efektive treguesit e

Fuqizimi i komunitetit të medievet faktkontrolluese është edhe pjesë e Kodit të vitit 2022 (*Strengthened Code of Practice on Disinformation*). Nënshkruarit e këtij Kodi e pranojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe mbështetjen e aktiviteteve të komunitetit të faktkontrolluesve si pjesë e një strategjie efektive për trajtimin e dezinformimit.

#### Kode mbi dezinformimin

- **EU Code of Practice on Disinformation – shtator 2018** - Code of Practice on Disinformation
- **Annex ii current best practices from signatories of the code of practice** Annex: best practices
- **The sounding board’s unanimous final opinion on the so-called code of practice – 24 september 2018** Opinion of the Sounding board
- **2022 Strengthened Code of Practice on Disinformation 2022** Strengthened Code of Practice on Disinformation



besueshmërisë.

*Kodi i Praktikës mbi Dezinformimin 2018* është materiali për të cilin industria ka rënë dakord mbi baza vullnetare (për herë të parë në mbarë botën) për standardet vetërregulluese për të luftuar dezinformimin.

Përfaqësuesit e platformave *on-line*, kompanitë kryesore të teknologjisë dhe industria e reklamave ranë dakord për një kod vetërregullues praktik për të parandaluar përhapjen e dezinformimeve në internet. Kodi u nënshkrua nga platformat *Facebook*, *Google*, *Twitter*, *Mozilla* si dhe nga reklamuesit dhe industria e reklamave në tetor të vitit 2018 dhe nënshkruarit prezantuan

udhërrëfyesit e tyre për zbatimin e Kodit. *Microsoft*-i u bashkua në maj 2019, ndërsa *TikTok*-u e nënshkroi Kodin në qershor 2020.

*Kodi i Praktikës mbi Dezinformimin 2018* gjatë pandemisë së COVID-19 u zbatua edhe si monitorues për informacionin. Nga monitorimi rezultuan disa mangësi, ndaj dhe Komisioni Europian në maj të vitit 2021 nxori një udhëzues për forcimin e Kodit (*Udhëzues i Komisionit Europian për forcimin e Kodit të Praktikës për Dezinformimin (COM(2021) 262 final – European Commission Guidance on Strengthening the Code of Practice on Disinformation (COM(2021) 262 final)*), në të cilin shpjegohej se si duhet të eliminohen mangësitë. Në vazhdimësi të punës, zbatimit të strategjisë digjitale të Europës, EU ka nxjerrë kodin e

përforcuar të praktikës kundër dezinformimit, si një udhërrëfyes praktik dhe pas një procesi konsultimi më 16 qershor 2022 Komisioni Europian mirëpriti Kodin e Përforcuar të Luftës kundër Dezinformimit (*2022 Strengthened Code of Practice on Disinformation*).

Kodi i Praktikës mbi Dezinformimin i përforcuar i vitit 2022 është i ndarë në kapituj, ku përskruhen 44 angazhimet (*Commitment*) që duhet të udhëheqin pjesëmarrësit dhe nënshkruarit e këtij udhërrëfyesi si dhe masat për realizimin e tyre. Për të lehtësuar pjesëmarrjen dhe ndjekjen e Kodit janë përcaktuar angazhime jo vetëm për platformat shumë të mëdha *on-line*, të cilat e

kanë nënshkruar Kodin e vitit 2018, por edhe për operatorët e tjerë më të vegjël nga pikëpamja e numrit. Këta operatorë inkurajohen që t'u bashkëngjiten atyre angazhimeve (*Commitments*) që janë të përshtatshme për shërbimet e tyre dhe t'i zbatojnë ato përmes masave që janë proporcionalisht në përputhje me natyrën dhe madhësinë e shërbimit të tyre dhe burimet që ata kanë.

Industria mediatike u është përgjigjur problematikave me rënien e besimit të media dhe dezinformimin edhe nëpërmjet ndërtimit të mekanizmave për verifikimin dhe kontrollin e fakteve. Kështu, në vitin 2015 u ngrit Rrjeti i Kontrollit të Fakteve (IFCN) pranë Institutit Poynter për Studimet në Medie (St. Petersburg, Florida, SHIBA) për të bashkuar komunitetin e kontrolluesve të fakteve në mbarë botën në luftën globale kundër dezinformimit. Ky rrjet promovon saktësimin dhe kontrollin e fakteve në më shumë se 100 organizata faktkontrolluese (*fact-checking*) në mbarë botën.

Edhe në Tiranë vepron një organizatë që është pjesë e këtij rrjeti. “Faktoje.al”, shërbimi i parë fakt-kontrollues në Shqipëri, u themelua në vitin 2018 me mbështetjen e granteve nga donatorët e huaj dhe në bashkëpunim me organizata të tjera në vend. Prej korrikut të vitit 2019 “Faktoje.al” është e regjistruar në gjykatë dhe funksionon si organizatë mediatike joqeveritare e pavarur. Në raportin vjetor të hartuar nga “Faktoje.al” (*Disinformation Report: Albania 2023*) kjo organizatë rreshton disa nga tematikat rreth të cilave jepen informacione dezinformuese, aktorët që kanë kontribuar në shpërndarjen

e këtij dezinformimi dhe teknikat e përdorura. Raporti i plotë gjendet në faqen *on-line* të rjetit. *SEECheck* me pjesëmarrjen e organizatave nga pesë vende të Europës Juglindore, të cilat punojnë për promovimin e përgjegjshmërisë në medie dhe luftën ndaj çinformimit dhe dezinformimit<sup>3</sup>.

Fokusi i “Faktoje.al” është verifikimi i deklaratave, premtimeve dhe veprimeve të zyrtarëve publikë dhe të institucioneve më të rëndësishme të vendit. Klodiana Kapo, drejtoreshë ekzekutive e “Faktoje.al”, shpreh: “*Dezinformimi on-line është një armë e rrezikshme dhe e fuqishme në ditët e sotme, ku një gënjeshtrë e shpërndarë më shumë se 10 herë në më shumë se 10 medie këmbet në një belm që përkeqëson dhe dëmton shëndetin e gjatë. Verifikimi i premtimeve, deklaratave të politikanëve me fakte dhe sipas një metodologjie rigorozë ndihmon në forcimin e gazetarisë dhe të argumenteve të bazuara në evidencë të verifikuara. Faketet ndihmojnë në forcimin e së vërtetës, rritjen e besueshmërisë dhe forcimin e demokracisë. Misioni i Faktoje.al është t’u qëndrojnë fakteve dhe së vërtetës, ku dokumet përmes evidencave mund ta kuptojë dhe të krijojë qëndrimin dhe mendimin e tij. Media duhet të ecë në procesin e vetërregullimit pa presionin politik, ekonomik apo të organizatave kriminale.”<sup>4</sup>*

Fuqizimi i komunitetit të medieve faktkontrolluese është edhe pjesë e Kodit të vitit 2022 (*Strengthened Code of Practice on Disinformation*). Nënshkruesit e këtij Kodi e pranojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe mbështetjen e aktiviteteve të komunitetit të faktkontrolluesve si pjesë e një strategjie efektive për trajtimin e dezinformimit

Vetërregullimi si qasje e mirë ndaj dezinformimit shoqërohet me çështje që kërkojnë zgjidhje. Problemi i parë lidhet me konkurrencën dhe koordinimin, pasi vetërregullimi kërkon që kompanitë mediatike të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, ndërkohë që kompanitë janë në një konkurrencë mjaft të fortë me njëra-tjetrën. Volumi i madh i informacionit është një tjetër faktor shqetësues për vetërregullimin. Për rrjedhojë, nevojitet që vetë platformat të ndërtojnë mekanizma të automatizuar bazuar në fjalë apo grupe fjalësh për të minimizuar ndërhyrjen e njerëzve. Kjo na çon në përfshirjen e inteligjencës artificiale (AI), që është një tjetër problematikë dhe që mund të jetë në dëm të lirisë së shprehjes. Duke krijuar këto institucione të reja dhe parime etike, po rindërtohet ajo çfarë është media, por duhet bërë kujdes për

respektimin e standardeve të vendosura, që janë përgjegjshmëria, transparenca dhe pavarësia.

### **Përgjigja e hartuesve të politikave**

Problematikave me dezinformimin, çorientimin informativ apo *fake news* autoritetet publike të shteteve të ndryshme u janë përgjigjur në forma të ndryshme, në disa raste duke inkurajuar vetërregullimin e në raste të tjera duke bërë klasifikime më të detajuara të asaj që në medie etiketohet “përmbytje e paligjshme”. Këto veprime marrin formën e: i) ligjeve të reja për detyrimet e kompanive mediatike, ndërmjetësuesit e internetit dhe përdoruesit përfundimtarë përgjegjës ndaj përhapjes së dezinformimeve; ii) formën e ngritjes së agjencive shtetërore që kanë përgjegjësi të identifikojnë dhe monitorojnë proceset e dezinformimit; iii) formën e vendosjes së standardeve përmes miratimit të përkufizimeve të reja për keqinformimin dhe dezinformimin, përfshirë kodet e sjelljes.

Gjatë viteve 2016–2017 politikë-bërësit u përpoqën të rregullonin problemin e lajmeve të rreme si pjesë e debatit për përmbytjet e dëmshme. Gjermania miratoi ligjin e njohur me shkurtimet “NetzDG”, i quajtur gjithashtu “Akti i Facebook-ut”<sup>5</sup>, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2018. Sipas këtij akti, rjetet e medieve sociale me mbi dy milionë përdorues në Gjermani duhet të krijojnë një procedurë transparente për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave me përmbytje të paligjshme. Këto medie duhet të bllokohen ose të heqin përmbytjen e paligjshme brenda 24 orëve nga marrja e një ankese. Në Francë në vitin 2018 u miratua dhe hyri në fuqi ligji kundër manipulimit të informacionit, i quajtur “ligji infox” ose “ligji i lajmeve të rreme”<sup>6</sup>. Megjithatë, në të dy vendet organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kanë bërë kritika, përmes të cilave kanë vënë në dukje klasifikimet e gjera për atë çfarë është përmbytje e

paligjshme.

Si reagimi i industrisë së medies, ashtu dhe ai i politikëbërësve synojnë një balancim midis lirisë së medies dhe rregullimit. Në studimin “Liria e medies, rregullimi dhe besimi - Një qasje sistematike ndaj shtrembërimit të informacionit” (*Media Freedom, regulation and trust – A systemic approach to information distortion*), thuhet: “... thirrjet për reforma urgjente duhet të trajtohen me kujdes në sektorin e medies. Ndërsa rreziqet e rregullimit informativ janë reale dhe kërkojnë reforma, ka një potencial për keqje dhe abuzim me futjen e ligjeve të reja, që do të formësojnë rreziqesist sistemin mediatik. Në shumë vende thirrjet për rregullimin e medieve të reja udhëhiqen nga interesa mediatike të trashëguar. Qeveritë mund të kërkojnë gjithashtu të përdorin reformën e medies në disavantazh të aktorëve të rinj politikë, prandaj politikëbërësit duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet e përgjigjeve ndaj rregullimit informativ.”<sup>7</sup>

Analistët theksojnë se ndryshimet rregullatore kanë ndikim mbi demokracinë. Mbrojtja e vlerave demokratike kërkon vëzhgim të thelluar, transparenca dhe ndërtim institucional të bashkërenduar. Monitorimi i bashkërrregullimit dhe vetërregullimit si dhe përcaktimi për filtrimin, heqjen dhe promovimin e përmbytjes duhet të jetë transparent. Rekomandimet e kësaj analize nënvizojnë standardet e mëposhtme:

- i) vendimmarrja duhet të jetë e hapur dhe transparente;
- ii) palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të kontribuojnë gjatë gjithë procesit të hartimit të politikave dhe ligjbërjes;
- iii) veprimet duhet të bazohen në dëshmi dhe kuptim të ndikimit;
- iv) ngarkesat rregullatore për bizneset, individët dhe administratat publike duhet të mbahen në nivel minimal<sup>8</sup>.

Reformat për rregullimin e përmbytjes *on-line* shtrojnë detyra të rëndësishme për rregullim më të mirë. Ato kërkojnë një qasje fleksibël, funksionale dhe sistematike me shumë palë të interesuara, të cilat duhet të përfshijnë shtetet, rregullatorët, moderatorët,

<sup>3</sup> <https://seecheck.org/index.php/2024/06/14/disinformation-report-albania-in-2023/>.

<sup>4</sup> Intervistë me znj. Klodiana Kapo, qershor 2024.

<sup>5</sup> Perma | Gesetz zur Änderung des Netzwerkdurchsetzungsgesetzes

<sup>6</sup> LOI n° 2018-1202 du 22 décembre 2018 relative à la lutte contre la manipulation de l’information (1) - Légifrance ([legifrance.gouv.fr](http://legifrance.gouv.fr)).

<sup>7</sup> <https://rm.coe.int/cyprus-2020-new-media/16809a524f>.

<sup>8</sup> Po aty

botuesit, reklamuesit, platformat, mediet sociale, ndërmjetësit, pra të gjithë ata që janë të përfshirë në ekologjinë e shpërndarjes së përmbajtjes. Disa nga parimet që mund të udhëheqin reformat e propozuara në rregullimin e medias përshkruajnë mënyrat me të cilat vendosën parimet e Këshillit të Europës për pavarësinë e medias<sup>9</sup>, si: i) vendosja e standardeve për përmbajtjen; ii) puna editoriale; iii) rregullimet e shpërndarjes; iv) gjykimi i ankesave; v) transparenca; vi) Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (*Strategic Lawsuits Against Public Participation – SLAPP*).

Paditë SLAPP, sipas një përcaktimi të përgjithshëm, janë padi që synojnë të censurojnë, frikësojnë dhe heshtin kritikët, duke i ngarkuar ata me koston e një mbrojtjeje ligjore deri sa të heqin dorë nga kritika ose kundërshtimi i tyre. Objektivi i vërtetë i padive SLAPP nuk është të fitojnë një çështje gjyqësore, por të mposhtin të pandehurin përmes procedurave të stërzgaturave ligjore, kostove të tepërta dhe barrës psikologjike përkatëse.

*“Paditë SLAPP të fokusuar në akuzat për shpifje përdoren shpesh për të dekurajuar gazetarët që të avancojnë punën e tyre, duke parandaluar publikimin ose heqjen e përmbajtjeve të caktuar dhe duke dekurajuar të tjerët që të mbulojnë të njëjtat çështje.”<sup>10</sup>*

### **Përvoja e disa vendeve europiane në dekriminalizimin e shpifjes**

Komiteti për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara ka deklaruar prej kohësh se “vendet duhet të marrin në konsideratë dekriminalizimin e shpifjes”<sup>11</sup>. Kjo deklaratë e bërë në sesionin e 102-të në Gjenvë (*General comment 34*) ka ardhur pas observimeve të bëra nga Qendra për të Drejta Politike dhe Civile në disa shtete, si Itali, Britani e Madhe, Irlandën e Veriut dhe Maqedoninë e Veriut. Në deklaratë thuhet se ligjet për shpifjen duhet të hartohen me kujdes për të siguruar që në praktikë të mos shërbejnë për të mbytur lirinë e shprehjes. Konkretisht thuhet: “Në çdo rast një interes publik në temën e kritikës duhet të njihet si mbrojtje. Shtetet palë duhet të kenë kujdes për të shmangur masat dhe ndëshkimet e tepërta.”<sup>12</sup>

Një qëndrim i ngjashëm mbahet edhe në studimin e OECD-së të marsit 2017, i cili shqyrton ekzistencën e ligjeve penale për

shpifjen dhe fyerjen në territorin e 57 shteteve pjesëmarrëse në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE). Në studim theksohet se organe të ndryshme europiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kanë kritikuar vendosjen e sanksioneve penale në rastet e shpifjes. Konkretisht në studim ndër të tjera thuhet: *“Kjo kritikë është e rrejtësuar pjesërisht në frikën se sanksionet penale, kur kerabasohen me mjetet juridike civile, mbartin një potencial më të madh për të gjeneruar një efekt stobës në medie e më gjerë në lirinë e shprehjes. Përveç kësaj ligjet penale për shpifjen, që përfshijnë ushtrimin e pushtetit shtetëror dhe përdorimin e burimeve shtetërore, janë veçanërisht të pritura ndaj abuzimit për t’u mbyllur gojën kundërshtarëve dhe kritikëve.”<sup>13</sup>*

Studimi tregon se vetëm 15 shtete të OSBE-së kanë shfuqizuar të gjitha dispozitat e përgjithshme mbi shpifjen dhe fyerjen penale, pra e kanë hequr tërësisht nga Kodi Penal, ndërsa vendet e tjera e kanë hequr atë pjesërisht. (Dispozitat penale për shpifjen në studim janë të ndara në dispozita të përgjithshme, dispozita për shpifje penale ndaj zyrtarëve publikë, ndaj kreut të shtetit, ndaj vendit dhe simboleve të tij, ndaj vendeve të huaja dhe simboleve të tyre, ndaj personave që kanë ndërruar jetë, ndaj fesë dhe simboleve të tyre etj.)

### **Legjislacioni shqiptar për rregullimin e shpifjes dhe refleksionet aktuale**

Shpifja mbetet vepër penale në Shqipëri<sup>14</sup>. Kodi Penal shqiptar në nenet 119, 120 parashikon vepra penale për fyerjen e qëllimshme të personit, shpërndarjen e materialeve raciste dhe ksenofobe, frymëzimin me motive raciste ose ksenofobe, përhapjen e qëllimshme të thënieve dhe të çdo informacioni tjetër që cenon nderin dhe dinjitetin e personit. Ndërsa në nenin 318 parashikon vepër penale për fyerjen e gjyqtarëve dhe të anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit mbrojtës ose të anëtarit të arbitrazhit.

Organizata “Artikulli 19”<sup>15</sup> në vitin 2004, në kuadër të fushatës globale për lirinë e shprehjes dhe me kërkesë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), ndërmoi një studim për lirinë e shprehjes në legjislacionin shqiptar, ku bëri

një analizë për ligjin shqiptar civil dhe penal, përfshirë dispozitat për të drejtën e përgënjeshtimit përkundrejt standardeve ndërkombëtare për lirinë e shprehjes. Duke studiuar informacionin dhe kuadrin rregullator, “Artikulli 19” në vitin 2004 theksonte se “ligjet shqiptare për shpifjen përbëjnë një pengesë serioze për gazetarinë e pavarur dhe kritike” dhe se “*rekomandimi ynë kryesor është që dispozitat penale për shpifjen të shfuqizohen dhe të zëvendësohen me dispozitat e dubura civile*”<sup>16</sup>.

Mjaft nga rekomandimet e studimit të “Artikullit 19” janë marrë parasysh në ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal ndër vite dhe miratimi i tyre në vitin 2012, sidomos heqja e mbrojtjes së veçantë për zyrtarët dhe simbolet. Gjithashtu u lehtësuan edhe masat e dënimit. Edhe rekomandimet e “Artikullit 19” që lidheshin me nenin 625 të Kodit Civil u reflektuan në ndryshimet e tij, duke e përcaktuar më saktë veprën e shpifjes me përfshirjen edhe të reputacionit.

Aktualisht Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999, me ligjin nr. 8781, datë 3.05.2001, me ligjin nr. 17/2012, datë 16.02.2012, me ligjin nr. 121/2013, datë 18.04.2013, me ligjin nr. 113/2016, datë 3.11.2016 dhe me vendimin Gjykatës Kushtetuese nr. 69, datë 27.12.2023, përmban nenin 617 dhe nenin 625 që lidhen me shpifjen.

Rekomandimi i studimit të “Artikullit 19” ka qenë që “Kodi Civil duhet t’u japë përparësi dëmshpërblimeve jofinanciare”<sup>17</sup>. Dispozitat shpesh u shfuqizuan në vitin 2012. Ligji nr. 23/2012, datë 1.03.2012, solli ndryshime të gjera në ligjin shqiptar për shpifjen, përfshirë shfuqizimin e neneve 227 (“Fyerja e përfaqësuesve të vendeve të huaja”), 229 (“Vepra fyese ndaj himnit dhe flamurit”), 239 (“Fyerje për shkak të detyrës”), 240 (“Shpifje për shkak të detyrës”) dhe 241 (“Shpifje ndaj Presidentit të Republikës”). Në nëntor të vitit 2015, pas kritikave të brendshme dhe ndërkombëtare, qeveria shqiptare tërhoqi një projektligj që vendoste një dispozitë penale për shpifjen ndaj një zyrtari të lartë shtetëror ose një të zgjedhuri.

Në Shqipëri nuk ka legjislacion të posaçëm për trajtimin dezinformimit. Në

vitin 2018 qeveria ndërmoi një nismë për hartimin e një projektligji për shpifjen, që u jepte autoriteteve në vend mundësinë për të trajtuar problematikat mbi dezinformimin, për të cilat u jepte mekanizma rregullues, që nga kërkesa për heqjen e materialeve, vendosja e gjobave (në vlera të konsiderueshme monetare) dhe pezullimi i veprimtarisë. Projektligji u kontestua nga mediet, organizmat e pavarur dhe organizatat ndërkombëtare. Komisioni i Venecias në opinionin e tij për projektligjin kundër shpifjes shprehej: “Në interes të lirisë së shprehjes së medias dhe pluralizmit në Shqipëri, Komisioni i Venecias vlerëson se projektamendamentet nuk janë gati për miratim në formën e tyre aktuale. Ligji vuan nga paqartësia dhe ka të ngjarë të ketë një efekt ftohës, duke shtypur diskutimin e lirë dhe fjalën politike në sektorin shqiptar të internetit.”<sup>18</sup> Në vitin 2022 qeveria shqiptare e tërhoqi projektligjin.

Edhe Komisioni Europian në raportin e vitit 2023 për Shqipërinë rekomandoi që “të sigurojë zero tolerancë ndaj frikësimit dhe ndjekjeve efektive gjyqësore në rastet e sulmeve kundër gazetarëve, duke përfshirë edhe dekriminalizimin e plotë të shpifjes.”<sup>19</sup>

Në studimin e vitit 2022 “Liria e shprehjes” është marrë në shqyrtim se si pasqyrohet jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut nga gjykatat shqiptare, duke shqyrtuar mbi 200 vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Lartë për çështje të viteve 2016–2021. Studimi<sup>20</sup> ka vëzhguar ecurinë

e proceseve që lidhen me nenin 10 (“Liria e shprehjes”) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe rezulton se mediet dhe gazetarët përbëjnë 25% të rasteve kur ata janë paditës për shkelje të këtij neni<sup>21</sup>. Dorian Matlija, ndër autorët e studimit “Liria e shprehjes, përmbledhje 2022”, thekson se është e rëndësishme që shteti të mos përdorë mekanizmin penal te paditë e shpifjes. “Unë mendoj se gjuha e urrëfjes duhet të mbetet në Kodin Penal, ndërsa tejkalimi i lirisë së shprehjes duhet të jetë vetëm pjesë e dënimeve sipas Kodit Civil<sup>22</sup>”, – shprehet ai. Gjithashtu ai mendon se heqja dënimit për fyerjen dhe shpifjen në Kodin Penal është e rëndësishme edhe për prezencën e tyre në dëshminë e penalitetit. “Sado i vogël që të jetë dënimi penal, kur kërkon dëshminë e penalitetit, ai është i cilësuar dhe del në dokumentin që merret si dëshmi penaliteti. Dhe kjo është cilësuar edhe nga gjykata e Strasburgut si problem”, – nënvizon avokati D. Matlija.

### Përfundime

Nga analizat e mësipërme del se kriminalizimi i shpifjes e ngurtëson debatin për çështjet e interesit publik, se me kriminalizimi i shpifjes zakonisht abuzohet nga të fuqishmit për të limituar kritikizmin dhe se kriminalizimi ka efekt pengues, ngurtësues për lirinë e fjalës. Duke vlerësuar përvojat e vendeve të tjera, bazuar në këto përfundime, por dhe në intervistat me përfaqësues të medias dhe të shoqërisë civile në Shqipëri, rekomandojmë shfuqizimin e neneve 119 dhe 120 të Kodit Penal për

shpifjen dhe zëvendësimin e tyre me gjykime nga Kodi Civil. Ky rekomandim mbështetet edhe në rekomandimet e mëparshme të organizatës “Artikull 19”<sup>23</sup>, që mbron lirinë e shprehjes dhe të informacionit, si dhe në rekomandimet e raportit të komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2023<sup>24</sup>.

Kur diskutohet për dezinformimin, duhet të mbahet në vëmendje legjislativi dhe direktivat europiane, sidomos “European Media Freedom Act”, (EU) Regulation 2024/1083 e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Europës, miratuar në prill 2024, që vendos një kuadër të përbashkët për shërbimet e medias, EU Digital Service Act, si edhe “2022 Strengthened Code of Practice on Disinformation”. Analizat e mësipërme rekomandojnë që:

- i) vendimmarrja duhet të jetë e hapur dhe transparente;
- ii) palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të kontribuojnë gjatë gjithë procesit të hartimit të politikave dhe ligjëbërjes;
- iii) duhet të inkurajohet vetërregullimi në medie dhe bashkimi profesional i medieve në respektim të Kodit të Etikës;
- iv) fuqizimi i komunitetit të medieve faktkontrolluese sipas orientimit të Kodit Praktikës mbi Dezinformimin 2022<sup>25</sup>, bashkëpunimit dhe mbështetjes së aktiviteteve të medieve faktkontrolluese për trajtimin e dezinformimit;
- v) të ngrihet niveli i edukimit mediatic të publikut.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Defamation laws and SLAPPs increasingly “misused” to curtail freedom of expression (dhjetor 2022–prill 2023).

<https://www.unesco.org/en/articles/defamation-laws-and-slapps-increasingly-misused-curtail-freedom-expression>

Informacion mbi paditë SLAPP do të jepet më i gjerë në kapitullin 3.

<sup>11</sup> “General comment No. 34”, U.N. Human Rights Committee, 102nd session, published 12 September 2011. <https://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/comments.htm>

<sup>12</sup> “General comment No. 34”, U.N. Human Rights Committee, 102nd session, published 12 September 2011.

<sup>13</sup> Defamation and Insult Laws in the OSCE Region: A Comparative Study (2017).

<https://www.osce.org/fom/303181>

<sup>14</sup> Griffen, S. And Trionfi, B., Defamation and lawsuit in OECD region: Acomarativ study (2017), Study by the Office of the Representative on Freedom of the Media of the Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE). Albania | Defamation Laws (freemedia.at)

<sup>15</sup> <https://www.article19.org/>

<sup>16</sup> Artikulli 19”, Londër (shtator 2004), “Memorandum për ligjin shqiptar për shpifjen. Me kërkesë të përfaqësuesit të Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë për lirinë e medias” <https://www.osce.org/files/f/documents/1/a/29582.pdf>

<sup>17</sup> Po aty.

<sup>18</sup> European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) (2020) Albania Opinion on Draft Amendments to

Law N°97/2013 On The Audiovisual Media Service.

<sup>19</sup> Raporti i Komisionit Europian për vitin 2023. [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en)

<sup>20</sup> Dule, I., Alexandridis, Th., Matlija, D. (2022), studim, “Liria e shprehjes”, përmbledhje 2022.

<sup>21</sup> Po aty

<sup>22</sup> Intervistë me avokatin Dorian Matlija, 4 qershor 2024.

<sup>23</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/1/a/29582.pdf>

<sup>24</sup> <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/8181fd61-7eee-11ee-99ba-01aa75ed71a1/language-en>

<sup>25</sup> (<https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/2022-strengthened-code-practice-disinformation>)

# Depistimi i HPV-së dhe roli i ndërgjegjësimit në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës



Kanceri i qafës së mitrës, i shkaktuar nga virusi i papillomës njerëzore, mbetet një sfidë shëndetësore serioze në Shqipëri, pasi ka një numër të madh rastesh të diagnostikuara çdo vit. Kjo sfidë është e tillë në shumë vende të botës dhe vitet e fundit po i kushtohet një rëndësi e veçantë për shkak të shtimit të rasteve të këtij kanceri.

Depistimi<sup>1</sup> për praninë e virusit të papillomës humane (HPV) ka një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe zvogëlimin e këtij kërcënimi të shëndetit publik. Ky punim synon të shqyrtojë aktualitetin e depistimit për HPV-në dhe ndërgjegjësimin e popullsisë shqiptare për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Në Shqipëri ndërgjegjësimi për rrezikun e kancerit të qafës së mitrës dhe programet e depistimit janë në zhvillim, por sfidat mbeten të dukshme. Faktorë si mungesa e informacionit, vështirësitë ekonomike dhe shkalla e ulët e ndërgjegjësimit rreth rrezikut të HPV-së dhe kancerit të qafës së mitrës përbëjnë sfida të mëdha në këtë fushë.

Studimet aktuale tregojnë se krahas përmirësimit të shërbimeve shëndetësore është i nevojshëm përfundimi i programeve për depistimin dhe trajtimin e HPV-së si dhe përdorimi i strategjive të ndryshme të ndërgjegjësimit dhe të edukimit të publikut. Gjetjet e ndryshme tregojnë se një punë më e madhe në drejtim të edukimit të popullsisë, përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore dhe përdorimi i teknologjive të reja për depistimin dhe monitorimin e HPV-së mund të ndikojnë në zvogëlimin e incidencës<sup>2</sup> së kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri.

Pa dyshim që na duhet të kuptojmë më mirë sfidat që hasen në këtë fushë, nevojat e programit të depistimit të HPV-së e të ndërgjegjësimit për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, si dhe të ofrojmë rekomandime për politikën shëndetësore dhe praktikën e mira në këtë fushë. Në këtë sfidë është e rëndësishme të përfshihen të gjithë aktorët kryesorë: ata të fushës së arsimit, të shëndetësisë, të kujdesit social si dhe politikëbërësit për të ofruar alternativat më të mira për përbalimin e këtij kërcënimi për shëndetin e gruas dhe të vajzave.



Dr. Elona GJEBREA (HOXHA)  
Universiteti "New York",  
Departamenti i psikologjisë, Tiranë  
Drejtoreshë e Qendrës për Popullsinë  
dhe Zhvillimin

## Hyrje

Çdo vit në botë ka më shumë se 570 mijë raste të reja të kancerit të qafës së mitrës dhe 311 mijë vdekje nga kjo sëmundje. Parashikohet që deri në vitin 2030<sup>3</sup> këto shifra të arrijnë në më shumë se 700 mijë raste të reja dhe mbi 400 mijë vdekje në vit. Shumica e rasteve të reja dhe vdekjeve ndodhin te gratë e pafavorizuara, që jetojnë në vende me të ardhura të ulëta, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, të cilave u mungojnë programet efektive të parandalimit të kancerit të qafës së mitrës, që janë të zakonshme në vendet me të ardhura të larta<sup>4</sup>.

Në Shqipëri, ashtu si në shumë vende të botës, kanceri përbën një problem, pasi numri i rasteve të reja është në rritje, çka tregon se lypset të trajtohet me një qasje të Shëndetit Publik. Ndërkohë që rritet numri i viktimave nga kanceri, sistemi shëndetësor ndeshet me nevojën për të siguruar bama të efektshme dhe pajisje të teknologjisë së fundit.

Virusi i papillomës njerëzore ose

humane (HPV) është përgjegjës për kancerin e qafës së mitrës, i pari tumor i njohur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si tumor krejtësisht me prejardhje nga një infeksion. HPV-ja është një virus i zakonshëm infektues, i cili mund të shkaktojë disa lloje kanceri dhe sëmundje të tjera, si p.sh. lythas. Ka mbi 100 lloje të virusëve HPV, por vetëm një numër i vogël i tyre shkakton kancer. Ekzistojnë 1200 lloje të ndryshme nga këndvështrimi gjenetik (gjenotipa) të virusit HPV, i aftë të infekttojë njeriun, një e treta e tyre janë të lidhur me sëmundjet (patologjike) të pjesës anogjenitale, qoftë beninje, qoftë dhe malinje. Nga këta gjenotipa tipi 16 është përgjegjës për gati 50% të rasteve të kancerit në qafën e mitrës, tipi 18 është përgjegjës për 20% të rasteve dhe pjesa tjetër për 30% të rasteve. Gjenotipat 6 dhe 11 janë përgjegjës për lythas gjenitalë.

HPV-ja është një infeksion mjaft i zakonshëm si te femrat, ashtu dhe meshkujt, por nuk shfaqet në fëmijëri. Ai shfaqet me rritjen e moshës dhe largohet vetvetiu. Në shumicën e njerëzve të infektuar me HPV virusi nuk shkakton shenja, por infeksioni i vazhdueshëm me nëntipat kancerogjenë të HPV-së mund të shkaktojë disa lloje kanceri, ku më i shpeshti është ai i qafës së mitrës te femrat dhe kanceri i fytyrës.

Virusi i papillomës humane përhapet sidomos nëpërmjet kontaktit seksual. Për të transmetuar këtë infeksion është i mjaftueshëm një kontakti thjeshtë në zonën gjenitale (edhe marrëdhënie seksuale jo e plotë). Prania e mbartësve të shëndoshë është shumë e përhapur në shoqëri. Në përgjithësi qoftë burri, qoftë gruaja nuk paraqesin shenja të dukshme të infeksionit, edhe pse mund të ketë arritur në atë gradë që ata e ta transmetojnë virusin. Profilaktikët

(prezervativët) duhet të përdoren gjithmonë për parandalimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, por nuk garantojnë mbrojtje të plotë kundrejt virusit HPV.

Në HPV Prevention Policy Atlas 2023<sup>5</sup>, apo Atlasi për Parandalimin e HPV-së, që mbështetet nga Forumi Parlamentar Europian (EPF), i cili analizon se si funksionojnë autoritetet publike europiane

lartë.

Asambleja Botërore e Shëndetësisë në maj 2020 miratoi *Strategjinë globale për përshpejtimin e eliminimit të kancerit të qafës së mitrës si problem i shëndetit publik*, me synimin që të gjitha vendet të arrijnë një normë incidence nën 4 për 100 mijë<sup>7</sup> gra. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) përcaktoi hapat<sup>8</sup> që nevojiten për

**Kanceri i qafës së mitrës mund të zbulohet herët, që do të thotë se në parim është gjithashtu i parandalueshëm, por, fatkeqësisht, shpesh diagnostikohet në fazën e fundit, kur është bërë i pashërueshëm.**

në tri fusha kryesore: i) *parandalimi parësor*; ii) *parandalimi dytësor* (shqyrtimi); dhe iii) *informacioni në internet*, Shqipëria renditet me indeksin 38,8% në shkallën e renditjes me 48 vendeve të tjera europiane. Atlasi synon të ofrojë informacione të përditësuara të disponueshme publikisht në të gjitha vendet e rajonit europian të OBSH-së në përputhje me *strategjinë e OBSH-së për eliminimin e kancerit të qafës së mitrës* dhe planin e Europës për të mposhtur kancerin. Në bazë të të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, kanceri është shkaku kryesor i vdekshmërisë në vend pas sëmundjeve kardiovaskulare<sup>6</sup>. Ekzistojnë metoda të provuara dhe me kosto efektive për eliminimin e kancerit të qafës së mitrës, por ende nuk janë zbatuar gjerësisht në vendet ku barra e sëmundjes është më e

të arritur këtë synim, të cilët janë:

- i) parandalimi parësor nëpërmjet vaksinimit;
- ii) parandalimi dytësor nëpërmjet depistimit (kontrollit) të qafës së mitrës dhe trajtimit të lezioneve prekanceroze;
- iii) trajtimi dhe kujdesi paliativ për kancerin invaziv të qafës së mitrës.

Krahasuar me Europën Perëndimore numri i rasteve të reja dhe vdekjeve nga kanceri i qafës së mitrës është gati 10 herë më i madh në rajonin e Europës Lindore dhe në Azinë Qendrore dhe përbën shkakun e dytë më të zakonshëm të vdekjes së grave nga kanceri në moshë riprodhuese. Ka prova të qarta se shkaqet e niveleve më të larta të incidencës dhe vdekshmërisë që shihen aktualisht në rajon janë:

<sup>1</sup> Testimi i një personi ose i grupi njerëzish për praninë e një sëmundjeje apo të gjendjeve të ngjashme.

<sup>2</sup> Numri i rasteve të reja në një periudhë të caktuar në një numër të caktuar njerëzish. Ky informacion merret nga regjistrat e kancerëve dhe mund të shprehet në vlerë absolute për një vit ose në formën e një shkallë për 100 mijë persona në vit.

<sup>3</sup> IARC, Vlerësimet e Observatorit Global të Kancerit (GLOBOCAN) 2018. Marrë nga: <http://gco.iarc.fr/>.

<sup>4</sup> Bray, F., Ferlay, J., Soerjomataram I etj.

Statistikat globale të kancerit 2018: Vlerësimet e GLOBOCAN të incidencës dhe vdekshmërisë në mbarë botën për 36 kancere në 185 vende. CA Cancer J. Clin. 2018; 68 (6): 394-424.

<sup>5</sup> HPV Prevention Policy Atlas 2023, [https://www.epfweb.org/sites/default/files/2024-01/HPV%20Atlas\\_EN%202024-JAN25.pdf](https://www.epfweb.org/sites/default/files/2024-01/HPV%20Atlas_EN%202024-JAN25.pdf).

<sup>6</sup> Programi Kombëtar për Kontrollin e Kancerit, Ministria e Shëndetësisë, [https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Programi\\_Kombetar](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Programi_Kombetar)

[\\_per\\_Kontrollin\\_e\\_Kancerit.pdf](#)

<sup>7</sup> Asambleja Botërore e Shëndetësisë miraton strategjinë globale për përshpejtimin e eliminimit të kancerit të qafës së mitrës. [www.who.int/news-room/detail/19-08-2020-world-health-assembly-adopts-global-strategy-to-accelerate-cervical-cancer-elimination](http://www.who.int/news-room/detail/19-08-2020-world-health-assembly-adopts-global-strategy-to-accelerate-cervical-cancer-elimination)

<sup>8</sup> Strategjia globale për përshpejtimin e eliminimit të kancerit të qafës së mitrës si një problem i shëndetit publik. Gjenevë: Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020 [www.who.int/publications/i/item/9789240014107](http://www.who.int/publications/i/item/9789240014107)

- i) mungesa e programeve efektive të depistimit (kontrollit) të qafës së mitrës<sup>9</sup>;
- ii) mungesa e programeve të përhapura të vaksinimit kundër HPV-së;
- iii) mungesa e trajtimit të aksesueshëm dhe me cilësi të lartë të kancerit të qafës së mitrës.

Kanceri, kjo sëmundje e shekullit, tashmë është një problem serioz në vend, përgjegjës për 17% të të gjitha vdekjeve, duke u bërë kështu një barrë në rritje për sistemin e kujdesit shëndetësor në vendin tonë<sup>10</sup>. Kanceri i qafës së mitrës mund të zbulohet herët, që do të thotë se në parim është gjithashtu i parandalueshëm, por, fatkeqësisht, shpesh diagnostikohet në fazën e fundit, kur është bërë i pashërueshëm.

### Programi Kombëtar i Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës

*Programi Kombëtar i Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës* bazohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 30.01.2019 dhe përdor si ekzaminim primar testimin për HPV me risk të lartë. Programi fillestar teston gratë e moshës 40–50-vjeçare. Synimi është që brenda pesë vjetësh të gjitha gratë e kësaj grupmoshe të mund të bëjnë një test për virusin e papillomës humane (HPV) me rrezik të lartë, si pjesë e ekzaminimeve rutinë të bëra në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor (KSHP).

Mbi bazën e komizës teknike të *Programit Kombëtar i Depistimit*, çdo mjek i qendrës shëndetësore u sugjeron grave që kanë dalë pozitive në testin për HPV të bëjnë një kolposkopi diagnostike te një gjinekolog i kualifikuar dhe, kur është e nevojshme, edhe një citologji ose biopsi.

*Programi i Kombëtar i Depistimit* përmirëson identifikimin e grave që janë më të rrezikuara për t'u prekur nga kanceri i qafës së mitrës, zbulon në kohë të mërkurës parakanceroze, trajtimin e tyre dhe parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Të gjitha testet e depistimit primar dhe ekzaminimet e mëtejshme sigurohen falas në pikën e kujdesit shëndetësor, pavarësisht nga statusi i sigurimit shëndetësor të pacienteve.

“*Programi kombëtar i depistimit të kancerit të qafës së mitrës*” është në përputhje me një numër politikash shëndetësore kombëtare, përfshirë “*Programin kombëtar të kancerit*”, “*Planin e kontrollit të sëmundjeve jo të transmetueshme*”,

“*Strategjinë e shëndetit riprodhues*” dhe “*Strategjinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor*”. Ai është gjithashtu në përputhje me dokumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë.

Programi filloi të ndërtohej gjatë periudhës shkurt–qershor 2019. Në nivel rajonal koordinatorët e përzgjedhur prej njësite vendore të kujdesit shëndetësor janë përgjegjës për koordinimin dhe menaxhimin lokal, marrjen e kiteve të testimit nga ISHP-ja dhe shpërndarjen e tyre në çdo qendër shëndetësore, mbledhjen e mostrave vaginale (skedave) për t'i dërguar në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP) për ekzaminim laboratorik dhe shpërndarjen e rezultateve laboratorike në qendrat shëndetësore. Në Laboratorin e Biologjisë Molekulare (IPH) të gjitha mostrat vaginale të mbledhura testohen dhe përgjigjet nominale shpërndahen te mjekët e familjeve me ndihmën e njësite vendore të kujdesit shëndetësor.

Në qendrën shëndetësore drejtori dhe kryeinfermiera janë personat kryesorë për programin. Ata kujdesen për koordinimin e aktiviteteve, duke filluar nga ftesa e grave, sigurimin e vazhdimet të aktiviteteve të parashikuara nga programi i depistimit. Në disa zona urbane, si p.sh. në Tiranë, gjinekologët e qendrës së gruas kanë qenë shumë të rëndësishëm për programin. Gjinekologët të kualifikuar në spitalet universitare të Tiranës dhe në disa spitale rajonale kanë ofruar kujdes të specializuar klinik për diagnozën dhe trajtimin e parakancerit.

Është e nevojshme që ky program të njihet sa më shumë në nivel kombëtar qoftë nga personeli shëndetësor, qoftë nga popullata në përgjithësi.

### Tregues të performancës së programit të depistimit

Prevalenca e përgjithshme e HPV-së me risk të lartë midis pjesëmarrëseve në program deri në vitin 2019 ishte 6,6% dhe ishte më e lartë te gratë e zonave urbane dhe tek ato me arsim të lartë, të punësuara dhe të pamartuara. Gratë e klasave më të ulëta socio-ekonomike dhe ato të zonave rurale, ndërsa kanë dëshmuar një prevalencë më të ulët të infeksionit HPV, të tërhequra nga aksesimi shumë i lehtë dhe kostot e papërfillshme, kanë qenë më të prirura për të përdorur Programin Kombëtar të Depistimit.

Në vitin e parë të programit u bë vlerësimi i cilësisë së shërbimit në një kampion grash që rezultuan pozitive në testin e HPV-së. Koha mesatare nga testi primar i depistimit deri në marrjen e rezultatit ka qenë rreth 25 ditë. 96% e grave i morën rezultatet e tyre brenda afatit të premtuar të programit prej dy muajsh. 90% e grave shkuan për të marrë rezultatit brenda 7 ditëve nga dita e kontaktimit. Të gjitha gratë që rezultuan pozitive shkuan në qendrën shëndetësore për të marrë rezultatit e testit dhe 87% e tyre raportuan shqetësime të rëndësishme emocionale lidhur me rezultatit pozitiv. Rreth 70% e grave që rezultuan pozitive në testin e HPV-së shkuan për vizitë kolposkopie *follow up* dhe 20% planifikojnë që, sapo të mundën, të shkojnë në spital për një vizitë sipas rekomandimit. Koha mesatare nga marrja e rezultatit të testit deri në vizitën gjinekologjike për gratë pozitive ishte vetëm 6 ditë. Shumica kanë bërë kolposkopinë në spitalet universitare gjinekologjike të Tiranës, por rreth 10% e grave që kanë rezultuar pozitive në depistimin primar hezitojnë të shkojnë në spital për ndjekje të mëtejshme.

Programi i depistimit duhet të mbajë në minimum të gjitha shpenzimet nga xhepi. Vendimi i qeverisë shqiptare mbi të cilin mbështetet programi përcaktoi se të gjitha shërbimet që lidhen me depistimin primar dhe vizitat në vijim të tij në sektorin publik janë falas në pikën e kujdesit shëndetësor. Personeli shëndetësor është trajnuar për të informuar gratë për këtë, në mënyrë që të minimizojë të gjitha shpenzimet personale të evitueshme, megjithatë më shumë se një në tri gra që kanë bërë kolposkopi kanë zgjedhur kujdesin shëndetësor privat për këtë, ndërsa 8% e tyre kanë shkuar jashtë vendit për ekzaminimet e rekomanduara, zakonisht në Greqi dhe Itali. Rezulton se gratë me arsim universitar janë më të prirura të shkojnë për një vizitë gjinekologjike në një institucion privat, kryesisht jashtë vendit.

Rreth 4% e grave që kanë rezultuar pozitive në depistimin primar u diagnostikuan me faza të ndryshme të parakancerit. Frekuenca e parakancerit ose e kancerit raportuar nga gratë e intervistuar ishte e ngjashme me frekuencën e identifikuar në regjistrat klinikë në Spitalin Universitar të Tiranës.

Rreth 9 në 10 gra e vlerësuan shërbimin e përgjithshëm në kujdesin shëndetësor

parësor si dhe në kujdesin e specializuar “të mirë” ose “shumë të mirë”. Vetëm 10% e grave e konsideruan atë “mesatar” ose “të keq”.

### **Nevoja e një regjistri të kolposkopisë në kuadër të programit të depistimit**

Programi Kombëtar i Depistimit të

Instituti i Shëndetit Publik ka filluar bashkëpunimin me spitalet gjinekologjike universitare në Tiranë, që është konkretizuar në dy marrëveshje bashkëpunimi në fushën e programit të depistimit të kancerit të qafës së mitrës. Pra, janë hedhur bazat e një regjistri të veçantë të kolposkopisë, që do të funksionojë krahas regjistrit të depistimit primar të programit. Synohet që

Ndërkohë që gjithmonë e më shumë gra po i nënshtrohen shërbimit të depistimit, është e domosdoshme të vazhdojnë përpjekjet për forcimin e kapaciteteve për diagnostikimin më të mirë dhe trajtimin e lezioneve parakanceroze, në mënyrë që gratë të kenë mundësi për vizita të specializuara, për kolposkopi dhe biopsi. Të gjitha gratë e identifikuar me sëmundje të qafës së mitrës nga programi i depistimit duhet të marrin trajtim dhe kujdes shëndetësor spitalor me cilësi të lartë dhe me kosto të papërfillshme.

Në vitin e dytë të programit u bë vlerësimi i kapaciteteve dhe përvojës në shërbimin e kolposkopisë pranë spitaleve rajonale, prej nga rezultojnë se vetëm një pjesë e vogël e klinikave të gjinekologjisë në spitalet publike kanë mundur të bëjnë ekzaminime kolposkopike për gratë që kanë rezultuar pozitive në depistimin primar në kuadër të programit. Shumica e rasteve janë ndjekur në klinikat e spitaleve gjinekologjike universitare në Tiranë. Në disa raste, megjithëse ekziston personeli me përvojë dhe gjithë infrastruktura e përshtatshme, në spitalet rajonale numri i ekzaminimeve kolposkopike gjatë një viti ka qenë shumë i vogël. Është e nevojshme që të sigurohet një balancë mes afimit të shërbimit sa më pranë grave të infektuara me HPV dhe garantimit të volumit të nevojshëm të ekzaminimeve për gjinekologët për të ruajtur ekspertizën dhe cilësinë e shërbimit. Gjithashtu është e nevojshme të përcaktohen standardet e shërbimit dhe protokollet e referimit për kolposkopinë në klinikat gjinekologjike në spitalet publike dhe private. Këto standarde duhet të përfshijnë:

- i) personelin e specializuar për vizitat e nevojshme kolposkopike në vit;
- ii) infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme për ekzaminimin kolposkopik dhe trajtimin e lezioneve parakanceroze;

<sup>9</sup> Bray, F., Ferlay, J., Soerjomataram, I etj., *Statistikat globale të kancerit 2018: Vlerësimet e GLOBOCAN të incidencës dhe vdekshmërisë në mbarë botën për 36 kancere në 185 vende*. CA Cancer J. Clin. 2018; 68 (6): 394-424.

<sup>10</sup> Programi Kombëtar për Kontrollin e Kancerit, Ministria e Shëndetësisë, [https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Programi\\_Kombetar\\_per\\_Kontrollin\\_e\\_Kancerit.pdf](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Programi_Kombetar_per_Kontrollin_e_Kancerit.pdf)

**Programi Kombëtar i Depistimit përmirëson identifikimin e grave që janë më të rrezikuara për t'u prekur nga kanceri i qafës së mitrës, zbulon në kohë dëmtimet parakanceroze, trajtimin e tyre dhe parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Të gjitha testet e depistimit primar dhe ekzaminimet e mëtejshme sigurohen falas në pikën e kujdesit shëndetësor, pavarësisht nga statusi i sigurimit shëndetësor të pacienteve.**

Kancerit të Qafës së Mitrës ka një regjister të depistimit primar dhe për çdo grua të testuar për HPV qendrat shëndetësore plotësojnë një skedë të thjeshtë. Skedat grumbullohen në ISHIP dhe informacioni analizohet në mënyrë periodike.

Ndërkohë informacioni i detajuar mbi ndjekjen e rasteve pozitive në shërbimin spitalor mungon. Gjurmimi i rasteve të veçanta nëpërmjet emrave apo ID-së në të gjitha spitalet rajonale dhe në spitalet universitare është shumë i vështirë dhe mund të bëhet vetëm në kampione të veçanta në studime të dedikuara, që kërkojnë kohë dhe burime njerëzore. Nga mbi 40 mijë gra të testuara në depistimin primar vlerësohet të jenë identifikuar mbi 2000 gra të infektuara me HPV. Ndjekja e specializuar në kohë e këtij grupi të shëndetshëm në princip, por me risk të lartë për të zhvilluar kancer të qafës së mitrës, është i rëndësishëm për suksesin afatgjatë të programit. Është e nevojshme që të ndërtohet një sistem informacioni i bazuar te rasti (*case based surveillance*) për gratë që kanë rezultuar pozitive në depistimin primar dhe vijojnë vizitën gjinekologjike.

bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit mes ISHIP-së dhe spitaleve gjinekologjike të bëhet në vijimësi dhe në mënyrë sistematike. Është e nevojshme që shkëmbimi i informacionit të shtrihet edhe me spitalet rajonale, që bëjnë ndjekjen gjinekologjike afatgjatë të grave që rezultojnë pozitive në depistimin primar. Nevojitet që ky bashkëpunim të shtrihet më tej dhe me qendrat që i ofrojnë këto shërbime.

Regjistri i kolposkopisë do të ndihmojë për të ndjekur në mënyrë sistematike gratë e diagnostikara me parakancer dhe kancer si dhe trajtimin e tyre. Gjithashtu do të ndihmojë në përlllogaritjen e disa treguesve të rëndësishëm të programit, si p.sh. përqindja e rasteve të grave pozitive që janë ndjekur nga specialisti gjinekolog me kolposkopi, numri i parakancereve të diagnostikuara dhe të trajtuara në kohë në kuadër të programit.

### **Nevoja për miratimin e standardeve të shërbimit dhe protokolleve të referimit për kolposkopinë në klinikat gjinekologjike pranë spitaleve rajonale**

iii) laboratorin e përshtatshëm të citohistopatologjisë për mostrat citologjike vaginale.

Spitalet e përzgjedhura si qendra për kolposkopinë dhe të gjitha spitalet e tjera rajonale do të përfitonin nga rishikimi i udhërrëfyesve kombëtarë mbi rolin e spitaleve rajonale në trajtimin e parakancereve dhe kancereve si dhe sistemin e referimit në këtë fushë.

Nevojiten mbështetja e edukimit mjekësor të vazhdueshëm dhe ngritja e rrjeteve profesionale kombëtare të shkëmbimit të përvojave mbi kolposkopinë. Gjithashtu nevojitet përditësimi i hartës së klinikave të kolposkopisë që plotësojnë standardet e cilësisë, të personelit e të pajisjeve si dhe numrin e vizitave të bëra. Klinikat pranë spitaleve rajonale do të shërbejnë si qendra referimi dhe për ndjekjen afatgjatë të programit. Në terma më afatgjatë harta duhet adaptuar në përputhje me ndryshimin e kapaciteteve rajonale dhe vlerësimin e nevojave.

Për të përmirësuar performancën dhe cilësinë e shërbimeve të kolposkopisë në spitalet rajonale nevojitet rekomandimi i qartë nga mjekët e familjes për të përdorur shërbimet publike të spitalit që mbulon territorin e tyre. Kjo do të shmangte kostot e panevojshme për gratë që do të shkonin në shërbime private apo në Tiranë. Gjithashtu përdorimi i klinikave gjinekologjike në spitalet publike rajonale do të rriste numrin e vizitave dhe do të sillte përmirësimin e vazhdueshëm profesional në kolposkopi të mjekëve socialistë.

Koncesioni i laboratorëve spitalorë përfshin edhe citologjinë dhe histologjinë patologjike. Nevojitet një udhëzim për përjashtimin nga kostot e anatomisë patologjike të të gjitha grave të identifikuar pozitive nga programi dhe që bëjnë kolposkopinë. Pritet që fillimi i modelit të ri të shërbimit laboratorik pranë spitaleve të zgjidhë problemin e mungesës së diagnozës anatomopatologjike. Nevojitet një informim më i mirë i grave të infektuara me HPV mbi mënyrën e funksionimit të programit, shërbimet e nevojshme dhe ato që nuk janë të nevojshme. Nevojitet gjithashtu caktimi i infermiereve për mbështetjen afatgjatë të grave të identifikuar pozitive në hallkat e sistemit.

## Depistimi i HPV-së për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës

Depistimi i papillomavirusit human në Shqipëri realizohet përmes disa metodave dhe programeve të organizuara nga autoritetet shëndetësore vendore. Kryesisht ky proces përfshin testimin e përbashkët për HPV dhe përdorimin e teknologjive të avancuara për identifikimin e infeksioneve me HPV në popullatën femërore. Këto teste kryhen në qendrat shëndetësore, në klinikat private dhe në spitalet publike, duke siguruar kështu qasje të gjerë për popullsinë<sup>11</sup>. Për më tepër, në strategjinë e depistimit janë integruar programe të ndërgjegjësimit dhe edukimit, përfshirë fushat e informimit publik, sesione të edukimit në shkolla dhe qendra komunitare shëndetësore. Këto masa synojnë ndërgjegjësimin e popullsisë për rrezikun e HPV-së dhe të kancerit të qafës së mitrës, promovimin e tërësisë shëndetësore dhe parandalimin e sëmundjeve të lidhura me HPV-në në Shqipëri.

Zbulimi i lidhjes midis infeksionit të vazhdueshëm me një ose më shumë prej 12 llojeve të HPV-së me rrezik të lartë (hrHPV) dhe zhvillimi i kancerit të qafës së mitrës ka çuar në zhvillimin e testeve të depistimit të hrHPV-së, që janë më të ndjeshme, më pak subjektive dhe më të lehta për t'u zbatuar në mjedise me burime të kufizuara<sup>12</sup>. Gjatë dy dekadave të fundit studime të shumta kanë treguar se testimi i hrHPV-së është superior ndaj citologjisë së qafës së mitrës për depistimin primar si në vendet me të ardhura të larta, ashtu dhe në ato me të ardhura të mesme dhe të ulëta<sup>13</sup>.

Si rezultat, shumica e udhëzimeve ndërkombëtare, përfshirë "*Strategjinë globale*" të OBSH-së, tani rekomandojnë testin e hrHPV-së si testin e preferuar të depistimit të qafës së mitrës për vendet me të ardhura të ulëta, të mesme dhe të larta. Një numër vendesh e kanë zbatuar tashmë këtë për programet kombëtare dhe rajonale, përfshirë dhe Shqipërinë.

Vaksinimi kundër tipave të rrezikshëm të virusit të papillomës njetëzore (HPV), që janë shkaktarë për shumicën e rasteve të kancerit të qafës së mitrës, është i sigurt dhe efikas. Nga nisja e programit të depistimit të kancerit të qafës së mitrës në vitin 2019 në Shqipëri janë depistuar mbi 31 mijë gra. Rreth

4% e tyre kanë rezultuar pozitive në testin depistues falas dhe më pas janë diagnostikuar dhe trajtuar në kohë. Çdo vit në vendin tonë diagnostikohen rreth 130 raste të reja me kancer të qafës së mitrës<sup>14</sup>. Nëpërmjet testimit dhe identifikimit në kohë të problematikave kanceri i qafës së mitrës mund të parandalohet, çka do të thotë të shpëtojmë jetë.

Në praktikën aktuale të shëndetit publik testet e papillomavirusit human me rrezik të lartë (hrHPV) janë rekomanduar si një metodë efektive për depistimin primar të kancerit të qafës së mitrës, për shkak se kanë dhënë rezultate në identifikimin e infeksioneve aktive me HPV, që janë të lidhura me zhvillimin e kancerit të qafës së mitrës. Kjo i bën ato një mjet të fuqishëm për zbulimin e përhapjes së virusit dhe identifikimin e grave me rrezik më të lartë për të zhvilluar kancer. Testet e hrHPV-së kanë treguar gjithashtu një nivel të lartë të saktësisë në krahasim me metoda të tjera të depistimit. Për shkak të teknologjisë së avancuar që përdoret në këto teste, ato ofrojnë rezultate të qarta dhe të besueshme. Testet e hrHPV-së janë relativisht të shpejta dhe efikase, pasi ofrojnë mundësi për një depistim të hershëm dhe intervenim efektiv. Në krahasim me paptestet tradicionale, testet e hrHPV-së mund të jenë më efikase nga pikëpamja e kohës dhe kostos. Duke identifikuar infeksionet me HPV që janë potencialisht kancerogjene në një fazë të hershme, testet e hrHPV-së ofrojnë një mundësi për të ndërthyrë në mënyrë efektive dhe parandaluar zhvillimin e kancerit të qafës së mitrës në fazën e përparuar. Për këto arsye testet e hrHPV-së rekomandohen për depistimin primar të kancerit të qafës së mitrës dhe janë pjesë e shumë programeve të depistimit në shumë vende, përfshirë dhe Shqipërinë.

## Metodat për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri

Ka disa metoda për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, që në Shqipëri zbatohen bashkë me promovimin e vazhdueshëm për të zvogëluar incidencën dhe përhapjen e kësaj sëmundjeje, nga të cilat veçojmë:

1. Programi i vaksinimit kundër papillomavirusit human (HPV), i zbatuar nga

Ministria e Shëndetësisë që nga viti 2023 dhe që është përfshirë në kalendarin kombëtar të vaksinimit falas për të gjitha vajzat e moshës së paraadoleshencës<sup>15</sup>, është një nga metodat më efektive për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Programi i depistimit të kancerit të qafës së mitrës përdor teste të ndryshme për të identifikuar infeksionet me HPV dhe për të zbuluar ndryshimet e hershme që mund të shfaqen në qelizat e qafës së mitrës. Këto teste përfshijnë paptestin (*pap smear*) dhe testin e HPV-së me rrezik të lartë (hr-HPV).

2. *Ndërgjegjësimi i publikut për faktorët që shkaktojnë kancerin e qafës së mitrës*, për rëndësinë e skenarit dhe vaksinimit kundër HPV-së është një komponent i rëndësishëm për parandalimin e këtij kanceri. Fushatat informuese dhe veprimtaritë edukative promovojnë ndërgjegjësimin, sjellin në vëmendje rrezikun e kancerit të qafës së mitrës dhe shtojnë përpjekjet për parandalimin e tij.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (*United Nations Population Fund – UNFPA*)<sup>16</sup>, Federata Ndërkombëtare e Planifikimit Familjar (*International Planned Parenthood Federation – IPPF*)<sup>17</sup>, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)<sup>18</sup> në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik prej vitesh kanë mbështetur fushatat kombëtare ndërgjegjëse në këtë fushë, ku theksi është vënë te nevoja e kontrolleve periodike të grave përmes paptestit dhe te vaksinimi i vajzave të reja, si pjesë e vaksinave të kalendarit kombëtar

të vaksinimit falas<sup>19</sup>. Së fundi Grupi Parlamentar Vullnetar për Popullsinë dhe Zhvillimin, i knjuar me deputete të Kuvendit të Shqipërisë, është angazhuar në disa vizita ndërgjegjësimi në këtë fushë në disa qytete të Shqipërisë.

3. *Kontrolli i rregullt shëndetësori* grave dhe vajzave përmban edhe kontrollin e qafës së mitrës dhe testin e HPV-së për të identifikuar ndonjë ndryshim qelizor ose infeksion me HPV, që mund të ketë nevojë për trajtim të hershëm.

Këto metoda parandaluese përqendrohen në identifikimin e hershëm dhe trajtimin e faktorëve rrezikues për kancerin e qafës së mitrës dhe promovimin e sjelljeve shëndetësore të rëndësishme për të reduktuar rrezikun e kancerit dhe për të mbrojtur shëndetin e grave në Shqipëri.

### **Përvoja ndërkombëtare në depistimin dhe ndërgjegjësimin për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri**

Përvoja ndërkombëtare ka treguar se programet e vaksinimit kundër HPV-së për të parandaluar kancerin e qafës së mitrës kanë pasur sukses. Për shembull, Australia ka zbatuar një program të suksesshëm të vaksinimit kundër HPV-së. Sipas një studimi të publikuar në revistën “*The Lancet*”, zbatimi i këtij programi ka pakësuar dukshëm infeksionet me HPV dhe rastet e kancerit të qafës së mitrës<sup>20</sup>.

Shembujt nga vendet e tjera tregojnë

se ndërgjegjësimi i popullsisë për rrezikun e kancerit të qafës së mitrës dhe për rëndësinë e testimit të HPV-së është i rëndësishëm për suksesin e programit. Fushatat informuese dhe veprimtaritë edukative në shkolla dhe në komunitet janë efektive në ndërgjegjësimin dhe promovimin e sjelljeve shëndetësore të rëndësishme<sup>21</sup>.

Vendet që kanë zbatuar programe efektive të skanimit dhe testimit të HPV-së për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës kanë pasur një zvogëlim të incidencës së kancerit. Për shembull, programi “PAP” në Zelandën e Re dhe programi “HPV” në Mbretërinë e Bashkuar<sup>22</sup> janë shembuj të suksesshëm të programeve të skanimit dhe testimit, pasi kanë ndihmuar në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës.

Këta shembuj dëshmojnë përfitimet e programeve të vaksinimit, të ndërgjegjësimit të publikut dhe kontrollit të rregullt shëndetësor në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe Shqipëria mund të përfitojë nga përvoja dhe praktikat e ndërmarra në nivel ndërkombëtar për të përmirësuar situatën e saj shëndetësore në këtë drejtim.

### **“Atlasi i politikave për parandalimin e HPV-së” – një instrument i rëndësishëm për politika më të mira**

Forumi Parlamentar European për të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese (EPF)

<sup>11</sup> Instituti i Shëndetit Publik, <https://www.ishp.gov.al/cfare-eshte-programi-kombetar-i-depistimit-te-kancerit-te-qafes-se-mitres/>

<sup>12</sup> Tommasino, M., “Familja e papillomavirusëve njerëzore dhe roli i saj në kancerogjenezë”, *Semin. Cancer Biol.* 2014;26:13–21; Schiffman, M., Doorbar, J., Wentzensen, N., et al., “Infeksion kancerogjen nga papillomavirusi i njeriut”. *Nat Rev Dis Primers.* 2016, 2:16086.

<sup>13</sup> Programi kombëtar i depistimit të qafës së mitrës në Shqipëri. Raporti i vlerësimit i vitit të parë, 2020 <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/2report-evaluation-screening-program-final-2020.pdf>

<sup>14</sup> Test falas për depistimin e hershëm të kancerit të qafës së mitrës, të gjitha gratë e moshës 40–50-vjeçare të drejtohen pranë

qendrave shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë, <https://shendetesia.gov.al/manastirliu-test-falas-per-depistimin-e-hershem-te-kancerit-te-qafes-se-mitres-te-gjitha-grate-40-50-vjec-te-drejtohen-prane-qendrave-shendetesore/>

<sup>15</sup> *Vaksina HPV falas për të gjitha vajzat në moshën paraadoleshente*, Ministria e Shëndetësisë <https://shendetesia.gov.al/java-boterore-e-imunizimit-manastirliu-jep-lajmin-e-mire-vaksina-hpv-falas-per-te-gjitha-vajzat-nemoshen-paadoleshente/>

<sup>16</sup> <https://www.unfpa.org/resources/preparing-introduction-hpv-vaccines>

<sup>17</sup> <https://www.ippf.org/blogs/hpv-what-you-should-know>

<sup>18</sup> <https://acpd.org.al/?p=296>

<sup>19</sup> <https://www.ishp.gov.al/mbledhja-per-procesin-e-vaksinimit-per-hpv-dhe-ecurine-e-tij-6-mars-2024/>

tij-6-mars-2024/

<sup>20</sup> Garland, S. M., Brotherton, J. M. L., & Skinner, S.R. (2019), “Vaksinimi i adoleshentëve dhe të rinjve për HPV në Australi: arritje dhe sfida. Mjekësia parandaluese”, 126, 105. doi:10.1016/j.jpmed.2019.105

<sup>21</sup> Brotherton, J. M., & Kaldor, J. M. (2019), “Vaksinimi HPV: arritja e ëndrrës për parandalimin e sëmundjeve”, *The Lancet*, 394(10197), 209–210. doi:10.1016/s0140-6736(19)31699-1

<sup>22</sup> Dillner, J., Rebolj, M., Birembaut, P., Petry, K. U., Szarewski, A., Munk, C., Herdman, C. (2008), “Vlerat parashikuese afatgjata të citologjisë dhe testimit të papillomavirusit njerëzor në shqyrtimin e kancerit të qafës së mitrës”, studim i përbashkët european i grupit. *BMJ*, 337, a1754. doi:10.1136/bmj.a1754

është një organizatë ndërkombëtare që mbron çështjet e popullsisë dhe të zhvillimit, kryesisht përmes forcimit të kapacitete të parlamentarëve mes vendeve të ndryshme, përmes angazhimit të tyre në veprimtari ndërkombëtare dhe organizimit në nivel kombëtar, si p.sh. grupe parlamentare formale ose informale që janë njohës të këtyre çështjeve dhe kanë njohuri paraprake në këtë fushë. Ky forum gjithashtu përpilon atlase të ndryshme në fusha si HPV-ja, kontracesioni, HIV/AIDS etj.

Së fundi EPF-ja prezantoi edicionin e dytë të “Atlasit të politikave për parandalimin e HPV-it” për vitin 2023, ku zbuloi një situatë të pabarabartë të kancerit të qafës së mitrës në gjithë rajonin europian dhe punën e bërë në këtë drejtim. Vendet me performancë të lartë, si Danimarka, Suedia, Finlanda, Britania e Madhe dhe Irlanda, janë në kontrast me vendet e rangut më të ulët, si Kosova e më pas Azerbajxhani dhe Bosnjë-Hercegovina.

“Atlasi i politikave për parandalimin e HPV-së” është një studim shkencor i udhëhequr prej Forumit Parlamentar Europian për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe i mbështetur nga Organizata Europiane e Kancerit. Qëllimi i studimit është të vlerësojë performancën e autoriteteve publike europiane në parandalimin parësor, shqyrtimin dhe shpërndarjen e informacionit për HPV-në në internet. Atlasi synon të përputhet me strategjinë e OBSH-së për eliminimin e kancerit të qafës së mitrës dhe planin e Europës për të mposhtur kancerin.

Forumi Parlamentar Europian për të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese (EPF) dhe Organizata Europiane e Kancerit u bëjnë thirrje qeverive europiane që t’u japin përparësi iniciativave të vaksinimit dhe depistimit të përshkuara në planin europian kundër kancerit të qafës së mitrës.

“Atlasi i politikave për parandalimin e HPV-së” ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të politikave për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në 46 vende europiane. Ai shërben si një mjet për krahasimin e qasjeve të kombeve për parandalimin parësor nëpërmjet vaksinimit kundër HPV-së, parandalimit dytësor nëpërmjet programeve të shqyrtimit dhe ofrimit të informacionit shtetëror për HPV-në në internet.

Atlasi nuk pasqyron drejtpërdrejt normat e prevalencës së kancerit të qafës së mitrës

brenda vendeve që analizon, pasi objektivi i tij kryesor është të vendosë një pikë referimi për krahasimin e politikave, të edukojë aktorët kombëtarë dhe të stimulojë diskursin midis politikëbërësve.

Atlasi përdor metodën analitike të hierarkisë, e njohur si “procesi i hierarkisë analitike” (AHP) për të shënuar secilin vend sipas tri kriterëve kryesorë dhe katërmëdhjetë nënkritereve. Kjo metodë përfshin vendosjen e një qëllimi të përgjithshëm dhe më pas përcaktimin e tij në tituj hierarkikë, kriterë dhe nënkriterë të ngjashme me degët në një pemë. Çdo nënkriter merr një peshë të veçantë dhe në bazë të përgjigjeve caktohet një pikë përqindje. Rezultatet për çdo nënkriter përcaktojnë rezultatit e secilit vend, duke lehtësuar një vlerësim të nuancuar të peizazhit të politikave të tyre.

“Atlasi i politikave për parandalimin e HPV-së” për vitin 2023 është i organizuar në tri pjesë të dallueshme:

1. Parandalimi primar (vaksinimi kundër HPV-së. Këtu përfshihen: informacioni i përgjithshëm i politikave ndërkombëtare, aksesit shtetit në vaksinën e HPV-së (politikat, kriteret e vaksinimit dhe administrimi i vaksinës), financimi për vaksinën.

2. Parandalimi sekondar (depistimi i kancerit të qafës së mitrës). Këtu përfshihet disponueshmëria e programit të depistimit për çdo shtet, aksesit dhe financimi.

3. Informacioni në internet. Këtu përfshihen faqet e internetit që kanë informacion mbi HPV-në, lloji i informacionit që mund të gjendet në internet mbi HPV-në, depistimi i kancerit të qafës së mitrës dhe mënyrat se si mund të aksesohet vaksina dhe gjithashtu se e thjeshtë është të përdoren këto faqe, ku përfshihet sa të zbulueshme janë.

Rezultatet e “Atlasit të politikave për parandalimin e HPV-së” për vitin 2023 ofrojnë njohuri për përparimin e bërë që nga edicioni i mëparshëm i vitit 2020. Gjetjet e tregojnë se Belgjika, Danimarka, Irlanda dhe Britania e Madhe janë kampione të politikave, pasi kanë zbatuar politika shembullore për parandalimin parësor dhe dytësor, së bashku me shpërndarjen e informacionit të bazuar në prova për qytetarët. Nga ana tjetër, Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Azerbajxhani renditen dobët, ku vihet re mungesa e informacionit

dhe e politikave që kanë të bëjnë me parandalimin parësor dhe dytësor të HPV-së.

“Atlasi i politikave për parandalimin e HPV-së” evidenton pabarazitë e theksuara në përpjekjet për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në të gjithë Europën. Është evidente një ndarje e dallueshme midis vendeve të Europës Veriore, Jugore dhe Lindore, ku vihen re mospërputhje në aksesin ndaj vaksinave dhe teknologjive të shqyrtimit. Pabarazi të tilla kontribuojnë në rritjen e shkallës së incidencës dhe të vdekshmërisë, çka e bën imperative zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse për të zbutur barrën e kancerit të qafës së mitrës në të gjithë kontinentin.

Shqipëria renditet në vendin e 38-të, pra është në zonën e kuqe. Gjetjet e studimit tregojnë se nuk ka politika konkrete për vaksinën dhe kriteret për përfutjesit, nuk ka një regjistër kombëtar mbi disponueshmërinë dhe burimet e informacionit në internet janë të pamjaftueshme. Gjithsesi, në aspektet pozitive të situatës në Shqipëri mund të përfshijmë faktin se ka një program depistimi, i cili është i aksesueshëm në institucionet kombëtare, ku përfshihen paptesti dhe testi i HPV-së, ka mundësi për vetëtestim dhe testet ofrohen falas, ka materiale informative në internet, që janë lehtësisht të aksesueshme. Vlen të theksohet se “Atlasi i politikave për parandalimin e HPV-së për vitin 2023 pasqyron arsyet e vitit të mëparshëm dhe pritet që atlasit të vitit të ardhshëm të jetë më pozitiv për Shqipërinë, duke llogaritur arsyet që janë bërë në fushatën e vaksinimit të vajzave të reja, fushatë që duhet të vazhdojë në nivel kombëtar. Një risi është ngritja e Grupit Parlamentar Vullnetar për Popullsinë dhe Zhvillimin me vendim të Byrosë së Kuvendit dhe mbështetjen e Forumit Parlamentar Europian për të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese (EPF), Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD), i cili ka qenë shumë aktiv dhe në pararojë të disa nismave në dobi të shëndetit, si p.sh. nisma për vaksinimin e vajzave të reja kundër HPV-së.

### **Rekomandime për Shqipërinë**

Në Shqipëri parandalimi dhe trajtimi i kancerit të qafës së mitrës është një sfidë e rëndësishme shëndetësore. Programet

ekzistuese për depistimin dhe ndërgjegjësimin e popullsisë janë në zhvillim, por ende kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme për të arritur një efektivitet më të madh. Vaksinimi kundër HPV-së dhe testimi i infeksioneve me HPV janë një pjesë e rëndësishme e strategjisë së parandalimit. Përvoja ndërkombëtare tregon se programet e vaksinimit dhe kontrollet e rregullta, siç ndodh në vende si Australia dhe Zelanda e Re, janë të suksesshme në zvogëlimin e incidencës së kancerit të qafës së mitrës. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i popullsisë, kryesisht i grave, nëpërmjet fushatave informuese dhe programeve edukative në shkolla dhe komunitete luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e parandalimit dhe zbulimin e hershëm të kancerit të qafës së mitrës, megjithatë për të arritur sukses në luftën kundër këtij kanceri është e nevojshme të përmirësohet aksesueshmëria në shërbimet shëndetësore dhe të zbatohen strategji të përshtatshme monitorimi dhe vlerësimi për efektivitetin e programit. Përvoja dhe praktikat ndërkombëtare ofrojnë një bazë të rëndësishme për përmirësimin e politikave dhe të programeve lokale për parandalimin dhe trajtimin e kancerit të qafës së mitrës.

Për të përmirësuar parandalimin dhe menaxhimin e kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri rekomandojmë:

1. T'u sigurohet mundësi e barabartë dhe e lehtë të gjitha grave në shërbimet shëndetësore për depistimin dhe trajtimin e kancerit të qafës së mitrës. Kjo përfshin sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe trajnimin e personelit shëndetësor.

2. Të intensifikohet puna për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut rreth rrezikut të kancerit të qafës së mitrës, për rëndësinë e testimit dhe të vaksinimit kundër HPV-së. Kjo mund të realizohet përmes fushatave informuese në medie, vepnimtarive në komunitet dhe programeve të edukimit në shkolla dhe qendra shëndetësore.

3. Programet e vaksinimit kundër HPV-së duhet të përforcohen dhe të zgjerohen për të mbuluar një gamë më të gjerë të popullsisë, përfshirë edhe vajzat e grupeve të marginalizuara. Vaksinimi i tyre falas mund të ndihmojë në rritjen e mbulimit dhe në zvogëlimin e rrezikut të kancerit të qafës së mitrës në të ardhmen.

4. Është e rëndësishme të ketë një sistem të përshtatshëm monitorimi dhe vlerësimi për programet e depistimit të kancerit të qafës së mitrës për të siguruar efikasitetin e tyre në zvogëlimin e incidencës së kancerit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë.

5. Të nxitet rritja e performancës dhe cilësia e shërbimeve të kolposkopisë në spitalet rajonale dhe të shihet mundësia për të pasur një regjistër kombëtar për personat që rezultojnë pozitiv në testin e HPV-së.

Përmbushja e këtyre kërkesave dhe marrja e masave për të përforcuar programet e parandalimit do të bënin të mundur që Shqipëria të përmirësojë situatën e saj në luftën kundër kancerit të qafës së mitrës dhe të sigurojë një shëndetësi më të mirë për të gjithë qytetarët.

#### Referencat

- Asambleja Botërore e Shëndetësisë miraton strategjinë globale për të përsheptuar eliminimin e kancerit të qafës së mitrës. [www.who.int/news-room/detail/19-08-2020-world-health-assembly-adopts-global-strategy-to-accelerate-cervical-cancer-elimination](http://www.who.int/news-room/detail/19-08-2020-world-health-assembly-adopts-global-strategy-to-accelerate-cervical-cancer-elimination).
- Bray, F., Ferlay, J., Soerjomataram, I. etj., *Statistikat globale të kancerit 2018: vlerësimet e GLOBOCAN të incidencës dhe vdekshmërisë në mbarë botën për 36 kancere në 185 vende*, CA Cancer J Clin. 2018; 68 (6): 394-424.
- Brotherton, J. M., & Kaldor, J. M. (2019), *Vaksinimi HPV: arritja e ëndrrës për parandalimin e sëmundjeve*, *The Lancet*, 394(10197), 209–210. doi:10.1016/s0140-6736(19)31699-1.
- Dillner, J., Rebolj, M., Birembaut, P., Petry, K. U., Szarewski, A., Munk, C., ... Herdman, C. (2008), *Vlerat parashikuese afatgjata të citologjisë dhe testimit të papillomavirusit njerëzor në shqyrtimin e kancerit të qafës së mitrës*, studim i përbashkët evropian i grupit BMJ, 337, a1754. doi:10.1136/bmj.a1754
- Garland, S. M., Brotherton, J. M. L., & Skinner, S. R. (2019), "Vaksinimi i adoleshentëve dhe të rinjve për HPV në Australi: arritje dhe sfida". *Mjekësia parandaluese*, 126, 105. doi:10.1016/j.jpmed.2019.105.
- IARC. Vlerësimet e Observatorit Global të Kancerit (GLOBOCAN) 2018. Marrë nga: <http://gco.iarc.fr/>.
- HPV Prevention Policy Atlas 2023, <https://www.epfweb.org/sites/default/>

files/2024-01/HPV%20Atlas\_EN%202024-JAN25.pdf.

• Instituti i Shëndetit Publik, <https://www.ishp.gov.al/cfare-eshte-programi-kombetar-i-depistimit-te-kancerit-te-qafes-se-mitres/>.

• *Programi kombëtar i depistimit të qafës së mitrës në Shqipëri*, raporti i vlerësimit të vitit të parë, 2020 <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/2report-evaluation-screening-program-final-2020.pdf>.

• *Programi kombëtar për kontrollin e kancerit*, Ministria e Shëndetësisë, [https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Programi\\_Kombetar\\_per\\_Kontrollin\\_e\\_Kancerit.pdf](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Programi_Kombetar_per_Kontrollin_e_Kancerit.pdf)

<https://www.unfpa.org/resources/preparing-introduction-hpv-vaccines>

<https://www.ippf.org/blogs/hpv-what-you-should-know>

<https://acpd.org.al/?p=296>

<https://www.ishp.gov.al/mbledhja-per-procesin-e-vaksinimit-per-hpv-dhe-ecurine-e-tij-6-mars-2024/>.

• *Strategjia globale për të përsheptuar eliminimin e kancerit të qafës së mitrës si një problem i shëndetit publik*, Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020, [www.who.int/publications/i/item/9789240014107](http://www.who.int/publications/i/item/9789240014107)

• Schiffman, M., Doorbar, J., Wentzensen, N. et.al., "Infeksion kancerogjen nga papillomavirusi i njeriut", *Nat Rev Dis Primers*. 2016;2:16086.

• "Test falas për depistimin e hershëm të kancerit të qafës së mitrës, të gjitha gratë 40-50 vjeç të drejtohen pranë qendrave shëndetësore", Ministria e Shëndetësisë, <https://shendetesia.gov.al/manastirliu-test-falas-per-depistimin-e-hershem-te-kancerit-te-qafes-se-mitres-te-gjitha-grate-40-50-vjec-te-drejtohen-prane-qendrave-shendetesore/>.

• Tommasino, M., "Familja e papillomavirusëve njerëzorë dhe roli i saj në kancerogenezë", *Semin. Cancer Biol*. 2014;26:13–21.

• "Vaksina HPV falas për të gjitha vajzat në moshën paraadoleshente", Ministria e Shëndetësisë <https://shendetesia.gov.al/java-boterore-e-imunizimit-manastirliu-jep-lajmin-e-mire-vaksina-hpv-falas-per-te-gjitha-vajzat-ne-moshen-paraadoleshente/>

# Roli i Anselmo Lorekios në mendimin politik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare

Epoka e Rilindjes Kombëtare Shqiptare përfshin një periudhë të gjatë historike, që shtrihet prej viteve '30–'40 të shek. XIX e deri në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Rilindja shënoi jo vetëm lëvizjen më të fuqishme e më të organizuar politike që shqiptarët kishin njohur deri në atë kohë, por edhe një zhvillim të madh politik dhe kulturor kombëtar, të gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Ajo çoi në lindjen e nacionalizmit, një lëvizje e re për nga përmbajtja dhe objektivat e saj në historinë moderne të të gjithë popujve, e cila, si në çdo vend, edhe në Shqipëri kishte si synim të formonte shtetin e pavarur kombëtar<sup>1</sup>.



Prof. dr. Valentina DUKA  
Universiteti i Tiranës

Historiani i shquar shqiptaro-amerikan Stavro Skëndi në librin e tij *“Zgjimi kombëtar shqiptar”*<sup>2</sup> shkruan se nacionalizmi shqiptar u përqendrua në tri drejtime kryesore: i) në historikun e legjendës së Skënderbeut; ii) në fushën letrare e kulturore; iii) në fushën gjuhësore. Sipas tij, këto tri nisma do të shkonin paralel me njëra-tjetrën, pasi veprat letrare e kulturore përpiqeshin të promovonin legjendën e Skënderbeut dhe përdorimin e një gjuhe të folur e të shkruar të dallueshme nga gjuhët e tjera ballkanike. Shpresohet që Skënderbeu të mund të përdorej si një shembull historik për të vërtetuar se pse populli shqiptar meritonte të drejtën për të pasur shtetin e tij dhe pse ai nuk duhej të bëhej pjesë e të tjerëve. Legjenda e Skënderbeut do të rezultonte një mjet i efektshëm për nxitjen e zgjimit kombëtar, gjë që u arrit veçanërisht përmes veprës *“Historia e Skënderbeut”* të Naim Frashërit, e cila e përhapit këtë mesazh në radhët e shqiptarëve të arsimuar<sup>3</sup>.

Bashkimi kombëtar nuk mund të arrihej pa arsim e ndriçim. Popujt e tjerë ballkanikë kishin punuar gjatë për

emancipimin kulturor, më përpara se të arrinin çlirimin e tyre. Për shqiptarët kjo qe një detyrë e vështirë. Adriatiku shpesh nuk e lidhte me perëndimin, por e ndante prej tij. Rrymat e mendimit perëndimor mezi arrinin tek ata<sup>4</sup>. Pavarësisht pengesave të shumta, ndriçimi mendor i shqiptarëve u realizua, në radhë të parë jashtë kufirit të Perandorisë Osmane.

Krahas forcave përçarëse përbrenda dhe jashtë Shqipërisë ne duhet të sjellim në vëmendje edhe disa faktorë pozitivë që ndihmuan të bëhej e mundur arrija e këtij suksesi të madh. Duhet të theksojmë që në fillim se rolin kryesor në bashkimin kombëtar e ka luajtur gjuha. Ajo ka qenë gjithmonë e rëndësishme në lëvizjet kombëtare të popujve, por në Shqipëri, ku forcat ndarëse ishin aq të shumta, roli i gjuhës së përbashkët qe i një rëndësie sipërore. Gjuha i bënte shqiptarët të ndienin se ata ishin të ndryshëm nga turqit, nga grekët dhe nga kushdo i huaj tjetër, u falte atyre ndjenjën se i përkitnin të njëjtit komb<sup>5</sup>.

Kur marrim parasysh gjithë ato



pengesa të çuditshme që u dilnin përpara në zgjimin e tyre kombëtar, përparimi i shqiptarëve, i cili në shikim të parë duket i ngadalshëm, mund të konsiderohet një

hap titanik. Në lëvizjen për zhvillimin e vetëdijes kombëtare shqiptare një rol të rëndësishëm luajtën kolonitë shqiptare<sup>6</sup>, por këtu do të ndalemi në kontributin e komunitetit të italo-shqiptarëve. Ky qe një fenomen unik. Kujtimet e së kaluarës së largët mbetën të gjalla ndër shqiptarët e Italisë, që ndienin mall për tokën e stërgjyshërve të tyre, të cilën donin ta

dhe publicist, për shumë vjet me radhë Lorekio u mor me veprimtari patriotike individuale. Për herë të parë ai hyri në fushën e veprimtarisë patriotike kolektive në dy kongreset gjuhësore arbëreshe. Në kongresin e parë, që u mbajt në Korilano-Kalabro në vitin 1895, ai u zgjodh sekretar i Shoqërisë Kombëtare Shqiptare (*Societa Nazionale Albanese*) të themeluar nga

artikujsh dhe i disa studimeve për çështjen kombëtare shqiptare, ku shprehej për vendosjen e marrëdhënieve të gjithanshme italo-shqiptare. Gazeta *La Nazione Albanese* ("Kombi shqiptar", 1897–1924) e drejtuar prej tij, botuar në italisht, disa artikuj edhe në shqip, që dilte një herë në dy javë, u bë organi i Shoqërisë Kombëtare Shqiptare. Në faqet e kësaj gazete botuan shkrimtarë italo-shqiptarë, publicistë nga Shqipëria dhe nga kolonitë shqiptare<sup>10</sup>. Studiuësja Natali Klajer (*Nathalie Clayer*) në librin e saj "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar" thotë se gazeta *La Nazione Albanese* e Lorekios në vitin 1899, për herë të parë në shtypin shqiptar, filloi të shpaloste në faqen e parë një shqiponjë dykrenore, simbol i flamurit kombëtar<sup>11</sup>, që së bashku me togfjalëshin "Shqipëria avant" dhe portretin e Skënderbeut në ballinë përbënin diskursin kryesor vizual të saj<sup>12</sup>.

Gazeta nuk qarkullonte vetëm mes italo-shqiptarëve, por edhe në Shqipëri, ku kishte si lexues pjesëtarë të klerit katolik dhe tregtarë, të cilëve zakonisht u dërgohej falas<sup>13</sup>. Me artikujt për historinë e shqiptarëve, për politikën ballkanike dhe krijimin e kombit shqiptar, me poezitë dhe publicistikën e saj gazeta bëri shumë lexues jo vetëm në Shkodër, por edhe në Durrës e pjesërisht edhe në Elbasan e Kavajë. Kjo gazetë ka luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare ndër shqiptarë. Gazeta gjithashtu botoi të gjitha memorandumet që shqiptarët dërguan në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX në kërkim të

**“ Anselmo Lorekio, ky yll me shkëlqim të fortë në yllësinë e kombit shqiptar, ishte personaliteti tek i cili kombinoheshin aq bukur eruditi mahnitës dhe vrojtuesi i hollë i realitetit shoqëror, veprimtari politik i Lëvizjes Kombëtare, njohësi brilant i historisë dhe kulturës kombëtare të shqiptarëve me adhuruesin e flaktë të qytetërimit perëndimor në përgjithësi dhe atij italian në veçanti. ”**

shihnin të lirë<sup>7</sup>. Njëllor si në Juglindjen europiane, edhe për Kalabrinë dhe Sicilinë fillimi i shek. XIX ishte sinonim i transformimeve të rëndësishme politike dhe sociale<sup>8</sup>. Njerëzit e ditur të italo-shqiptarëve, që shpesh i përkitin hierarkisë kishtarë të ritit ortodoks, formuan elitën e një popullsie pothuajse rurale, e cila jetonte në kushte të vështira ekonomike. Ata krijuan klube kulturore, hapën shkollë në gjuhën shqipe dhe botuan gazeta në gjuhën shqipe.

Ndër shumë protagonistë të kësaj lëvizjeje kulturore e politike do të veçonim Anselmo Lorekion (*Anselmo Lorechio*), i cili lindi në Puhërinë arbëreshe të provincës së Katanzaros në Italinë Jugore. Anselmo Lorekio, ky yll me shkëlqim të fortë në yllësinë e kombit shqiptar, ishte personaliteti tek i cili kombinoheshin aq bukur eruditi mahnitës dhe vrojtuesi i hollë i realitetit shoqëror, veprimtari politik i Lëvizjes Kombëtare, njohësi brilant i historisë dhe kulturës kombëtare të shqiptarëve me adhuruesin e flaktë të qytetërimit perëndimor në përgjithësi dhe atij italian në veçanti. Avokat, gazetar, poet

kongresi. Dy vjet më vonë, në shkurt të vitit 1897, ai kryesoi kongresin e dytë, që u mbajt në Unger (Lugaro) të Kalabrisë. Ishte një kongres kulturor, por që mori një vendim të rëndësishëm për elitën arbëreshe. Duke ndryshuar dispozitën 10 të statutit të kongresit të vitit 1895, ai lejoi veprimtarinë politike në mesin e italo-shqiptarëve, me arsyetimin se nuk mund të kishte diskutime linguistike dhe letrare pa diskutime politike<sup>9</sup>. Lorekio bashkëpunoi me organe të ndryshme të shtypit italian. Ai është autor i një sërë

<sup>1</sup> Shaban Demiraj, Kristaq Prifti, "Kongresi i Manastirit", botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2004, f. 14.

<sup>2</sup> Stavro Skëndi, "Zgimi kombëtar shqiptar 1878–1912", "Phoenix" dhe Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë, 2000.

<sup>3</sup> Nikola Guy, "Lindja e Shqipërisë", f. 27.

<sup>4</sup> Stavro Skëndi, "Zgimi kombëtar shqiptar", f. 420.

<sup>5</sup> Nathalie Clayer, "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar", botimet "Përpjekja", Tiranë, 2012, f. 423–424.

<sup>6</sup> Nikola Guy, "Lindja e Shqipërisë", f. 15–16.

<sup>7</sup> Stavro Skëndi, "Zgimi kombëtar shqiptar",

f. 421.

<sup>8</sup> Nathalie Clayer, "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar", botimet "Përpjekja", Tiranë, 2012, f. 153.

<sup>9</sup> Po aty, f. 363–364.

<sup>10</sup> Stavro Skëndi, "Zgimi kombëtar shqiptar", f. 202.

<sup>11</sup> Nathalie Clayer, "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar", botimet "Përpjekja", Tiranë, 2012, f. 400.

<sup>12</sup> La Nazione Albanese (1899–1924).

<sup>13</sup> Nathalie Clayer, "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar", botimet "Përpjekja", Tiranë, 2012, f. 500–501.

autonomisë së Shqipërisë<sup>14</sup>.

Programi i të dy kongreseve gjuhësore që përmendëm më sipër, ku ndër protagonistët kryesorë ishte Lorekio, kërkonte: i) një alfabet të unifikuar; ii) përpilimin e një fjalori; iii) themelimin e një shoqërie kombëtare shqiptare; iv) nisjen e lidhjeve dhe marrëdhënieve në shkallë të gjerë me mëmëdheun<sup>15</sup>. Shoqëria Kombëtare Shqiptare, që u themelua dhe u fuqizua nga këto kongrese, qe në një pozitë më të favorshme sesa shoqëritë shqiptare në Rumani, Egjipt e Bullgari dhe kishte më shumë mundësi për realizimin e programin e saj, sepse në Itali ka pasur një liri më të madhe veprimi për italo-shqiptarët sesa ka pasur diaspora shqiptare në vendet e tjera europiane. “Në Itali ne jemi 200 mijë të shpërndarë në tokat pjellore të Sicilisë dhe në qarqet e Italisë Jugore. Ne flasim të njëjtën gjuhë si vëllezërit tanë përtej Adriatikut, gjuhë e folur prej hynjorëve pellazgë [...] Që të bëjmë të njohur kujtesën e lumtur të madhështisë sonë [...] është e domosdoshme që ne të merremi vesh me njëri-tjetrin me anën e shkrimit”, – do të deklaronte A. Lorekio në proklamatinë e shpallur më 5 nëntor 1895 në emër të Shoqërisë Kombëtare Shqiptare. Ndërsa më 1 maj 1897 ai u bëri thirrje shqiptarëve të Shqipërisë të bashkoheshin për çdo veprimtari kulturore e politike dhe u kujtoi atyre se qenë të gjithë prej një gjaku, flisnin të njëjtën gjuhë, kishin të njëjtat tradita dhe aspirata në jetë<sup>16</sup>.

Ndonëse e gjithë elita italo-shqiptare kishte objektiv kryesor politik pavarësinë e Shqipërisë, sipas historianit Stavro Skëndi, në radhët e saj mbizotëronin dy rryma rreth rrugëve që do të ndiqeshin për arritjen e tij. Njëra përfaqësohej nga Zef Skiroi, i cili përkrahte idenë e revolucionit për të shpejtuar pavarësinë e Shqipërisë, tjetra kishte si zë kryesor Anselmo Lorekion, i cili ishte për reforma dhe autonomi. Ky diskurs, që nuk shkonte kundër politikës zyrtare të Italisë, pati shumë përkrahës në qarqet e elitës arbëreshe të kohës. Sipas tij, rruga më fitimprurëse për shqiptarët ishte rruga e reformave dhe e rregullimeve të brendshme, që do ta bënin Shqipërinë të zonjën të kishte marrëdhënie me botën e qytetëruar. Shqiptarët duhej të kërkonin vazhdimisht ndihmën e Italisë dhe të fuqive të tjera për t’ia arritur këtij qëllimi. Ata duhej

të ngulin këmbë se nuk donin t’u cenohej atdheu në asnjë mënyrë.

Në shërbim të idesë së tij politike, A. Lorekio u tregua aktiv edhe në rekrutimin e patriotëve shqiptarë që jetonin në Shqipëri dhe në diasporë për të nxitur botimin e organeve të reja me përmbajtje kryesisht politike. I pari qe Mehmet Frashëri, një shqiptar nga Jugu, të cilin më



1889 e ndihmoi të botonte në Romë gazetën “Zëri i Shqipërisë”. Kjo gazetë dilte me shkrime në shqip, frëngjisht dhe turqisht, por shpejt pushoi botimin për shkak të mospajtimeve midis Lorekios dhe Mehmet Frashërit, kryesisht lidhur me çështje politike për të ardhmen e Shqipërisë<sup>17</sup>.

Shoqëria italo-shqiptare nisi të bëhej më aktive politikisht. Në peticionin e qershorit të vitit 1899 drejtuar Sulltanit ajo propozonte që për vilajetin e Shkodrës, të Kosovës, Manastirit, Selanikut dhe Janinës të krijohet një komision regional për pronat perandorake në Gadishullin Ballkanik” me qëndrim në Manastir dhe me komisionerë specialë të varur prej tij në kryeqytetet e vilajeteve të tjera. Gjuha zyrtare e komunikimit midis komisionit regional dhe qeverisë qendrore në Stamboll mund të ishte turqishtja, porse gjuha zyrtare që do të përdorej në të pesë vilajetet duhej të ishte shqipja<sup>18</sup>. Kjo ishte një kërkesë e paqartë politike, por në thelb tregonte një mbështetje të kamufluar të autonomisë së Shqipërisë, e shtrirë në vilajetet osmane ku jetonin në shumicë dhe në mënyrë kompakte shqiptarët.

Sa kohë që lëvizja e italo-shqiptarëve zhvillohej në planin kulturor, udhëheqësit nacionalistë shqiptarë e mirëpritën, po kur ajo erdhi e u bë tepër aktive në politikë, shumë prej krerëve shqiptarë që jetonin në Shqipëri dhe në diasporë nuk deshën të bashkëpunonin më me arbëreshët. Pas

kongresit gjuhësor italo-shqiptar të vitit 1895 Faik Konica qe ndër të parët nacionalistë shqiptarë që i shprehu përgëzimet e tij Anselmo Lorekios për themelimin e Shoqërisë Kombëtare Shqiptare. Ai shkroi se kjo shoqëri do të ndihmonte shumë në nxitjen e studimeve shqiptare. Mirëpo më vonë, kur nisi të botonte revistën “Albania”,

Konica filloi të kishte dyshime për lëvizjen italo-shqiptare. Polemikata kryesore ai i pati me Lorekion, si një ndër protagonistët kryesorë të mendimit politik të arbëreshëve, të shprehur qartë te redaksionalet e organit të tij *La Nazione Albanese*. Në gazetën “Albania”, që botohej në Bruksel, pati shkrime ku Konica u mohonte haptas çdo të drejtë italo-shqiptarëve për t’u angazhuar aktivisht me fatet e Shqipërisë, jo aq shumë për shkak të pesë shekujve që i ndanin ata prej shqiptarëve dhe “gjaku i tyre ishte përzier dhe gjuhë e tyre prishur”, sikundër shprehej ai vetë, por më shumë për shkak të qenies së tyre qytetarë italianë. Duke interpretuar idenë e Lorekios për bashkimin e shqiptarëve, Faik Konica shtroi me ironi tri alternativa: i) shqiptarët e Italisë ose donin të aneksonin Kalabrinë dhe Sicilinë me Shqipërinë; ii) ose donin të anekso nin Shqipërinë me Kalabrinë dhe Sicilinë; iii) ose donin të ngriheshin dhe të emigronin në masë në Shqipëri. “Po të mos plotësohet njëra nga këto kondita, – thoshte Konica, – nuk mund të ketë bashkim.” Shqiptarët do të ishin të kënaqur të kishin marrëdhënie intelektuale me italo-shqiptarët, por ata nuk duhej të merreshin me politikë dhe të vazhdonin të flisnin për bashkim<sup>19</sup>. Në një letër dërguar një politikani vjenez Konica mburrej se ishte ai dhe vetëm ai që ia kishte prerë rrënjët

ndikimit në rritje të italo-shqiptarëve, të cilët mund të bëheshin një armë e tmerrshme në duart e Italisë<sup>20</sup>. Nga ana tjetër, A. Lorekio pati pohuar haptazi se dy parime themelore udhëhiqnin përpjekjet politike të italo-shqiptarëve: i) *Shqipëria për shqiptarët*, e cila përputhej edhe me politikën italiane; dhe ii) *Adriatiku ishte një det italian dhe shqiptar*. Ai e kishte bindje se Shqipëria mund të prosperohej vetëm me ndihmën e qeverisë italiane, me forcimin e ndikimit të saj ekonomik dhe politik në Shqipëri.

Si Konica, ashtu dhe Lorekio e mbështetnin pavarësinë e Shqipërisë, ata ishin figura eminente në radhët e nacionalizmit shqiptar, por diskutet e tyre ndaheshin kur diskutoheshin fuqia e huaj tek e cila duhet të mbështeteshin shqiptarët në zgjidhjen e çështjes së tyre kombëtare: Austro-Hungaria apo Italia? Faik Konica dhe politikanë të tjerë shqiptarë e donin Shqipërinë të lidhur me politikën austro-hungareze, sepse e quanin të përshtatshme për interesat e atdheut. Ata nuk mund të bashkëpunonin me një lëvizje që kundërshtonte Austro-Hungarinë dhe favorizonte Italinë, siç ishte lëvizja politike e italo-shqiptarëve<sup>21</sup>.

Ndryshe nga Konica, protagonist i kryesor i shpalljes së pavarësisë, Ismail Qemali, mbështeste veprimtarinë politike dhe letrare të italo-shqiptarëve dhe gjatë viteve të mërgimit të tij ai e kishte vizituar disa herë Kalabrinë dhe Sicilinë, kishte marrëdhënie shumë të mira me Lorekion dhe e vlerësonte punën e madhe të tij në shërbim të kombit shqiptar.

Anselmo Lorekio nuk e ndali veprimtarinë e tij në shërbim të Shqipërisë edhe pas shpalljes së pavarësisë së saj në nëntor të vitit 1912. Ai u rreshtua në radhët e para të elitës politike shqiptare për mbrojtjen e pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të Shqipërisë, nuk pajtohej me një mbret gjerman për Shqipërinë dhe ishte shumë aktiv si politikan dhe gazetar në Konferencën e Paqes në Paris më 1919–1920, ku mori pjesë si delegat i shoqërisë “Vatra” të shqiptarëve të Amerikës. Si shpërblim për kontributin e tij për çështjen shqiptare, me

propozim të Fan Nolit, i cili e respektonte shumë Lorekion, më 2 mars 1922 qeveria shqiptare e emëroi atë ambasador pranë Selisë së Shenjtë, që për arsye të brendshme politike shqiptare nuk funksionoi.

Anselmo Lorekio ka dhënë një kontribut të madh edhe si shkrimtar dhe studiues. Ai është autor i librave *La questione albanese* (“Çështja shqiptare”, 1898), *Il pensiero albanese in raporti agni interessi italiani* (“Mendimi shqiptar në raport me interesat italiane”, 1904), i përmbledhjes me akte të Rilindjes Shqiptare “*Memorandume për pavarësinë e Shqipërisë*”, 1920, e cila iu dërgua edhe kancelarive kryesore europiane, i një broshure me titull “*Shqipëria pranohet në Lidhjen e Kombeve*” etj. Këto botime luajtën një rol të rëndësishëm edhe në njohjen e perspektivës shqiptare nëpërmjet një gjuhe të njërit prej kombeve më me influencë në Europën e kohës siç ishte Italia.

Ishte ky kontribut i Lorekios në çështjen kombëtare shqiptare që e bëri figurën e tij shumë të respektuar në ambientet politike dhe publicistike shqiptare të kohës. Vdekja e tij më 22 mars 1924 u përjetua me dhimbje në Shqipëri. Në parlamentin shqiptar u mbajtën 5 minuta heshtje në nderim të tij. Në fjalën e tij Terenc Toçi do të quante Lorekion një atdhetar të pashoq, që për 40 vjet kishte punuar pa u lodhur për të drejtat e popullit tonë, luftëtar i paepur i çështjes shqiptare, që u kishte mësuar të gjithëve si të nderohej e të mbrohej e drejta e Shqipërisë<sup>22</sup>. Në mbledhjen e datës 24 maj 1924 parlamenti shqiptar vendosi t’u jepej një pension prej 80 franga ari gruas dhe vajzës së tij<sup>23</sup>.

Gazetat dhe revistat shqiptare të kohës botuan gjithashtu artikuj homazh për Lorekion, i cili me gazetën e tij *La nazione Albanese* mbajti gjallë emrin e Shqipërisë ndër qindra shkrimtarë dhe politikanë në Itali<sup>24</sup>. Faik Konica në gazetën “Dielli” do të shkruante: “*Ja dhe një tjetër nga kapëdanët e vjetër të Lëvizjes Shqiptare u zhdruk tani nga mesi jonë. Pavarësisht nga polemikat e së shkuarës, tani së fundi Lorekio ishte miku im.*”

Ndërsa gazeta “*Ora e maleve*”, që botohej në Shkodër, në prill 1924 do të shkruante: “*Më 22 mars, mbas një lëngate të shpejtë është ndarë nga kjo jetë në Romë, në moshën 81-vjeçare, ushtari i palodhur i përlindjes shqiptare në lëmë të gazetarisë, kavaleri Anselmo Lorekio. Ky zotni i paharruar ish prej gjakut tonë dhe rridhte nga një familje e njohur e shqiptarëve të Italisë. Pajisur mendërisht me një kulturë të shëndoshë dhe i ushqyer me ndjesi të lartë atdhedashurie, u vu qysh i ri në shërbim të vendit të të parëve të vet. Gazeta që ai botoi për 27 vjet rresht në vendlindje, në Pallagorio, *La Nazione Albanese*, me kryefjalën ‘*Shqipëria përpara*’, me argumente të forta historike mbrojti të drejtat e një populli të robëruar për çlirim kombëtar. Të gjitha koleksionet e kësaj gazete janë një gur i çmuar, sepse përmbajnë një lëndë fort të vlefshme e dokumente me rëndësi mbi zhvillimin politik e letrar. Pavarësisht punës së vështirë si gazetar, ai nuk u ligështua, sepse për të shtypi ishte arma më e fuqishme për të përhapur idetë kombëtare e për të punuar për independencën e vendit të të parëve të tij.*”<sup>25</sup>

<sup>14</sup> “Historia e popullit shqiptar”, vëll. II, botim i Akademisë së Shkencave, “Toena”, Tiranë, 2002, f. 332.

<sup>15</sup> Stavro Skëndi, “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, f. 202.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Stavro Skëndi, “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, f. 211.

<sup>18</sup> Po aty, f. 203–204.

<sup>19</sup> Stavro Skëndi, “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, f. 212.

<sup>20</sup> Faik Konica, *Vepra 4*, botimet “Dudaj”, Tiranë, 2001, f. 141.

<sup>21</sup> Stavro Skëndi, “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, f. 212.

<sup>22</sup> “Bisedime parlamentare”, 1924, Tiranë, 2015, f. 631.

<sup>23</sup> “Bisedime parlamentare”, 1924, Tiranë, 2015, f. 890.

<sup>24</sup> “Studime historike”, shkrimi i Beqir Metës, “Marrëdhëniet e Anselmo Lorekios me federatën ‘Vatra’”, Tiranë, 2009 (1-2), f. 252.

<sup>25</sup> Po aty, f. 253.

# “Arbëreshët e Horës - stoli e kombit dhe e historisë së Shqipërisë”



Kryetarja e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, bëri një vizitë në Horën e Arbëreshëve me rastin e themelimit të kësaj qendre të rëndësishme arbëreshe në Sicili, që historikisht është shquar për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë unike arbëreshe.

Në këtë ditë të veçantë të historisë së tyre banorët e Horës organizuan një sërë veprimtarish kulturore. Këngët e vallet e arbëreshe, gjuha shqipe, e ruajtur me fanatizëm prej tyre për 600 vjet, kostumet e mrekullueshme, traditat, kultura e pasur shpirtërore - të gjitha këto u shpalosën bukur gjatë vizitës së znj. Elisa Spiropali në vendbanimin më të madh arbëresh të Sicilisë. Duke festuar ditën e themelimit të vendbanimit

të tyre, pasardhësit e bashkëlufetarëve të Skënderbeut manifestuan me krenari rrënjët e tyre, që i lidhin me vendin amë, Shqipërinë, dhe mikpritën me dashuri e bujari delegacionet e mbërritura nga Shqipëria e gjithandej nga diaspora. Gëzimi i tyre arriti kulmin në çastin e ngritjes së përmendores së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Për t’iu bashkuar gëzimit të tyre dhe për të dëshmuar afërsinë, kujdesin dhe ndjenjat e pamohueshme vëllazërore e për t’u dhënë mesazhin se ne jemi një, znj. Spiropali u vesh me kostumin tradicional arbëresh.

Në vijim të vizitës ajo mori pjesë dhe përshëndeti në konferencën kushtuar Heroit tonë Kombëtar të organizuar nga autoritetet lokale të

Horës, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të diasporës shqiptare nga vende të ndryshme të botës. Pasi u shprehu mirënjohjen kryetarëve të bashkive arbëreshe që e bënë pjesë të festës së themelimit të Horës, kryeparlamentarja u ndal te figura e “Atit të përjetshëm të shqiptarëve kudo që janë, Kastriotit të lavdishëm dhe zulmëmadh”, siç e quajti ajo Skënderbeun. “Ne shqiptarët [...] mund të mos biem dakord për shumëçka me njëri-tjetrin. Ne mund të debatojmë, madje mund të mbajmë edhe mëri qoftë dhe për ndryshimin e stinëve, por të gjithë e pranojmë njëzëri se Gjergj Kastrioti është emblema solemne e kombit shqiptar, është hiri, himni, heroika dhe vetë flamuri i ndërgjegjes



## Elisa SPIROPALI:

Ne mund të debatojmë,  
madje mund të mbajmë edhe mëri  
qoftë dhe për ndryshimin e stinëve,  
por të gjithë e pranojmë njëzëri  
se Gjergj Kastrioti është emblema  
solemne e kombit shqiptar, është hiri,  
himni, heroika dhe vetë flamuri  
i ndërgjegjes sonë kombëtare.



sonë kombëtare. Është Ati që lindi dhe Biri që mbrojtí atdheun. Është prova dhe sprova, është shembulli dhe vizioni, është ëndrra e jetuar dhe beteja e fituar në kryeluftën tonë për identitet: Perëndim ku lind apo Lindje ku perëndon? Në historinë tonë kombëtare Skënderbeu është një udhëheqës i madh politik dhe ushtarak, një prijës popullor, shtetar dhe shtetëformues, luftëtar i penës dhe diplomat i shpatës”, – do të shprehej znj. Spiropali duke folur për Heroin tonë Kombëtar. Më tej ajo shtoi: “Bustet dhe emri i tij u japin hijeshi shesheve dhe rrugëve në Tiranë, Prishtinë, Romë, Gjenevë, Zyrih, Paris, Londër, Bruksel, Budapest, Shkup e madje edhe në Miçigan e Çikago në

Shtetet e Bashkuara. Sot Gjergji vjen në bronz si shenjt mbrojtës dhe monument kujtese edhe në qytetin tuaj, si për të na kujtuar të gjithëve se na bashkon një gjuhë e një gjak, se secili nga ne sot e fëmijët tanë nesër do të jemi një gur në piedestalin e pavdekshëm të Kastriotit tonë.”

Në vijim të fjalës së saj, pasi vlerësoi kontributin e arbëreshëve në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditave shqiptare, Kryetarja e Kuvendit vuri në dukje se vitet e fundit Kuvendi, qeveria dhe institucionet e Shqipërisë po i kushtojnë një kujdes të veçantë bashkëpunimit me diasporën, me komunitetet dhe përfaqësuesit e saj kudo që ndodhen, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në bashkëpunimin me komunitetin

arbëresh dhe emigrantët shqiptarë në Itali . “Bashkëpunimi ynë me komunitetin arbëresh, por edhe me shqiptarët emigrantë në Itali, po zhvillohet në një kontekst shumë pozitiv edhe për shkak të marrëdhënieve të shkëlqyera mes Shqipërisë dhe Italisë, mes Kryeministrit Edi Rama dhe Kryeministres Xhorxhia Meloni (*Georgia Meloni*). Partneriteti strategjik dhe bashkëpunimi intensiv dypalësh, mbështetja e fuqishme e integritimit evropian të Shqipërisë nga Italia, marrëveshja e saporatifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Italinë për pensionet, zbatimi i protokollit të bashkëpunimit për emigrantët e paligjshëm, bashkëpunimi i gjerë dhe intensiv parlamentar mes Kuvendit të Shqipërisë, Dhomës së Deputetëve dhe Senatit italian, angazhimi i qeverisë italiane për mbështetjen e Kosovës, kontributi i përbashkët në luftën për paqe në Ukrainë janë disa tregues të bashkëpunimit Shqipëri–Itali, i cili asnjëherë nuk ka qenë më i mirë dhe më produktiv se sot”, – tha znj. Spiropali.

Në vijim të vizitës në vendbanimin kryesor arbëresh në Sicili Kryetarja e Kuvendit vizitoi muzeun e kulturës arbëreshe “Nikola Barbatò”, ku pati mundësinë të njihej nga afër me historinë, kulturën, traditat, punën dhe jetën e përditshme të komunitetit arbëresh.

Kryetarja e Kuvendit vizitoi edhe bibliotekën “Zef Skiroi” (*Giuseppe Schiro*), e cila shërben si një libër i hapur për historinë, kulturën, jetën dhe qytetërimin e arbëreshëve të Horës. Aty ajo u njoh me koleksionin e gjerë të materialeve që dokumentojnë rrënjët e thella dhe trashëgiminë kulturore të arbëreshëve.

Më pas së bashku me papas Janin ajo mori pjesë në një ceremoni shpirtërore në kishën lokale, ku morën bekimin e Shën Mërisë Odigitria. Kjo ceremoni solemne shërbeu si një lutje e përbashkët për mirëqenien e të gjithë arbëreshëve të Horës, të Sicilisë dhe të krejt Italisë, por dhe për gjithë shqiptarët kudo që ndodhen në botë.



# Kryetarja e Kuvendit vizitë zyrtare në Kosovë

Vizitën e saj të parë zyrtare jashtë vendit pas marrjes së detyrës Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali, e bëri në Kosovë për të konfirmuar edhe një herë bashkëpunimin vëllazëror mes dy vendeve. Gjatë kësaj vizite ajo u takua me Kryeministrin Albin Kurti, me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca, dhe me deputetë të Kuvendit të Kosovës. Në këto takime u afirmua edhe një herë përkushtimi për të forcuar marrëdhëniet midis dy vendeve, për stabilitetin e rajonit dhe për të ecur së bashku përpara drejt integritimit euroatlantik si dy vende që kanë të njëjtin qëllim dhe vizion.

Në takimin me Kryeministrin Albin Kurti kryeparlamentaja theksoi se Shqipëria dhe Kosova duhet të thellojnë më tej bashkëpunimin mes tyre për ta kthyer atë në një model për rajonin. Ajo e vuri theksin te përfitimet konkrete që do të kenë qytetarët e dy vendeve nga ky bashkëpunim dhe premtoi mbështetjen e Kuvendit të Shqipërisë



për çdo nismë që forcon lidhjet ndërqeveritare dhe ndërinstitucionale. Në vijim të bisëdës Kryetarja e Kuvendit riafirmoi përkushtimin e Shqipërisë për të mbështetur sovranitetin dhe integritetin kushtetues të Kosovës dhe shtoi se Shqipëria do të vijojë të llobojë me forcë për anëtarësimin e Kosovës në OKB, në Këshillin e Europës, në NATO dhe në Nismën SHBA–Karta e Adriatikut.

Nga ana e tij Kryeministri Kurti shprehu vlerësimin për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet qeverive të dy vendeve dhe theksoi rëndësinë e mbështetjes së dy parlamenteve për zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara. Ai falënderoi Kuvendin e Shqipërisë për mbështetjen në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin

e Europës dhe shprehu bindjen se kjo mbështetje do të vijojë.

Gjatë takimit znj. Spiropali dhe z. Kurti diskutuan edhe për mundësinë e zgjerimit bashkëpunimin ekonomik midis dy vendeve për t'u bërë partnerë kryesorë ekonomikë të njëri-tjetrit.

Në takimin me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca, Kryetarja e Kuvendit vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet dy parlamenteve. Ajo i tha homologut të saj se Kosova mbetet një prioritet për Shqipërinë dhe theksoi rëndësinë e Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar në shtator të vitit 2022 në krijimin e një bazë solide për marrëdhëniet e ndërsjella parlamentare. Kryeparlamentarja e vlerësoi mbledhjen e përbashkët të dy parlamenteve në nëntor të po atij viti si një hap i rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shprehu bindjen se kjo frymë bashkëpunimi do të vazhdojë, çka do t'i shërbejë forcimit të marrëdhënieve midis dy vendeve, stabilitetit në rajon dhe integritimit euroatlantik.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Konjufca, e vlerësoi bashkëpunimin midis dy parlamenteve si model për rajonin dhe theksoi rëndësinë e vazhdimin të këtij bashkëpunimi në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Ai theksoi se Shqipëria dhe Kosova kanë një lidhje të fortë vëllazërore, e cila është ndërtuar mbi histori dhe sakrificë të përbashkëta, çka i obligon dy vendet që të qëndrojnë pranë njëri-tjetrit.



# “Gjuha shqipe për ne shqiptarët është e shenjtë, pasi ajo ka të bëjë me thelbin e identitetit tonë”

Kryetarja e Kuvendit bëri një vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut me ftesë të homologut të saj, z. Afrim Gashi, i cili e priti me nderimet më të larta shtetërore.

Në bisedën me kryeparlamentarin Afrim Gashi znj. Spiropali i vlerësoi të shkëlqyera marrëdhëniet mes dy vendeve, por tha se, si partnere në NATO dhe si aspirante për në BE, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut këto marrëdhënie duhet t'i forcojnë më tej dhe të vijojnë të bashkëpunojnë e kontribuojnë për sigurinë dhe stabilitetin në rajon e më gjerë. Ajo e siguroi homologun e saj maqedonas se Shqipëria do të vijojë të mbështesë “perspektivën europiane të RMV-së, sepse anëtarësimi në BE është prioritet strategjik i dy vendeve tona”, që “do të vijojnë të jenë pjesë aktive në nismat rajonale, si Fondi i Ballkanit Perëndimor, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Procesi i Brdo-Brijunit, Procesi i Berlinit, RYCO, BSEC, NAI, MARRI etj.”.

Kryeparlamentarja i shprehu z. Gashi gatishmërinë e saj dhe të Kuvendit për intensifikimin e marrëdhënieve ndërparlamentare, çka “do t'i shërbejë fuqizimit të bashkëpunimit politik, ekonomik e tregtar dypalësh dhe miqësisë mes popujve tanë”. Në vijim të bisedës ajo i tha se Shqipëria mbështet përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut në institucionet e vendit, nxit kontributin e tyre si faktor demokratizimi, zhvillimi, integrimi euroatlantik dhe stabiliteti, sepse bashkë me maqedonasit në Shqipëri ata janë një urë lidhëse në miqësinë që ekziston mes dy vendeve.

Edhe z. Gashi shprehu gatishmërinë e tij dhe të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut për forcimin bashkëpunimit mes dy vendeve dhe dy parlamenteve, sepse



bashkëpunimi, tha ai, “na e bën më të lehtë rrugëtimin drejt BE-së”. Më tej ai shtoi: “Sot hapëm dyert për forcimin e bashkëpunimit mes dy parlamenteve në të gjitha nivelet, mes komisioneve e deputetëve. Bashkëpunimi parlamentar do të nxisë bashkëpunimin dypalësh politik, ekonomik, tregtar, energjetik, infrastrukturor, arsimor, kulturor etj.”

Në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut znj. Spiropali u takua me z. Talat Xhaferi, ish-kryetar i Kuvendit të RMV-së dhe ish-kryeministër, dhe me kryetarin e BDI-së, z. Ali Ahmeti, me të cilët diskutoi mbi rolin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut si faktor demokratizimi, integrimi, stabiliteti e paqeje në vend e në rajon dhe nevojën e ruajtjes së përfaqësimit të drejtë e proporcional të shqiptarëve në shoqërinë dhe institucionet e RMV-së. “Gjithmonë i veçantë takimi me kryetarin e BDI-së, bacën Ali Ahmeti, dhe z. Talat Xhaferi, ish-kryetar i Kuvendit dhe ish-kryeministër i Maqedonisë së Veriut. Jemi krenarë për rolin e shqiptarëve në

Maqedoninë e Veriut, të cilët janë një faktor i rëndësishëm stabiliteti, paqeje dhe orientimi euroatlantik në vend, ku theksuam nevojën e ruajtjes së përfaqësimit të drejtë e proporcional të shqiptarëve në shoqërinë dhe institucionet e RMV-së si dhe respektimin e arritjeve shumëplanëshe të tyre në funksion të një shoqërie multietnike e demokratike”, – u shpreh Kryetarja e Kuvendit në takimin me ta.

Me kryetarin e LSDM-së, z. Venko Filipçe, Kryetarja e Kuvendit diskutoi për marrëdhëniet mes dy vendeve, për partneritetin si anëtarë të NATO-s, për integrimin rajonal dhe përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të shqiptarëve në RMV. Znj. Spiropali vlerësoi përpjekjet e qeverisë së drejtuar nga LSDM-ja për progresin politik dhe ekonomik të RMV-së, për procesin e integritit evropian dhe përpjekjet për të krijuar një shoqëri funksionale demokratike multietnike.

Gjatë vizitës në Shkup znj. Spiropali u takua edhe me Kryeministrin Hristijan

Mickoski. Në bisedën me të Kryetarja e kryeparlamentarja shprehu vullnetin e Shqipërisë për zgjerimin e bashkëpunimit mes dy vendeve dhe kontributin e

përbashkët në nxitjen e bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar. “Vendet tona gjenden në zemër të Korridorit VIII, një projekt strategjik dhe një mekanizëm

bashkëpunimi, integrimi e sigurie në rajon e më gjerë dhe ne duhet ta shfrytëzojmë këtë avantazh. Dy vendet tona do të vijojnë të bashkëpunojmë për thellimin e reformave demokratizuese dhe integruese, për përafrimin e legjislacionit dhe të politikave me standardet e BE-së si dhe për perspektivën euroatlantike të Ballkanit Perëndimor. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut e meritojnë anëtarësimin në BE”, – i tha Kryetarja e Kuvendit z. Mickoski, të cilit i kërkoi që në Maqedoninë e Veriut të ruhet përfaqësimi i drejtë i shqiptarëve në institucione dhe guha shqipe.

Kryeministri Hristijan Mickoski vlerësoi bashkëpunimin dypalësh dhe progresin e dy vendeve në procesin e integritit europian. “Dy vendet tona e kanë merituar prej kohësh anëtarësimin në BE, sepse arritjet tona në plotësimin e standardeve europiane janë të dukshme dhe të prekshme”, – u shpreh ai.



### Nga deklarata e znj. Spiropali për mediet pas takimit me Kryetarin e Kuvendit të RMV-së

...Shqipëria nxit fort dhe pa asnjë mëdyshje perspektivën europiane të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Anëtarësimi në BE mbetet prioriteti ynë strategjik si në politikën e brendshme, ashtu dhe në politikën e jashtme. Modestisht, por dhe në të drejtën tonë, ne gjykojmë se BE-ja duhet të vazhdojë të ofrojë një rrugë të qartë dhe të arritshme anëtarësimi për dy vendet tona, por dhe për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Duke mbajtur një politikë të besueshme zgjerimi, BE-ja mund të stimulojë reformat dhe të nxisë një ndjenjë shprese dhe besimi. Është domosdoshme që BE-ja dhe vendet e Ballkanit Perëndimor të riafirmojnë angazhimet reciproke ndaj procesit të anëtarësimit. Në këtë kontekst, ne jemi të keqardhur për mosarritjen e plotësimin të angazhimit të ndërmarrë nga Republika e Maqedonisë së Veriut për ndryshimet kushtetuese.

Janë shprehëdhënëse mesazhet nga Brukseli gjatë takimit të Presidentes së Komisionit Europian, znj. Ursula fon der Lajn (Ursula von der Leyen), me liderët e Ballkanit Perëndimor se vendet e rajonit tonë i përkasin Europës dhe se Bashkimi Europian dhe Ballkani Perëndimor po i afrojnë ekonomitë dhe tregjet e tyre përmes planit të rritjes me gjashtë miliardë euro për rajonin. Natyrisht, jam e lumtur të nënvizoj rolin, vullnetin dhe angazhimin e faktorit shqiptar, tërësisht të orientuar në përmbyshjen e këtij detyrimi. Ne ndjekim me vëmendje zhvillimet në vendin tuaj, vend mik yni, si dhe rolin dhe kontributin e shqiptarëve si element shtetformues në këtë vend. Nuk ka qenë e lehtë, përkundrazi, por me një bashkëpunim strategjik klasa politike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht ndryshimeve mes vedit, pati vizionin dhe guximin të ndërmerre reforma mjaft të vështira e shpesh edhe të dhimbshme në funksion të anëtarësimit në BE dhe në NATO. Ne pranojmë me krenari se faktori shqiptar vazhdon të luajë një rol të qenësishëm në ruajtjen e stabilitetit të vendit. Faktori

shqiptar në Republikën e Maqedonisë së Veriut luan gjithashtu një rol vendimtar në marrëdhëniet mes dy vendeve. Ashtu si maqedonasit në Shqipëri, shqiptarët në Maqedoninë e Veriut janë një urë e fortë lidhëse miqësie dhe bashkëpunimi mes dy vendeve tona. Besoj se tashmë askush nuk ka mëdyshje ta pranojë këtë. Është e dukshme se nuk është më një aspiratë dhe mundësi, por një realitet i prekshëm gjeopolitik, që konfirmon se siguria e rajonit dhe e nesërmja e tij është e varur edhe nga faktori shqiptar. Ky faktor kombëtar dhe njerëzor, i shtrirë në tri shtete dhe në tri republika: në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut dhe në Shqipëri, me tre flamuj e simbole të ndryshme, pranon njëberësh simbolin e Europës së bashkuar dhe flamurin e saj. Në këtë frymë dhe në këtë filozofi, jam e sigurt se përfaqësimi i drejtë dhe proporcional i shqiptarëve në institucionet e vendit, bazuar edhe në këtë realitet gjeopolitik të rajonit dhe në interes të ndërsjellë, do të vijojë sipas standardeve bashkëkohore demokratike të një shoqërie multietnike. Ky është një nga kushtet që garanton përpjekjet për ndërtimin e një shoqërie funksionale multietnike të bazuar në zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit.

Njëllor siç jemi të interesuar, presim me besim dhe shpresojmë që të zbatohet plotësisht ligji për gjubët. Gjuba shqipe për ne shqiptarët është e shenjtë, pasi ajo ka të bëjë me thelbin e identitetit tonë. Cenimi i saj, në çdo formë qoftë, pa dyshim që dbemb shumë, sepse cenon pikërisht këtë identitet, që ne e ofrojmë në këtë botë të madhe, në rajon e përtej tij, si vlerën tonë.

Njohim dhe mirëkuptojmë plotësisht shqetësimin e faktorit shqiptar për mundësinë e ndryshimeve të mundshme, por, pavarësisht vendimit të pritshtëm të Gjykatës Kushtetuese, presim që trazime të tilla të kenë zgjidhje po sipas frymës që dikton Marrëveshja e Ohrit...

# Kryetarja e Kuvendit në Vatikan, pritet në audiencë nga Papa Françesku



**P**as vizitës në Shkup Kryetarja e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, shkoi për vizitë zyrtare në Vatikan. Gjatë vizitës ajo u prit në audiencë të veçantë nga Ati i Shenjtë, Papa Françesku, të cilin e falënderoi për kontributin në mbrojtjen e vlerave të humanizmit, solidaritetit, drejtësisë shoqërore e paqes dhe dashurinë që ka treguar për Shqipërinë. “Sot pata nderin e rrallë dhe kënaqësinë e jashtëzakonshme të pritem në audiencë të veçantë nga Ati i Shenjtë, Papa Françesku. Krahas mirënjohjes për këtë takim të paharruar i shpreha Shenjtërisë së Tij falënderimin e thellë për kontributin e paçmuar që ka dhënë në mbrojtjen dhe lartësimin e vlerave të humanizmit, solidaritetit, drejtësisë shoqërore e paqes, për dashurinë e tij për Shqipërinë, e cila i ka dhënë botës Shën Terezën, për lumnimin e 38 martirëve të Kishës Katolike Shqiptare, për kujdesin e

veçantë për besimtarët dhe bashkëjetesën e tolerancën fetare në vendin tonë, të cilën Ati i Shenjtë e ka cilësuar ‘një trashëgimi historike e njerëzimit’”, – shkroi kryeparlamentarja në një postim të saj në *Facebook*.

Në vijim të vizitës Kryetarja e Kuvendit mori pjesë në veprimtarinë e organizuar nga ambasada e Shqipërisë pranë Selisë së Shenjtë me rastin e 10-vjetorit të vizitës së Papa Françeskut në Tiranë. Në fjalën e saj të rastit znj. Spiropali tha se “Papa Françesku erdhi në Shqipëri për të bekuar popullin e vuajtur, por të mbijetuar, për të vlerësuar dialogun ndërmjet besimeve, për t’i dhënë shpresë e besim popullit shqiptar”. Në fund të veprimtarisë kulturore pjesëmarrësit ndoqën dokumentarin “Pritja” të regjisorit Roland Sejko.

Gjatë vizitës në Vatikan kryeparlamentarja vizitoi Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, ku ruhet “Meshari”

i Gjon Buzukut. “Në prag të Ditës së Alfabetit, në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, ku ruhet ‘Meshari’ i Gjon Buzukut, libri i parë në gjuhën tonë amtare, botim që është njëkohësisht produkt i Rilindjes Europiane. Një provë e lidhjeve mes kulturës shqiptare dhe kësaj epoke të viganëve të kulturës europiane, të atij kontributi që na vendos denjësisht mes popujve që i kanë dhënë kulturës botërore dhe njerëzimit”, – shkroi znj. Elisa Spiropali në postimin e saj.

Kryetarja e Kuvendit u takua edhe me kardinalin Ernest Simoni, i cili 28 vjet të jetës së tij i kaloi në burgjet komuniste. Edhe pse sot është një 96-vjeçar, ai vazhdon të jetë ende me mendje të kthjellët. “28 vjet në burgjet komuniste. Sot 96 vjeç. Me mendje të kthjellët dhe shpirt në paqe, kardinali Ernest Simoni është, siç e ka quajtur Papa Françesku, një martir i gjallë i besimit dhe lirisë”, – shkroi për të znj. Spiropali në *Facebook*-un e saj.

